

UNIVERSITETI I SHKODRËS
“Luigj Gurakuqi”

BULETIN SHKENCOR

Seria e shkencave shoqërore

Viti LXXI i botimit

Nr. 71

Shkodër, 2021

REDAKSIA

Kryeredaktor - Prof. dr. Artan HAXHI
Sekretar shkencor - Prof. dr. Alfred ÇAPALIKU
Anëtarë - Prof. dr. Nertila LJARJA,
prof. as. dr. Orjeta Baja, prof.as. dr. Arben Prendi
prof. as. dr. Nevila Dibra

DREJTOR I REVISTËS
Prof. dr. Suzana GOLEMI

Korrektori dhe punoi në kompjuter: Arta Bajrami

Pronë letrare e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Adresa e redaksisë: Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Redaksia e Buletinit Shkencor
Seria e Shkencave Shoqërore
Tel/fax: ++399 22 43747

PASQYRA E LËNDËS

- *Gjuhësi*

Bahri BECI

Rreth shkaqeve të formimit të bashkësisë gjuhësore ballkanike dhe rolit të shqipes në këtë proces

About the formation causes of the Balkan language community and the role of Albanian language in this process7

Jani THOMAI

Për nyjat e shqipes - semantikë gramatikore e semantikë leksikore

For Albanian nodes - grammatical semantics and lexical semantics.....25

Mimoza PRIKU

90 vjet nga botimi i një gramatike

90 years from the life of a grammar.....35

Tefë TOPALLI

Gjuha poetike në poezitë e Arben Prendit

Poetic language in the poems of Arben Prendit.....49

Artan HAXHI, Tefë TOPALLI

Terminologjia si sistem

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

The Terminology as a system

(Dictionary of linguistic terms).....81

Orjeta BAJA

Figurat e stilit

(Fjalor terminologjik shpjegues)

The figures of the style
(*Explanatory terminological dictionary*).....91

Anisa KOSTERI

Leksiku i Kuvendit të Arbënit nga Atë Vinçenc Malaj
The lexicon of the Assembly of Arbën from Father Vinçenc Malaj...101

Alva DANI

Përkthimi i “Fjalëve të papërkthyeshme” në Lahutën e Fishtës
Translation of “untranslatable words” in Lahuta e Malësisë by
Fishta.....109

Klotilda HARKA, Emrije KROSI & Shezai RROKAJ

Diskursi i gjuhës fishtiane në poezinë “Nji lule vjeshtet”
Fishta’s linguistic discourse in the poem “An Autumn Flower”.....119

Karmen LAZRI, Zamira SHKRELI

Ndihmesa e studiuesit Kolë Ashta për terminologjinë mbështetur mbi
fjalorin e Xhevat Lloshit
The contribution of the researcher K. Ashta for the terminology based on the
dictionary of Xh. Lloshi.....133

Evalda PACI

Historia e një libri përmes studimesh dhe arritjesh të reja kërkimi
The story of a book through new research studies and achievements... ..145

- *Letërsi*

Alfred ÇAPALIKU

Publicistika e Kolë Thaçit
Publishing work of Kolë Thaçi (45-54).....165

Gëzim PUKA

Prurje letrare e studimore nga shqiptarët përtej kufirit

Literary and study feed by albanians overseas.....175

- *Gjeografi*

Sokol AXHEMI

Gjeografia sociale dhe politikat sociale në kuadrin e pandemisë

Covid - 19 në Shqipëri

Social geography and social policies in the context of the Covid - 19 pandemic in

Albania.....185

- *Histori*

Alida AVDULLARI & Fatmira RAMAJ

Bashkëpunimi politik shqiptaro-jugosllav në vitet 1945-1948

Albanian-Yugoslav political cooperation during 1945-1948.....197

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

RECENSION

Mimoza PRIKU - Tomor Osmani “*Gramatika e gjuhës shqipe të traditës*”

(Refleksione), (Botime Shkodra, Shkodër, 2020, 296 f.)

“*Grammar of the Albanian language of tradition*”

(Reflections).....209

Bora LOGU - Një vështrim në kohë i kolanës “*Studime shqiptare*”,
1993-2020

A timely look at the set of works

" <i>Albanian Studies</i> "	213
Olimpia Kakarriqi - Bibliografi e antikuarit të bibliotekës së Universitetit "Luigj Gurakuqi", (1508 - 1944) Bibliography of antiques of the library of the University "Luigj Gurakuqi"	221

Nekrologji:

Njazi Kazazi (1948-2021).....	231
----------------------------------	-----

JETA SHKENCORE

I. Veprimtari shkencore <i>Scientific activity</i>	235
II. Gradat dhe titujt e fituar <i>Degrees and titles won</i>	244
III. Librat e botuar gjatë vitit 2020 <i>Books published during 2020</i>	245

Bahri BECI

**RRETH SHKAQEVE TË FORMIMIT TË
BASHKËSISË GJUHËSORE BALLKANIKE DHE
ROLIT E SHQIPES NË KËTË PROCES**

**I. Studiuesit e derisotshëm për shkaqet e formimit të bashkësisë
gjuhësore ballkanike**

**Studiuesit e huaj për shkaqet e formimit të
“bashkësisë gjuhësore ballkanike”**

Lidhur me shkaqet e formimit të bashkësisë gjuhësore ballkanike, janë
vërejtur teori ose qëndrime të ndryshme.

a. Teoria e ndikimit të substratit

Jernej Kopitar

J. Kopitar, në monografinë e tij të vitit 1829 “*Albanische, walachische und bulgarische Sprache*”, ka vënë re i pari ngjashmëritë gjuhësore ndërmjet shqipes, rumanishtes (vllahishtes) dhe bullgarishtes. Sipas tij “deri në kohën e sotme në veri të Danubit në Bukovinë, Moldavi dhe Vllahi, Transilvani, Hungari, si edhe në anën tjetër të Danubit në Bullgarinë e mirëfilltë, pastaj në të gjithë vargun e Alpeve të Ballkanit, në kuptimin e vjetër më të gjerë të këtij vargmali, nga njëri det në tjetrin, në vargmalet e Maqedonisë, në Pind dhe përmes Shqipërisë sundon *vetëm një formë gjuhësore*, por me tri lloje lënde gjuhësore (nga të cilat njëra është vendëse, ndërsa dy të tjerat kanë ardhur nga perëndimi dhe nga lindja)”¹.

Siç shihet, ka shkruar Sh. Demiraj, Kopitar-i ishte i mendimit që në shqipen, rumanishten dhe bullgarishten “sundon një formë gjuhësore, por me tri lloj lënde gjuhësore. Sado që në këtë mendim ka njëfarë teprie, sidomos kur është fjala për bullgarishten, e cila mbetet gjithnjë një gjuhë sllave jugore, prapë nuk mund të mos mbahet parasysh fakti që bullgarishtja dhe (sidomos) maqedonishtja i janë nënshtruar prej kohësh procesit të ballkanizimit, që i ka bërë ato të dallohen gjithnjë e më shumë

¹ J. Kopitar, *Albanische, walachische und bulgarische Sprache*. “Jahrbücher der Literatur”, 46, f. 59-106, Wien, 1829 (ribotuar në vëllimin II të veprave të tij më 1945 në Ljubljana).

nga gjuhët e tjera sllave, përfshirë këtu edhe serbokroatishtja”².

Zbërthimi i mëtejshëm i mendimit të B. J. Kopitar-it, ka shkruar R. Ismajli, do të tregonte se kjo *Sprachform njësore* e tri gjuhëve ballkanike buron nga dy gjuhë fqinjësore dhe të afërta midis tyre, përkatësisht nga *ilirishtja* dhe *trakishtja*³.

“J. Kopitar-i (...) formuloi parimin sipas të cilit gjithçka është e përbashkët midis shqipes e rumanishtes e nuk ka prejardhje latine, sllave etj., duhet të konsiderohet si e ardhur prej një idiome të lashtë ballkanike, u quajt ajo *ilire* a *trakase*”⁴.

Franz Miklosich

Sllavisti sloven Fr. Miklosich është i pari studiues që ka bërë kërkime më të detajuara për ngjashmëritë e gjuhëve ballkanike. Në veprën "Die slavischen Elemente im Rumunischen" të botuar më 1861 lidhur me burimin e dukurive gjuhësore të përbashkëta ballkanike Miklosich ka shkruar: “Jemi të bindur, se, nëse jo të gjitha afritë, shumica e tyre duhet të shihen si të dala nga elementi i vjetër autokton”⁵.

Pikëpamjen e Fr. Miklosich-it e ka mbështetur edhe H. Schuchard⁶. Edhe G. Weigand e kërkonte burimin e dukurive gjuhësore të përbashkëta ballkanike tek veprimi i substratit⁷.

Të tjerë për rolin e substratit

Sipas J. Feuillet në mungesë të dokumenteve të reja, të gjitha shpjegimet përmes substratit mbetën të pavërtetueshme”⁸.

Sipas tij “është arsyeshme të jemi mosbesues në lidhje me ndikimet e substratit dhe superstratit, aq më shumë kur gjuhët e zhdukura janë shumë pak të njohura. Në përgjithësi, konstatohet se substrati dhe superstrati mund të ndikojnë, ndonjëherë në mënyrë të konsiderueshme, leksikun - që është pjesa më e ‘depërtueshme’ e gjuhës, rrallë fonetikën (huazimi i një foneme të huaj nuk është i zakonshëm), në raste të jashtëzakonshme morfo-sintaksën”.

² Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 15-16.

³ R. Ismajli, *Miklosiçi si albanolog*, « Etni e modernitet », Pejë, 1994, f. 100.

⁴ R. Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë, 2015, f. 302.

⁵ Fr. Miklosich, *Die slavischen Elemente im Rumunischen*, “Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften”, Philos-hist. Classe XII, Wien, 1861, f. 49.

⁶ H. Schuchard, *Der Vokalismus des Vulgärlateins*, vol. 3, Leipzig, 1868, f. 49.

⁷ G. Weigand, *G. Ethnographie von Makedonien*, Leipzig, 1924, f. 58-67; *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?* « Balkan-Archiv », III, Leipzig, 1927, f. 11.

⁸ J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, “Cahiers Balkaniques”, nr. 10, Paris, 1986, f. 109.

“Siç është theksuar disa herë, ka shkruar J. Feuillet, përdorimi i substratit për të shpjeguar pajtueshmërinë është joshës. Kështu, gjuhëtarët rumunë A. Rosetti dhe C. Poghiric e kanë shpjeguar kalimin e *a-së* në *ă* në gjuhën rumune dhe shqipe me ndikimi i trakishtes. Për fat të keq, kjo është e pavërtetueshme për dy arsye: 1) e njohim shumë pak trakishten për të pohuar që ajo e kishte këtë dukuri; 2) është e pamundur të ndiqet gjeneza e kësaj dukurie, sepse dokumentet e shkruara janë shumë të vonë”⁹.

Edhe sipas Asenova-s teoria e substratit, mbetet gjithmonë një supozim, meqenëse ka shumë pak mbetje të gjuhëve indigjene për të gjykuar strukturat e tyre gramatikore. Në përgjithësi kjo teori i takon periudhës paraprake të gjuhësisë ballkanike - sot ajo është e braktisur¹⁰.

“Çështja e substratit, ka shkruar Sh. Demiraj, paraqit një varg vështirësish pothuaj të pakapërcyeshme. Në radhë të parë, do pasur parasysh se gjuha substrat që mendohet të ketë ndikuar në formimin e ballkanizmave, qoftë ajo ilirishtja, trakishtja apo ndonjë tjetër, është e panjohur për ne, kështu që sqarimi i një të panjohure me një tjetër të panjohur nuk sjell ndonjë dobi në këtë mes. Gjithashtu, mbrojtësit e hipotezës së substratit duhej të sqaronin se në cilën nga gjuhët e gjalla ka ndikuar më parë substrati i supozuar dhe si pastaj dukuria apo dukuritë gjuhësore të zhvilluara nën ndikimin e tij janë përhapur edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit. Veç kësaj, në bazë të një hipoteze të tillë, për sa i takon shqipes, e cila është vazhduesja e drejtpërdrejtë e një gjuhe të vjetër të Ballkanit, nuk mund të bëhet fjalë për ndikim të substratit, pasi hipoteza e substratit, siç e ka vënë në dukje Çabej, parakupton mbishtresimin e një gjuhe mbi një gjuhë tjetër që zhduket. Nga ana tjetër, mbrojtësit e kësaj hipoteze duhej të vërtetonin se dukuritë ballkanike, që ata përpiqen t'i shpjegojnë me ndikimin e substratit, kanë një zanafillë shumë të vjetër, që do të ngjitej deri në atë kohë kur gjuha substrat nuk ishte shuar ende”¹¹.

“Këmbëngulja te shpjegimi mbi bazë të një substrati gjithsesi të paspecificuar, sipas R. Ismajlit, mbetet e pakonkretizuar dhe më shumë një koncept kallauz, se një shpjegim real”¹².

b. Teoria e ndikimit “roman”

Në periudhën e dytë të gjuhësisë ballkanike doli një teori e re e shpjegimit

⁹ J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, “Cahiers Balkaniques”, nr. 10, Paris, 1986, f. 25.

¹⁰ P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, “Linguistique balkanique”, XII, 1, Sofija, 1979, f. 16.

¹¹ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 57.

¹² R. Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë, 2015, f. 374-375.

të dukurive të përbashkëta gjuhësore ballkanike.

Sipas kësaj teorie karakteristikat e përbashkëta të gjuhëve ballkanike shpjegoheshin me ndikimin e një gjuhe me prestigj politik e kulturor, si *greqishtja* dhe *latinishtja*.

G. Reichenkron i ka shpjeguar dukuritë e përbashkëta të gjuhëve ballkanike si rezultat i ndikimit roman, po pa nënvlerësuar ndikimin grek. Sipas tij latinishtja vulgare dhe gjuha e vjetër romane orientale së bashku me greqishten, të përhapura që nga epoka e Aleksandrit të Madh dhe trashëgimtarëve të tij, janë në bazën ose themelet e tipareve të përbashkëta të gjuhëve ballkanike¹³.

Edhe Zb. Gołab ka mbështetur tezën mbi origjinën romane ose greke të dukurive të përbashkëta ballkanike¹⁴.

Edhe H. Birnbaum e kërkonte burimin e ballkanizmave në latinishten. Sipas tij “Roli i latinishtes vulgare ka qenë i madh në lindjen e Sprachbundit ballkanik, më i rëndësishëm se i greqishtes, e cila sot është “*ndër gjuhët më periferike ballkanike*”¹⁵ (Birnbaum 1985: 80).

Me ndikimin e greqishtes bizantine dhe të latinishtes vulgare i kanë shpjeguar dukuritë e përbashkëta gjuhësore ballkanike edhe B. Havránek, J. Sedlaček, J. Kurzen, J. Šabršula¹⁶.

Lidhur me këtë tezë Sh. Demiraj ka shkruar “Disa gjuhëtarë kanë shprehur mendimin se disa ballkanizma, si prapavendosja e nyjës shquese, njësimi formal i rasave gjinore e dhanore, rimarrja e kundrinave me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë etj., janë formuar nën ndikimin e latinishtes”. Natyrisht, këtu është fjala për latinishten vulgare ballkanike. Kjo hipotezë gjen njëfarë mbështetjeje në faktin e njohur që sundimi i gjatë romak në Gadishullin Ballkanik ka lënë gjurmë të shumta në gjuhët e këtij Gadishulli. Madje, disa nga gjuhët e vjetra të Ballkanit u zhdukën nën trysninë e romanizimit, siç është rasti i gjuhës së dakëve që u romanizuan.

Edhe kundër kësaj hipoteze mund të bëhen po ato vërejtje kryesore që u parashtruan në lidhje me hipotezën e substratit, sidomos vërejtja lidhur me kronologjinë relative¹⁷. Veç këtyre, në këtë rast lind natyrshëm pyetja:

¹³ G. Reichenkron, *Der typus der Balkan-chprachen*, “Zeitschrift für Balkanologie”, nr. 1, Wiesbaden, 1962, f. 99, 105.

¹⁴ Zb. Gołab, *Ballkanisms in the South Slavic Languages*, “The Slavic and East European Journal”, VI, Madison, 1962, f. 138-142.

¹⁵ H. Birnbaum, *New approaches to Balkan linguistics*, “Zbornik u čast Petru Skoku”, JAZU, Zagreb, 1985, f. 80.

¹⁶ P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, “Linguistique balkanique”, XII, 1, Sofija, 1979, f. 17.

¹⁷ Këtu i referohet atyre që ka shkruar më sipër: “mbrojtësit e kësaj hipoteze duhej të vërtetonin se dukuritë ballkanike, që ata përpiqen t'i shpjegojnë me ndikimin e

Përse latinishtja vulgare ballkanike të ketë marrë një zhvillim të ndryshëm nga latinishtja vulgare e trevave të tjera të perandorisë romake? Si rrjedhim në këtë rast do të nxirrte krye përsëri çështja e ndikimit të substratit mbi latinishten e përhapur në trevat e Ballkanit¹⁸.

c. Teoria e ndikimit të gjuhëve sllave

Ballkanisti jugosllav M. Pavlović, i konsideronte gjuhët sllave jugore si pikënisjen e ballkanizmave, meqenëse ato zënë pjesët qendrore dhe më të mëdha të gadishullit dhe ata i janë mbivendosur substratit dhe reflektojnë tiparet e shtresave të ndryshme të tij.

Disa sllavistë si H. Birnbaum, A. Vraciu, J. Maslov, K. Mirčev, M. Pavlović, J. Sedlaček, I. Lekov pranojnë ekzistencën e ballkanizmave në gjuhën e parë letrare sllave, bullgarishten e vjetër. Të tjerë si Reichenkron, Birnbaum, Gołab mendojnë se është e vështirë të gjenden ballkanizma me origjinë sllave¹⁹.

d. Teoria e interferencës gjuhësore

Sipas V. Georgiev-it duket më reale të supozohet se "shkaku kryesor i vendosjes së një unioni gjuhësor është interferenca gjuhësore, përkatësisht format e ndryshme të bilinguizmit, për shkak të substratit, adstratit e superstratit, që shtrihet në tre mileniume"²⁰.

Edhe sipas J. Feuillet "Zgjidhja e vetme për problemin e zanafillës së bashkimit duhet të jetë, siç kanë theksuar disa linguistë, simbioza. Që gjuhë kaq të ndryshme gjenetikisht, siç janë gjuhët ballkanike, të kenë kaq shumë concordanca, duhet të kenë qenë në kontakt për një kohë të gjatë (...)" . Sipas tij "Është përzierja e popullsisë - e cila natyrshëm çon në përzierjen e gjuhëve - që shkakton një evolucion më të shpejtë"²¹.

e. Teoria e ndikimit të greqishtes

H. Pedersen është i pari që ka vënë re se, duke folur për dukuritë gjuhësore

substratit, kanë një zanafillë shumë të vjetër, që do të ngjitej deri në atë kohë kur gjuha substrat nuk ishte shuar ende" (Demiraj 1988: 57)

¹⁸ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 57

¹⁹ P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, "Linguistique balkanique", XII, 1, Sofija, 1979, f. 17.

²⁰ Vl. Georgiev, Vl. *Le probleme de l'Union linguistique balkanique*, "Actes du premier Congrès international des Etudes Balkaniques et sud-est europeennes", IV, Linguistique, Sofia 1968, f. 9, 14.

²¹ J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, "Cahiers Balkaniques", nr. 10, Paris, 1986, f. 26.

ballkanike, është lënë pas dore në përgjithësi superioriteti kulturor i grekëve në marrëdhëniet e tyre me popujt e tjerë të gadishullit. Sipas tij *humbja e infinitit*, për shembull, do të shpjegohej më tepër si një veçori e greqishtes që duhet të jetë përhapur në gjuhët e Ballkanit²².

Kr. Sandfeldi për rolin e greqishtes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike

Kr. Sandfeld i shpjegonte dukuritë e përbashkëta ballkanike me rolin e një gjuhe me prestigj politik e kulturor si greqishtja.

Sipas tij “e rëndësishme është se elementi grek ka mbijetuar në Ballkan që nga kohëra të lashta dhe (...) nuk ka pushuar të jetë bartës i një qytetërimi *më superior* se ai i fqinjëve. Ky qytetërim, qendra e të cilit ishte Bizanti, ka vepruar fuqimisht mbi popujt fqinjë, sidomos përmes organizimit të kishës greke, e cila deri në kohët moderne ka arritur që nga popullata kaq të ndryshme të Ballkanit të krijojë *një unitet të vetëdijshëm të krishterë (...)*²³.

Sipas tij numri i tipareve të përbashkëta për të gjitha gjuhët ballkanike është shumë i konsiderueshëm. “Që kjo është efekt i rastësisë, është e pamundur ta pranosh (...). Përgjashtuar prapavendosjen e nyjës shquese dhe të disa pikave të dyshimta, ne jemi përpjekur të tregojmë se në shumicën e rasteve këto janë veçori që zhvillohen në greqisht dhe që janë përhapur nga ajo në gjuhë të tjera (...).

Për ta shpjeguar këtë fakt, mjafton, sipas tij, t'i referohemi rolit që ka luajtur *qytetërimi bizantin* dhe veçanërisht ndikimit unifikues të *kishës greke*.

Fakti që *humbja e paskajores* është vërejtur vetëm në gjuhën greke, bullgare, rumune dhe vetëm në *jug të Shqipërisë* tregon, *vetëm ajo*, se “zhdukja e paskajores është një fenomen që është përhapur përmes gjuhëve në fjalë *nga jugu*, domethënë nga greqishtja (...). Ajo që është e mrekullueshme nuk është aq shumë zhdukja e paskajores, sesa fakti që të gjitha gjuhët në fjalë e kanë zëvendësuar atë pikërisht në të njëjtën mënyrë”²⁴.

Edhe e ardhmja e formuar me ndihmën e foljes “dua”, sipas Kr. Sandfeld, ka ardhur nga jugu. “Dominimi i kësaj të ardhmeje (formuar me foljen “kam” BB) në *shqipen veriore* dhe prania e saj në rumanishte tregon më shumë se çdo gjë se e ardhmja e formuar me ndihmën e foljes “dua”,

²² Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 164.

²³ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 17.

²⁴ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 175.

shkruante ai, ka ardhur nga jugu"²⁵.

Sipas tij ndikimi i greqishtes "është në shumicën e rasteve shpjegimi më i natyrshëm, ndonjëherë i vetmi i mundshëm"²⁶.

Të njëjtin mendim, po pak më të modifikuar dhe të nuancuar, kanë ndarë edhe M. Małecki, T. Capidan etj.²⁷

Sipas Sh. Demirajt "Mjaft gjuhëtarë, sidomos pas botimit të veprës së Sandfeldit, kanë mbrojtur tezën se në formimin dhe përhapjen e disa ballkanizmave një rol vendimtar ka luajtur greqishtja. Këtu është fjala vetëm për ata ballkanizma që ndeshen edhe në greqishte. Mbrojtësit e kësaj teze e argumentojnë këtë me faktin e njohur që greqishtja si gjuhë kulture dhe si gjuhë zyrtare e administratës bizantine dhe e kishës ortodokse ka ndikuar mjaft mbi gjuhët e tjera të Ballkanit. Në ndonjë rast ata e mbështesin më tej tezën e tyre me të dhënat e gjeografisë gjuhësore të ballkanizmave si edhe me faktin që ballkanizmat e greqishtes janë të dokumentuara më herët".

Por edhe këto argumente janë të diskutueshme. Kështu, ndikimi greqishtes mbi gjuhët e tjera të Ballkanit në përgjithësi është mbivlerësuar. Natyrisht, këtu është fjala për ndikimin mbi strukturën gramatikore. Të kihet parasysh edhe se ndikimet në këtë fushë jo vetëm që janë të jashtëzakonshme, por, edhe kur vërtetohen, kanë burim popullor. E greqishtja si gjuhë kulture ka qenë e panjohur për masat popullore të vendeve të tjera të Ballkanit. Edhe argumenti i gjeografisë gjuhësore të ballkanizmave duhet parë për secilin rast të veçantë. Përsa i takon dokumentimit më të hershëm të disa ballkanizmave në greqishte, kjo shpjegohet me faktin e njohur që greqishtja ka një dokumentim shkrimor pothuaj të pandërprerë që nga kohët e lashta. Por ky argument do të kishte vlerë, sikur edhe gjuhët e tjera të Ballkanit të kishin një dokumentim të hershëm shkrimor. Mirëpo dy gjuhë ballkanike, siç janë shqipja dhe rumanishtja, për arsyet e njohura historike, kanë nisur të lëvrohen me shkrim relativisht vonë. Gjithsesi, dokumentimi shkrimor i tyre nuk e kapërcen shekullin XVI, kurse ballkanizmat në këto dy gjuhë janë pa dyshim më të hershëm²⁸.

Edhe më 1994 Demiraj ka shkruar "Një pjesë e mirë gjuhëtarësh kanë vazhduar ta kërkojnë burimin e ballkanizmave, që dëshmohen edhe në greqishte, pikërisht në këtë gjuhë, që ka një dokumentim të hershëm dhe të

²⁵ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 185.

²⁶ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 165.

²⁷ P. Asenova, *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, "Linguistique balkanique", XII, 1, Sofija, 1979, f. 16.

²⁸ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 57-58.

pandërprerë dhe që, si gjuhë kulturore dhe si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine dhe e kishës ortodokse, duhet të ketë ushtruar ndikim mbi gjuhët e tjera fqinje. Por ithtarët e kësaj hipoteze nuk kanë mundur të shpjegojnë faktorin a faktorët, që i kanë dhënë shkas shfaqjes së këtyre ballkanizmave në vetë gjuhën greke. Kështu p.sh. zëvendësimi i paskajores nëpërmjet mënyrës lidhore në një gjuhë kulturore si greqishtja del si një dukuri e papritur. Madje, mund të shkohet edhe më tutje duke pranuar mendimin e Soltas që greqishtja "qysh nga fundi i periudhës antike ka ardhur duke u ballkanizuar gjithnjë e më shumë"²⁹.

Studiuesit shqiptarë për shkaqet e formimit të "bashkësisë gjuhësore ballkanike"

E. Çabej për shkaqet e formimit të "bashkësisë gjuhësore ballkanike"

Lidhur me shkaqet e formimit të "bashkësisë gjuhësore ballkanike" E. Çabej ka shkruar: "Si kudo në proceset gjuhësore, edhe në afrinë e gjuhëve ballkanike kanë ndihmuar disa rrethana të caktuara të rendit historik e gjeografik.

Në pikëpamje historike, përhapja e Ilirëve nga perëndimi gjer në lindje të Gadishullit dhe përhapja e Trakasve nga lindja gjer në perëndim pat sjellë qysh në kohët e lashta të antikitetit një *rrafshim të ndryshimeve nacionale*. Këtë proces njësimit e plotësoi më vonë shtrirja e kulturës dhe e gjuhës greke nëpër gjithë bregdetet e në pjesën jugore të kësaj treve; duke nisur sidomos që nga sundimi i Aleksandërit të Madh, me të cilin nisi epoka e helenizmit. Po që sidomos *sundimi romak* me përhapjen e latinishtes si gjuhë zyrtare të perandorisë që solli një nivelim të përgjithshëm dhe në këto anë, e zhduku shumicën e diferencimeve etnike. Në kohë të mesme ka ndihmuar në formim të njësisë ballkanike sundimi i gjatë i Bizantit me kulturën e tij gjysmëorientale e me gjuhën e kishën greke, që u përhap në më të madhen pjesë të Gadishullit. Edhe vendosja e Sllavëve e më vonë dyndja e Osmanëve shtuan me përhapjen e tyre disa karaktere të përbashkëta të popujve ballkanikë e të gjuhëve të tyre.

Në formimin e njësisë ballkanike rëndësi vendimtare kanë pasur dhe rrethanat gjeografike, të cilat gjer në një farë mase kanë përcaktuar dhe ngjarjet e historisë. Në këtë zonë janë rrasur qëmoti një tok gjuhësh në një territor relativisht të ngushtë. Kjo rrethanë bëri që marrëdhëniet në mes të këtyre u zhvilluan në një mënyrë intensive³⁰.

²⁹ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 21.

³⁰ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*, "Studime Gjuhësore", III, Prishtinë, 1976, f. 79. Botuar në Tiranë si dispensë më 1957 dhe ribotuar më 1959, 1960, 1963, 1970, 1976.

Sh. Demiraj për shkaqet e formimit të “bashkësisë gjuhësore ballkanike”

Sh. Demiraj ka pranuar që “Marrëdhëniet shumëshekullore ndërmjet popujve të Gadishullit Ballkanik kanë bërë që në gjuhët e tyre të zhvillohen e të përhapen disa fakte e dukuri gjuhësore të përbashkëta, që njihen me termin *ballkanizma*. Këtu është fjala për disa *bashkëpërkime* dhe *paralelizma*, që janë përftuar gjatë evolucionit historik të gjuhëve ballkanike (...).

Ballkanizmat nuk kanë të njëjtën përhapje në gjuhët e Gadishullit Ballkanik. Ato ndeshen më fort në shqipe, rumanishte, maqedonishte, bullgarishte dhe greqishte, që për këtë arsye janë quajtur edhe gjuhë ballkanike. Në serbokroatishte ballkanizmat janë më të pakta për nga numri dhe më të kufizuara për nga shtrirja gjeografike.

Ballkanizmat, në kuptimin e ngushtë të kësaj fjale, ndeshen më fort në strukturën gramatikore. Ballkanizmat kryesore janë:

1) prapavendosja e nyjës shquese në shqipe, rumanishte dhe bullgarishte e maqedonishte;

2) formimi i kohës së ardhme me ndihmën e foljes “dua” (të ngurosur, përkatësisht të pangurosur) në shqipe, greqishte, bullgarishte, maqedonishte, rumanishte dhe serbokroatishte;

3) njësimi formal i rasave gjinore e dhanore në shqipe, rumanishte dhe greqishte;

4) zëvendësimi i paskajores nga lidhorja në greqishte, bullgarishte, maqedonishte, rumanishte, shqipe e pjesërisht edhe në serbokroatishte;

5) rimarrja e kundrinave me anë të formave të patheksuara të përemrave vetorë në shqipe, rumanishte, maqedonishte, bullgarishte dhe greqishte. Ballkanizma ndeshen edhe në fjalor edhe në shprehje frazeologjike³¹.

Pra, nga sa më sipër, mund të thuhet që Sh. Demiraj, pranon në fakt një proces ballkanizimi të kësaj ose asaj gjuhe. Kjo del edhe nga sa ka shkruar, për shembull, kur ka komentuar përfundimet e J. Kopitarit, mbi karakterin ballkanik të *shqipes*, *rumanishtes* dhe *bullgarishtes*. Ndër të tjera atje ka shkruar” kur është fjala për bullgarishten, e cila mbetet gjithnjë një gjuhë sllave jugore, prapë nuk mund të mos mbahet parasysh fakti që *bullgarishtja* dhe (sidomos) *maqedonishtja* i janë nënshtruar prej kohësh *procesit të ballkanizimit*, që i ka bërë ato të dallohen gjithnjë e më shumë nga gjuhët e tjera sllave”. Mirëpo kur trajton tiparet ballkanike si të tilla, ai i vështron ato si zhvillime paralele ose si zhvillime të pavarura në

³¹ Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f.55-56.

secilën nga këto gjuhë³².

II. Rreth rolit të shqipes në formimin e “bashkësisë gjuhësore ballkanike”

Studiuesit e huaj për rolin e shqipes në formimin e “bashkësisë gjuhësore ballkanike”

Lidhur me qëndrimin e studiuesve të huaj për rolin e shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike janë vënë re dy qëndrime kontradiktore.

Periudha deri në vitin 1930

Në një periudhë të parë të studimeve ballkanike pranohej roli përcaktues i ilirishtes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Në veprën “Die slavischen Elemente im Rumunischen” të botuar më 1861 Miklosichi shkruante: “Jemi të bindur, se, nëse jo të gjitha afritë, *shumica e tyre* duhet të shihen si të dala nga elementi i vjetër autokton. Besojmë se ai element do të ketë qenë *i njëjtë* me atë prej nga ka dalë *shqipja e sotme*, që, sipas mendimit tonë, është pasardhëse e ilirishtes³³.

Siç ka theksuar R. Ismajli, Fran Miklosich-i që i pari të shihte në shqipen *çelësin* për sqarimin e shumë fenomeneve ballkanike. “Meqenëse bërthamën e interesimit të tij e përbënte substrati, në shqipen ai shihte një gjuhë që jep ndihmë vendimtare për përcaktimin e natyrës së tij. Në kundërshtim me shumë substratistë dhe ballkanologë të mëvonë, Miklosich-i ishte krejtësisht i paanshëm dhe kurrë nuk iu shtrua politizimit të problematikës³⁴.

Fran Miklosich-i, pra, e shihte shqipen si *çelës* për sqarimin e shumë fenomeneve ballkanike.

Pikëpamjen e Fr. Miklosich-it e ka mbështetur edhe H. Schuchard, po ai e konsideronte shqipen si vazhduese të trakishtes³⁵.

Edhe G. Weigand e kërkonte burimin e dukurive gjuhësore të përbashkëta ballkanike tek veprimi i substratit të përbashkët trako-shqiptar, duke e konsideruar shqipen, në ndryshim nga Fr. Miklosich, si vazhduesen e trakishtes³⁶.

³² Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, f. 59 - 66; *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994, f. 15-25.

³³ Fr. Miklosich, *Die slavischen Elemente im Rumunischen*, “Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften”, Philos-hist. Classe XII, Wien, 1861, f. 8.

³⁴ R. Ismajli, *Miklosiçi si albanolog*, “Etni e modernitet”, Pejë, 1994, f. 109-110.

³⁵ H. Schuchard, *Der Vokalismus des Vulgärlateins*, vol. 3, Leipzig, 1868, f. 49.

³⁶ G. Weigand, *G. Ethnographie von Makedonien*, Leipzig 1924, f. 58-67; *Sind die Albaner*

Periudha pas vitit 1930

Në një periudhë të dytë të gjuhësisë ballkanike ka mbizotëruar pikëpamja që e mohonte mundësinë e rolit të shqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Lidhur me këtë problem Kr. Sandfeld-it ka shkruar: “është e paimagjinueshme që një gjuhë *kulture* si greqishtja të këtë mundur të pësojë (...) ndikimin e një gjuhe *barbare* që nuk mbështetet në asnjë autoritet politik (...)»; “(...) gjurmët e ndikimit të shqipes në greqishte, sipas tij, janë *shumë të pakta* dhe të vërtetuara deri tani vetëm në *fushën e leksikut*”³⁷.

Edhe J. Feuillet, duke folur për origjinën e zhdukjes së paskajores në gjuhët ballkanike, në pajtim me Kr. Sandfeld, ka shkruar se «për sa i përket shqipes, që ka ndikuar *shumë pak* në gjuhët e tjera ballkanike, është krejt e pamundur të jetë në *origjinën* e këtij fenomeni ».

Edhe duke folur për origjinën e formimit të numrave 11-19, J. Feuillet ka shkruar: “Sa për gjuhën shqipe, e cili ka ushtruar *shumë pak* ndikim mbi gjuhët e tjera të Ballkanit, është *shumë pak e mundshme* të jetë në bazën e këtij fenomeni”³⁸.

Sipas R. G. Solta-s “ideja e Sandfeld-it që greqishtja ka mbartur peshën kryesore për burimin e ballkanizmave *nuk mund të pranohet*. Përkundrazi qysh nga fundi i antikitetit greqishtja ka ardhur *duke u ballkanizuar* gjithnjë e më shumë. Gjuhë *vendimtare* e ballkaneve duhet të jetë pikërisht *shqipja*, pranë së cilës mund të vendosen rumanishtja dhe bullgarishtja”³⁹.

Edhe W. Schaller i ka klasifikuar gjuhët ballkanike në gjuhë ballkanike të shkallës *së parë* (*shqipja, bullgarishtja, maqedonishtja dhe rumanishtja*), të shkallës *së dytë* (*greqishtja, serbo-kroatishtja*) dhe të shkallës *së tretë* (*turqishtja, sllovenishtja dhe hungarishtja*). Origjina e ballkanizmave, sipas tij, duhet kërkuar në gjuhët e shkallës *së parë*. Gjuhët e shkallës *së dytë* “për sa i përket ballkanizmave të tyre, nuk janë gjë tjetër veçse *rezultat* i rrezatimeve të dukurive gjuhësore që vinë nga gjuhët ballkanike të shkallës *parë*”⁴⁰.

die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker? “Balkan-Archiv”, III, Leipzig 1927, f. 11.

³⁷ Kr. Sandfeld, *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930, f. 177-178.

³⁸ J. Feuillet, *La linguistique balkanique*, “Cahiers Balkaniques”, nr. 10, Paris, 1986, f. 112.

³⁹ G. R. Solta, *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Darmstadt, 1980, f. 233.

⁴⁰ H.W. Schaller, *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkan philologie*, Heidelberg, 1975, f. 77.

Studiuesit shqiptarë për rolin e shqipes në formimin e “bashkësisë gjuhësore ballkanike”

Eqrem Çabej

Roli i shqipes a i parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike nuk ka qenë objekt i drejtpërdrejtë i studiuesve shqiptarë.

Vetëm E. Çabej e ka trajtuar këtë problematikë fillimisht në librin e tij “Hyrje në historinë e shqipes. Fonetika historike”⁴¹. Në kapitullin “Elemente të shqipes në gjuhët e tjera të Ballkanit” të kësaj vepre ai ka trajtuar: *bazat historike e kulturore për këtë ndikim; elementet shqipe në greqishten e re, në dialektet e saj veriore e në argotë; elementet shqipe në gjuhët sllave jugore, në dialektet dhe argotë e tyre; disa elemente të shqipes në turqishten,* duke u përqendruar pothuajse tërësisht në huazimet leksikore⁴².

Gjithsesi sipas E. Çabejt “Bazat historike e kulturore për një të tillë ndikim nga ana e shqipes nuk mungojnë. Shqiptarët kanë ruajtur *kulturën e vjetër* të Ballkanit më mirë nga çdo tjetër popull i kësaj zone. Ata me mënyrën e jetesës e me zakonet që kanë ditur të mbajnë nëpër shekuj janë përfaqësonjësit e një *tipi etnografik të veçantë* në rrethin e popujve ballkanikë. Nga ky origjinalitet i disa anëve të jetës shqiptare kuptohet mirëfilli pse disa nga elementet e kësaj kanë depërtuar te popujt fqinj. Ndër këto ka elemente si të kulturës materiale si të jetës shpirtërore. Nga ato të parat hyjnë këtu disa *vegla shtëpiake* e sidomos disa *elemente të kostumeve*. Në lëmin e jetës shpirtërore vihet re një ndikim në popujt fqinj në *pushë të muzikës* e të *valleve popullore*. Grekët e Epirit këndojnë këngët e tyre me melodi labërishte, Arumunët e Toskërisë (Frëshërotët) i këndojnë të vetat në mënyrë të këngës toskërishte (kolonjarçe etj). Ata Serbë që janë fqinj të Shqiptarëve kanë marrë prej këtyre meloditë e këngëve malsorçe. Edhe doke e zakone shqiptare kanë kaluar te këta popuj. Kështu pra Shqiptarët kanë qenë edhe dhënë ndaj fqinjve të tyre. Kjo është një gjë me rëndësi për etnografinë e Gadishullit Ballkanik, që gjer më sot nuk është gjurmuar sa duhet.

Nga të tilla marrëdhënie në jetën materiale e mendore kuptohen edhe ndikimet gjuhësore, të cilat nuk janë veçse një refleks i atyre, e duhet të vlerësohen si një pasqyrë e ndikimit kulturor. Këto bëhen edhe më të kuptueshme, kur të kemi parasysh që shqipja është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit me një vend të rëndësishëm midis gjuhëve fqinje.

⁴¹ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*, “Studime Gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 1-149.

⁴² E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*, “Studime Gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 71.

Nga sfera sociale le të përmendim që fjala *besa* ka hyrë pothuajse në gjithë gjuhët ballkanike, duke përfshirë dhe turqishten.

Në kulturën materiale gjurmët e shqipes shihen sidomos në fushë të jetës baritore e të blegtorisë. Kjo ka qenë si të thuash mjeshhtëria nationale e Shqiptarëve gjatë shekujve. Në kronikat bizantine e në dokumentet historike të Serbisë mesjetare Shqiptarët na dalin kudo si barinj e stanarë, shpeshherë së bashku me Vlleh. Një anonim, nga sa duket, domenikan frëng, që në vitin 1308 bëri një udhëtim nëpër Europën Lindore, përshkrimin e të cilit e ka botuar historiani polak O. Gorka me titullin “*Anonymi descriptio Europae orientalis*” thotë për Shqipërinë: “*Terra est fertilis in carnibus, caseis et lacte, in pane et in vino non multum abundans*”.

Dhe vazhdon me parashtrimin e huazimeve leksikore në greqishten e re, në gjuhët sllave dhe në turqishten⁴³.

Më 1970 ka botuar një artikull tjetër me titull “Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike”.

Në këtë artikull fillimisht evidentohen disa përkime a analogji midis shqipes dhe gjuhëve të lashta jo greke të Ballkanit, si mesapishtja, ilirishtja ballkanike, dakishtja dhe trakishtja.

Duke i shikuar përkimet (analogjitë) e çekura shkurt këtu, në tërësinë e tyre, shkruante E. Çabej, ato, në lidhje edhe me disa të tjera, na tregojnë që mbeturinat e gjuhëve dhe të dialekteve ballkanike të moçme që përfshihen me emrat ilirishtja dhe trakishtja, na shfaqen në shqipen e sotme pjesërisht në një mënyrë të tillë, që shihet se kemi të bëjmë më fort me një lidhje gjenetike sesa me një huazim nga ana e kësaj gjuhe prej atyre gjuhëve. Në këtë vështrim dëshmojnë edhe disa elemente jo greke në greqishten e vjetër dhe jolatine në latinishten, të cilat plotësojnë materialin gjuhësor të mësipërm, elemente që duket se janë të një burimi ballkanik të vjetër dhe që njëkohësisht sqarohen me anë të shqipes. Po kjo gjë vlen edhe për ato fjalë relikte (mbeturina) të atyre viseve të Gadishullit Ballkanik e të Gadishullit Apenin, ku dikur është folur trakisht ose ilirisht ose ndonjë idiomë e afër me ato gjuhë, fjalë relikte, të cilat edhe këto pjesërisht na dalin në gjuhën shqipe⁴⁴.

Pastaj parashtron ndikimet leksikore të shqipes në gjuhët ballkanike. “Në marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje, shkruan Çabej, është e vërtetë që roli dhënës i saj është më i pakët se roli marrës, po megjithatë edhe ai

⁴³ E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*, “Studime Gjuhësore”, III, Prishtinë, 1976, f. 71-78.

⁴⁴ E. Çabej, *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1977, f. 336.

është me rëndësi jo vetëm në vetvete, po edhe sepse ka lidhje me disa nga problemet me të cilat ka kohë që merret ballkanistika. Ky ndikim gjuhësor shkon dorë më dorë me një ndikesë në fushën etnografike, në mënyrë që disa dukuri të formave të jetës shqiptare, për arsye sociale dhe, nga sa duket, edhe për punë të karakterit të veçantë që kanë, kanë depërtuar te popujt fqinj (...).

Dihet mirëfilli që ndikimi etnografik e social ka sjellë me vete dhe ndikimin gjuhësor, që pra bashkë me elementet e kulturës materiale e shpirtërore kanë shtegtuar dhe emërtimet e tyre, sepse pas fjalëve fshihen realitetet konkrete.

Elementin shqiptar në leksikun e greqishtes së re, që nga Gustav Meyeri e këtej, e çmojnë me afërsisht gjashtëdhjetë fjalë, nga të cilat një pjesë është e mbarë greqishtes, një pjesë është e kufizuar në dialektet veriake të saj. Për mendimin tonë ai është mjaft më i madh në të dyja grupet, sidomos në këtë të dytin. (...). Një fushë e veçantë ku është shtrirë ndikimi i shqipes, janë gjuhët e fshehta dhe të zejtarëve, sidomos të krahinave veriore të Greqisë (...).

Ndikimi i shqipes, ashtu si në greqishten e re, edhe në gjuhët sllave jugore serbokroatisht e bullgarisht përfshin më fort sferën materiale se mendoren, në radhë të parë, jetën baritore dhe blegtorinë, jetën shtëpiake dhe shtazët shtëpiake, emra shtazësh e bimësh, sidomos emra drurësh. Si atje, edhe këtu ky ndikim ka rrokur edhe gjuhët e fshehta. Dhe si atje, edhe këtu mund të dallojmë dy grupe huazimesh. Njeri nga këta përfshin elemente të mbarë gjuhës, tjetri, ky shumë më i madh se ai, rrok elemente dialektore, të kufizuara në viset përreth, si Bosnjën, Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë jugore e Maqedoninë⁴⁵.

Sipas E. Çabejt “bash disa nga çështjet kryesore të filologjisë ballkanike lidhen me problemet e gjuhës shqipe e të historisë së saj. Vetë nga kjo gjë, dijes i del në të ardhmen detyra që të afrojmë këtë gjuhë, më shumë se sa ka bërë gjer më sot, në fushën e kërkimeve krahasimtare. Në pikëpamje metodike na del detyra që çështjet shkencore t'i shikojmë në një mënyrë më tërësore, sidomos të shtiem në punë *përfundimet* e historisë e të arkeologjisë prehistorike për studimet gjuhësore”⁴⁶.

⁴⁵ E. Çabej, *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1977, f. 335-344.

⁴⁶ E. Çabej, *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, “Studime gjuhësore”, IV, Prishtinë, 1977, f. 346.

Mahir Domi

Sipas M. Domit “Shqipja është karakterizuar shpesh, dhe për një kohë të gjatë, si gjuhë "par excellence Ballkanike". Elementet e saj të përbashkëta me gjuhët e tjera të Ballkanit kanë filluar të vihen në dukje nga shumë autorë që nga fillimi i studimeve të para për gjuhët e Gadishullit Ballkanik dhe marrëdhëniet midis tyre (...).

Një vend qendror iu dha shqipes në studimin e parë përgjithësues për dukuritë dhe tiparet e përbashkëta gjuhësore ballkanike nga F. Miklosich (*Die slavischen Elemente im Rumunischen*, 1861) dhe në shumë studime të mëvonshme në këtë fushë nga G Weigand, Kr. Sandfeld dhe të tjerët.

Shqipja merr pjesë në të gjitha këto fenomene të quajtura "balkanizma" dhe ka elemente të rëndësishme të përbashkëta sidomos me rumanishten, shumë konkordanca dhe paralelizma me gjuhët e tjera të Ballkanit, si greqishtja, maqedonishtja, bullgarishtja, madje edhe me Serbo-kroatishten.

Mund të pohohet se “asnjë gjuhë tjetër nuk karakterizohet nga *kaq tipare të përbashkëta ballkanike* dhe nga *raporte kaq të shumta dhe të ndryshme* me gjuhët e tjera të Gadishullit sa shqipja”.

Vlen të përmendet fakti karakteristik që më shumë se një herë fenomenet gjuhësore ballkanike në shqip kanë marrë një karakter më të përgjithësuar ose më të plotë, proceset kanë shkuar më larg ose kanë marrë forma më të qarta ose më unitare se shumë gjuhë të tjera” dhe sjell si ilustrim përdorimin e nyjës së prapme dhe të përparme, formimin e së ardhmes me “do”, zëvendësimin e paskajores me lidhoren.

“Ky karakter i dukshëm "ballkanik" i shqipes dhe marrëdhëniet e saj të ndryshme me gjuhët e Gadishullit janë të kuptueshme, nëse shikojmë faktorët historikë dhe gjeografikë.

Ja pse shqipja ka një rëndësi të veçantë për studimin e "bashkimit gjuhësor të Ballkanit". Njohja më e hollësishme dhe e detajuar e fakteve të saj, ballafaqimi i përpiktë i tyre me faktet përkatëse të gjuhëve të tjera mund të kontribuojë në një sqarim më të mirë të problemit të përgjithshëm të Ballkanistikës dhe të hedhë dritë edhe mbi më shumë se një çështje të strukturës dhe të historisë së gjuhëve të tjera të Ballkanit”⁴⁷.

⁴⁷ M. Domi, *Considérations sur les traits communs ou paraleles de l'albanais avec les autres langues balkaniques et sur leur études*, Corapport lu au III^e Congrès International des Études du Sud-Est européen à Bucarest (4-10 septembre 1974), Bucarest, 1975, f. 81.

Rexhep Ismajli

Lidhur me rolin e shqipes a të parashqipes në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike R. Ismajli ka shkruar: “Në të gjitha vështrimet e deritashme ballkanistike/ ballkanologjike është vënë në pah shumë qartë se *gjuha shqipe* dhe *"bota shqiptare"* përbëjnë një nga segmentet më të rëndësishme të këtyre studimeve. Doajeni i studimeve krahasimtare, por edhe ballkanike, Eric P. Hamp, më 1978 pati thënë: *"gjuha shqipe është thelbi i studimeve ballkanistike"*.

Studiues të mëhershëm, themelues të ballkanistikës, si G. Weigand, e vendosnin shqipen po ashtu në zemër të ballkanistikës.

Studimet si ai i Juoko Lindstedt e kanë treguar shqipen praktikisht pjesëmarrëse në një mënyrë a në një tjetër në të gjitha tiparet karakteristike për Sprachbundin ballkanik: nyja e prapavendosur, dyfishimi i objektit, përdorimi i parafjalëve në vend të rasave, shkrirja dativ / gjenitiv, shkrirja qëllim/lokacion, relativum generale, pastaj folje ndihmëse + folje e mbaruar, futuri *volo*, futuri i shkruar si kushtore, perfekti *habere*, evidencialët, krahasimi analitik etj. Sipas këtyre tipareve, indeksimi i gjuhëve të Ballkanit jepte këtë pasqyrë: printe sllavishtja ballkanike me indeksin 11.5 (brenda saj maqedonishtja me 12.0), shqipja me 10.5, rumanishtja e Ballkanit dhe greqishtja me 9.5, romishtja me 7.5, çka vetëm pjesërisht pajtohet me përndarjet më fine që në qendër shohin shqipen, bullgarishten-maqedonishten, arumanishten, torllakishten, ndërsa në një radhë të dytë greqishten, rumanishten e të tjerat. Por shqipja ka një pozitë të veçantë ndaj ballkanizmave, qoftë të konceptuar si të trashëguar, apo si *contact induced*. Nëse marrim strukturën fonetike, shqipja në gjendjen aktuale, ndryshe nga gjuhët ballkanike, ka zanore hundore në njërin prej kryedialekteve të saj, ka gjatësi zanoresh me vlerë funksionale po në atë dialekt (këtë e ka pasur më herët në tërësi), e ka në përdorim paskajoren, pos futurit me *do* ka edhe futur me *kam*, e ka të zhvilluar sistemin e habitores. Ka gjithandej ndërlihdje areale me gjuhët e tjera ballkanike, por edhe diferencime brenda saj, një situatë vërtet dinamike të përfshirjes në/apo të daljes nga Sprachbundi gjithë duke qenë në qendrën e tij gjeografike”⁴⁸ (Ismajli 2015: 18-19).

⁴⁸ R. Ismajli, *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë, 2015, f. 18-19.

BIBLIOGRAFI:

- Asenova, P., *Aperçu historique des études dans le domaine de la linguistique balkanique*, "Linguistique balkanique", XII, 1, Sofija, 1979.
- Birnbaum, H., *New approaches to Balkan linguistics*, "Zbornik u čast Petru Skoku", JAZU, Zagreb, 1985.
- Çabej, E., *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike*, "Studime Gjuhësore", III, Prishtinë, 1976.
- Çabej, E., *Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike*, "Studime gjuhësore", IV, Prishtinë, 1977.
- Demiraj, Sh., *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë 1988.
- Demiraj, Sh., *Gjuhësi ballkanike*, Shkup 1994.
- Domi, M., *Considérations sur les traits communs ou paraleles de l'albanais avec les autres langues balkaniques et sur leur études*, Corapport lu au III^e Congrès International des Études du Sud-Ést européen à Bucarest (4-10 septembre 1974), Bucarest 1975.
- Feuillet, J., *La linguistique balkanique*, "Cahiers Balkaniques", nr. 10, Paris 1986.
- Georgiev, Vl. *Le problème de l'Union linguistique balkanique*, "Actes du premier Congrès international des Etudes Balkaniques et sud-est européennes", IV, Linguistique, Sofia, 1968.
- Gołab, Zb., *Ballkanisms in the South Slavic Languages*, "The Slavic and East European Journal", VI, Madison, 1962.
- Ismajli, R., *Miklosiçi si albanolog*, «Etni e modernitet», Pejë, 1994.
- Ismajli, R., *Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik*, Prishtinë, 2015.
- Kopitar, J., *Albanische, walachische und bulgarische Sprache*. "Jahrbücher der Literatur", 46, Wien, 1829 (ribotuar në vëllimin II të veprave të tij më 1945 në Ljubljana).
- Miklosich, Fr., *Die slavischen Elemente im Rumunischen*, "Denkschriften der Kaiserlichen Akademie der Wissenschaften", Philos-hist. Classe XII, Wien, 1861.
- Reichenkron, G., *Der typus der Balkan-chprachen*, "Zeitschrift für Balkanologie", nr. 1, Wiesbaden, 1962.
- Sandfeld, Kr. *Linguistique balkanique. Problèmes et résultats*, Paris, 1930.
- Schuchard, H., *Der Vokalismus des Vulgärlateins*, vol. 3, Leipzig, 1868.
- Schaller, H.W., *Die Balkansprachen. Eine Einführung in die Balkan philologie*, Heidelberg, 1975.
- Solta, G. R., *Einführung in die Balkanlinguistik mit besonderer Berücksichtigung des Substrats und des Balkanlateinischen*, Dermstadt, 1980.
- Weigand, G., *Ethnographie von Makedonien*, Leipzig 1924; *Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Thraker?* "Balkan-Archiv", III, Leipzig, 1927.

**About the formation causes of the Balkan language community
and the role of Albanian language in this process**

ABSTRACT

The first part of the article presents the views of foreign and Albanian scholars on the reasons for the formation of the "Balkan language community".

In the article there are treated the theory of the influence of the substratum (Jernej Kopitar, Franz Miklosich, others on the role of the substratum), the theory of the roman influence, the theory of the influence of Slavic languages, the theory of linguistic interference and the theory of the influence of Greek. A special place is devoted to the views of Kr. Sandfeld on the Greek role of $\epsilon\phi$ in the formation of the Balkan language community.

Regarding to the views of foreign scholars on the role of Albanian language in the formation of the Balkan language community, there have been noted two contradictory views.

In a first period (until 1930) the defining role of Illyrian and pre-Albanian in the formation of the Balkan linguistic community was accepted (Miklosich, Weigand), while in a second period (after 1930) there was noted the view that denied the possibility of the role of Albanian in the formation of the Balkan language community (Sandfeld, Feuillet). But in recent times this optics has also been modified.

The role of Albanian or pre-Albanian in the formation of the Balkan linguistic community has not been a direct object of Albanian scholars. However, directly or indirectly researchers, such as E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, R. Ismajli have expressed their views on this issue which are conveyed through this article.

Jani THOMAI

PËR NYJAT E SHQIPES

– SEMANTIKË GRAMATIKORE E SEMANTIKË LEKSIKORE*

Nyjave të shqipes akademik Shaban Demiraj, në veprën “Gramatikë historike e gjuhës shqipe”¹, i ka kushtuar një kapitull të veçantë, me titull “Problemi i nyjave të shqipes”, duke i trajtuar në sistemin gramatikor (morfologjiko-sintaksor) e atë leksikor në katër rrafshë: etimologjiko-historik, krahasimtar, bashkëkohor dhe eptimor, si dhe në dy boshte: semantik e funksional. Këtu nuk do të merrem me analizat etimologjiko-historike e krahasimtare, as me format rasore të nyjave², por me ç’është gramatikore e ç’është leksikore në semantikën e tyre të sotme dhe, lidhur me këtë, me identitetin kategorial të nyjave jo më si pjesë ligjërata, pra, jo si kategori leksiko-gramatikore.

Që në krye të studimit akad. Sh. Demiraj pohon: “Megjithëse problemit të nyjave të shqipes i kanë kushtuar një vëmendje të posaçme mjaft gjuhëtarë, shqiptarë e të huaj, edhe sot nuk ka një mendim të përbashkët jo vetëm për çështje të veçanta dytësore, por edhe për thelbin e këtij problemi” (297). Po shtoj që kategoria e nyjave në shqipe është mjaft e ndërlikuar jo vetëm për shkak të prejardhjes, të trashëgimisë e të zhvillimit historik, por edhe për përbërësit kuptimorë (semat) që mbartin e funksionet po aq të ndërlikuara që kryejnë. Këtu nënkuptohen si natyra, vlerat e funksionet e tipeve të nyjave në shqipe, ashtu edhe pikëpyetja për cilësimin e mjeteve përkatëse brenda gjithë këtij grupi si “nyja”, pra, kundërvënia *nyjë* <> *jonyjë*. Me këtë pohim përlligjet arsyeja përse, krahas gramatologjisë, edhe leksikologjia merret me studimin e nyjave të shqipes.

* Me rastin e 100-vjetorit të lindjes së akad. Shaban Demiraj.

¹ Tiranë, 1986, f. 297-357.

² Nuk merrem këtu as me historinë e mendimit të autorëve të tjerë në studimet e tyre e në gramatikat për për konceptin që shpreh termi “nyjë” dhe kategorinë e tipet e nyjave gramatikore. Për lehtësi kuptimi kam shfrytëzuar shpjegimet për zërat “nyjë” dhe “një” në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe në “Fjalorin e gjuhës shqipe” (2006), që citohen më poshtë, të vlerësuara si vepra leksikografike në të cilat përkufizimet e termave janë sintezë e mendimit shkencor shqiptar, natyrisht duke u mbështetur në përcaktimet më të argumentuara, më bindëse e më të pranueshme.

Këtu më parë mund të shtrohen tri pyetje?

1. A ka arsye për një dallim të mëtejshëm ç'është gramatikore e ç'është leksikore te nyjat e shqipes? Parimisht gjurmët e burimeve të nyjave, vlera kategoriale e semave, ndërthurja e fortë e kuptimit me funksionin etj. e mbështesin këtë dallim.

2. A mund të ketë një ndarje të prerë ndërmjet gramatikes e leksikores te nyjat? Mendojmë se gërshetimi i tyre është arritur deri në atë gjendje, sa disa sema të interpretohen në të dyja rrafshet, – gramatikore e leksikore, – ka edhe raste të ndërmjetme, krahas rasteve më të qarta ka edhe raste të paqarta.

3. Përse vlen studimi i nyjave në këtë kënd vështrimi? Mendoj se vlen për të dalluar tipin e semave, po ashtu për të dalluar kuptimet nga funksionet³, për të përcaktuar shkencërisht vetë “thelbin” ose kategorinë e nyjave, për të plotësuar të dhënat për tipet e nyjave sipas kuptimit e funksionit (paraprakisht po përmend nyjat e prapme për shquarsinë, gjininë, numrin e rasën; nyjat e gjinore për rasën e për trajtëformimin, por edhe për përkatësinë a “pronësinë”; nyjat e mbiemrave për kategorinë leksiko-gramatikore, gjininë, numrin e rasën, por edhe për fjalëformimin; të ashtuquajturit “nyja pronorë” për gjininë, numrin e rasën, por edhe për kuptimin leksikor të qartë si trajtat përkatëse të përemrave pronorë).

Cilësimi i vlerës themelore (kuptim + funksion) të nyjave ka qenë i ndryshëm për shkak të këtyre ndërthurjeve e ndërlikimeve, sidomos për shkak të mosdallimit të qartë ndërmjet kuptimit e funksionit. Akad. Sh. Demiraj, me një emërtim përmbledhës i quan “mjete gramatikore” të gjitha nyjat që trajton, por “me kuptim leksikor shumë të zbehur” (297). Shkalla

³ Për *kuptimin* e *funksionin* në mjetet gjuhësore të kuptimshme të të gjitha niveleve (morfemë – fjalë – fjali) do t'u përmbahem këtyre koncepteve: *Kuptimi gramatikor* lidhet me mjetin trajtëformues, jo me realien, ai nuk shenjon asnjë tregues a tipar të realies (mjafton si shembull dallimi ndërmjet gjinisë natyrore e gjinisë gramatikore) dhe kundërvihet semantikisht me çdo morfemë të zhveshur nga kuptimi leksikor; *kuptimi leksikor*, edhe pse mund të shprehet nga të njëjtat mjete gjuhësore, lidhet me realien dhe me kundrimin tonë ndaj saj, shenjon një tregues (semë) të realies a vetë realien nëpërmjet bashkësisë së semave që shprehin tregues ose tipare thelbësore a të dukshme të asaj realieje ose të të gjithë klasës së saj; *funksioni*, duke përdorur gjuhën e matematikës, është “vlerë e ndryshueshme” që varet nga vlera e një mjeti tjetër brenda fjalës dhe që ndikon mbi të; funksioni lidhet me dallimin e një mjeti gjuhësor nga mjetet e tjera të njëjta (siç janë në gramatikë vetë paradigma e eptimit, dallimi i mbiemrit të nyjshëm nga ndajfolja e së njëjtës temë, ndërtimi i gjinore me mjet trajtëformues dhe kundërvënia me dhanoren etj., ose në leksik dallimi i fjalës nga morfema, nga togfjalëshi e nga fjalia).

“e zbehjes së kuptimit leksikor” te nyjat, të krahasuara me njësitë burimore, është e ndryshme te tipet e tyre të ndryshme dhe përbën gjithashtu një çështje për studim (sa e si). Më tej akad. Sh. Demiraj cilëson si kuptim gramatikor *shquarsinë*, kundërvënien *kuptim i caktuar – kuptim i pacaktuar*. Në vështrimin tim e në vija të trasha, gjinia, numri e rasa u përkasin kuptimeve të pastra gramatikore. *Përkatësia* (“pronësia” te gjinorja), *totalitariteti* (te numërorët e nyjshëm) e *pjesërisht shquarsia* me nyjat e prapme (sema “e njohur, e përmendur më parë”) i përkasin semantikës leksikore; këtu mund të përfshihet edhe shprehja *e gjinisë natyrore* te mbiemrat. Gjinia është semë e mirëfilltë gramatikore tek emërtimet e realieve pa gjini natyrore dhe tek emrat mashkullorë e femërorë me gjini natyrore (të tipit *dajë ...*, me paradigmë të kundërt gramatikore), por është edhe leksikore tek emërtimet e realieve që kanë gjini natyrore. *Fjalëdallimi* (*mbiemër – ndajfolje*, *gjinore – dhanore*) dhe *fjalëformimi* (emërzimi i mbiemrit, mbiemrat e nyjshëm) u përkasin *funksioneve* leksiko-gramatikore.

Nyjen shquese (të prapme) do ta lë mënjanë, sepse, sikundër pohon me të drejtë akad. Sh. Demiraj, “nyja shquese është reduktuar në një morfemë *sui generis*”, ajo nuk sjell asnjë lëvizje në kuptimin leksikor të emrit dhe as vetë nuk mbart ndonjë semë leksikore. Ai pohon gjithashtu se nyjat në përgjithësi “e kanë humbur jo vetëm mëvetësinë formale, por edhe kuptimin leksikor të dikurshëm” (298), veçanërisht nyjat e prapme janë desemantizuar leksikologjisht dhe janë fuqizuar gramatikisht, “prandaj, – pohon pa mëdyshje akad. Sh. Demiraj, – nyjat duhen trajtuar jo si njësi leksikore, por si mjete gramatikore, si morfema *sui generis*” (299), çka do të thotë se nuk mund të formojnë një pjesë ligjrate të vaçantë, d.m.th. kategori leksiko-gramatikore më vete. Për nyjat e prapme mund të themi që desemantizimi leksikor i plotë, shprehja vetëm e kuptimeve gramatikore (gjini, numër, rasë), shndërrimi në paradigmë eptimi, prapavendosja e njësuar me temën e emrit, përfshirja kategoriale e të gjithë emrave (madje edhe të përveçëm, ku nuk ka asnjë semë leksikore, veç funksion anaforik), krijimi i opozicioneve *i shquar – i pashquar*, *i caktuar – i pacaktuar*, ndryshimi formal i plotë nga njësitë e origjinës etj., i kanë kthyer historikisht e përfundimisht këto nyja në mjete thjesht gramatikore, pa asgjë leksikore të ruajtur, me funksione të ngjashme a të njëjta me mbaresat a formantet e tjera kategoriale gramatikore, siç janë, fjala vjen, edhe mbaresat e eptimit foljor.

Për *nyjat e përparme* akad. Sh. Demiraj thotë se ato nuk kanë asgjë të përbashkët me nyjen e prapme shquese. Si të tilla ai njuh:

I. “Nyja të përparme” që kryejnë funksione të ngjashme me ato të

morfemave⁴. Në këtë grup hyjnë:

1. “Nyja e përparme” që dallon rasën gjinore nga dhanorja.
2. “Nyja e përparme” që shërben si pjesë përbërëse e mbiemrave të nyjshëm ... dhe e përremrave ...

3. “Nyja e përparme” që shërben si pjesë përbërëse e emrave të tipit *e hënë, të korrat, të folurit* etj.

II. “Nyja e përparme” ... para numërorëve themelorë ..., para përremrave të pacaktuar ... për të shenjuar një tërësi të pacaktuar ..., i ngjashëm me atë të nyjës shquese të paravendosur numërorëve themelorë ...

III. “Nyja e përparme”... para disa emrash të lashtë farefisi ... Kjo, për nga kuptimi afrohet me përremrat pronorë ..., ndeshet edhe në përdorime të tipit *i Mirditas, i Dukat..., i Matjan...*⁵ (po shtoj që te “Moj e Sotiraqit”, d.m.th. “gruaja e Sotiraqit”, e është e gjinores, që shpreh më qartë “përkatësinë”).

Në këto formulime të autorit dua të tërheq vëmendjen te disa emërtime përcaktuese për objektin e kësaj kumtese, sepse në to me përpikëri shkencore shënohen disa nga vlerat e funksionet e këtyre nyjave, ku mund të rrokim jo vetëm dallimin ndërmjet kuptimit e funksionit, por edhe ndërmjet gramatikores e leksikores, si: “kryejnë funksione të ngjashme me ato të morfemave”; “dallon rasën gjinore nga dhanorja”; “shërben si pjesë përbërëse e mbiemrave të nyjshëm”; “për të shenjuar një tërësi të pacaktuar”; “për nga kuptimi afrohet me përremrat pronorë”. Këto përcaktime janë të qarta e nuk është e vështirë t’i vërejmë dallimet.

Lidhur me objektin e kësaj kumtese, më tej do të diskutoj rreth katër tipeve të cilësuar si “nyja”: nyjat e përparme të gjinores, nyjat e përparme të mbiemrave, sidomos nyjat e përparme të ashtuquajtura “nyja pronore” dhe e ashtuquajtura “nyja joshquese *një*”, e përfutur historikisht nga numërori *një*.

Nyjat e përparme të gjinores në rrafshin gramatikor, siç dihet, shprehin kuptimet gramatikore të gjinisë, të numrit e të rasës, pra, nga këto vlera e funksione janë mjete gramatikore, por kanë edhe një semë leksikore, “përkatësi, të përkitur, pronësi” (libri *i vëllait* = libri *që është i vëllait, që i përket vëllait, që është pronë e vëllait*). Kjo semë nuk është gramatikore e pastër, por ajo ndërkaq kushtëzon *funksionin* e rasës gjinore, kryen, si të thuash një “shërbim gramatikor”, duke e dalluar edhe nga rasa dhanore, – tipar gjithashtu gramatikor në paradigmen e lakimit, si mjet gjuhësor trajtëformues.

⁴ Po kujtoj këtu që morfema nuk është njësi e pavarur leksikore, por disa morfema (f.v. rrënja a tema e fjalës, ndajshesat etj.) janë mbartëse semash leksikore.

⁵ Sh. Demiraj, *vep. e cit.*, f. 305-306.

Nyjat e përparme të mbiemrave në rrafshin gramatikor shprehin gjithashtu kuptimet gramatikore të gjinisë, të numrit e të rasës, por kanë edhe një vlerë leksiko-gramatikore *fjalëformuese*. Akad. Sh. Demiraj pranon rolin e dyfishtë të kësaj nyje të mbiemrave, njëherazi rol fjalëformues e trajtëformues (306). Duke lënë mënjanë zhvillimin historik, në vështrimin e sotëm ato dallojnë mbiemrat e nyjshëm nga ndajfoljet përkatëse (*i mirë–mirë*), pra, kundërvënia është fjalëformuese, formale e kuptimore njëherazi, si pjesë të ndryshme të ligjëratës, pra, me kuptim të ndryshëm *leksiko-gramatikor*. Këtë rol e luan edhe formanti i prapavendosur i emëzimit të këtyre mbiemrave (*i miri*), duke i kaluar në një pjesë tjetër ligjërate. Kuptimi “*i caktuesisë*” i nyjës para numërorëve nga *dy* e lart (318), – e ashtuquajtur “nyjë shquese e përparme” (319), – me sa më duket, ka më shumë natyrë leksikore.

Të ashtuquajturat “*nyja të përparme pronore*” (*i ati, e ëma, të vëllezërit, së motrës*) mendoj se duhen përfshirë nga kategoria e nyjave. Kuptimi leksikor të këto të ashtuquajtura “nyja” është i qartë, i njëjtë me format e plota të përemrave pronorë përkatës (*i ati = ati i tij / i saj / i tyre*). Gjininë, numrin e rasën ato e shprehin njësoj si trajtat e plota përemërore (*i tij / i saj / i tyre, e tij / e saj / e tyre, të tij / të saj / të tyre*)⁶. Kjo e ashtuquajtura “nyjë e përparme pronore” del si paravendosje e njëjtë e përemrave pronorë në vetë të parë e të dytë (*im atë, yt atë*); në vetë të tretë (*ati i tij / i saj*), në mënyrë analogjike, gjithashtu paravendoset, veçse në trajtë të shkurtër (*i ati*). Në këtë kuptim leksikor e funksion gramatikor këto të ashtuquajtura “nyja” barazohen edhe me përemra të tjerë dëftorë a të pacaktuar, si *ky, kjo* etj. Akad. Sh. Demiraj sjell edhe një argument tjetër në të mirë të kësaj teze: “... nyja e përparme me vlerë pronori, në zanafillë, nuk duhet të ketë qenë nyjë shquese ...; kjo ‘nyjë’ përdoret vetëm para emrash farefisi të trashëguar ..., ose të burimit latin ..., por jo para emrash prej burimi sllav ose turk” (324), çka lidhet edhe me kronologjinë e përfuturit të saj dhe me gjendjen e sotme “të cunguar”.

Diskutime janë zhvilluar edhe për të ashtuquajturën “*nyjë e përparme joshquese një*”, për të cilën do të ndalem pak më gjatë. Sipas

⁶ Te *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, 2006, në pjesën “Disa njësi gjuhësore në kufi të fjalës”, f. 45, kam pohuar: “Të ashtuquajturat ‘nyja-pronorë’ (*i ati, e ëma, të vëllait, së motrës* ...) kanë kuptim pronësie, mbartin kuptimin leksikor të trajtave të plota përemërore (*i ati = ati i tij / i saj; e ëma = ëma e tij / e saj*) edhe nëse ato vijnë nga nyjat e këtyre trajtave”; “e ashtuquajtura ‘nyjë me funksion pronori’ ka kuptim leksikor (atë të pronësisë, të të përkulturit), pasi shënon pronarin, sido që në mënyrë të zbehtë”, f. 46.

akad. Sh. Demirajt, “kjo shtrirje analogjike e përdorimit të njëjës shquese (përkatësisht joshquese) e ka dobësuar në njëfarë mase rolin e saj thjesht caktues të dikurshëm dhe e ka larguar atë përfundimisht nga përemri dëftor anaforik (përkatësisht numërori themelor *një*), prej të cilit ajo është përfutur historikisht” (300). Ndërkaq, ka disa argumente që dëshmojnë se e ashtuquajtura “një e përparme joshquese *një*” është larg së qeni “një” gramatikore:

Kjo “fjalëz”, e ndjekur nga një emër i pashquar, gjithsesi nuk i ka humbur krejt semat leksikore të numërorit burimor *një*, ndryshe do ta kishim një një të tillë edhe për shumësin. Veç kësaj, pohimet e akad. Sh. Demirajt, që “nyja *një* e trajtës së pashquar njëjës në krye të herës është përdorur vetëm në funksion individualizues”, që “nyja joshquese *një* si fonetikusht edhe kuptimisht nuk i ka humbur fare lidhjet burimore me numërorin themelor *një*”, “vetëm nëpërmjet theksimit dallohet ajo edhe nga përemri i pacaktuar *një*” e për më tepër “dallohet nga numërori *një* sepse ajo ka një kuptim leksikor të zbehur” (303), – e paravendosur në distancë nga emri si gjithë nyjat e përparme, – mbështesin mendimin që te kjo e ashtuquajtura “një e përparme joshquese” ka në përmbajtje semë kryesore leksikore, e zhveshur thujse tërësisht nga kuptimet e funksionet gramatikore kategoriale të nyjave. Në strukturë të njëjtë sintaksore me njëjës, para emrit në shumës do të qëndronte një numëror me kuptim përgjithësues, me po atë kuptim e funksion sikurse e ashtuquajtura “nyja joshquese *një*”. Mund të krahasojmë: “Ishte *një* djalë ai, që s’ e kish shokun!” dhe “Ishin *dy* djem ata, që s’kishin shoq!”. Kuptimi *pjesor* (partitiv) i pacaktuar që u njihet emrave të këtij tipi kur përdoren në njëjës e pashquar (303) është një dëshmi që e ashtuquajtura “një joshquese” e ruan këtë semë leksikore, që i përjashton vlerën e funksionin e saj si një. Mund të shtoj se te pohimi “nyja joshquese e numrit njëjës është përfutur për të shprehur më mirë kuptimin e pacaktuar në kundërvënje me kuptimin e caktuar të një emri të përgjithshëm të përdorur me kuptim individualizues” (302) gjejmë po ashtu semën leksikore “kuptim individualizues”. Përkundër këtyre, kjo “një” nuk shpreh kuptime gramatikore të gjinisë, të numrit e të rasës dhe nuk eptohet si nyjat e tjera të përparme, veçse ka tiparin gramatikor që të shkojë me disa emra në trajtë të pashquar njëjës në rrethana të caktuara. Akad. Sh. Demiraj argumenton se jo të gjithë emrat e marrin këtë “një joshquese”, se “gjuha shqipe ... një joshquese ka krijuar vetëm për numrin njëjës. Madje, edhe në këtë numër përdorimi i saj ka

disa kufizime” (302); po ashtu, “nyja joshquese *një* nuk përdoret zakonisht as me emrat përmbledhës, lëndorë dhe abstraktë”. Ai nënvizon se “gjuha shqipe ... nuk ka krijuar një *nyjë* joshquese për numrin shumës” (304), “kur ndihet nevoja, ... vendosen para tij përemrat e pacaktuar *ca* ose *disa*” (306). Atëherë, përse kjo “*nyjë*” nuk është e përhershme dhe e përgjithshme si gjithë nyjat e tipeve të tjera? Përjasje me mjetet për shumësin e pashquar shkon në të mirë të mendimit se e ashtuquajtura “*nyjë* e përparme joshquese *një*” nuk ka kuptimet e funksionet kategoriale të nyjave, ajo funksionon njësoj si përemrat e pacaktuar *ca* e *disa* dhe mund të cilësohet si e tillë ose si pjesëz⁷ (sikundër, f. v., të për mënyrën lidhore të foljeve, *do* për kohën e ardhme të foljeve etj.)⁸, që ndiqet nga emra të pashquar në njëjës, siç e kërkon edhe kuptimi leksikor i numërorit *një*, ose siç i kërkojnë emrat ndjekës në shumës të pashquar *ca*, *disa*, *dy*, *tre* ... E ashtuquajtura “*nyjë* e përparme *një*”, nga shkalla e desemantizimit ngjan me pjesëzat *do*, *të* (që u përmendën), por nuk ka funksion trajtëformues si ato. Veç këtyre, pashquarsia mund të shprehet edhe pa këtë “*nyjë* joshquese”, siç janë sjellë në studimin e akad. Sh. Demirajt raste e shembuj bindës (“Nuk mbeti *këmbë njeriu*”). Po shtoj se edhe në rastet kur ajo mund të

⁷ Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980, f. 1280, termi *nyjë* në gjuhësi shpjegohet si “pjesëz që shërben për të treguar nëse një emër ose një fjale tjetër e barasvlershme me të është në trajtën e shquar apo të pashquar (p.sh. *mal* ...); pjesëz që vihet përpara një emri ose një fjale tjetër të barasvlershme me të për të formuar trajtën e rasës gjinore (p.sh. *pragu i derës* ...); pjesëz që hyn në ndërtimin e një tipi të pasur mbiemrash të shqipes (*i kuq* ...), në ndërtimin e disa përemrave dëftorë lidhorë, pronorë e të pakufishëm (*i tillë* ...), në ndërtimin e numërorëve rreshtorë (*i parë* ...) e të disa emrave femërorë e asnjane (*e hënë*, ... *të hyrët* ...), duke u vendosur para temës së tyre pa u shkruar me të ...”.

⁸ Në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*, f. 1283, “*një*” pranohet si *nyjë joshquese*, me përkufizimet: “1. Përdoret para një emri kur duam që ky të shënojë dikë a diçka në mënyrë të përgjithshme, pa e veçuar plotësisht, pa e dalluar nga njësitë e tjera të së njëjtës klasë. *Një plak e një plakë ... Ishte një ditë e bukur ... Erdhi një shok...* 2. Vihet para një emri kur duam ta përdorim me kuptim të përgjithësuar dhe si përfaqësues të klasës së vet me kuptimin ‘çdo’. *Një libër i mirë është një shok i mirë ...* 3. Përdoret me një emër njeriu, kur këtë njeri nuk e njohim mirë ose nuk dimë me siguri si e quajnë. *A e njeh (a të kujtohet) një Shpëtim Bardhi nga Peqini?*”. Vërejmë se edhe në këto përkufizime përmbahen sema leksikore ose, deri diku, leksiko-gramatikore, si: “... në mënyrë të përgjithësuar ...; ... me kuptim të përgjithësuar dhe si përfaqësues të klasës së vet me kuptimin ‘çdo’ ...; kur këtë njeri nuk e njohim mirë ose nuk dimë me siguri si e quajnë”. Këto shpjegime për kuptimin e kësaj “fjalëze” tregojnë se semat janë leksikore e jo gramatikore dhe ato vetëm i shërbejnë fuqizimit të funksionit të saj. Te *Leksikologjia* ... kjo njësi gjuhësore nuk është trajtuar fare si një.

përdoret, nuk është e domosdoshme, prania a mosprania e saj nuk sjell asnjë ndryshim në përmbajtjen e emrit a të thënies (p.sh. “Është *një* njeri i njohur nga të gjithë” = “Është njeri i njohur nga të gjithë”; ose: “... ajo ka *një* kuptim leksikor të zbehur” = “... ajo ka kuptim leksikor të zbehur”)⁹. Veçanërisht mund të nënvizoj dy argumente: 1. E ashtuquajtura “*nyjë* e përparme joshquese *një*” nuk ka një gjegjëse *nyjë* të prapme joshquese. “*Një*” si *nyjë* nuk ka shoqe as në njëjës, as në shumës. Më në fund shtrohet pyetja: Përse do t’i duhej shqipes një *nyjë* e përparme joshquese, kur emri vetë në temë (pa *nyjën* e prapme shquese) është i pashquar? Kështu, si prapa edhe përpara pashquarsia ka një zero, pashquarsia mbartet nga vetë emri në sintagma të caktuara pa ndihmën e ndonjë nyje të posaçme, sikundër madje një emër *i pashquar* mund të shkojë edhe me parafjalë (*në dhomë*). 2. Kjo e ashtuquajtura “*nyjë*” ka mundësinë të përngjitet me emrin e pashquar e të kryejë funksionin *fjalëformues*, si te përemri i pacaktuar *njëfarë* (në *njëfarë* mënyre, ka *njëfarë* lëkundjesh, erdhi *njëfarë* Agron Bregu, ishte *njëfarë* gënjeshtari¹⁰, u bë *njëfarë* pajtimi ndërmjet të dyve) e për analogji me të edhe *njëlloj* (ishte *njëlloj* zbutjeje), *njësoj* (janë rritur *njësoj*), *njëmend* “tashti” (*njëmend* sa u ndamë), *njënatëzaj* “parmbrëmë” (*njënatëzaj* më gjeti në gjumë), *njëdash* “tashti” (*njëdash* po vjen), *njëvit(i)* “parvjet” (*njëviti* s’na u bë misri fare) etj. Është më e pranueshme që këtë funksion *fjalëformues* kjo njësi (*një*) ta ketë si pjesëz e jo si *nyjë*.

Studimi i akad. Sh. Demiraj për nyjat përbën kështu edhe një shembull tjetër të analizës e të argumentimit shkencor të gjerë e kompleks të njësive gjuhësore, në lidhje të ngushtë të gramatikës me leksikologjinë.

⁹ Për këtë “fjalëz”, e përdorur shpesh pa nevojë, si në raste të tilla, është më e lehtë të thuash çfarë nuk është sesa çfarë është!

¹⁰ *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 707.

**For Albanian nodes - grammatical semantics
and lexical semantics**

ABSTRACT

The nodes of the Albanian academic Shaban Demiraj, in the work "Historical grammar of the Albanian language, has dedicated a special chapter, entitled "The problem of the nodes of the Albanian", treating them in the grammatical system (morphological-syntactic) and the lexical one in four planes: etymological-historical, comparative, contemporary and optimal, as well as on two axes: semantic and functional. This scientific article deals with what is grammatical and lexical in their current semantics and, in this regard, the categorical identity of nodes is no longer as part of a lecture, ie not as a lexical-grammatical category.

Here are three questions first?

1. Is there a reason for a further difference between what is grammatical and what is lexical in Albanian nodes? Basically the traces of node sources, the categorical value of semas, the strong interplay of meaning with function, and so on. support this distinction.

2. Can there be a definite division between grammar and lexicon at the nodes? We think that their interweaving has reached the point where some sema are interpreted in both planes - grammatical and lexical - there are also intermediate cases, in addition to the clearest cases there are also unclear cases.

3. Why is it worth studying the nodes in this angle? I think it is useful to distinguish the type of nodes, as well as to distinguish meanings from functions, to scientifically determine the "essence" or category of nodes, to complete the data on the types of nodes according to the meaning of the function (previously mentioned nodes of back for prominence, gender, number and race; gender nodes for race and form, but also for belonging or "ownership"; adjective nodes for lexico-

grammatical category, gender, number and race, but also for word formation; "Possessive nodes" for gender, number and race, but also for a clear lexical meaning as the corresponding forms of possessive pronouns).

The study interprets only the anterior nodes of Albanian (gender nodes, adjectives, some nouns, "possessive nodes", numerals, intransitive nodes) with data from their origin, current form, lexical and grammatical semantics and syntactic functions, in comparison with other linguistic units, such as the word in general and the parts in particular, through a confrontation of previous thoughts expressed by the author, by prof. Sh. Demiraj and others.

Mimoza PRIKU

90 VJET NGA BOTIMI I NJË GRAMATIKE

(Fulvio Cordignano S. J. “Lingua albanese (dialetto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi”)

Hyrje

90 vjet më parë u publikua në Milano manuali gramatikor “Lingua albanese (dialetto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi” e misionarit italian Fulvio Cordignano S. J. i publikuar nga shtëpia botuese prestigjioze Ulrico Hoepli (Milano, 1931), një ent i njohur për disa botime me rëndësi nga fusha e albanologjisë¹. Kur flitet për gramatikën e Cordignano-s zakonisht bibliografitë e ndryshme i referohen botimit të viti 1931², por albanologu italian kishte botuar një gramatikë për shqipen edhe në vitin 1929 (“Grammatica albanese”, Milano, 1929)³.



Autori i gramatikës së vitit 1931, Emilio Fulvio Cordignano (1887-1952)⁴, ka qenë një misionar jezuit i cili ka punuar për shumë vite në Shqipëri dhe për më tepër, ka lënë kontribute të rëndësishme për gjuhën dhe kulturën shqiptare. Ai ka lindur në Itali në vitin 1887 dhe ka shërbyer në Shqipëri jo vetëm në mision shëtitëse, por ka qenë profesor në Kolegjin Saverian në Shkodër.⁵ Në

¹ Disa nga këto botime janë: Alberto Straticò, *Manuale di letteratura albanese*, Milano: Manuale Hoepli, 1896; Angleo Leotti, *L'albanese parlato. Cenni grammaticali. Vocabolario Albanese-Italiano - Italiano-Albanese (dialetto ghego). Proverbi – dialoghi*, Milano: Ulrico Hoepli, 1916; Vincenzo Librandi, *Grammatica Albanese con le poesie rare di Variboba* (Seconda edizione), Milano: Ulrico Hoepli Editore, 1928; Fulvio Cordignano S. J., *Dizionario Albanese-Italiano e Italiano-Albanese. (Il nuovo “Jungg”)*. *Parte albanese-italiana*, Milano: Ulrico Hoepli Editore, 1934.

² Papas Prof. Gaetano Petrotta, *Saggio di bibliografia albanese (1500-1930)*, Palermo 1931.

³ Markus W. E. Peters, *Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën: “Tipografia e Zojës së Papërlyeme” në Shkodër (1870-1945)*, Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2016.

⁴ Objekti i punës sonë është vetëm kontributi gjuhësor i këtij dijetari, duke lënë jashtë interpretimet rreth disa qëndrimeve individuale të tij për shqiptarët dhe Shqipërinë.

⁵ Më gjerësisht për jetën e F. Cordignano-s shih: S. Pepa “Atë Fulvio Kordinjano për kulturën shqiptare”, në *Gjurmime kulturore* (Studime, artikuj, kumtesa), Camaj-Pipa, Shkodër. 2000, f. 27-35; Robert Elsie, *Historical Dictionary of Albania*, Lanham, Maryland, 2010; Markus W. E. Peters, vep e cit.; Tefë Topalli, *Gjuhë e polemikës dhe e apolojisë: skandali Cordignano: Filip Fishta, Nikë Barcolla, Profesorët e Lyceut të*

albanologji Cordignano i nisi studimet me punimin “Epojeja kombëtare e popullit shqiptar” të botuar në Shkodër në vitin 1925⁶, ndërsa në fushë të gjuhësisë ka lënë gjurmë sidomos në fushë të leksikografisë ku “na dha dy fjalorë që, ndonëse ka kaluar më tepër se një gjysmë shekulli, ata janë me një vlerë të madhe edhe sot”⁷. Fjalori i parë me fjalësin shqip-italisht “Dizionario albanese-italiano e italiano-albanese (Il nuovo “Jungg”). Parte albanese-italiana” u botua në Milano nga U. Hoepeli në vitin 1934, ndërsa fjalori me fjalësin italisht-shqip, “Dizionario italiano-albanese e albanese-italiano. Parte italiano-albanese” u botua në Shkodër (Shtypshkronja e Zojës së Paperlyeme, 1938). Botimi i vitit 1938 ka pasur në periudhat e mëvonshme dy ribotime anastatike, një në Itali nga shtëpia botuese Forni (Bolonjë) në vitin 1968 tjetri, është realizuar në Shqipëri (Tiranë) në vitin 2019 nga Shoqata e Jezuitëve, nën kujdesin e Ardian Ndrecës. Në onomastikë mund të përmendim si ndihmesa veprën në tre vëllime “Catasto Veneto di Scutari e registrum concessionum 1416-1417” (Roma, Cuore di Maria, 1942), *Onomasticon del Catasto Veneto di Scutari e registrum concessionum* (Stabilimento Grafico “Carnia”, 1945). Kontributi i Cordignano-s në albanologji është i pasur, kështu vetëm në shtypshkronjën “Zoja e Paperlyeme” përfshihen rreth 2000 faqe të botuara.⁸

Nëse figura Cordignano-s si leksikograf ka tërhequr më tepër vëmendjen, Cordignano si hartues gramatikash ka qëndruar më në hije, ndoshta kjo gjë lidhet edhe me faktin se manualët e këtij albanologu nuk u përdorën si tekste shkollore. Këto gramatika nuk ishin shkruar me këtë qëllim, si gramatikat e J. Junggu-t⁹, Domenico Pasi-t¹⁰, Anton M. Xanonit¹¹ etj., të cilat i patën në dorë fëmijët që studiuuan në kolegjet në Shqipëri. Një arsye tjetër ndoshta ka të bëjë me kontributin shumë të vlerësuar të Cordignanos-s në leksikografi, vlerësim i cili ka lënë më në heshtje ndihmesat e tij në gramatologji.

Shkodrës, Ndre Zadeja, Shkodër, 2016.

⁶ Botime të tjera: *Geografia ecclesiastica dell’Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII* (1934), *Saggio di un regesto storico dell’Albania* (Shkodër, 1937-1940).

⁷ S. Pepa, “Atë Fulvio Kordinjano për kulturën shqiptare”, në *Gjurmime kulturore* (Studime, artikuj, kumtesa), Camaj-Pipa, Shkodër. 2000, f. 33.

⁸ Shih më gjerësisht: Markus W. E. Peters, *vep. e cit.*, f. 393.

⁹ J. Jungg, *Regole grammaticali della lingua Albanese compilata da Giacomo Junng, Zoja e Papërlyeme*, Shkodër, 1880; *Elementi grammaticali della lingua Albanese, Zoja e Papërlyeme*, Shkodër, 1881.

¹⁰ D. Pasi, *Liber per m’u msue me lezue scciyp*, Zoja e Papërlyeme, Shkodër, 1889.

¹¹ Anton M. Xanoni, *Gramatika Shqyp Qi perdoret N’ Seminarë e n’Mbësoitore t’ Sh’ Françesk Saverit n’Shkoder*, Zoja e Papërlyeme, Shkodër, 1909.

Në shtypin e kohës, vetëm në disa numra të gazetës “Vullneti i popullit” ndeshemi me diskutime për këtë gramatikë. Në numrin 314 të datës 3 maj 1931 gjejmë një recension mjaft pozitiv për këtë gramatikë përgatitur nga Karl Gurakuqi, ndërsa në dy numra të tjerë të këtij organi (nr. 333, datë 27 maj 1931 dhe nr. 334, datë 28 maj 1931) gjejmë një reflektim të Cordignano-s për disa vërejtje të bëra nga Justin Rrota në punimin “Analyzimi i rasave” që u botua asokohe në dy numra të revistës “Hylli i Dritës”. Gurakuqi në recensionin e tij të botuar në zërin “Bibliografi” e çmon mjaft punën e Cordignano-s dhe të bashkëpunëtorëve të tij, të cilët drejtpërdrejt apo tërthorazi e kishin ndihmuar studiuesin italian në realizimin e këtij botimi. Ndër të tjera ai shkruan: “vepra është shumë e çmueshme dhe është një liber *sui generis*, i cili u jep të huejve rasë, jo vetëm të nxajnë gjuhën shqipe në pikëpamje gramatikore, por edhe të formojnë një mendim pak a shumë të plotë mbi letërsinë shqiptare”¹².

Për ta parë Cordignano-n edhe nga këndi i gramatikanit po marrim në analizë manualin e tij të botuar në vitin 1931, megjithëse ai ka botuar edhe një gramatikë që e përmendëm më lart në vitin 1929 dhe dy metoda mësimi, njëra për mësimin e italishtes nga shqiptarët “L’italiano per gli Albanesi e l’ Albanese per gli italiani nei loro elementi semplici, pratici, indispensabili con particolare riguardo alla scuola e all’ esercito (me 219 faqe prej të cilave 129 faqe janë gramatikë, botuar në Shkodër në shtypshkronjën “Zoja e Papërlyeme” në vitin 1939)¹³ dhe tjera është metodë e mësimin të shqipes nga italianët me titull “Nuovo metodo pratico d’insegnamento della lingua albanese per gli italiani e della lingua italiana per gli albanesi con dizionario” (“Zoja e Papërlyeme”, Shkodër, 1939).

Kriteret e hartimit të gramatikës dhe metodologjia e punës

Gramatika e vitit 1931 hapet me një hyrje të shkurtër ku autori përshkruan se si i lindi ideja e hartimit të këtij manuali dhe ajo që bie në sy është metoda që ai ka zgjedhur. Edhe sipas K. Gurakuqit *At Cordignano ka qenë shumë praktik në përpilimin e kësaj vepre: i udhëhequn prej një kriteri të shëndoshë*¹⁴.

Kjo metodë, sipas autorit, është ajo e kohëve të fundit, por vështirësia e zbatimit të saj qëndron në përzgjedhjen e materialit dhe të formave gramatikore. Akoma nuk ishte arritur të unifikohet një gjuhë e përbashkët për shqipen ndaj dhe hartuesit e gramatikave kanë mbajtur qëndrime individuale për këto problematika. Këtë shqetësim e ndan me

¹² K. Gurakuqi, “La Lingua Albanese”- Fulvio Cordignano S. J., në *Vullneti i popullit*, nr. 3 14, 3 maj 1931, f. 2.

¹³ Shih: Markus W. E. Peters, *vep. e cit.*, f. 394.

¹⁴ K. Gurakuqi, *pun. i cit.*

lexuesit Cordignano që në hyrje të veprës. Ndër të tjera ai shkruan: “Kam shënuar atë që më është dukur se preferohet; gjithmonë kam shprehur me respekt mendimin e të tjerëve se mund të jetë një përparësi praktike, duke trajtuar një gjuhë ende të paunifikuar, dhe për të cilën nuk ekziston një gramatikë të plotë” (Prefazione: XVIII). Kjo situatë shpesh ka sjellë përpilimin e gramatikave të bazuara herë tek dialekti gegë e herë tek ai toskë nga autorë të ndryshëm apo edhe nga i njëjti autor. Kujtojmë këtu A. Leotti-n me dy botimet: “Grammatica elementare della lingua albanese (dialetto toscano) botuar në Romë në vitin 1915 dhe “L' albanese parlato: cenni grammaticali: vocabolario albanese-italiano-italiano-albanese (dialetto ghego)” botuar në Milano në vitin 1916. Për hartimin e kësaj gramatike Cordignano kishte zgjedhur të nisej nga dialekti gegë, kjo ndoshta për faktin se e njihnte më mirë këtë variant gjuhësor, sepse kishte shkelur vetë në mjaft fshatra të zonës së Veriut. Cordignano ishte nxitur edhe nga bashkëvëllai i tij P. A. Serreqin S. J., i cili kishte mbledhur më parë, gjatë misioneve të tij, fraza e proverba dhe donte t’i botonte ato, por ndarja nga jeta e kishte penguar realizimin e këtij projekti.

Konceptimi i këtij libri i pajisur me pjesë nga letërsia popullore dhe ajo e kultivuar nga autorë, si Pashko Bardhi e Ndre Mjedja, me frazeologji e proverba dhe të gjitha këto të sjella në origjinal, por edhe të përkthyer edhe në italisht, e bën këtë gramatikë të vlefshme si për italianët që duan të mësojnë gjuhën shqipe, por ju vjen në ndihmë edhe shqiptarëve “që do ta donin të mësonin gjuhën italiane” (Prefazione: XVIII). Cordignano është modest për punën e tij, sepse veprën e quan një hyrje praktike për studimin e gjuhës shqipe, pra kemi të bëjmë me një gramatikë të hartuar për qëllime praktike. Në të gjithë rrugëtimin e vet hartuesi i këtij manuali nuk ka qenë i vetëm, por ai është mbështetur nga bashkëpunëtorët e miqtë që e njihnin mirë shqipen. Këtë fakt e dëshmon edhe ai vetë. Kështu për pjesën teorike ai ka pasur si pikënisje këshillat e shkrimtarit dhe gjuhëtarit të njohur Ndre Mjedja. Albanologu italian e njeh mirë kontributin e paraardhësve të tij në fushë të gramatologjisë dhe shpesh i referohet atyre për çështje të veçanta. Duke qenë një gramatikë e dialektit gegë ai i referohet Justin Rrotës për prezencën e lokativin e vjetër me mbaresën *-t* në këtë dialekt¹⁵. Megjithatë shembujt e sjellë nga Cordignano si dhe qëndrimet e tij teorike kanë

¹⁵ Megjithëse J. Rrota e ka kritikuar Cordignano-n për interpretimin e disa rasave të emrit, që sipas Rrotës, janë keqkuptime të Cordignanos. Ndër të tjera Rrota shkruan: “Sa për rrasa sporadike t’ akuzativit (të hershem) me funksion t’objektit të drejtë në *t*, qi ndeshemi ndonji here në Buz., Budin e Bog, na i gjykojm pa tjetër analogjizme me trajta t’asnjansit.” (“Analyzimi i rasavet t’emnit e zhvillimi historik i tynve”, *Hylli i Dritës*, Shkodër, Vjeti VII, 1931, nr. 5, f. 266).

ngjallur edhe disa debate mes autorit të gramatikës dhe J. Rrotës. Polemika mes tyre u bë për disa probleme teorike të rasave të shqipes e jo vetëm të vendores. Që në pjesën e parë të punimit të tij për rasat e shqipes J. Rrota shkruan: “Prej këtyne pak rreshtave mund të shifet më kjashtë mendimi ynë, qi ka ndryshim prej atij, qi pak si ngutshem, bjen n’ êmen t’ onë i Ndrishmi P. F. Cordignano S. I, puntuer i palodhshem i gjuhës s’ onë, në një liber italisht mbi gjuhë shqype, shtypë ndër këto ditë në Milan.¹⁶” Rreth këtyre vërejtjeve të J. Rrotës ka reaguar edhe Cordignano me shkrimin “Rreth një çashtje gramatike” në dy numra të gazetës “Vullneti i popullit” (nr. 333, 27 maj 1931, f. 9 dhe nr. 334, 28 maj 1931, f. 3). Ndër të tjera Cordignano shkruan: “Po kalojmë në çashtjen parimore, jo per me polemizue, por vetem qi t’ epet rasë si ati si cdo kundruesi të gjuhës Shqype, të vëhen në shesh hypothezat e theorit e ndryshme dhe t’ i avitena ma mirë së vertetës.¹⁷”

Cordignano i ka pasur në dorë edhe gramatikat e Aleksandër Xhuvanit, por në disa raste sjell mendime të ndryshme edhe nga Xhuvani. Cordignano i lë të kuptojë lexuesit të gramatikës se ka njohuri edhe për disa çështje të gramatikës historike të trajtuara nga Meyer-i, Weigand-i e ndonjë albanolog tjetër. Në këtë aspekt duket se Cordignano ka një parapërgatitje teorike për gramatikën e sotme dhe atë diakronike të shqipes, ka në krah të djathtë Ndre Mjedjen dhe prandaj Cordignano në profilin e hartuesit të gramatikës nuk vjen i rastësishëm.

Metodologjia e punës është e shpjeguar hap pas hapi nga vetë autori. Cordignano kërkon që t’ i shmanget arsyetimeve teorike që në krye të herës, ndaj dhe e nis përshkrimin me anën praktike. Në lidhje me lakimin e emrave ndër të tjera ai shkruan: “Duke studiuar paradigmat, kuptohet para së gjithash *arsyeja* e ndryshimeve në përdorimin e nyjave” (Norme: XXI). Ky parim ndjek gjithë fillin e gramatikës e do ta ndeshim në të gjitha nëndarjet e saj. Në gramatikë ai nisët nga morfologjia dhe shkon drejt sintaksës duke e shoqëruar çdo hap me shembuj praktikë nga letërsia shqipe.

Rreth strukturës së kësaj gramatike

Gramatika ndahen në tri pjesë: pjesa e parë (“Cenni grammaticali” - (Shënime gramatikore), f. 3-132) mbart peshën kryesore teorike të këtij manuali; pjesa e dytë (“Saggi di letteratura” - (Sprova të letërsisë, f. 135-227) ka të përfshira brenda saj tekste nga letërsia popullore me gojëdhëna, përralla, por dhe pjesë nga letërsia e kultivuar; pjesa e tretë (“Frazeologia e

¹⁶ J. Rrota, *pun. i cit.*, f. 265.

¹⁷ F. Cordignano, “Rreth një çashtje gramatike” në dy numra të gazetës *Vullneti i popullit*, nr. 334, 28 maj 1931, f. 3.

proverbi” - (Frazeologjia dhe fjalët e urta, f. 235-308) përmban frazeologji dhe proverba nga autorë të cilët do t'i shohim në vijim.

Pjesa e parë “Shënime gramatikore” përmban disa kapituj ku janë shqyrtuar të gjitha çështjet gramatikore, duke nisur me disa shënime me karakter fonetik e fonologjik. Pas paraqitjes së alfabetit të gjuhës shqipe, Cordignano ka tërhequr vëmendjen rreth disa rregullave të drejtshqiptimit të zanoreve, bashkëtingëlloreve dhe grupeve të bashkëtingëlloreve. Në lidhje me drejtshqiptimin e bashkëtingëlloreve ai ju vjen në ndihmë përdoruesve të këtij manuali edhe në një formë tjetër, me anë të shqiptimit të atij tingulli në gjuhë të tjera p. sh. “**dh** shqiptohet si *th* e ëmbël në fjalën angleze *weather* apo **g** shqiptohet si *g* në *gatto* të italishtes” (1931:4). Kjo gjetje e autorit ndihmon sidomos të huajt që duan të mësojnë shqipen, por përpiket të krijojë edhe një model drejtshkrimor e drejtshqiptimor për gjuhën shqipe. Kjo ndarje ndiqet nga përshkrime gramatikore të rrafshit morfologjik sipas nëntë klasave të paraqitura në këtë gramatikë: nyja, emri dhe lakimi i tij, mbiemri, përemri, folja, numërori, ndajfolja, parafjala dhe lidhëza. Pjesën kryesore sigurisht e zë folja, e parë sipas ndarjeve: folje të rregullta, folje vetvetore, folje pasive dhe ato të parregullta. Kur bëhet fjalë për foljen, një peshë të madhe ka zgjedhimi i saj sipas mënyrave dhe kohëve të ndryshme, ndaj dhe Cordignano është ndalur më gjatë tek këto përdorime. Rrafshin sintaksor hartuesi i kësaj gramatike e ka trajtuar më tepër nga ana praktike me pjesë e fraza konkrete nga shkrimtarë të njohur shqiptarë dhe më pak teorikisht. Edhe ky hap të bind edhe më shumë për karakterin praktik të këtij teksti.

Parimin e dhënë që në fillim të gramatikës nga praktika drejt teorisë e shohim të zbatuar me përpikmëri edhe në trajtimet morfologjike. Kështu për shpjegimin e nyjave Cordignano nisat nga rastet konkrete. Ai jo vetëm që përpiket të shpjegojë se ku mund të gjenden nyjat, por dalëngadalë ka hyrë në konteks duke argumentuar rregullat e përdorimit të njërës apo tjetrës nyjë p. sh. në rastet kur nyja i paraprin një mbiemri ajo thjesht klasifikon gjininë e tij: *nieri* (m.) *i mirë*; *nâna* (f.) *e dashtun* (1931:7). Në trajtesat e tjera Cordignano është shtrirë në diskurs, duke dhënë rekomandimet e duhura për përdorimin e nyjave, sidomos në rastin kur ata paraprihen nga parafjalë si p.sh. nga parafjala prej: *prej së motrës* (da sua sorella).

Lakimi i emrave zë një vend me rëndësi në shpjegimet gramatikore. Cordignano njih shtatë rase për emrin: emërore, thirrore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore dhe vendore. Paradigma e lakimit të emrave është dhënë e plotë duke u shoqëruar edhe me disa rregulla rreth formave analogjike, si gjinore-thirrore apo emërore e pashquar-vendore për emrat e

gjinisë mashkullore dhe femërore. Megjithëse Cordignano është përpjekur të krijojë një gramatikë të gegërishtes me forma së përgjithshme, por ai ka shënuar aty-këtu edhe disa forma të veçanta më të ngushta dialektore apo të ndonjë të folmeje. Kështu ai ka veçuar nga e folmja e Mirditës dhe e Pukës rasën vendore e cila në këto të folme del me mbaresën e veçantë *-t* dhe më tej ai i ka krahasuar dy format e vendores: *shkova n' mal: shkova n'malt* (1931:11). Trajta e pashquar e emrit paraqitet me dy palë forma, njëren për emëroren, thirroren, kallëzoren, vendore dhe tjetrën për gjinoren, dhanoren dhe kallëzoren. Lakimi i emrave paraprihet nga fleksioni i nyjave. Gjatë paraqitjes së eptimit të emrave Cordignano është treguar i vëmendshëm duke shënuar edhe të dhëna plotësuese me karakter historik për rasia të veçanta, p. sh. për rasën rrjedhore të shquar *-vet* ai shënon se tek autorët e vjetër gjendet edhe mbaresa *-shit*. Vëzhgime të tilla me karakter historik ai i ka bërë gjatë gjithë gramatikës së tij duke pohuar se gjuha evoluon dhe duhet t'i referohemi fakteve të sotme gjuhësore, ndërsa problemet historike ia lë në dorë filologjisë dhe gramatikës krahasimtare.¹⁸

Në lakimin e emrave në numrin shumës Cordignano ka dalluar dhanoren e pashquar me mbaresën *-ve* nga e shquara me *-vet* dhe për këtë arsytim pranon se “Ed io ho accettato questo col Mjedja” (1931: 17). Më vete autori i gramatikës ka trajtuar emrat që nuk lakohen sipas gjinisë së cilës i përkasin duke përfshirë në këtë grup emrat e përgjithshëm, si *babë, axhë, tatë* apo emrat e njerëzve *Kolë, Tefë* etj., të cilët ndjekin konkretisht lakimin e emrave të gjinisë femërore, ndërsa emrat e përveçëm *Dan* (si emër vajze), *Çiluk* etj. shkojnë sipas paradigmës së emrave të gjinisë mashkullore. Kategoria e numrit zë vend me rëndësi në trajtimet e Cordignano-s për klasën e emrit. Autori i gramatikës ka rreshtuar edhe një varg emrash, që sipas tij, e formojnë shumësin në mënyrë të parregullt, si: *derë:dyer, krue:kroje, shí:shina, asht:eshtna, ujë:ujna, lug:lugje* etj. Lakimi i emrave të gjinisë asnjnjëse është parë me vete. Kjo gjini, morfologjikisht është shtrirë tek emrat (*kryet, ujët*), tek mbiemrat (*t'mirët*) dhe tek format foljore të substantivuara (*t' shpifunit*). Lakimi i emrave asnjnjës është shoqëruar me paradigmen e plotë të lakimit të shoqëruar në fund me disa shënime, konstatime apo duke bërë edhe krahasime mes disa formave të autorëve të vjetër me ato të të folmeve në qytete apo malësisë: *Ujë e Drinit (âsht) â t' rrebët: Ujë e Drinit âsht i rrebët* (1931:24).

Një tjetër pjesë ligjërata e trajtuar në këtë gramatikë është mbiemri, ndaj dhe janë identifikuar mbiemrat me praninë e një nyje (të nyjshëm) dhe ato pa praninë e saj (të panyjshëm), si: *i bardhë, i moçëm~plak, fatmirë* etj.

¹⁸ Shënimi 1, *vep e cit.*, f. 18.

Cordignano është ndalur edhe te disa sintagma me karakter krahasues të ndërtuara mbi bazën e një mbiemri, si: *i shndoshët si molla; un jam aq i fórt, sá ti* (1931:29).

Një klasë e pasur me lloje dhe përdorime është ajo e përemrave. Ai ka trajtuar përemrat vetorë, vetvetorë, pronorë, dëftorë dhe më vete disa përemra apo mbiemra përemërorë (*kush, tjetër, i vetem, i cilli, njëni*). Në disa raste Cordignano ka mbajtur qëndrime individuale, p. sh. ai i lakon përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë edhe në rasën gjinore. Në vijim ai ka shënuar trajtat e shkurtra (forme enclitiche) që hasen në rasën dhanore dhe kallëzore e më pas ka kaluar në tabelën e plotë të trajtave të bashkuara duke i shoqëruar me shembuj të mjaftueshëm, si: *Kush t' ká trazue? Ju kan sjellë fort per s' mbarit* (1931: 32); *Ket fjal kurr s'kam me jau pranue* (1931:33). Me radhë janë marrë në shqyrtim përemrat vetvetorë (*vedit, vetvedit*), përemrat pronorë (*i êm/ e ême (e jême), i yt, e jote* etj.). Këto të fundit janë analizuar sipas gjinisë dhe numrit, por si emrat ata janë lakuar në trajtën e pashquar dhe në trajtën e shquar (*e jote-e jotja, i vet-i veti* etj.). Në disa raste Cordignano ka bërë vërejtje edhe rreth disa formave të gabuara në përdorimin e përemrave. Ai i konsideron të pasakta trajta të tilla, si: *i joti*. E pasur me forma del edhe klasa e përemrave dëftorë, si: *kjo (njekjò, qekidò)*. Si në shqipen e sotme, edhe Cordignano ka dalluar përemrat dëftorë *ai, ajo (aj nieri, ajò vajzë)* që përdoren edhe si vetorë. Edhe format e ndryshme të përemrave ndiqen nga një numër i bollshëm shembujsh konkretë, duke mbizotëruar edhe në këtë rast përdorimet praktike. Më tej autori është ndalur te përemrat dëftorë (*njiký, qiký, kjo, njikjò* etj.) e përemrat apo mbiemrat përemërorë, si ato pyetës (*kush? cilli?*) të tjerë (*tjeter, tjeterkùsh, gjithkùsh, shumkùsh* etj.).

Klasa e foljes zë vendin kryesor në përshkrimet morfologjike. Ajo nis me kategorinë e kohës dhe ndarjet: e tashme (*une shiqoj*) - e shkuar (aoristi i parë: *une shiqova*, aoristi i dytë: *pata kênë*; e pakryera: *une shiqojshe*; e kryer: *une kam shique*; mëse e kryer: *une kishë shique*) - e ardhme. Të bien në sy format dytësore të së ardhmes të ndërtuara njëra mbi bazën e paskajores gege të tipit *me pasë (unë kam me pasë) shique* dhe tjetra e mbështetur në formën e pashtjelluar të tipit *për të larë (kam per të pasë shique)*, duke na dhënë një prirje përbashkuese të shqipes për të dy dialektet. Me shënime të veçanta ai ka shpjeguar dallimet mes kohëve të gjuhës shqipe në një anë dhe italishtes në anën tjetër. Në lidhje me format e mbipërbëra (*kam pasë kênë, kishë pasë kênë*) ai konstaton se “në thelb bëhet fjalë për një të kryer e mëse të kryer prej ku aksioni transferohet në një kohë më të largët” (1931:46). Në ndonjë rast autori i gramatikës është përpjekur të hyjë edhe në kuptimet e kohëve p. sh. ai dallon aoristin me

kuptimin e kohës së kryer (*shiqova = kam shique*). Kuptimi i së ardhmes, sipas Cordignano-s, mund ta shprehë edhe një e tashme e paraprirë me ndajfoljen *tesh: tesh po vî* (1931:47). Autori ka veçuar gjashtë mënyra për foljen: *dëftoren, lidhoren, kushtoren, dëshiroren, habitoren, urdhëroren*.

Le të ndalemi në disa forma karakteristike të ndërtimit të këtyre mënyrave. Kështu mënyra kushtore nuk paraqitet me forma të veçanta gramatikore, por shihet më shumë si ndërtim sintaksor me kuptim të kushtëzuar. Sipas Cordigani-s e tashmja e mënyrës kushtore është dhënë me dy forma, njëra e ndërtuar me paskajore e tjetra me lidhore: *me kënë unë* dhe *t'ishe unë*. E njëjta logjikë ndiqet edhe për kohët e tjera të kësaj mënyre. Edhe e ardhmja e tipit *n' kjos* mund të përdoret sipas tij edhe thjesht si një kushore (*Me kënë ti i mirë, kihse me ta bâ at nderë*, 1931:51).

Nga format e pashtjelluara Cordignano dallon infinitin e tashëm (*me kënë*) dhe të shkuar (*me pasë kënë*); gerundin e tashëm (*tuj kënë*) dhe të shkuar (*tuj pasë kënë*); substantivin verbal (*të kënëunit*). Pjesorja del me dy forma, një të shkurtuar (*kënë*) dhe një tjetër të gjatë (*kënnun*). Edhe në këtë rast autori e ka shoqëruar klasën e foljeve me shembuj konkretë të zgjedhimeve të foljeve të rregullta, në mënyra e kohë të ndryshme. Duke ndjekuar të njëjtin parim, vetëm pas paraqitjeve të këtyre paradigmave, autori bën vërejtjet me karakter teorik. Cordignano ka tërhequr vëmendjen edhe për disa ndërrime fonetike që mund të pësojë tema e foljeve në ndonjë prej zgjedhimeve. Kështu ai ka vënë re se foljet me temë në zanore pësojnë zakonisht ndryshime fonetike në zanoren e temës së tyre, ndërsa foljet e zgjedhimit të dytë (*me çilë*) që dalin me temë në bashkëtingëlloren **t** e ndryshojnë atë në **s** p. sh.: *me paditë- une padis*. Siç shihet edhe nga shembujt e dhënë, formë përfaqësuese e foljes është marrë infiniti, ndikimi Cordignano-s nga formimi i tij lingistik. Në ndonjë rast ndërrimi bashkëtingëllor mund të shoqërohet edhe me ndonjë ndryshim zanor nga **a** në **e**: *bërtàs- bërtët*. Një vend më vete zënë foljet reflexive, si: *levdòhem, levdòheshe, u levdoshe, u levdokam, levdò-u, m' u levdue, tuj u levdue, per t' u levdue* etj. apo foljet pasive. Për këto të fundit Cordignano shënon: “nuk janë gjë tjetër vetëm një pjesore [...] e një foljeje e ndjekur nga folja *me kënë*” (1931:70): *me kënë rrahë, unë jam rrahë, une kjeçë rrahë* etj. Si zë më vete janë trajtuar foljet e parregullta: *me ardhë, me dalë, me dashtë, me dekë, me dhanë, me hanëgër* etj. Me interes janë edhe disa trajtime teorike për kuptimet e kohëve të foljeve. Sipas Cordignano-s për të shënuar të tashmen, kur akti është në veprim, përdoret ndërtimi *jam kahë bâj = po bâj*. Ndërsa foljet në kohën e pakryer, të kryer, e kryer e thjeshtë në tregimet popullore apo përrallat përdoren për të shënuar një veprim të ndodhur ose

për të shënuar një kusht në të shkuarën¹⁹. Mendojmë se një prej meritave të kësaj gramatike qëndron në faktin se folja nuk është trajtuar vetëm sipas ndërtimit të formave gramatikore, por gjerësisht autori i saj është marrë me kuptimet kohore dhe ato modale, gjë që mendojmë se i tejkalon caqet e një gramatike thjesht me karakter praktik. Në vijim Cordignano ka tërhequr vëmendjen rreth disa rasteve të përdorimit të formave të së ardhmes me kuptimin e nevojës apo domosdoshmërinë, si: *do të përpiqem me at nieri, per me pá se kû jena, pse ndryshej mund t' m' hupin një pare e madhe* (1931:83). Mënyra habitore, sipas autorit, nuk është vetëm mënyra që tregon habi, po përmes saj “rrefyeshi ose ai që bën gjykimin mbi një fakt ose një person, pasi ka arritur atë pikë të veçantë, e thekson atë, e bën atë të spikasë: *Kênka ashtû pernjimênd!*²⁰”

Mënyra kushtore e konceptuar, siç e theksuam më lart, më shumë si ndërtim kushtor sesa si mënyrë morfologjike, është klasifikuar në katër tipa:

- a) Tipi i realitetit ku premtimi, megjithëse është deklaruar në formën e një hipoteze, fakti i mësipërm pranohet gjithashtu si i sigurtë dhe real: *në kjojë se kà një Zot, ká një drejtsí.*
- b) Tipi i dytë që e lë të paqartë apo të mundshëm realitetin e premtimit. Për të shprehur këtë kuptim përdoret aoristi i paraprirë ose jo me lidhëzën kushtore **po**: *(Po) hangre fikun, vesh losnikun.*
- c) Tipi i eventualitetit, që e paraqet si të mundshëm premtimin dhe konsekuencën: *N'hypish në maje t'Kunorës, mund t'a shofish fushën e Jakovës.*
- d) Tipi i irealitetit, kur premtimi është i pamundur të realizohet: *Po t'ishte Zoti i rrêishem, s'kishte me qindrue kurr farë së vërtete*²¹.

Pjesë e rëndësishme e gramatikës së një gjuhe është padyshim edhe sintaksa, prandaj edhe Cordignano nuk e ka lënë aspak pas dore atë në gramatikën e tij. Përfshirja e sintaksës në këtë gramatikë ka qenë edhe pjesa më e vlerësuar e përshkrimeve me karakter gramatikor. Sipas K. Gurakuqit “në përpilimin e syntaksit, qi âsht copë e pa-ndame e pjesës së parë; rregullat e dhanuna prej tij mbi përdorimin e kohëve të ndryshme të verbit, mbi mënyrët, mbi bashkërendimin, mbi përdorimin dhe fuqin e rasave t'êmnit, etj. janë gadi ekskluzivisht prodhimi i tij, mbassi shumë pak kemi shkruem deri më sot mbi këtë pjesë të dytë të gjuhës s'onë. Me këtë punë

¹⁹ Shënimi 1, *vep e cit.*, f. 80.

²⁰ *Po ai, po aty*, f. 85.

²¹ *Po ai, po aty*, f. 88.

na jep né një udhëheqje për të bâm studime ma të thella mni gjuhë dhe mbi përdorimin e saj²²”.

Siç e përmendëm më lart, edhe në këtë ndarje nga praktika kalohet në përgjithësimet me karakter teorik. Përshkrimet nisin me shembuj të vjelë nga Pashko Babi dhe Ndre Mjedja, në funksion të të kuptuarit të mënyrës së përshtatjes së dy gjymtyrëve kryesore, kryefjalës dhe kallëzuesit nga lexuesi. Zënë vendin më pas struktura me ndërtime asnjënjëse, përdorime të rasave të ndryshme po nga dy autorët e sipërpërmendur duke e ndarë se çfarë i përket njërit autor dhe çfarë është e tjetrit. Merita e kësaj gramatike dhe e autorit të saj, qëndron në këtë rast në dhënien e shembujve në origjinal dhe në italisht. Përkthimet dhe përshtatjet janë bërë nga vetë Cordignano. Ai ka veçuar disa përdorime të së ashtuquajturës “caso continuato” me të cilën ai kupton rastin “kur shumë emra e mbiemra apo përemra ndjekin njëri-tjetrin të drejtuar nga e njëjta folje apo parafjalë (1931:98). Më pas janë radhitur përdorimet e mbiemrit në shkallën sipërore. Një kujdes autori ka treguar edhe për përdorimin e trajtave të shkurtra (ose siç i quan ai pronomi enclitici). Nga shembujt ai ka dalë në disa përfundime në lidhje me domosdoshmërinë ose jo të përdorimit të këtyre trajtave. Sipas tij, “Përemri enklitik, **e**, **i** (kallëzore) duhet domosdoshmërisht të përdoret kur i referohet një emri ose shprehjeje në një fjali tjetër” (1938:103). Në fjali një rol qendror zë folja-kallëzues, prandaj Cordignano i ka lënë hapësirë të veçantë përdorimit të foljeve në kontekste të ndryshme, ku shfaqen edhe kuptimet e kohore e modale, ndërëmbimët mes tyre dhe operatione të tjera morfosintaksore. Vend kanë zënë përdorimet e mënyrës kushtore, dëshirore etj. Cordignano ka shënuar edhe rastet kur dëshirorja bashkëshoqërohet me mënyrën habitore. Nuk janë lënë jashtë as format e pashtjelluara e përdorimet e klasave të tjera. Në secilin rast teorik nuk mungojnë shembujt e nevojshëm që e bëjnë më të kuptueshme sintaksën e gjuhës që bën objekt mësimi.

Pjesa e dytë (“Saggi di letteratura”) ka të përfshira brenda saj, për arsye studimore, pjesë nga letërsia popullore dhe ajo e kultivuar. Në këtë ndarje nuk ka më ndërhyje teorike, por vetëm disa shënime të shkurtra ku janë dhënë më shumë shpjegime fjalësh e shprehjesh dhe pak vërejtje me karakter gramatikor, si sqarime për disa forma të shumësit të emrave (*krue*, *kroni*, *kroje*; *kokël*, *kokla*, *kokla-t* etj.); variante fonetike të disa fjalëve (*qartas*, *kjartas* nga *i*, *e* (*kjartë*); edhe shënime për disa forma që ai konsideron si dialektore (si *tuke=tuj*; *grua* forma toske për *grue*; *muluen-mluen-mluenes* etj.). Për elementet turke si fjalë apo formante autori ka

²² K. Gurakuqi, *pun. i cit.*

ndërhyrë edhe me shpjegime të shkurtra. Kështu shënon burimin turk për ndajshitesën *-xhi*; jep ekuivalencat shqipe për ndonjë fjalë me këtë burim, si: *sabah-agim* etj. Nganjëherë hyn edhe me disa interpretime tekstore p. sh. për trajtën *e âma* Cordignano tërheq vëmendjen rreth forcës së nyjës që paraprin emrat që shënojnë lidhje farefisnore.

Meqenëse teksti është hartuar edhe për të huajt që duan të mësojnë shqipen, Cordignano, që dëshmon se e njeh edhe kulturën shpirtërore e zakonore shqiptare, ka bërë edhe interpretime me karakter etnolinguistik, si për *Zanat*, *Orët* ose për fjalën *drekë* e cila, sipas tij, në gegërishten veriore nënkupton “drekën mortore”; shpjegimi i legjendës së Rozafës etj. Disa shënime janë edhe me karakter historik.

Dalëngadalë është zgjeruar rrethi i autorëve nga janë marrë tekstet me krijimtarinë e Mark Harapit, Hamid Gjylbegajt, Mati Logorecit, Rrok Zojzit, Ndre Zadejës. Këto pjesë mund të jenë produkte origjinale të autorëve të përmendur më lart, por edhe përralla a gojëdhëna të mbledhura në popull prej tyre. Cordignano i ka bërë në këtë mënyrë edhe një shërbim të mirë letërsisë shqipe, e ka promovuar tek të huaj këtë pasuri bashkë me krijuesit e saj. Edhe në këtë pjesë Cordignano punon me metodologji. Në tekstet popullore në shumë raste është shënuar edhe zona së cilës i përkasin. Këto saktësime do të mund të ndihmojnë atë që do të punojë me këtë gramatikë, për të kuptuar edhe disa dallime gjuhësore mes zonave të ndryshme. Tekstet janë në të dyja gjuhët, në shqip dhe italisht e janë përzgjedhur në prozë dhe poezi. Megjithëse ai e quan “përkthim të lirë” (traduzione libera) për pjesët në prozë mund të konstatohet se teksti ka ardhur dhe është përshtatur mirë në italisht. Me mjaft art janë përkthyer poezitë, megjithatë kjo përqasje ndërgjuhësore përbën një argument që mund të trajtohet në një rast tjetër. Në fundt të poezive ka edhe shënime kritike, por që i përkasin një lëmie tjetër.

Pjesa e tretë (“Frazeologia e proverbi”) është e pasur me frazeologji të mbledhura nga P. A. Serreqi e Pashko Vasa dhe proverba nga Frang Bardhi. Ato që Cordignano i quan frazeologji janë më shumë shprehje që shërbejnë për të komunikuar në situata të ndryshme, por edhe idioma të përshtatura në shqip. Kjo është një punë e nisur nga P. A. Serreqi, por edhe Cordignano ka meritën e tij për sistemimin dhe saktësimin e materialit. Janë menduar e plotësuar me shprehje rreth 18 situata të tilla, si: biseda, këshilla, për të pohuar, mohuar apo dyshuar; për të falenderuar; për t’u bindur; për të komunikuar në raste gëzimesh, hidhërimesh etj. Edhe proverbat e vjela nga A. Serreqi klasifikohen sipas 10 situatave: gjendja e jetës, vese, virtyte, urime etj. Një syth më vete janë proverbat nga fjalori i Frang Bardhit dhe frazeologjitë e vjela nga gramatika e Pashko Vasës.

Sintagmat e shkëputura nga Pashko Vasa janë klasifikuar për qëllime praktike, për të parë përdorimin e ndajfoljeve, parafjalëve, lidhëzave etj. Gramatika mbyllet me listën e librave të konsultuar.

Si përfundim mund të themi se gramatika e Fulvio Cordignano-s e vitit 1931 renditet në vazhden e gramatikave të shqipes të hartuara për të huajt, e nisur kjo traditë që nga gramatika e vitit 1716. Ky manual edhe sot është një model i mirë për mësuar një gjuhë të huaj. E konceptuar si gramatikë e destinuar më shumë për të huajt, i lë më shumë hapësirë anës praktike, nisur nga parimi se një gjuhë e huaj mësohet më shpejt me anë të fjalive, teksteve letrare apo joletrare dhe nga teksti kalon drejt teorisë me metodën e vëzhgimit në mënyrë kritike të faktit gjuhësor. Shembujt e shumtë të emrave, foljeve që lakohen e zgjedhohen i jep mundësi lexuesit të praktikohet edhe vetë sipas modeleve të paraqitura. Cordignano është përpjekur t'i vijë lexuesit në ndihmë me të dyja gjuhët gati me të njëjtën peshë, si me shqipen ashtu edhe me italishten. Autori i gramatikës e ka njohur mirë shqipen, pasurinë e saj me modesti është përpjekur që t'i shfaq këto vlera në punën e tij. Kjo gramatikë mbart vlera edhe për historinë e letërsisë, sepse në faqet e saj janë publikuar edhe krijime origjinale të Mjedjes, disa prej të cilave nuk e kishin parë dritën e botimit në ndonjë organ.

Megjithëse një gramatikë e gegërishtes Cordignano është përpjekur të hartojë një gramatikë jo të bazuar mbi një të folme, por mbi forma të përgjithshme geqe e në disa raste ka provuar të dalë edhe përtej këtij dialekti.

BIBLIOGRAFI:

- Cordigano, Fulvio, *Lingua albanese (dialeto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, fraseologia e proverbi*, Ulrico Hoepli, Milano, 1931.
- Cordigano, Fulv, “Rreth një çështje gramatike”, në *Vullneti i popullit*, nr. 333, 27 maj 1931, f. 9; nr. 334, 28 maj 1931, f. 3.
- Gurakuqi, Karl, “La Lingua Albanese”- Fulvio Cordignano S. J., në *Vullneti i popullit*, nr. 314, 3 maj 1931, f. 2.
- Elsie, Robert, *Historical Dictionary of Albania*, Lanham, Maryland, 2010.
- Gjinaj, M & Mele, M. & Elmazi, M., *Bibliografi e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)*, Tiranë, 2010.
- Kastrati, Jup, *Histori e gramatologjisë shqiptare (1635-1944)*, Rilindja, Prishtinë, 1980.
- Osmani, Tomor, *Gramatika të gjuhës shqipe të traditës (Refleksione)*, Botimet Shkodra, Shkodër, 2020.
- Pellegrini, G. Battista, *Avviamento alla linguistica albanese* (Rende-Cosenza, Centro Editoriale e Librario dell'Università della Calabria, 1998).
- Pepa, Simon, “Atë Fulvio Kordinjano për kulturën shqiptare”, në *Gjurmime kulturore*

- (Studime, artikuj, kumtesa), Camaj-Pipa, Shkodër. 2000, f. 27-35
- Peters, Markus W. E. , Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën: "Tipografia e Zojës së Papërlyeme" në Shkodër (1870-1945), Shoqata e Jezuitëve, Tiranë 2016.
 - Petrotta, Gaetano *Saggio di bibliografia albanese (1500-1930)*, Palermo 1931.
 - Rrota, Justin, "Analyzezimi i rasavet t'emnit e zhvillimi historik i tynve", *Hylli i Dritës*, Shkodër, Vjeti VII, 1931, nr. 5, f. 252-267; nr. 6, f. 315-327.
 - Rrota, Justin, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
 - Topalli, Tefë, *Gjuhë e polemikës dhe e apologjisë: skandali Cordignano: Filip Fishta, Nikë Barcolla, Profesorët e Lyceut të Shkodrës, Ndre Zadeja*, Shkodër, 2016.

90 years from the life of a grammar

ABSTRACT

90 years ago in Milan the grammar "Lingua albanese (dialetto ghego): Grammatica, saggi di letteratura, phraseology and proverb" by the Italian missionary Fulvio Cordignano S. J. was published by the prestigious publishing house Ulrico Hoepli (Milan, 1931). Fulvio Cordignano is known especially in albanology in the field of history, lexicography and onomastics. The object of this study is grammar published in 1931 which has not been used as a textbook, however this does not make this text any less valuable. Grammar is divided into three parts: the first part ("Cenni grammaticali", pp. 3- 132) carries the main theoretical weight of this manual; the second part ("Saggi di letteratura", pp. 135-227) includes texts from popular literature with folklore, fairy tales, but also parts of cultivated literature; the third part ("Phraseology of proverbs", pp. 235-308) contains phraseology and proverbs by authors such as P. A. Serreqi and Pashko Vasa and Frang Bardhi. Conceived as a grammar intended more for foreigners, it leaves more space for the practical side, based on the principle that a foreign language is learned faster through sentences, literary or non-literary texts and after the text comes the theory. In conclusion it can be said that even today this grammar is a good model for learning a language.

Tefë TOPALLI

GJUHA POETIKE NË POEZITË E ARBEN PRENDIT

Arben Prendi është tashmë një zë i njohur në poezinë tonë bashkëkohore. Prej më se 25 vjetësh ai ka publikuar përmbledhjet me poezi: *Thirrja e horizonteve* (1989-95); *Të shtunën ndeze një qiri* (1996); *Vashat nguten me u ba gra* (1998); *Qirinj të ndezun për të gjallët* (2000); *Akuarelet e jetës dhe të vdekjes* (2008-2015); *Fushnajave të amshimit* (2010) dhe *Pasqyra e kohës* (2015). Duke qenë pedagog i departamentit të Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” prej rreth tre dhjetëvçarësh, ai ka edhe tregues mjaft të lartë të veprimtarisë studimore kushtuar veprave letrare dhe autorëve në zë të letërsisë shqiptare në Shqipëri e Kosovë, nga trashëgimia artistike e traditës si dhe kjo bashkëkohore. Si lektor i letërsisë gojore, ai ka sjellë këndvështrime të reja për vendin që zë kjo prodhimtari në gjerdanin e kulturës sonë kombëtare. Në vitin 2011, poeti ynë i ri doli para studiuesve me përmbledhjen "*Tekste në kontekste*"¹, ku me një paraqitje të thukët e aq të kursyer në planin e gjuhës, arriti të ravijëzojë kuintesencën e 24 shkrimtarëve: prozatorë e poetë, nga më të mirët - të ligjëruar e të ndaluar pothuajse për gjysmë shekulli në fondin e letërsisë e kritikës letrare. Vetë disa vjet më vonë, A.Prendi u radhit ndër studiuesit me autoritet të shumë autorëve dhe i veprave të tyre, si kritik edhe ridimensues i vlerave artistike, duke thënë fjalën e tij si kritik i matur, me studimin “Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor”² si dhe me vëllimin studimor "Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore – studime".³ Ai po dallohet në lëmë të botimeve edhe si kurator i krijimtarisë vetjake: ka përzgjedhur frymëzimet më të mira prej të gjithë krijimtarisë, në Vëllimin I "Vepra poetike".⁴

¹ Arben Prendi, *Tekste në kontekste*, Shtëpia Botuese "Naimi", Tiranë, 2011.

² Arben Prendi, *Ndërthurja e poetikave dhe çkodimi i realiteteve metafizike në romanin bashkëkohor*, Shtëpia Botuese Fiorentia, Shkodër, 2015.

³ Arben Prendi, *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore - studime*, Fiorentia, Shkodër, 2017.

⁴ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018.

* * *

I. Kredoja gjuhësore

1. Veçoritë e vjershërimit

Në këtë shkrim do të ndalemi vetëm në veçoritë e vjershërimit të këtij poeti, për të cilin mendojmë se ka gjetur e do të gjejë hapësira jo aq të rrahura nga krijues bashkëkohës të talentuar që po begatojnë letërsinë tonë në gjininë poetike. Në vështrimin e tij fokusohet koha, e sotmja dramatike e tragjike, perspektiva me dritë dhe errësirë, hovet shpirtërore dhe zhgënjimi, buzëqeshja e lotët, dënësia dhe euforia, psika shoqërore dhe individualiteti i vrarë. Në këtë vështrim, rrafsh me realitetin, ai është përpjekur ta prekë atë, ta godasë për ndryshim e të mos vishet asnjëherë me rrobën e të fantaksurit ëndrrimtar, larg asaj që sheh syri, që gjykon mendja në fluturim dhe grishin sirenat...

Puna e shkrimtarit, dëshmojnë stilistët, më së pari, është punë me gjuhën, si zgjedhje e menduar që do të veshë idetë dhe shpirtin e krijuesit. Lindur bash në vitin e kodit drejtshkrimor dhe normës standard të shqipes letrare, A.Prendi, nuk mungon ta shpallë atë që në këtë syth po e quajmë *kredo gjuhësore* të krijimit. Në këtë kohë të amullt - *edhe të vetëgjyqësisë së paanë* - liria pa kufi, ka prekur edhe fushën e krijimtarisë: sipas standardit, *antistandardit*, idiomës së përzier dialektore, deri edhe në shëmti gjuhësore, që nuk kanë asgjë të përbashkët me stilin, estetikën dhe shprehësinë. Prandaj dhe poeti i ri e ndjen se duhet të deklarojë diçka, përndryshe të shpallë kahjen gjuhësore, nga do të mbajë në këtë udhëkryq: vetë i formuar kulturalisht brenda njësisë linguistike të normuar, ndërkohë që shpallet folës i lindur i dialektit të gegërishtes! Shtojmë se këtij statusi i shtohet edhe njohja e thelluar dhe studimi që u ka bërë autorëve gegë të traditës. Të gjitha këto kanë ndikuar që A.Prendi, në krye të herës, kur merr të hartojë vargje, të ngulet tek problematika që ka ai dhe duhet të ketë secili bashkëkohënik i tij: "*Çështje problematike e poezive mbetet gjuha e shkrimit. Strukturat gjuhësore shkojnë gjithmonë kah strukturat e gegnishtes. Gegnishtja është gjuha e tyne e natyrshme, e leme, për shkak të formimit në gjuhën standarde shqipe, shkollimi, leximi i letërsisë së shkrueme me këtë normë, ndodh fenomeni i përziemjes herë-herë mes gegnishtes e gjuhës standarde.*"⁵ Ky pohim i Arben Prendit është larg gjykimit të bërë para një shekulli nga Faik Konica se proza qenkësh shartuar për toskët, kurse poezia vetëm për gegët! Atij i duket se kjo është gjendja ku ndodhet gjuhësisht: midis një dialekti dhe standardit, ndër të cilët, të parin e quan *të ndëshkuem*, kurse të dytin *të detyrueshëm*. Ai ka

⁵ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 7.

lindur bash në vitin kur u sanksionua gjuha letrare, por ka mësuar se po në atë vit, shkrimtari Kolë Jakova, pas dy vëllimeve të romanit satirik "Fshati midis ujërave",⁶ në variantin e shkruar të veriut, të tretin e hartoi sipas shqipes së njësuar, ashtu edhe me jo pak "shartime" trajtash sintagmatike e leksikore jo aq të natyrshme, gjeneruar prej një dramaturgu me vepra skene në dialekt. Me siguri, kështu shpjegohet pse autori përdor atributet *të detyruem e të ndëshkuem* - si dy pamje që qenë shfaqur njëherësh në jetën e gjuhës sonë. Ky fakt mund t'i kujtojë atij edhe kohën kur artistë të Estradës së Shkodrës nisën të performojnë skeçe, kuplete⁷ e komedi në normën e folur, kur vetë ky interpretim bëhej burim humori për konglomeratin fonetik të kolazhit të idiomës shkodranishte me njësinë e normës! Veçse, zënia e këtij pozicioni, për poetin, nuk është qëllimkeq, mbasi ai kthehet të nënvizojë se nuk i ka shkuar ndërmend se me këto poezi po mkamb dialektin gegë, as nuk ka shkruar të përmbysë gjuhën standarde, por është udhëheqë prej ndjenjës së leme gjuhësore dhe nga shprehja e përfueme prej letërsisë së autorëve të mëdhenj gegë, prej Buzukut deri te Camaj. Letrari ynë flet për vete, për një përzgjedhje të tijën, edhe pa qenë konsequent në mbarë krijimtarinë dhe nuk shpreh mendime kategorike që duhet bërë ndryshe, por, si gjithë geni i poetëve, dëshiron të gëzojë lirinë e frymëzimit sipas kodit të tij, pa droje për kanonet e normës....megjithëqë sikur e ka rënduar veten me shfaqjen atavike të shenjës diakritike të hundorësisë, të shkurtësisë e të zgjatësisë, për zanoret *â, á* (të bājë, mâ shpesh, i rândë, âsht, asgjâ, thám) dhe *ê, é* (brêj, njëni, ndêjë, me lé, me blé), *î* (flî, mbî). Nuk e quan *mëkat* se i shtron vargjet në idiomën standard apo gegnisht, nuk vuan qoftë edhe kur në mes të poezisë kërkon e gjen shprehësi stili me fjali a fraza dialektore, jo rrallë edhe me leksema apo paskajoren e *qitun përjashtë* standardit, si në strofën e vjershës "Në ndërrim të motit":⁸

"Kërmijtë dhe doktorët e shkencave enveriste
hyjnë në guackat e zyrave
me mbledhë mazën e parimeve
të shkrime
ndër shkrime....(1996)

⁶ Kolë Jakova, Fshati midis ujërave/ujërave, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1972.

⁷ Ferdinand Leka, Fjalor i termave të letërsisë, Infobotues, Tiranë, 2013, f. 221. [Shkruan autori: "Kuplet-i...këngë e ndarë në strofa, me karakter humoristik ose satirik, që këndohet në estrada, opera e vodëvile.]

⁸ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Të shtunën ndize një qiri), f. 117. Fiorentia, Shkodër, 2018

Tek stilema *mazë e parimeve*, autori pëlqen sinonimin e fjalës "ajkë-a", jo vetëm për të sjellë një leksemë të gegnishtes, por për ta përdorur atë si shprehëse edhe në pajtim me indin e paskajores *me mbledhë*, ashtu edhe me fjalët homofone të *shkrime* dhe *ndër shkrime*.

Në mbyllje të këtij sythi, pohojmë se vjershërimi i poetit A.Prendi, anon më tepër nga lëvrimi i vargut në idiomën gege, pa e kundërvënë as me prodhimin letrar të vetes gjatë fillsave të artit të tij, as me ndonjë krijues të kësaj kohe mjaft të begatë me botime në këtë gjini. Ai nuk mund të quhet prijatar i vjershërimit në idiomën gege, por ecën pas tyre, me individualitetin e tij, që rreket të jetë vetëm i tij, në këtë akt të ringjalljes së fjalës, si mund të thirret ky anim gjuhësor në lëvrimin e artit në dialektin e veriut. Prandaj dhe në fjalësin e poetikës së tij gjejmë leksema të tilla të cilat jetësohen më tepër në arealin gjuhësor verior, si: *blatoj, njomzak, sheston, ligisht, rrajëzon* (nxjerr rrënjë), *u mitos* (u bë mit), *kundron, dënese, kuiste, hukat, pendla, shkapet, i epshëm, rreket, rrokatet, e ajtun, uron, përzhitje, vorbullojnë, thalb, kapërdij, skamnor, zymti, lëmekem, vrik, atbotë, përhiq, guf, i gufmuem, dorcë, i ndragun, humneros, rubë, i kërthnestë, idhtësina* etj.etj.

2.Në kërkim të poetikës

Në mënyrë të figurshme, ashtu si fëmijët duan e kërkojnë hapësirë, kur hedhin hapat e parë, ashtu edhe poetët në vjershat e fillimit sikur i thërret muza poetike të dalin në horizonte, në rrafshet pa kufi të frymëzimit, mbasi vetëm kështu krijojnë edhe një marrëdhënie me fushën e lirë të artit. Në këtë çapitje jo aq të sigurt, poeti Prendi është orientuar nga kodi standard i gjuhës dhe është përpjekur t'i qëndrojë besnik në të gjitha nivelet që kërkon stili vetjak i tij, me të cilin, në vëllimin e parë të veprës poetike ka zënë plot 100 faqe me vargje. Këtu ka gjetur ai shprehjen poetike dhe poetizimin e fjalëve, një kërkesë bazë e poezisë, që nis me stilema të tilla, si: *mik i horizontit, stis kod marrëveshjeje, mitër krijimi, mëngjes i lagur, galopon mjegullës, qerre akulli, yje bizhu, të puthura rrëqethëse, të gëlltiti rruga, qiell lakuriq, tërhuzje⁹ e vetullave, musone e dashurive, kurm i virgjër, veton buzëqeshja, zë i burgosur, panxha perandorish, hundore naive, frushullimë urdhërash, tym i ozontë, guacka fjalësh, ndërmendje diskrete, shi peniciline, u ngërdhësja miqësisht, dimër mornicash* (krhs:

⁹ tërhuzje-ja, fjalë e rrallë e dialektit të gegërishtes, tek Fjalori i vitit 1954, me kuptimin: tremb, tërhuz - përdoret për kalin kur e zë rrebulli e nuk i shtrohet kalorësit e hidhet përjetë; thuhet edhe për njerëz kur u hipen damari e zemërohen: tërhuzet. Fjalori i vitit 2006 shton edhe kuptimin: tremb kalin, e bëj të mos i shtrohet kalorësit; në kuptimin figurativ, edhe tërbohem, turfulloj nga zemërimi.

mornica dimri), *fëmijë plak, smeralde harrese, kostum me lara dielli, gjak i së panjohurës, ëndrra të plogështa, veshje hibride, buis shiu, fëmijërisht e brishtë, dimër harrimi, netët e sedefta, ditë hirnake, erë e lagur, qen i zemërimit, gjamime të mysta, fusha të djerra, dëshpërima kukuere, shpërtheu dritshëm, thellësitë e gërmadhta, mokra trishtimesh, qeshnin fëminisht, ishuj mendimesh, prishur duhet, tym i fildishtë, humbja e fituar, burrec politik, mbramje e mufatun, shije eterike, rreze të pluhurta, drojë e vestë, qetësi anemike, kafkë e xhamtë* etj. etj. Edhe në një titull vjershe, si "Jeta asht e shkurtë,/ Bora ra gjithë ditën", ngjet e papritura e ngjizjes së përbërësve në stilemë: lexuesi mund të shqiptojë menjëherë sentencën latine "*ars longa*", nga thënia proverbiale e Hipokratit dhe përmendur nga filozofi romak, Seneka, *Vita brevis est, longa ars*.

"Prania e ndërtimeve stilemore brenda vargut, grupeve të tyre, apo në shtatin e tërë poezisë, sjell ngjyresën stilistikore të krijimit, ndikon në shprehësinë dhe ngre nivelin e vjershërimit. Na mjafton të shënojmë se në frazën e fundit të vjershës "Shurdhëri"¹⁰, emri "tejjetë" dhe ndërrimi i rendit të drejtë të përbërësve te folja "prishur duhet" (duke kaluar theksi ritmik e semantik mbi pjesorën), e bën këtë strofë aq të veçantë në gjithë trupin e poezisë.

Ndaj si në një tejjetë të shkretë,
gjithçka të duket;
dhe për të jetuar përsëri,
kjo shurdhëri e para, prishur duhet...." (1995)

Me këtë botim të parë, lexuesi do të ndahet me mbresa të veçanta për poezinë kushtuar motrës (motrave- cilatdo të jenë!), një krijim i frymëzuar, protestë sociale për vendin e femrës në shoqëri, shtypur e diskriminuar nga punët e rënda në shi e në erë, ngarkuar me dru dhe *mardhur*, që pret me sëpatë shkurre e cungje dhe e çon jetën e kërrusur nga pesha; ndërsa njeriu i sotëm ka shkuar në hënë e për në Mars bën gati anijet kozmike! Është një motiv ndocgjetian, ku motra e Ndocit ul kokën nga nyjet e Kanunit,¹¹ që e përshkojnë edhe në dasmën e saj; kurse *motra* e Arbenit përkulet më dysh nga barra e rëndë e jetës.

Në vëllimin ku jehojnë thirrjet e horizonteve, poeti i ri Prendi ngjet me versnikët e tij: do të përfshijë gjithçka, hap krahët si vargjet, pa lënë t'i

¹⁰ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I (Thirrja e horizonteve)*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 105.

¹¹ Ndoc Gjetja, *Biri i njeriut - Poezi të zgjedhura (Në dasmën e mortës)*, Toena, Tiranë, 2004, f.44.

ikën asgjë nga Toka e Qielli, Dielli e Hëna, stinët dhe ëndërrat, era e deti; por në qendër ka njeriun, nga fëmijët e të rinjtë, moshat e mesme dhe pleqtë - burra e gra, që përballen me gëzime e fatkeqësi, lot dhe brenga, vuajtje e dëshpërime, duke humbur shpeshherë edhe shpresën. Rrallë, autori merr joll¹² e i këndon gjuhës shqipe, Buzukut, alfabetit, Gj.Fishtës, Samsonit e Dalilës, deri edhe Dylqinjës së Tobozës. Në këtë qerthull të ngatërruar të jetës, ai ka vënë në qendër dashurinë - si leitmotiv të qenieve njerëzore, si e vetmja forcë eprore që do ta çojë përpara njerëzimin. Nuk mungojnë në këtë vëllim edhe pak vjersha me nuancë politike, por me një sharm therës. Madje, dashurinë, ai e kthen në kredo të jetës së njeriut:

Të gjithë nga pak tashmë kemi kuptuar:
Puna, shkathtësimi i gjymtyrëve ndihmuan vërtetë,
po dashuria, e para...e fundit...
ajo na kthen në njerëz. (pa datë...) ¹³
* * *

3. Takimi me rimën...

Ose më mirë: rimat që takojnë poetin...

Arben Prendi i takon brezit të poetëve "të çliruar" nga kanonet e rimës, të cilat edhe i kanë quajtur "shtrat të Prokustit"; krijojnë pa numëruar rrokje e gjysmëtinguj, jo rrallë edhe pa iu bindur shenjave të pikësimit! Dukuria e këtij drejtimi letrar e ka zanafillën tek formalizmi rus dhe themeluesi i saj Viktor Shklllovskij, 1914.¹⁴ Janë shkolla poetike, që tek ne kanë zbritur dhjetëvjetëshat e fundit në mbretërinë e vjershërimit. Kështu, tek krijimi në vargje i përmbledhjes që po shohim, gjejmë tek A.Prendi poezi pa asnjë rimemë, vargje që rimojnë tepër rrallë, ashtu edhe pak vargje me asonancë apo afri rime. Natyrshëm që kjo teknikë vargëzimi, si liri poetike e pakufizuar, i ndihmon krijuesit që të shtohen variantet e fjalësit të rimemave, larg atyre foljore dhe modeleve klishe, që e zbehin vargun dhe gjuhën poetike, e atrofizojnë përgjithësisht atë. Kështu, tek poezia "Baladë e sandaleve të prishura", brenda një strofe, dalin dy ndajfolje: njëra mënyre, tjetra ndajfolje pyetëse, një kombinim jo i lehtë në një strofë me rimë të rreptë:

¹² joll (tq.), udhë, hov (marr joll).

¹³ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I (Dashuria më bën njeri)*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 96.

¹⁴ Ag Apolloni: *Dashunia fillon prej gjysmës (P.Shllaku)*, Prishtinë, 2019, f. 5.

Të dashurat e mia lëkurore si më braktisët papritur <i>kështu?</i> Rripat, mbërtheckat fine, u këputën, humbën, <i>ku?</i> ¹⁵	Mirazheve, mirazheve, vërtitemi, e s'dimë ç'duam e ç'bëjmë në këtë <i>jetë</i> , e s'dimë në jemi ata që jemi në të <i>vërtetë</i> ... ¹⁶
---	---

Nuk mund të takojmë, brenda këtij vëllimi strofa radhazi me rimema, ka kalime nga rima të rregullta, në asonancë, në strofa katërshe pa asnjë rimë, pa mundur t'u përcaktojmë skemat tradicionale, siç jemi mësuar nga vjershërimi i traditës sonë.

Sot duhet të shihemi <i>patjetër</i> , se, o ç'mërzi, jeta pa <i>ty</i> . Më ngjan bota krejt <i>e vjetër</i> , Më ngjan bota krejt pa <i>sy</i> . ¹⁷	Kaherë, shumë kohë <i>ka</i> , një vashë që e doja e më donte, flokët m'i përkëdhelte me joshje. Do t'i pres, më thosh <i>paperâ</i> . ¹⁸
---	---

Në këtë mënyrë, poeti ynë sjell modele ndërtimi të strofës, sipas skemave që i gjen vetëm tek ai, si:B.....B; ...B.....B; por nuk mungojnë as strukturat ABBA:

Unë thyeja ca amfora me kujtime në vetminë *time*
vozitja mes rektimesh, hutohesha nga zëra *vezullues*.
Në zhurmën e heshtjes ngrihej një tym i fildishtë *avullues*,
Unë isha zjarri që digjej ulëritës në erë, mbi *burime*¹⁹

Është veçori e poetikës së A. Prendit që, më së shumti, në vargjet e lira, të sjellë rimema të puthura, edhe në vargje pa metër, si:

Poezia duhet të jetë e bukur, Duhet të jetë më e bukur se dje, Po sot jam më i pafuqishëm se dje, copa-copa shpirti është duke më <i>rënë</i> , prej fjalës së <i>pathënë</i> ²⁰	Shikimi përplasat në dritë, thyhet në njëmijë cifla, majemprehta, therëse, vetëtitëse, <i>ngado</i> . Vetëm unë <i>i shoh</i> ! ²¹
--	--

Ndodh që në pak vjersha, autori "i kripëzon" (*jo sheqeros*) vargjet edhe me asonanca edhe me rimema, pothuajse në gjysmën e shtrirjes së saj,

¹⁵ Ag Apolloni: Dashunia fillon prej gjysmës (P.Shllaku), Prishtinë, 2019, f. 46.

¹⁶ Po ai, po aty, f. 102.

¹⁷ Po ai, po aty, f. 102.

¹⁸ Po ai, po aty, f. 101.

¹⁹ Po ai, po aty, f. 95.

²⁰ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Art poetik), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 48

²¹ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Heshtje), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 86.

si në poezinë "Shpresa lakuriq",²² ku në 13 vargje, gjashtë janë të rimuar:

Mbetet shpresa
- fije e kashtës në thonjtë e të mbyturit
edhe kur kafka e fatit
krip me trutë e veta dheun.

Nuk çaj krye për fatin.

Në fushë qiti kryet shpresa e blertë AA
dhe jam krejt i qetë, AA
se shpresa prapë diku mbetet,
diku i çel lulekaçet e saj gjëmbore, BB
shpresa në çapojt e humbjes s'humbet prore. BB

Me këpucët godas një gur, CC
që më ka zënë rrugën,
dhe ec si dikur. (1993) CC

Te Arben Prendi, ka modele rimemash edhe nga strofa në strofë, të cilat sikur mbajnë drejtpeshimin e gjithë tekstit poetik dhe i trokasin lexuesit në procesin e receptimit se është brenda poezisë, si në vjershën "Baladë e re për dashurinë",²³ nga 5 vargjet e para, tek strofa II na tingëllojnë fjalët-rima:

Eh, sa herë qeshë mburrur mendjelehtë,	Në oaz të syve robërues të së dlires
Se i paprekshëm isha nga shigjetat e dashurisë.	M'u bani të fala miqve të rinisë.

Rrallëherë, poeti ynë gjen prehje në pak vjersha ku struktura na kujton strofat me 4 vargje klasike, lyer me rimë, së paku në dy prej tyre, si në v.II dhe IV te vjersha "Pleqtë":²⁴

U zhgënjyen nga jeta lavire,	Andrruen për një botë të bukur,
Njeni - tjetri dhe miqtë e tjerë;	ku njeriu t'i blatohej njeriut njeri.
Kafe zeher në mëngjes herët, pa feksë,	Eh, andërr e brishtë, e lashtë,
Kujdes gjatë ditës gjendja e tyne, e nderë.	Tash vërtiten pa motiv nëpër shtëpi.

Veçse poeti A.Prendi nuk është i përbetuar të mohojë rimën; sepse ajo i vjen herë-herë aq natyrshëm edhe në vargjet e lira, pa metër e masë, si të

²² Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Heshtje), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 45.

²³ Po ai, po aty, f. 138.

²⁴ Po ai, po aty, f. 123.

"Loti i paramë",²⁵ ku gjen vend edhe asonaca:

Edhe këtë javë,
 Lot i paramë prej *synit*
 Jam,
 Nën futën e *trishtimit*
 Dhe
 Si krimineli me pa
 Në vendin e *krimin...*

Es, 2, 2

Jo rrallë, ajo, asonanca, vjen e bëhet po aq e fuqishme sa dhe rima, si te vjersha "Histori me këpucë":

Tash do të kalbeni në plehna,
 Nën trishtime *zbutës*;
 Na njerëzit mosmirënjohës,
 S'e ndërtuem një muze për *këpucët* !

Imagjinata e autorit sjell në skenë edhe kohëra me këpucë, matur e përcaktuar prej vargjeve të plota-stileme: "*Koha e këpucës së randë me gozhda hekuri, / koha e këpucës së lehtë me llustër.*" Njeriu që i bart, mund të jetë i diktaturës së përgjakshme të pushtimit, ashtu edhe i një diktature demagogjike!

Nuk ka vende të caktuara ku poeti ynë të na afrojë rimema në klauzolat e vargjeve; muza e tij krijuese gjen fjalë-rima në strofën e parë, në dy vargje të puthitura, në strofa sipas një skeme ABA, ngjet që teksti poetik të hapet me rimë, ose, ose të mbyllet me dy vargje të tilla, si tek vjersha "Ikja",²⁶ ku shprehja "me iiiiiikë *more*" vjen e jehon si thirrja e maleve "*Ooo, ç'asht pushka, more!*"

²⁵ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I (Lot i paramë), Fiorentia, Shkodër 2018, f. 120.

²⁶ Po ai, po aty, f. 167.

Po, tash nxitoj me ikë,	Atdheu i ftohtë si <i>gur</i>
Asnjë minut kohë të merrem me <i>asgja</i> .	Trandafili i horizontit në dritare.
Siç janë më duhet t'i la të gjitha,	Librat, portretet në <i>mur</i>
As kryet të mos e kthej <i>mâ</i> Me ikë, me iikë, me iiiiiikë <i>more</i> ,
	Si i dalun <i>fare</i> .

Ky vend m'i han gëzimet e pakta,
E si kaproll, ndjekë nga egërsinat,
Më ban me *ikë*,
Lamtumirë kujtime, imazhe, *grafikë*..!

II. Sintaksa e vargjeve

1. Shtrimi teorik i problemit

Do të provojmë në këtë segment të sjellim një vështrim gjuhësor, në planin sintaksor, për veprat poetike të Arben Prendit, duke e shoqëruar këtë përpjekje tonën edhe me një paraqitje teorike të sintaksës së vargjeve, përndryshe, të ligjërimin poetik. I pari ndër gjuhëtarët tanë që ka dhënë disa karakteristika të qenësishme të ligjërimin poetik në vargje, është prof. Xhevat Lloshi, tek teksti universitar “Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika”.²⁷ Gjuhëtari ynë vë në dukje se shfaqja më eprore e organizimit dytësor tek poezia është paraqitja e gjuhës së tyre, si organizim në të gjitha nivelet, ku marrin vlerë përftesat *fonetike, prozodike, shkrimore, leksikore, semantike, sintaksore e mbisintaksore*. Krijimet poetike, sipas Xh. Lloshit, kanë si parim drejtues ritmin,

- i cili organizohet ose mishërohet në vargje,
- vargjet janë njësi të barasmatshme,
- ato kanë theksa pak a shumë të rregullt.

Autori nënvizon se zbatimi i organizimit me njësi në bazë të gjatësisë së rrokjeve, sipas gjuhëve klasike, nuk ka zënë vend në gjuhën shqipe.²⁸ Nga ana tjetër, ritmi është:

- pikënisje për harmoninë tingëllore të poezisë,
- për të arritur muzikalitetin,
- muzikaliteti shoqërohet me emocionalitetin.

Në nisma si kjo, duhet pasur parasysh se deri më sot, kërkimet stilistike të studiuesve të ndryshëm, kanë objekt një tjetër poezi: vjershërimin tradicional, vargjet e metruara rreptë, shpesh struktura strofash katërshe apo gjashtëshe, ku përbërësit dalin sipas parimit "varg e fjali". Rastet e shmangies së këtyre ndërtimeve e kalimit përtej këtyre kufijve, janë parë si

²⁷ Lloshi, Xhevat, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Albas, Tiranë, 2012.

²⁸ Po ai, po aty, f. 272.

figura sintakse, çka nuk mund të flitet për natyrën e poezive të Arben Prendit e brezit të tij. Prandaj dhe shkrimi në vijim do të jetë një përshtatje e rregullave sintaksore të vjershës me kostumin e këtyre vargjeve.

Ka poezi të A. Prendit që i bartin shumë apo disa nga këto karakteristika përnjëherësh. Nuk themi "të gjitha" sepse gjuhëtarë e stilistë si Xh. Llshi e kanë fjalën, kryesisht, për poezitë tradicionale, sonetet, vargjet safike me rima dhe të thurura sipas ligjeve metrike, një atribut që nuk mund të kërkohet tek prodhimi letrar i autorit tonë. Teorikisht shkruhet e flitet për modele metrike shumë të rralla, gjendur vetëm tek poetë të njohur, si: Naimi, Mjeda, Asdreni, Fishta e pak të tjerë, që provuan tetë rrokshin.

Në poezinë "Me mikun e kthjem nga mërgimi", ka ritëm që mbërrin muzikalitetin, i cili na prek emocionet, se tban²⁹e vjetër nuk ka ndryshuar, krimbat po brejnë dërrasat e çatia pikon muresh. E gjithë kjo pamje që vret, është shtruar në "varg e fjali" përgjatë strofës pesëshe, ku vetëm vargu II rimon me të V:

Nuk e di ku mund të ulesh miku im,
këtu siç e sheh është shumë rrëmujë;
jo, jo, asgja s'ka ndryshue që atëherë,
dërrasat e derës të krimbura janë,
muret djersijnë dimnit ujë.³⁰

Ndoshta, autori zihet ngusht se ndodhet në atë gjendje përpara mikut që ka emigruar; mbase edhe është penduar se nuk emigroi vetë, të mund të ngrinte një shtëpi të re... Përftesat poetike na i sjell përsëritja e tingujve: *r*; *rr*; *m*, si dhe zanorja *e*, me të cilat ndjehet harmonia tingëllore, duke krijuar një tablo pikturë të varfërisë, që i bren jetën vetë poetit!

"Pushteti i rreptë i rimës", dhe "etaloni i metaltë i metrikës" i bëjnë poetët "të vuajnë" në ndërtimin e strukturave të sintaksore; shto këtu edhe "vendin e detyruar" të theksave ritmikë, tregues që brenda intonimit dhe muzikalitetit, vijnë e përftohen edhe dukuri jo të lehta për t'u pranuar nga krijuesit e vjershës; është fjala këtu për shfaqjen sintaksore të asaj që quhet "l'enjambement" - tejkalim, siç e quajnë gjuhëtarët: kur semantika brenda një vargu, strukturë fjalië qoftë apo bashkim sintagmatik, nuk mbushet, por kërkon plotësinë edhe në vargun pas; veçse kjo shfaqje e sintaksës së vargjeve, që ndeshet aq dendur në poezinë klasike edhe në traditën tonë, në shkollën e sotme poetike, ku bën pjesë edhe vjershërimi i A.Prendit,

²⁹ tbanë-a, banesa, shtëpia; fjalë e vjetër dialektore e Malësisë së Madhe.

³⁰ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 146.

tejkalimi a kapërcimi nuk dalin si nevojë e domosdoshme përdorimi, si e gjejmë në poetikën e soneteve të Mjedës, në krijimtarinë e Fishtës, apo në ditët e tashme, tek B.Londo. Në vjershërinë e brezit të sotëm, kjo shfaqje sintaksore shkon deri në mosnjohje, megjithëse ne po e vëmë në dukje, sepse formalistët janë "të lirë" të shkurtojnë apo të zgjasin vargje pa fund... Por ndodh që përgjatë poezive të poetit tonë, brenda këtij vëllimi, të gjejmë edhe vjersha ku në secilën strofë të vëmë në dukje tejkalimin, si te "Kohë është edhe tash",³¹ apo "Buzëqeshje e hidhun".³²

Jeta kalon si ujnat,
nën kambët e urës së Buenës
së amshueshme të kohës....

Shoh sendet dhe njerëzit tash,
përmes një buzëqeshjeje të hidhun ironike,
në mëngjesin e pushtuem
prej reve zymtake.

S'ka asgjâ të panjohun,
në këto sende e shpirtën,
fronin e magjisë,
e zuni përsëritja.

Largohem rrugës,
tue fikë,
një buzëqeshje të hidhun,
ndër shqisa,
se e di:
rrufeja shpejt ka me ra
nder brej e lisa.

Në begatinë e vargjeve e të formave të shtruara me anë të strofave nga A.Prendi, gjen këtu-atje edhe vjersha në *kornizë*, që nga stilistët shpjegohet si rimarrje strofe, por autori i kësaj përmbledhjeje që po shfletojmë gjen një trajtë origjinale për ta kornizuar poezinë: jo mes dy strofave të njëjta, siç gjendet në stilin e Martin Camajt, por mes dy vargjeve, edhe këtë me topikë jo të njëjtë, si te "*Miku im, nuk u pamë ma*",³³ në "*E ma s'u pamë*" - varg që mban tragjedinë e madhe të humbjes së një miku të poetit, në vitin 1993:

³¹ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 266.

³² Po ai, po aty, f. 194.

³³ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 171.

Ti ike, o mik,
 matanë detit,
 deshta me thanë.
 ...Në fund të detit, më thanë
 E ma s'u pamë.

Edhe kur nis e projekton korniza poetike, siç përshkruhen me rregull, ai gjen rastin e "dredhon" prej tyre, i prirur nga një strukturë origjinale, që kërkon të jetë e tija, vetëm në vjershërinë e tij, si tek poezia intime "Ti po qan",³⁴ ku korniza i ravijëzohet edhe me nga dy vargje në hyrje e në mbyllje të frymëzimit:

<i>Unë e di se ti po qan,</i>	Dhe shpirtrat tanë që aq u deshën,
<i>Me lot të valë pendimi.</i>	Shtegtuan skajesh diku larg.
Të ëmblat puthje përmes i ndamë,	Tani veç andrrat na kanë mbetur,
Me dimre harrimi.	Sa të kota andrrat, sa tradicionale!

Unë e di se ti po qan,
Me lot të valë pendimi.
 E zu vendin e shpresës,
 Mërzia dhe strishtimi ?!

Edhe më e bukur e poetike na vjen vjersha në *kornizë*, për dashurinë, me titullin "Shfaqje", f. 78; por jo me dy strofa përsëritje: vetëm me nga dy vargje të fillimit e mbylljes:

Ti më shfaqesh përsëri,Ti më shfaqesh përsëri,
imazh i ëmbël dhe i butë..... imazh i ëmbël dhe i butë,
 Besomë, desha, Por ndarja është mes nesh,
 veç të jesh e lumtur..... e thyer si një urë...

Duke vijuar eksplorimet për gjuhën poetike të A.Prendit, është mirë të ndjekim klauzolat-rima në vjershërinë e autorit, sa ka mundur ai t'i qëndrojë shumësisë së fjalëve sipas klasave të tyre; p.sh.: në poezinë me 7 vargje të thyera, "Kumti i mbramjes", na shfaqen dy herë distikë me rimë të puthur: AA, BB, ka 4 rimema shprehur me 4 emra: dy në rasën kallëzore (E4) dhe dy në E3 dhe E2.

³⁴ Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 74.

Demat e tredhun
 tërheqin
 qerren,
fshatarin
 dhe *barin*.
 - Kështu i kumtoi rrota e majtë *baltës*,
 në vigjiljen e *natës*.³⁵

Pra, nuk janë rima uniforme në ndarjen që u bëjmë klasave të fjalëve, gjë që na bën të mendojmë se pasuria apo sjellja e fjalëve gjithnduerësh në shtatin e poezisë, edhe pse ihtarët e këtij drejtimi letrar nuk i përulen pushtetit të saj, rritin shprehësinë e naltojnë mjeshtërinë artistike. Në poezinë "Loja e mjegullës",³⁶ megjithëqë me rimë të puthur, ndjehet se autori po zgjedh ndër klasa të ndryshme fjalësh:

Mjegulla e marrë,
 valët e detit në mall,
 krejt harrim,
 në Shëngjin
 copëtoheshin.
 Fytyra jote,
 Endej këso bote,
 Dhe prapë mungonte,
 Kur mjegulla luate lojë

Por ka raste që përdorimi i një trajte të fjalës, siç është paskajorja geqe, megjithëse në folje të ndryshme, vjen e bëhet kakofone brenda një strofe apo edhe në mbarë vjershën, si te "Marrëzi cerebrale",³⁷ ku gjenden 9 folje të ndryshme në 9 vargje, për të cilat përherë në studime për poezinë, bëhen raporte me klasa të tjera fjalësh:

...prandaj nuk mundem ma *me dëgjue*
 nuk mundem me folë, as *me shkruë*.
 Nuk mundem *me lexue*,
 as *me fjetë*
 as *me ndejë zgjue*;
 as andrra nuk mundem *me pá*
 nuk mundem as *me qa*;
 nuk mundem *me dashunue*
 as *me krijue*.....

³⁵ Arben Prendi, Vepra poetike-Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 74.

³⁶ Po ai, po aty, f. 245.

³⁷ Po ai, po aty, f. 236.

Na mjaftojnë dy strofa ku rimemat e vargjeve nuk janë folje po emra, si vijon, për të rrokur e ndjerë kumbimin e efektit-rimë, ndryshe nga ajo që mund të presim nga rimat-folje:

...të thotë si apostull edhe bariu në brigjet e Buenës,
tue kullotë ditët e tij - *edha*,
përmes mjegullës ku qesin shkëndija legjendat e reja...
atje ku Drini plak e i përrallshëm,
fillon e bân *dredha*. (f. 271)

E4

E4

S'mundem m'e marrë një lundër,
të bâhem Noe i *botës*,
ndaj rri e sodis i pafuqi,
me vënë fundin e *gotës*. (f.273)

E2

E2

Mund të vërehet lehtë se vargun e fundit këtu e bën poetik jo aq rima, sa rendi i gjymtyrëve;

pas foljes "sodis" sipër tij, lexuesi do të priste vendosjen: ... *fundin e gotës me venë*, ndërsa gjen tjetër rend, jo të detyruar në kërkim të rimës, por lirinë për të rënë në sy, për të tërhequr vëmendjen.

Edhe më tepër rritet tingëllimi poetik, kur në klauzolat me rimema fjalët shënuese (kuptimplota) dalin të kombinuara me fjalë shërbyese, si në tercinën e mëposhtme:


Miku që iku prej *këtej*,
kryet mbas e *kthej*
derisa mbeti *pa kokë*,
dhe shpirti i fluturoi në atë *botë*. (f.261)

Më duhet mendjen kot *ta vras*:
Çka do të bâhet me ata
që e kanë kohën përpara
dhe me ata që e kanë kohën *mbas* ? (f.270)


Në të rrallë, autorit tonë-pedagog letërsie, i troket apo i kumbon në vetëdijen krijuese edhe ndonjë fjalë poetike nga Mjeda, edhe prej Lazgushit, të marra, jo si plagjiat i fshehur, por duke gjeneruar sipas modelit të tyre, b.f., në vargun e bukur për *Drinin plak*, duke i afruar karakterizimin e bukur "*i përrallshëm*" - siç pat bërë Poeti i Pogradecit: "*Ku Drini plak e përrallor/Buron prej Shëndaumi*." ³⁸Të tre mbiemrat e prejardhur nga rrënja "përrallë-a", ndahen në smantikën e tyre, sipas emrave me të cilët bashkohen në valencë:³⁹

³⁸ Lasgush Poradeci, Vepra letrare, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1990, f. 284.

³⁹ ASHSH, Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe prespektivë (Hajri Shehu, *Çështje të sintagmatikës në fjalorë të shqipes*), Tiranë, 2005, f. 158 - 168.



Ndodh në krijesat - vjershë të A.Prendit që struktura poetike e vargjeve të dalë me varësi vetëm tek një folje dhe gjithë teksti të marrë trajtën imagjinare të një vile rrusi, si tek "Më lini vetëm me diellin" (f.63):



2. Fraza – tekst

Në studimet tona sintaksore të traditës dhe në Gramatikën shkencore të Akademisë së Shkencave,⁴⁰ shkruhet: "Tani po bëhet fjalë edhe për njësi më të mëdha sintaksore se periudha. Është pak a shumë e njohur qenia e njësisë semantike-strukturore të përbërë prej fjalish të mëvetësishme a periudhash të ndryshme, e cila ka një përmbajtje të lidhur, të organizuar zakonisht me mjete gramatikore. Mund të quhet *thënie e lidhur*." Por, në rrafshin e kërkimeve gjuhësore evropiane, gjenden hulumtime të këtij lloji që arrijnë deri tek marrëdhëniet e frazës me tekstin, madje flitet edhe për sintaksë teksti. Këtë vështrim të ri, sjellë sipas gjuhëtarit italian Stefano Telve,⁴¹ po përpiqemi ta ndjekim në poetikën e A.Prendit. Për të qenë më konkret lidhur me këtë risi në studimet neolatine, po marrim një model sintaksor të Ndre Mjedës, përndryshe një fragment tekstor nga poema "Andrra e jetës", pjesa IV- Zoga.⁴² Gjithë poema është shkruar me rimë të rregullt: ABAB,

⁴⁰ ASHR SH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e gjuhës shqipe- II, Tiranë, 1997, f. 64. [Më tej, autorët kanë shënuart se *kjo njësi sintaksore përgjithësisht është pak e studiuar. Në gjuhën shqipe, ajo s'është bërë ende objekt vizhimi të veçantë.*]

⁴¹ Stefano Telve, L'italiano: frasi e testo - Nuova edizione, Carocci editore, Bussola, S.p.A. Roma, 2013.


⁴² Ndre Mjeda, Vepra letrare I, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1988, f. 89-90.

ABBC, me vargje safike që mbajnë skemën AABB; ka edhe vargje të rimuara në fundet e secilës strofë, si te pjesa II, III e këngës Tringa, f. 75 - 80. Tek kënga "Zoga", f. 89, janë 4 strofë shumë të veçanta, që nuk ngjasojnë me asnjë segment të kësaj vepre dhe në të gjithë trashëgiminë letrare të poetit. Është shembulli i shkëlqyer i asaj që u shtrua më lart për të ashtuquajturën "frazë-tekst" - nëse duam, edhe "teksti-frazë", për të cilin themi se e bën Mjedën pionier të kësaj forme poetike, dhe për të, duhet kërkuar një analizë krejt tjetër nga ajo që i bëhet periudhës.

Janë 4 strofa gjashtëshe, secila në masën e një njësie sintaksore-periudhë, me 24 vargje; e para ka ndërtim të drejtë, përmban 2 njësi drejtuese me nga 2 të varura secila; II ndërtim të zhdrejtë, me një fjali drejtuese e 3 të varura kohore; strofa III ka ndërtim simetrik: 2 fjali drejtuese me nga 1 të varur kohore, kurse strofa IV- me ndërtim të drejtë-ka strukturë të ndërlikuar, pasi njësia II drejtuese del e ndërmjetuar prej 3 njësive të varura predikative përcaktore (e veçuar ajo është: *Nuk i ngjet prilli...as fllad...foshnjës*). Këto 4 strofa janë shumë të lidhura kuptimisht me njëra-tjetrën, sa formojnë një tekst, një kuadër peizazhi ku nuk duhet të mungojë asnjë detaj: hëna me yjëzit, agimi me rruzullimin, shendi me shpend e lule, si dhe qielli me muajin prill e me lule. Në këtë parajsë tokësore, në qendër të saj, është vendosur: foshnja plot gaz me *Nënë* e saj, kur ajo i përkulet mbi të. Por, sidomos kjo lidhje vjen e pakëputur edhe gjuhësisht, në mënyrë të veçantë mes strofës III, IV, sepse konektori (lidhëza kundërshtore) "por" duhet të lidhë dy anë të krahasueshme midis tyre. Autorja e monografisë "Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe", L.Mëniku shkruan: "*Pozicioni karakteristik i konektorit por është ai në mes të fjalive. Ndonëse pozicioni i lidhëzës kundërshtore por i përshkruar në gramatikën e shqipes, mbetet ai në mes të fjalive, në gjuhën e shkruar vihet re gjithnjë e më shumë një rritje e përdorimit të saj në fillim të fjalive.*"⁴³ Në pikëpamje logjike, ky konekt vë përballë kontrastin mes dy pamjeve, cilësive apo mendimeve të ndryshme, në mos, në opozicion.

Pa u larguar nga shembulli klasik i Mjedës, ja dhe pamja skematike e përbërësve predikativë që e formojnë tekstin-frazë, që sollëm për model ndërtimi të pandarë:


⁴³ Linda Mëniku, Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe, Albas, Tiranë, 2014, f. 122.




Dukuria me konektin "por", natyrshëm, ndryshe prej Mjedës, del edhe në vjershërinë e A.Prendit, veçse te ky poet i ri, strofat e nisura me këtë mjet gramatikor, sikur bëjnë konkluzionin e autorit, pas rreshtimit të disa shfaqjeve në vargjet më sipër, sikurse tek vjershat "Patjetër duhet të ndryshojë bota" dhe "Dylqinja e Tobozës", f. 102-103. Në të parën renditet një botë e mërzitshme, e vjetër, me vargje të përlotura, me mirazhe areale,..... është një botë, së cilës autori duhet të shprehet në mënyrë kategorike,është një strofë që nis me.....*p o r*, e cila përafrohet si varg i Internacionales, ndërsa luhet për një ndjenjë në sferën e dashurisë; dhe 5 njësitë kumtuese, shtrirë në 4 vargje, nuk mund të qëndrojnë pa përmbajtjen e strofave më sipër, duke e bërë tekstin një frazë të vetme semantike:

Por ka një gjë që nuk lëkundet më,
Sot do të shihemi patjetër.
Më ngjajnë gjërat pa kuptim,
Më ngjan bota krejt e vjetër


Kurse tek Dylqinja, ajo "por" vjen në kundërti me vetë heroinën sarkastike të heroit po aq sarkast, Don Kishot!! Është një dukuri në botën fizike e shpirtërore të një personi popullor në literaturën botërore.....!Në sintaksën e vargjeve të A.Prendit na shfaqen skema laryshe, sidomos në strukturën e fjalive me shumë gjymtyrë që varen nga një folje poshtë tyre, ose anasjelltas, si në modelet e poezive "Odise i humbur", f. 44:



Anasjella e kësaj strukture del dendur, si në poezinë "Stinë e rrezikshme", f. 42, ku ndryshimi gjuhësor vjen edhe nga kundërvënja e rasave rrjedhore me ato kryesisht emërore:



Ndonjëherë strofat e lira, sa i takon numrit të vargjeve, jepen "mbërthyer" mes dy foljeve: në fillim dhe në mbyllje, sikur shpërndahen sa për njëjërën, ashtu edhe për tjetrën, në mënyrë simetrike, si e dallojmë tek vjersha "Skema", f. 30.



Gjykojmë se autori ynë merr e ndërton skema të habitshme, me lidhje strofike të atillë, që vargjet sipër dhe poshtë, e kanë qendrën e varësisë të një folje në mes tyre, qoftë edhe pa simetri numerike leksemash, si te vjersha e shkurtë "Çmagjepsja", f. 137:

Si një pelë gërdallë e lodhun,
 me buzë të vyshkuna, thundra të pista,
 shikim plot qelb të ngrimë,
 brinjë të drezgosuna feminiliteti,
 tualet dhe kundërmim arficial,
ish e dashuna më kalon pranë.
 E rëndomtë,
 torollake,
 me dy pauza idiote,
 mbas koke.

Ndërtimi gjuhësor (sintaksor) i vargjeve të lira dhe i strofave të tyre amorfe, siç janë dhe *parregullsitë* e këtij drejtimi letrar, e bën jo pak të vështirë të nxjerrim përfundime për strukturën e frazës, në vjershërinë e Arben Prendit, sepse krijues të tillë gjenerojnë poezi me mendime të lirshme dhe pa kufij numerikë fjalësh e pa metër; ka shumë fjali të varura, pak njësi drejtuese dhe kryesore, të cilat nuk mbajnë në varësi njësi kallëzuese; shfaqen bashkime me parataksë, pak struktura hipotaktike dalin në indin e krijimeve të përmbledhjes që kemi në dorë. Ka pak strofa të thurura si modeli në vijim, nga poeti ynë:


"Fjalë s'u dëgjoja veç kapja të qeshurën,
 që variacione ajri dhe drite muzikonte në hapësirë,
 të kaloja pranë tyre ata do të iknin,
 ndaj ndërrova drejtim. (f.98)

Fr. { Fjkr. Fjdr. Fjdr. Fjkr.
 - Fjvprc. Fjvksh. -

Në rastet kur autori zë e përsërit vargje apo mjete të lidhjes sintaksore, nuk i sjell me topikë të njëjtë, por, duke i ruajtur marrëdhëniet e raportet midis njësive kumtuuese, ndërton vetëm vendin e tyre, si në vjershën intime "Ti je fajtore", f. 100, ku vargu i njëjtë "*ti je fajtore, je pa dyshim*" dhe lidhëza e kushtit "*nëse*", edhe pse dalin dy herë, nuk e rëndojnë poezinë në tërësi:

"Kërcasin hapat e mi prizme akulli
 nga majë e gishtrinjve te flokët kjo krismë,
nëse tani ca rrecka mbetën nga blerimi,
ti je fajtore, je pa dyshim.

Me atë drejç vrapit të marrë humbje
 mbi florën, faunën shpërndaje ngricë.
Ti je fajtore, je pa dyshim,
nëse akullnajat nga polet zbresin një ditë



Bie në sy që strukturimi i vargjeve në sekuenca të ndryshme tekstore, si në ato dinamike, përshkruese apo statike, autori ia del të përshtasë e të zgjedhë mjete gjuhësore, të sjellë me shumicë klasa fjalësh që shprehin veprime, siç janë foljet, emrat prejfoljorë, kurse, kur ravijëzon një tablo jete të qëndrueshme, nuk i sjell ato të pranishme, deri edhe ndërton strofa me një folje, të shtjelluar, si në vjershën "Ndërmjet dy botësh", f. 296:


Tue u kalamendë nëpër brenga,
shoh pamje, fytyra të njajta e të ndryshme,
 e ata sy me shikime të zverdhuna e hileqare,
 përgojuese të vështrimeve të të tjerëve,
 në një pazar të madh teshash të përdoruna,
 ndjenjash e mendimesh,
 ndërmjet dy botësh:
 Orient e Oksident.

Për skemat e ndryshme gjuhësore-sintaksore, studiuesit e sotëm kanë shprehur bindjen se ato shfaqin skema të të menduarit logjik. Psikolinguisti amerikan, Fodor, këmbëngul se është "forma logjike" e shprehjes në gjendje të luajë një funksion interfaqës, pasi, në trurin e njeriut ndodhet një modul specifik, i aftë të udhëheqë proceset e përmbajtjes, duke shndërruar tingujt në domethënie; e mund ta bëjë këtë falë relacionit të ngushtë që ka forma logjike nga njëra anë, me sistemin e tingujve dhe, nga ana tjetër, me strukturën sintaksore të mendimit."⁴⁴ Prandaj dhe në punën me gjuhën, është gjykuar prej kohësh që strukturat e frazës, në një masë jo të vogël, të shoqëroheshin me skemat përkatëse, duke i quajtur ato pasqyrime të strukturës së të menduarit. Strofa më sipër shfaq një formë të menduari poetik, individualisht, të A. Prendit, kur ai do të sjellë disa të dhëna, nëpërmjet enumeracionit, si një inventar sendesh e cilësish që do t'i rreshtojë në realitetin që vëzhgon....

Ky *ligjërim i shpejtuar* (në mund themi me këtë atribut), është i pranishëm

⁴⁴ Francesco Ferretti, *Alle origini del linguaggio umano - Il punto di vista evoluzionistico*, GLF Editori Laterza, Roma- Bari, 2017, p. 37.

në mjaft krijime poetike të poetit, madje kjo mënyrë të thëni, duke zbratur përnjëherësh çka mbahet ngërthyer, vjen e përdoret edhe në rastet kur vargnimi *si breshëri*, del në masën e *tekstit-frazë*, kësaj radhe jo me konektin e analizuar më sipër tek Mjeda, por me "E pra", i cili duhet shfaqur vetëm në vijimësi të një teksti, si në strofën II të një poeme,⁴⁵ f. 306 dhe asnjëherë në fillim; gjithashtu as vargjet në vazhdim nuk mund të qëndrojnë të shkëputur nga 6 vargjet, para konektit të dhënë me të zeza:



Gjuhëtari dhe stilisti Xh.Lloshi ka vërejtur se qysh me krijimtarinë e Migjenit “*ka zënë vend të qëndrueshëm vargëzimi i mbështetur në ritmin e të folurit emocional sipas stilit të gjuhës bisedore, me elementë të ritmit lirik dhe nëpërmjet pyetjeve ose dialogut*”,⁴⁶ duke sjellë si shembull të kësaj dukurie fillimin e Poemës së Mjerimit: *Kafshatë që s’kapërdihet asht, or vlla, mjerimi...*; është një nisje me disa vargje që kanë tipare bisedimi. Mendojmë se pamje të tilla, në letërsinë tonë kanë zënë fill me krijimtarinë e Mjedës; mjafton të krahasojmë nisjen e poemës “Andrra e jetës”:

⁴⁵ Arben Prendi, *Vepra poetike, Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 306.

⁴⁶ Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 272.

“Molla t’kputuna një dege,
Dy qershija lidhë’n’nji rrfanë,
Ku fillojnë kufijt’e gege,
Rrinë dy çika me një nanë”

Janë vargje poetike që na ngjajnë si rrëfimi i një përralle, ose kur duam të tregojmë ku banojnë dy a më tepër njerëz. Në të folmen bisedore përdoret më së shumti folja “rri”, si në replikat e mundshme: “rri në Shkodër”, “rri në fshat”, “rri në malësi” etj. Pra, kjo folje vjen në vend të foljes “banoj”, ose “jetoj”: “jetoj/banoj në Shkodër”, “jetoj/banoj në fshat, malësi” etj. Sipas studiuesve, mendimi poetik lëviz me masa ritmike, në organizime tingëllore, fushë me të cilat merret metrika dhe ku kanë dhënë ndihmesën e tyre autorë të tillë, si: Dh.Shuteriqi, Gj.Zheji,⁴⁷ e tash së voni, edhe gjuhëtari Mina Gero, me veprën unikalë në llojin e saj “Fjalori rimor i Dritëro Agollit”.⁴⁸ Ky strukturim ritmik vjen për të gjitha nivelet e gjuhës: në fonetikë, gramatikë, leksik e sidomos në sintaksë, ku kërkojnë vëmendje të posaçme:

- sintaksa poetike,
- leksiku poetik, - figurshmëria.⁴⁹

Motiv mjedian do ta quaja poezinë *Plaku i braktisun*,⁵⁰ e cila ngjan aq shumë me *Molla t’kputuna* e krijime të tjera të Poetit të madh, duke përmbushur njëherësh 3 kërkesat më lart dhe ka një ritëm të mrekullueshëm, edhe pse autori nuk është ruajtur aspak të mos dalë nga hullia e 8-rrokëshit, që vjen e zotëron; ka në këtë vjershë edhe ndikim e pak "plagjiat" - me dashje - nga *pisi plak i Tulës!*⁵¹ Një vendosje e dy teksteve pranë e pranë, do ta bëjë lexuesin të përfarojë në figuracion: gotën e arit me putirin, si dhe dy vargjet: Mbreti i Tulës: "*Fikun syt' e s'pau ma kurr/ edhe kurrë ma nuk u çue*" (Plaku i braktisun). Nga leksiku poetik, zgjedhim si vijon: *hije peme, putiri* (leksemë folklorike - jo gotë), *ditë jete, i molisun, arratia, lëndina, ngau e ngau, i shkreti, nëpër andërr, nuk u çue*. Është një nga poezitë më të frymëzuara të përmbledhjes që kemi në dorë: dramatike dhe tragjike për gjendjen e vendit, që po plaket e vdes pa u ndjerë...

⁴⁷ Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988.

⁴⁸ Gero, Mina, "Fjalori rimor i Dritëro Agollit", Toena, Tiranë, 2013.

⁴⁹ Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 273.

⁵⁰ Arben Prendi, *Vepra poetike*, Vëllimi I, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 331.

⁵¹ Ndre Mjeda, *Vepra letrare-1*, Kombinati Poligrafik, Shtypshkronja e Re, Tiranë, 1988, f. 151-152.

Plaku fjet nën hije t'pemës,
raki piu ai me putira,
ndër sa ditë që pati jetë,
kjo veç është mât e mira.

Përmbas fëmisë që s'i ka afër,
as nuk din se ku kanë shkue;
ngau e ngau i shkreti plak....
edhe kurr'ma nuk u çue.

Studiuuesi dhe shkrimtari Gj.Zheji, në një syth të veçantë, ka trajtuar liritë poetike, të cilat i ndan në dy grupe: a. Ato që pakësojnë rrokjet, si: *afereza, sinkopa, apokopa, sinalefa* dhe b. Liri poetike që shtojnë rrokjet: *proteza, epenteza, paragoga, diereza dhe hiatusi*.⁵²Për të gjitha këto dukuri, poetët e drejtimit letrar, ku krijon edhe A.Prendi, janë të pandjeshëm, pasi nuk praktikojnë metrin në poezi, veçse herë-herë, për arsye ritmi, ato duhen përdorur.

Sipas studiuesve, *sintaksa e vargjeve u nënshtrohet kërkesave, që nisin nga rima e theksi e vijnë deri tek llojet e strofave, kështu që përmban shmangie nga sintaksa e zakonshme, gjë që ka sjellë nocionin e "lirive poetike."*⁵³ Për këtë nivel të gjuhës, stilistët dhe gjuhëtarët përgjithësisht, kanë arritur në përfundimet se, për poezinë, sintaksa ka disa përkatësi, që nuk i përmban ajo e prozës apo dramës, në tekstet përkatëse; kështu, ajo (sintaksa e vargjeve):

- është faktori veprues kryesor në vargje,
- ajo bashkërendon elementet e tjerë,
- ndërton grupet e krahasueshme ose paralele.

Arben Prendi ka fituar prej vitesh përvojën *ta zotërojë* vargun dhe gjithë tekstin poetik, t'i japë kahun drejt synimit të idesë dhe të ngjyrimit të kohës, por jo vetëm të një kohe të caktuar, por ai arrin të ndër-këmbejë tregues kohorë, të bëjë paralelizma, siç bënte Noli ynë te *Krishti me kamxhik* kur ia dhunuan vendin e shenjtë. Kështu, edhe autori i kësaj tube bukur të bashme, bëhet *Mësues*, vetëquhet siç e quajtën Apostujt Mesinë kur jetuan dhe u ndanë prej tij... Është leksiku që i prin poetit në vjershën e realizuar "Miniaturë" - një titull që ka përmasat e Madhështisë, për realitetin shqiptar që prek, për shqetësimin e njeriut largpamës...edukator dhe Mësues-Pedagog. Ja fjalësi që na sjell kohën e *Erës së Re*: dishepull, pergamenë, parashoh, rreket, gjykim (Dita e Gjykimit), Juda, Mësuesi para tij - i mohuar e tradhtuar përjetësisht! Poeti-Pedagog përjeton në auditor autorë e personazhe botërore, nga *Romeo, Idioti, Tre shokët; Beatriçja e Madam*

⁵² Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988, f. 77.

⁵³ Lloshi, Xhevat, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmaika*, Albas, Tiranë, 2012, f. 273.

Bovari - i zë në gojë se i njeh ata, sepse nga aulat universitare si studentët e tij kanë dalë; në krahun tjetër sjell ndër mend Abelin e pafajshëm- vvarë nga Kaini, që mungon atë ditë mësimi - Shën Pjetrin apostull, Shën Jozefin e Marijës, Sarën e Dhiatës së Vjetër dhe Madalenën mëkatnore, që falet nga Jezusi...! Autorin nuk e shqetëson fakti si janë studentët e tij, por si do të jenë në jetë, ... *dikur* - është dhe fjala e fundit e poezisë:

Bota në miniaturë
janë studentët e mi,
dhe unë dishepull i harruem...
Fytyrat e tyne - pegamenë të hapun
kur parashoh të ardhmen,
ndaj më përqeshin.....

-

Juda nuk mungon,
në bankën e fundit,
por mbas puthjes,
ai ka me e tradhtue prapë Mësuesin...
Dhe Mësuesi do ta falë....
me shpresë se
ka me ndryshue dikur....

* * *

3.Poezitë - pikturë

(*Peizazhe*)

Janë karakteristike mjaft krijime të këtij poeti, të cilat, në vështrimin gjuhësor dalin të tilla: me elipsë të theksuar kryesisht të foljeve, me emërzim tej mase në numër të fjalive, si të ishin vizatime me penelin disangjyrësh të autorit. Aq më tepër se vëllimi që u bë këtu objekt vështrimi analitik, përmban edhe një tubë të emërtuar "Akuarelet e jetës dhe të vdekjes",⁵⁴ me poezi të tilla, si: *Paskajore*, f. 270, *Zoja Morde*, *Me zemrën e mbushun me pikëllim* etj.

Në shfaqje si këto *krijohen rrethana ligjërimore që diçka të bjerë në sy ose të shquhet*; edhe në një vjershë panoramike, pikturë për një pamje ekzotike, ku duhet ta kthejnë shikimin të gjithë ata që kanë në dorë fatet e një populli, siç shikohet tek poezia me 9 vargje, edhe njëfjalëshe; janë vetëm dy folje: njëra në aorist, tjetra të kohë të tashme; e para që ndiqet nga disa objekte homogjenë, tjetra që ka ka përpara ato. Është një "ngjeshje" sintaksore dhe një topikë poetike e vendosjes së përbërësve gjymtyrorë, si te vjersha "Ciganët",⁵⁵ me rimë të largët.

⁵⁴ Arben Prendi, *Vepra poetike-I* (Akuarelet e jetës dhe të vdekjes, f. 259-276), Fiorentia, Shkodër, 2018.

⁵⁵ Arben Prendi, *Vepra poetike-I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 159.

E pava prapë atë popull fantastik,

mushkat, çadtrat, arushat, qentë, kazanët, shtrojet,
djepat, fëmijët dhe plqetë,
me eshtrat e stërgjyshëve në *shpinë*.

Ciganët,
një atdhe,
një tokë,
mbartin ngado:
Lirinë.

Ose, edhe pa asnjë folje, si strofa e fundit e vjershës *requem* "Ditë zije"⁵⁶ për miqtë e mbytur bashkë me anijen në det, apo në peizazhin "Deti" (f. 61):

.....
Në TV, muzikë e hareshme,
dekrete qeveritare, delegacione shpëtimi
filma optimistë me fund të lumtun,
deklarata partiake lufte dhe pajtimi,
dukumentarë për mbarështimin
e brumujve dhe kërmijëve.

Trumba me guaska,
të kuqërreme, të gjelbra, të hirta,
të bardha,
në breg,
si kabinat telefonike,
në sheshet kryesore të një qyteti.

.....
Edhe portrete njerëzish, madje i nënës, vjen e pikturohet si një gravurë, me ngjyrat-fjalë, nga autori, duke zgjedhur një leksik me të cilat ravizohet shpirti e vuajtja gjatë gjithë jetës, me sintagma, si: duar të rreshkura, duar me damarë, palcë druri, e fortë si ashti, etj.:

N a n a ...⁵⁷

Nana,
me duart e rreshkura plot damarë,
si harta e mundimeve dhe vuajtjeve,
nga koha e egër,
e fortë si ashti,
palcë druri e butë,
nën fodullëk të diellit përvëlues rrëmih,
ende dheun e çarë,
pranë bimëve në fushë,
si një gravurë,
që koha e gdhendi
në kujtim.

⁵⁶ Arben Prendi, *Vepra poetike-I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 144.

⁵⁷ Po ai, po aty, f. 142.

Edhe strofa të tëra me shumë vargje krijohen tablo piktore, që fokusohen vetëm nga një folje (*je* - ndodhesh), por që vijnë e mbështeten nga mbiemra prejfoljorë, të cilat e kanë në semantikën e tyre veprimin e foljeve që mungojnë (e fshehun - *që fshihet*; e mbrojtun - *që mbrohet*):

Sa mirë që larg je !
 Sa dashunisht je larg,
 e fshehun,
 e mbrojtun,
 nga kërcimi somnambul i figurinave të vapës,
 trompat e pashmangshme të mushkajave dhe grethave,
 nudoja molisëse
 e dashunisë sime
 të alivanosun
 nga ândrrat.⁵⁸

Klasat e fjalëve që u japin ngjyrë *poezive-piktura* në disa vjersha vijnë e bëhen emrat prejfoljorë, me prapashtesat - *im*, - *esë* dhe - *je*, si: shterrim, harresë, kthim, shikim, izolim, zvarritje, thirrje, shurdhim, dyshim, rrënim, si dhe ndonjë pjesore e mbiemër i panyjshëm prejfoljor, si te poezia "Rrënimi":⁵⁹

Në fillim, shterrimi i ideve të reja,
 pastaj harresa e kufijve diku,
 kthimi i shikimit vazhdimisht pas
 e ftohta në tru.

Izolimi në zvarritje,
 nën banderola optimiste thirrjesh,
 fosilizim i llahtarshëm i indeve,
 shurdhimi i plotë.

Kështu përfytyrova një ditë hirnake,
 karfosur nga dyshimet dhe të ftohtit,
 rrënimin e mekanizmit orientues,
 të kombit. (1990)


Përftesa me rendin është një mjet i përhershëm stili gjatë hartimit poetik, megjithëse liria e krijimit, domosdo që përfshin edhe lirinë e vendosjes së gjymtyrëve funksionale sintaksore. *Loja me rendin*, siç mund të shkruhet për vargnimin, kthehet në mjet shprehësie, kur ka mjeshtërinë e përdorimit, si në distikun që kemi dhënë më lart tek fjalia njëshe, ku gjithçka varet tek endiada "rri e sodis"⁶⁰

⁵⁸ Arben Prendi, *Vepra poetike-I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 127.

⁵⁹ Po ai, po aty, f. 85.

⁶⁰ Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. 405.

".....ndaj rri e sodis i pafuqi,
me vënë fundin e gotës"



Por, tek poezitë e vargut të lirë të Arben Pprendit dhe brezit të tij, përftesa me rendin duhet të quajmë edhe vendosjen e foljes-kallëzues të fjalisë, në raport me gjymtyrët e dyta, edhe me kryefjalën, siç thuhet dendur vendosje "*majtas dhe djathtas*", pamje që vjen e shfaqet në dy vargjet vijuese:

Në lumin e njerëzve t'qytetit,
Shuej etjen e vetmisë (f. 224)

ku radha e gjymtyrëve në vargun e parë (rrethanori me përcaktorin) dalin para foljes, ndryshe nga kundrina dhe përcaktori i saj, që vendosen pas saj. Edhe më tepër bien në sy ndërtimet emërore, pa folje, në të cilat kryefjala vendoset në fund të strofës, si poezia "Njollë antropologjike":⁶¹

E brengosun, e zhvoshkun,
lavire memece,
mbramja jonë kombëtare. (f. 220)

Ka raste kur edhe një gjymtyrë krahasimi zë pozicionin mes dy foljeve, duke bartur theksin logjik dhe tërhequr vëmendjen e gjithë ndërtimit të strofës:

.....Sot, mbi varr të mëngjesit
Po këlthasin gjith' telefonat e botës,
si zogjtë e Stimfalit,⁶²
me lajmue
vdekjen e tij....(f. 217)

Krijuesit e çfarëdo shkolle a drejtimi letrar, duhe ta ndjejnë edhe pa dashur se në gjuhën tonë, realiteti i njësisve predikative njëshe, kaq të pasura në

⁶¹ Arben Pprendi, *Vepra poetike*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 220.

⁶² Stimfal-i, në mitet greke, zogj monstruoze të liqenit me të njëjtin emër, me fletë e krahë metalikë, që ushqeheshin me mish njeriu; edhe emër qyteti në Peleponez.

variante ndërtimore, të cilat janë quajtur e përfshirë në ato attribute që përmbledh "*natyra e shqipes*", veprojnë bukur mirë edhe në përftesat me rendin sintaksor të saj, si në vargjet më poshtë, ku kryefjala mungon për natyrë të gjuhës sonë:


Bjer ku të mundesh,
ku ta marrë mendja
se dhimbje të pamatë qet. (f. 188)

Këtu merret frymë për brinjësh,
E thonë përherë të pavërteta!
Këtu veç një herë dimë me vdekë.

Largohem rrugës,
tue fikë,
një buzëqeshje të hidhun,
ndër shqisa,
se e di:
rrufeja shpejt ka me ra
nder brëj e lisa.... (f. 194)

Përftesa me rendin duhet marrë në këtë varg, edhe disa ndërtime të rralla, ku autori ndan nga fraza-tekst një ind të saj, që del më vete, edhe pse nis me një mjet lidhjeje sintaksore - shenjë të hipotaksës. Para shumë viteve, këtë dukuri që po përhapej, gjuhëtari M.Domi⁶³ e ka quajtur *parcelizim* ose *segmentim* të një njësie superfrastike, e cila, më tepër se në vjershëri, i takon letërsisë në prozë. Këtë strukturë të tekstit poetik na e sjell autori ynë te vjersha "Se vjen një orë e mbrame",⁶⁴ ku strofa II nuk mund të organizohet gjuhësisht më vete:

E megjulla shpirtit m'i ka ra,
E ndëjt' me ditë e me net,
Lypte një flî, ti ishe tepër e brishtë
me u flijue,
e u flijova vetë.



Se vjen një orë e mbrame pa çudina,
një orë e mbrame si pyll i premë,
kur ujk të uritun të kthen vetmia,
e n'hanë të kujtimeve ulëron pa prâ.
(f. 174)

*

*

*

⁶³ Mahir Domi, *Studime filologjike*, Tiranë, 1984/4, f. 61, 65.

⁶⁴ Arben Prendi, *Vepra poetike I*, Fiorentia, Shkodër, 2018, f. 174.

PËRMBLEDHJE

Poeti Arben Prendi vjen në poezi i formuar në arsimin filologjik; ai afrohet aq shumë me lëndën që i duhet një krijuesi në këtë fushë, sa na jepet të lëmë në hije talentin e tij të lindur, kur ka nisur të shkruajë, siç bëjnë jo pak admirues të artit në moshën e poezisë.

1. Ai doli në lëmë të poezisë në kohën kur liritë e krijimit jehuan pa kufij në botën e letrave të shkrimtarëve shqiptarë, të cilët po përjetonin çka kishin të ndaluar deri në vitet 1990.
2. Motivet e vjershërisë së A.Prendit janë po kështu të paskajuara: nisin me njeriun e brezit të tij, që duhej të thoshte fjalën e vet për këdo e për gjithçka, prandaj dhe poetika e këtij autori përmbledh jetën e gjerë kur po merrte një kthesë aq të vrullshme dhe shpesh të paorientuar.
3. Ai lëvront vjershërinë në standard, në variantin e zgjedhur të gegërishtes, por edhe me elemente nga dy dialektet, pa droje se po bën sakrilegj, ashtu si i vjen frymëzimi para fakteve që e shqetësojnë.
4. Në qendër të motiveve të poetikës së A. Prendit janë hijedritat e kohës nëpër të cilën kalon subjekti lirik por edhe banori i kësaj kohe, i vendit dhe i botës ku jetojmë. Ndërkaq këto motive përshkohen nga dy ndjesi: nga ndjesia e një parajse të humbur nga njeriu, s'dihet se kur dhe si, (ndjesia e cila e bën atë në vetvete të palumtur filozofikisht); dhe nga pikëllimi që buron nga vetë përkohësia e qenies.
5. Fakti që vjershërisë së këtij poeti, mund t'i bëhet një analizë gjuhe dhe stili deri në rrafshin e paraqitur këtu, tregon se ai është sot një nga emrat e njohur dhe më të realizuar të poezisë bashkëkohore shqiptare.

* * *

BIBLIOGRAFI:

- Arben Prendi, *Tekste në kontekste*, Shtëpia Botuese "Naimi", Tiranë, 2011.
- Linda Mëniku, *Konektorët e tekstit në gjuhën shqipe*, Albas, Tiranë, 2014.
- Ndre Mjeda, *Vepra letrare I*, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1988,
- Arben Prendi, *Probleme, autorë dhe vepra nga letërsia bashkëkohore* - studime, Fiorentia, Shkodër, 2017.
- Arben Prendi, *Vepra poetike-I*, Fiorentia, Shkodër, 2018.

- Arben Prendi, *Vepra poetike-Vëllimi I*, Fiorentia, Shkodër, 2018.
- ASHR SH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës shqipe- II*, Tiranë, 1997.
- ASHSH, *Leksikografia shqipe-Trashëgimi dhe prespektivë*, Tiranë, 2005.
- Ferdinand Leka, *Fjalor i termave të letërsisë*, Infobotues, Tiranë, 2013.
- Francesco Ferretti, *Alle origini del linguaggio umano - Il punto di vista evoluzionistico*, GLF Editori Laterza, Roma-Bari, 2017.
- Gero, Mina, *Fjalori rimor i Dritëro Agollit*, Toena, Tiranë, 2013.
- Gjergj Zheji, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1988.
- Justin Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006.
- Kolë Jakova, *Fshati midis ujënave/ujërave*, Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1972.
- Lasgush Poradeci, *Vepra letrare*, Kombinati Poligrafik "Shtypshkronja e Re", Tiranë, 1990.
- Mahir Domi, *Studime filologjike*, Tiranë, 1984/4.
- Ndoc Gjetja, *Biri i njeriut - Poezi të zgjedhura (Në dasmën e mortës)*, Toena, Tiranë, 2004.
- Stefano Telve, *L'italiano: frasi e testo - Nuova edizione*, Carocci editore, Bussole, S.P.A. Roma, 2013.
- Xhevat Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Albas, Tiranë, 2012.

Poetic language in the poems of Arben Prendit

ABSTRACT

In this analytical writing lying in the plan of language and style within the poetics of *Arben Prendi*, the researcher has aimed to highlight the artistic values of the poet's poetry affirmed in literary creativity over 26 years, relying mainly on the anthological summary "Poetic works - Volume I", where are selected, with different themes, poems from 7 publications, 1989 - 2015. After the presentation of the literary production of the young poet, many data are provided for scientific and pedagogical work, as a professor of literature at the University of Shkodra; in the following, an assessment is made about the linguistic credo of his poetry, the selection of the written version, as well as the first steps in this field. Most of this research is occupied by issues of poetic syntax, the formal structures of the free verse that he uses the most, the organization of verses in verses, the meeting with the rhyme, as well as individual phenomena of his creativity,

in the field of figuration. Given the size of this article and its content, based on scientific criteria, it can be said that it is a thorough analysis, which is done for the first time to the production of A. Prendi's poem's. With publications in this field, *prof. T. Topalli*, has already created a well-known experience, both for the syntactic look of the syntax of the verses, as well as for the innovations brought by the linguistics of the text through this study.

Artan HAXHI
Tefë TOPALLI

TERMINOLOGJIA SI SISTEM

(Fjalor i termave të gjuhësisë)

(vijon)

AKSIONALITET

Aksionaliteti ose cilësia e veprimit (përkthim i termit përkatës gjerman *aktionsart*) është një nocion semantik, që ka të bëjë me klasifikimin e foljeve mbi bazën e disa veçorive karakteristike të kuptimit të tyre, në veçanti në lidhje me llojin e veprimit që ata shprehin. Ai është një koncept i lidhur ngusht me kuptimin leksikor të foljes dhe nuk është i varur nga folësi (siç është aspekti, me të cilin ai shpesh ngatërrohet). Për të shmangur konfuzionin e shkaktuar nga korrespondenca terminologjike angleze midis *aspektit* (aspekti gramatikor) dhe *veprimit* (aspektit leksikor), gjuhëtarët preferojnë të përdorin termin gjerman *Aktionsart* ose atë anglez aspekt leksikor.

AKTUALIZIM

Aktualizimi (nga fr. *actualiser* - “aktualizoj”) është veprimi me të cilin një njësi e gjuhës kalon në fjalë. Të aktualizosh një koncept, do të thotë të identifikosh një paraqitje reale të subjektit folës. Nga aktualizimi çdo koncept lokalizohet (vendoset në kohë dhe në hapësirë) dhe përcaktohet në pikëpamje sasiore (merr një përcaktues të sasisë). Ky quhet aktualizim i mjeteve të gjuhës. Aktualizimi mund të ketë natyrë të nënkuptuar (implicite) apo të qartë (eksplícite). Në këtë mënyrë, përcaktimi i sasisë është i qartë si tek emrat, ashtu edhe tek foljet (*qen/qentë, vrapoj/vrapojmë*). Emri *burrat* është qartësisht i aktualizuar nga pikëpamja sasiore (tregon një sasi të caktuar burrash, pra, më shumë se një burrë), por në mënyrë të nënkuptuar mund të jetë i aktualizuar edhe në pikëpamje cilësore (burra, në kuptimin trima, njerëz të besës).

Po kështu edhe situata e komunikimit mundet vetvetiu ta sigurojë aktualizimin. Më e zakonshme është situata gjuhësore, e cila, në rastin e shqiptimit të një fjale të vetme, siguron aktualizimin p.sh.:

Shko!

Zjarr!

Mirëdita!

Mirëmëngjes!” etj..

Po kështu, pjesëza pohuese *po*, si përgjigje ndaj një ngjarjeje gjuhësore të mëparshme (çështje e bashkëbiseduesit).

A e takove Agronin? - Po.

Ndonjëherë aktualizimi është themelor për të folurit; lexuesi i një tabele (⊖) që mban shënimin “*ndalohet*”, në përputhje me situatën e komunikimit, rivendos lidhje me një shprehje gjuhësore bazë, për shembull, “*kalimi është i ndaluar*”.

AKTUALIZUES

I quajmë aktualizuese të gjitha morfemat që realizojnë aktualizimin, domethënë kalimin nga koncepti tek fjala. Aktualizuesit janë elemente të ndryshme me të cilët gjuha operon për të lidhur objektet virtuale (konceptet, nocionet) dhe proceset e realitetit të jashtëm (referentët).

Ai mund t’u kundërvihet njërive leksikore, shenjave të plota (lidhja në mes të një shënjesi dhe një të shenjuari) dhe aktualizuesve, që janë morfema gramatikore. Në sintagmën *ky djalë*, fjala *djalë* përkon me përkrahimin sosyrian të shenjës (lidhjen midis një koncepti dhe një imazhi akustik), ndërsa përemri dëftor *ky* siguron lidhjen midis konceptit të librit dhe realitetit material të pranishëm në situatë (= një djalë i caktuar që e kam para meje). Në mënyrë të ngjashme, te folja, morfema e kohës shërben për të aktualizuar konceptin; p.sh. mbaresa *-ja* tek *ec-ja* (*ec*) përcakton procesin konceptual të “*të ecurit*” në boshtin kohor.

AKULTURIM

Akulturimi është një term i huazuar nga angloamerikanishtja (*acculturation*), që përdoret në disiplina të ndryshme, si : etnologjia, antropologjia, psikologjia, sociologjia etj.. Koncepti i akulturimit është studiuar shkencërisht vetëm aty nga viti 1918. Deri më sot studiuesit kanë zhvilluar më shumë se 100 teori të ndryshme të *akulturimit*, duke dhënë përkufizime të shumta për të përshkruar edhe elemente të veçanta të këtij procesi.

Në përgjithësi, akulturimi është proces i ndryshimit psikologjik dhe kulturor të një bashkësie të caktuar shoqërore, që buron nga prishja e ekuilibrit ndërmjet dy kulturave, ndërkohë që një bashkësi shoqërore e bjerr kulturën e vet tradicionale dhe përshtatet me kulturën mbizotëruese të shoqërisë. Me pak fjalë, akulturimi është një proces në të cilin një individ miraton, përvetëson dhe përshtatet me një mjedis të ri kulturor.

Në *etnologji* akulturimi i referohet procesit përmes të cilit një popullsi, një bashkësi ose një grup njerëzor etnikisht i përcaktuar, i karakterizuar nga veçoritë e veta kulturore, synon të përvetësojë kulturën ose elemente të

kulturës së një populli, bashkësie apo grupi të ndryshëm nga ai, pra, të përshtatet me një mjedis të ri kulturor.

Sociolinguistika shpesh e ka përshtatur këtë term, duke e lidhur mbi të gjitha me kontekste të caktuara :

I pari është shumë pranë konceptit etnologjik, pra, atij të humbjes së kulturës së vet nga ana e një bashkësie apo grupi të caktuar shoqëror dhe të përshtatjes me kulturën e një bashkësie apo grupi tjetër shoqëror.

I dyti, i futur kryesisht pas Luftës II Botërore, kur shoqëria rurale, e lidhur me një bujqësi të vetëqëndrueshme e me një kulturë tipike tradicionale, duke u ballafaquar në mënyrë të papritur me forma e modele ekonomike e kulturore më të forta, tipike për shoqërinë urbane, fillon të humbasë kulturën e vet dhe të përvetësojë atë të shoqërisë urbane. Grupe apo komunitete gjuhësore të tëra të çrrënjësura nga ambienti i tyre social e kulturor, nga njëra anë braktisin e harrojnë traditat, kulturën e dialektin e tyre, nga ana tjetër pësojnë imponimin me forcë, përmes kanaleve dhe agjencive më të fuqishme të shoqërizimit¹ (shkolla, administrata, mjetet e komunikimit të masës, feja), të modeleve kulturore e gjuhësore të konsumizmit urban. Shpesh individët që i përkasin një kulture të ndryshme përpiqen ta përfshijnë veten në kulturën e re më të përhapur, duke marrë pjesë në aspekte të kësaj kulture, por edhe duke ruajtur disa nga vlerat dhe traditat e tyre origjinale kulturore. Të paktën pjesërisht e ngjashme me këtë, është edhe fenomenologjia e integritit gjuhësor e lidhur me migrimet e mëdha, si ajo që u pa p.sh. në Shqipërinë e viteve 1990 dhe 2020, kur mijëra e mijëra qytetarë të rajoneve anësore (kryesisht të zonave rurale) u shpërngulen drejt qendrave të mëdha urbane, kryesisht në kryeqytet.

Konteksti tjetër në të cilin është i dallueshëm një përdorim sociolinguistik i termit të **akulturimit** është ai i të ashtuquajturit “*edukim kompensator*”. Sipas teorisë së Basil Bernstein, këtij fenomeni i nënshtrohen ata anëtarë të një bashkësie gjuhësore që zotërojnë vetëm një “*kod të kufizuar*”, me qëllim që t’i çojë ata në zotërimin e një “*kodi të përpunuar*” (kodi i përpunuar / kodi i kufizuar).

AKUSTIK, -E

Akustika (nga gr. ἀκουστικός/*akoustikos* që do të thotë “*e dëgjimit*”, “*i gatshëm për të dëgjuar*”) është disiplina që merret me studimin e tingujve, ultratingujve dhe infratingujve (të gjitha këto janë valë mekanike në gaze,

¹ **Shoqërizimi** - është procesi i transmetimit të informacionit nëpërmjet praktikave dhe institucioneve në gjendje për të kaluar në gjeneratat e ardhshme e trashëgiminë kulturore të grumbulluar.

lëngje apo trupa të ngurtë). Ajo gjen zbatim në fusha të ndryshme, si: gjuhësi, muzikë, mjekësi, arkitekturë, inxhinieri etj.

Fonetika akustike - është degë e fonetikës që merret me studimin e valëve të zërit të prodhuara nga organet vokale njerëzore gjatë procesit të komunikimit. Ajo ka për qëllim të studiojë vetitë fizike të valëve zanore, mënyrën e tyre të transmetimit në komunitet, si dhe të funksionimit të gjeneratorëve akustikë të aparatit vokal që i lind këto valë. Gjithashtun ajo studion edhe sinjalet akustike komplekse që synojnë zbërthimin e tyre në përbërësit e tyre të thjeshtë. Për ta realizuar një gjë të tillë ajo përdor kryesisht spektrografinë, teknikën e analizës që lejon shpërbërjen, me anë të procedurës matematikore të quajtur *transformimi Fourier*. Spektrogrami është paraqitja grafike e kësaj procedure. Matjet akustike na lejojnë të marrim të dhëna të menjëhershme mbi tingujt e gjuhës. Regjistrimi i të folurit në një aparaturë manjetike apo dixhitale na lejon të bëjmë matje të gjata e të sakta, duke anashkaluar të ashtuquajturin problem i karakterit “*të paqëndrueshëm*” të prodhimit zanor.

Sot është bërë masiv përdorimi i akustikës për të ilustruar ose vërtetuar aspekte të teorive fonologjike. Përveç thjeshtësisë relative dhe komoditetit të metodologjisë, kjo lloj qasjeje është favorizuar nga saktësia dhe objektiviteti i të dhënave të arritura. Megjithatë duhet të nënvizojmë që analizat akustike shpesh huazohen për të realizuar interpretime alternative.

Struktura akustike e tingujve të të folurit ka qenë subjekt i studimit dhe i përshkrimeve të hollësishme të llojeve të ndryshme të tingujve (zanore ose bashkëtingëllore) në gjuhë të ndryshme.

Segment akustik - në njohjen e të folurit, segmentet akustike rezultojnë të jenë segmentim i sinjalit të të folurit. Segmentet akustike janë interpretuar si fonema. Në përgjithësi, numri i fonemave të zbuluara është më i vogël se ai i segmenteve akustike. Kështu, një bashkëtingëlloreje okluzive të pazëshme (mbylltore e shurdhër) i korrespondojnë, në përgjithësi, tri segmente akustike, njëri që përfaqëson një zonë të heshtjes, tjetri një shpërthim të zërit dhe tjetri një zonë të jostabilitetit (trazicion drejt zanores).

ALALI

Alalia (nga gr. *αλαλία* : α- “pa” + *λαλία*/*lalia* “të folur”), e njohur edhe si vonesë e të folurit, i referohet një vonese në zhvillimin ose në përdorimin e mekanizmave që prodhojnë të folurin. Të folurit i referohet procesit të prodhimit të tingujve, që realizohet nga përdorimi i specializuar i disa organeve të trupit të njeriut, të tilla si : mushkëritë, kordat vokale, goja, gjuha, dhëmbët etj.

Nga ana tjetër vonesa në gjuhë i referohet një mangësie në zhvillimin ose në përdorimin e njohurive të gjuhës.

Duke qenë se gjuha dhe të folurit janë dy gjëra të pavarura, ato mund të jenë të vonuara pavarësisht njëra tjetrës. Për shembull, një fëmijë mund të jetë i vonuar në të folur (d.m.th., është i paaftë të prodhojë tinguj të foluri të kuptueshëm), por jo i vonuar në gjuhë. Në këtë rast, fëmija përpiqet të prodhojë një gjuhë të përshtatshme për moshën, por kjo gjuhë do të jetë e vështirë ose e pamundur të kuptohet, mbasi nuk arrin të prodhohet në mënyrë të saktë.

Gjithashtu një fëmijë mund të ketë vonesë gjuhësore, çka bën që ai të mos ketë pasur mundësinë të prodhojë tinguj të të folurit, ndaj me shumë mundësi mund të ketë edhe një vonesë në të folur.

ALATIVE

Alative (nga lat. *allāt* “për të sjellë në”) është një lloj rase gramatikore, që bën pjesë të nëndarjet e rasës vendore (rasa inesive, relative, ilative, adesive etj.) dhe shërben për të shprehur drejtim, lëvizje drejt një qëllimi apo vendi. Ajo është një rasë që shpreh kërkesë për ose kundrejt një referenti të emrit që përcaktohet. Termi rasë *alative* është përdorur në studimet kushtuar gjuhëve turke, ungro-fine dhe eskimeze. Sinonimi i saj, rasë *shtuese*, është përdorur veçanërisht në studimet baske. P.sh. në gjuhën finlandeze përdoret me kuptimin themelor të “*mbi, në*” dhe ndërtohet me mbaresën *-lle*, për shembull : *pöytä* (tavolinë) dhe *pöydälle* (në krye të tavolinës).

ALBANOLOG

Albanolog është ai që merret me studimin e gjuhës, të kulturës dhe të qytetërimit shqiptar. Studiues në fushën e albanologjisë.

ALBANOLOGJI

Albanologji është fushë e shkencës që merret me studimin e kulturës, të historisë, të artit, të letërsisë dhe të gjuhës shqipe, pra tërësia e studimeve në këtë fushë. Lindi si drejtim i veçantë studimesh nga fundi i shek. XVIII e fillimi i shek. XIX, duke u konsoliduar sidomos në gjysmën e dytë të shek. XIX. *Spektori i albanologjisë, fondi i albanologjisë, në fushën (në lëmin) e albanologjisë.*

ALEGORIA

Alegoria (nga gr. *ἀλληγορία/allēgoría* - të folur për ta kuptuar ndryshe, e përbërë nga *ἄλλος/állos* - tjetër dhe *ἀγορεύω/agoreúō* - flas, them) është një metaforë e zgjeruar, sidomos një fabul, në të cilën karaktere imagjinare dhe

veprimet e kryera prej tyre janë përdorur për të kuptuar dhe shprehur aspekte të koncepteve që lidhen me ekzistencën e njeriut. Alegoria është një paraqitje ose shprehje e tërthortë, prapa se cilës nënkuptohet një domethënie tjetër. Një nga arsytet për krijimin e alegorisë ka qenë pamundësia për të folur hapur e për të thënë të vërtetën. Krijime letrare të ndërtuara mbi bazën e alegorisë janë fabulat dhe parabolat (shëmbëlltyra), të cilat në përgjithësi janë alegori të shkurtëra, që përdoren për të dhënë një mësim moral. Ajo ndërtohet mbi bazën e simboleve. Në krijime alegorike *dhelpra* p.sh. përfaqëson njeriun hileqar e dinak, *ujku* njeriun e keq etj.. Ndër krijimet e bukura alegorike janë fabulat “*Dy qetë dhe ujku*” e Naim Frashërit, “*Ujku dhe qengji*” e Çajupit etj.. Po kështu edhe “*Vaji i bilibili*” i Ndre Mjedës është një krijim alegorik i ndërtuar mbi bazën e simboleve (*bilibili* simbol i shqiptarit të robëruar, *kafazi* pushtimi turk). Gjithashtu alegoria ka gjetur përdorim të gjerë edhe në teologji.

ALEGORIK

Alegorik, që është i lidhur me alegorinë, që ka të bëjë me alegorinë ose që i përket alegorisë.

1. *Shprehje alegorike* (flitet për një mënyrë të shprehuri). Ai që përdor alegori, që ka vlerën e alegorisë. Poemë, pikturë alegorike: fjalim, figurë, zhanër (lloj), foto, pikturë, karakter, histori, poemë, statujë, stil, tabllo alegorike.
2. *Domethënie alegorike*, kur një fjalë, një fjali, një tekst për shkak të alegorisë merr një kuptim të ndryshëm nga domethënia e vërtetë.
3. *Interpretim alegorik* (flitet për një mënyrë interpretimi). Ai që bën dallimin e alegorisë në një tekst të caktuar.

ALEKSI

Quhet **aleksi** (vjen nga greq. ἀλέξις/*aleksis*; *a* - mohuese dhe -λέξις/*léksis* “fjalë”) ose verbëri verbale, një çrregullim në procesin e leximit të vazhdueshëm. Ai shkaktohet nga një lëndim kortikal i pjesës së prapme të zonës së gjuhës, pa çrregullime të aparatit vizual. Në përgjithësi dallohen :

- *aleksia e drejtpërdrejtë*, ku subjekti, i aftë të lexojë relativisht mirë fjalët, nuk mund të lexojë shkronjat;
- *aleksia verbale*, ku subjekti, i aftë të lexojë shkronjat, nuk mund të lexojë fjalët;
- *aleksia frazore*, ku subjekti, i aftë të lexojë shkronjat dhe fjalët, nuk mund të lexojë e as kuptojë frazat (fjalitë).

ALFA

Alfa (nga gr. *ἄλφα/alpha*) është emri i shkronjës së parë të alfabetit grek (me shkronja të mëdha A, me shkronja të vogla α), që korrespondon me germën **a** të alfabetit latin. Prejardhja e saj është nga shkronja fenikase *alef* ('alep א).

Termi *alfa mohuese* (*alfa privative* - lat. *alpha privātīvum* “negativ”) i përket gramatikës tradicionale dhe ka funksionin e parashtesës që i jep kuptim mohues fjalës. Më konkretisht është parashtesa **a-** ose **an-** (para zanoreve), që përdoret në disa gjuhë indoevropiane (sanskrite dhe greke, apo edhe në fjalë të huazuara prej tyre nga gjuhë të tjera) për të shprehur mohimin ose mungesën, për shembull fjalët : *a-typical* (a-tipike), *anesthetic* (jo estetike), *an-algesic* (analgjezike) etj..

ALFABET

Alfabet (me origjinë nga gr. *ἀλφάβητος/alphabētos*, e përbërë nga dy shkronjat e para të alfabetit grek, *alfa* dhe *beta*), quhet një tërësi e standartizuar shenjash të rregulluara në mënyrë konvencionale, që përfaqësojnë fonemat e një gjuhe të folur. Shkrimi i parë plotësisht fonemik, shkrimi proto-kanaanit, i njohur më vonë si alfabeti fenikas, konsiderohet të jetë alfabeti i parë. Ai është paraardhësi i alfabeve të moderne, përfshirë edhe atë arab, cirilik, grek, hebraik, latin dhe ndoshta atë brahmik.

Alfabeti latin është i përbërë nga 26 shkronja dhe shërben për të shkruar (me modifikime të lehta dhe shtim të shenjave diakritike) tërësinë e gjuhëve romane, të atyre anglo-saksone, gjuhën çeke, turke, shqipe etj.; alfabeti grek, i prejardhur nga alfabeti fenikas, shërben për të shkruar gjuhën greke; alfabeti cirilik, i prejardhur nga shkronjat e mëdha të alfabetit grek, shërben për të shkruar disa prej gjuhëve sllave (rusishten, bullgarishten) etj..

ALFABETIK

Alfabetik mund të jetë një sistem shkrimor. Sistemet shkrimore të karakterit fonetik ose fonologjik janë shkrime alfabetike ose shkrime silabike (rrokjesore), që i kundërvihen shkrimit ideografik. Në shkrimin alfabetik grafemat kanë për referencë, në parim, fonema unike (një fonemë të vetme), si p.sh. alfabeti latin dhe ai cirilik. Disa gjuhë praktikisht e respektojnë korrespondencën mes fonemës dhe grafemës. Por sistemet nuk kanë qenë plotësisht fonologjike dhe ata e kanë prirjen për ta bërë përherë e më pak një gjë të tillë. Kështu, alfabeti fenikas përdorte vetëm bashkëtingëlloret (nga 22 grafema), por më pas për të plotësuar nevojat fitoi aftësinë për të futur në mes bashkëtingëlloreve zanoret.

ALITERACION

Aliteracioni (nga lat. *allitteratio-onis* = pranë+shkronjë, që rrjedh nga lat. *littëra* - shkronjë) është një figurë e retorikës, e përdorur sidomos në poezi. Ajo është përsëritja, spontane apo e kërkuar (për qëllime stilistike dhe për shprehësi tingullore), e një tingulli bashkëtingëllor ose e një rrokjeje, akustikisht identike ose të ngjashme, në krye (më rrallë brenda) të dy ose më shumë fjalëve që pasojnë njëra tjetrën, duke prodhuar homofoni (e barabartë me rimën). Aliteracionet krijojnë bukurtingëllimin e brendshëm në trupin e vargut.

Duke qenë strukturë e zakonshme e gjuhës, me kohë ajo u shndërrua në figurë stilistike në prozën poetike dhe në poezi, e më pas u bë pjesë e simetrisë fonetike të vargut (ose të grupeve të vargjeve) apo edhe përbërës metrik strukturor.

Fillesat e saj i gjejmë në shërbimet liturgjike (lutjet, fjalët magjike etj.) dhe në folklor (fjalët të urta). Në dorëshkrimet e lashta në këtë kuptim është përdorur edhe termi *homeoproforon* (*homoeoprophoron* - ngjashmëri e shqiptimit).

Si mjet retorik, është i zakonshëm tek autorët latinë. Një nga shembujt më të njohur është heksametri i *Analeve* të Ennios :

“O Tite tute Tati tibi tanta tyranne tulisti”.

Gjithashtu në poezinë e lashtë gjermanike ai është element themelor i vargut.

E ndeshim të përdorur edhe në letërsinë shqipe, p.sh. nga Lasgush Poradeci në krijimin *“Vallja e luleve”* :

Vijnë vashat valle-valle

Gushë e gji-stolisura.

Aliteracioni është përdorur gjerësisht edhe në fushën publicitare (reklamat), si një strategji e vërtetë e marketingut, sepse një sllogan që të funksionojë, duhet të krijojë atë *“virtuozitet”* muzikor që do të kontrollojë auditorin.

ALEGROFORM

Alegroform është term gjerman, i cili ka si element të parë termin muzikor *“allegro”* (i gëzuar, gazmor), i futur në punë për të emërtuar një formë të veçantë fonetike me të cilën një fjalë paraqitet në të folurën e shpejtë (dhe / ose informale). Kjo është një formë gjuhësore e shkurtuar që vjen si rezultat i shfaqjes së shpeshtë të saj në të folurit e shpejtë (p.sh. në anglisht *miss* në vend të *mistress*).

Një *alegroform* shfaq fenomene të ndryshme të reduktimit (asimilim, fshirje rrokjesh etj.), të përcaktuara nga ritmi më i lartë i të folurit : p.sh. në frëngjisht *il ne fait pas* - [i n fε pa] shqiptimi i reduktuar për [il nε fε pa].

Edhe humbja e aftësisë për të formuar (diftong) rrokje nga ana e zanoreve ngjitur me zanore të tjera është një fenomen tipik i reduktimit që i përket stilit alegro, p.sh. [bie'n:a:le] alegro [bje'n:a:le].

Zakonisht janë të prirura për të zhvilluar alegroforma fjalët dhe sintagmat me denduri më të madhe përdorimi në të folurën bashkëbisedore: p.sh. reduktimi progresiv në format e lidhëzave angl. *and* [ænd] – [ənd] – [nd] – [n], në gjermanisht “*Guten Morgen*” : alegroform [ˌguːnˈmɔʁən] - lentoform [ˌguːtənˈmɔʁən]...ose Mojn" për "Mirëmëngjes!"; ose në shqip "Mirëmëngjes!" - (mjes) aop Natën e mirë – natën.

ALOFON

Alofoni (nga gr. *állos* (tjetër) + *phoné* (tingull) është varianti kombinator i një foneme, ndryshe variant fonetik i një foneme në një gjuhë të caktuar. Alofonet (ose variantet) janë realizime konkrete të ndryshme që një fonemë ka në zinxhirin e të folurit.

Ky term është futur në gjuhësi nga fonologjia amerikane (*allophone*). U përmend për herë të parë nga Benjamin Lee Whorf rreth vitit 1929.

Përdorimi i përhapur i këtij termi e ka ngushtuar kuptimin e tij (alofonit), duke e bërë sinonim me “*variant pozicional*” (edhe variant kontekstual ose kombinator), duke ia kundërvënë atij të *variantit të lirë*. Në një kuptim të tillë *alofoni* i një foneme **A** është një tingull **A** fonetiksht i dallueshëm nga realizimi i zakonshëm i **A**, që bashkëndan me të një numër të caktuar tiparesh fonetike të dallueshme dhe ndodh në shpërndarje plotësuese, duke mos u kundërvënë kurrë në të njëjtin kontekst.

Alofonet janë të ndarë në tri kategori :

- **individuale**, që janë variante tingujsh artikulimi i të cilëve vjen si rezultat i veçorive fonatore të folësve të veçantë;
- **kontekstuale**, që janë variante tingujsh artikulimi i të cilëve ndikohet nga tingujt përreth;
- **gjeografike**, që janë variante tingujsh me një shpërndarje të kufizuar territoriale.

BIBLIOGRAFI

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002), *Gramatika e gjuhës shqipe*, I, Tiranë.
- Austin, J. L. (1962), *How to do things with words*, London: Oxford University Press.
- Bache, Carl (1985), *Verbal Aspect: A General Theory and Its Application to Present-Day English*, Odense: Odense University Press, fq. 10.
- Beccaria, G.L. (2004), *Dizionario di linguistica e di filologia, metrica, retorica*, Piccola Biblioteca Einaudi.
- Belluscio, G. & Rrokaj, Sh. (2011), *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë*, Arbëria, Tiranë.
- Dubois, J. & Giacomo, M. & Guespin, L. & Marcellesi, Ch. & Marcellesi, J. & Mevel, J. (2001), *Dictionnaire de linguistique*, Larousse, ISBN : 2-03-532047-X.
- Gjata, Lindita (2010), *Teksti argumentues*, Geer, Tiranë, f. 28.
- Herbert, Louis (2006), *The Actantial Model*, in Louis Hébert (dir.), Signo [online], Rimouski (Quebec), <http://www.signosemio.com>
- Jakobsøn, Romàn (1963), *Saggi di linguistica generale*, Parigi, cit. te Marchese, cit., lemma *Assi del linguaggio*
- Leka, Ferdinand (2013), *Fjalori i termave të letërsisë*, INFBOTUES, Tiranë, ISBN 978-9928-173-11-9.
- Sbisa, Marina (1978), *Gli atti linguistici-Aspetti e problem di filozofia del linguaggio*, Milano, Feltrinelli.
- Searle, J. R. (1969), *Speech Acts*, Cambridge University Press.
- Vendler, Zeno (1967), Dubuc, R. (1992), *Manuel Pratique de terminologie*, Linguatex: Brossard.
- Vendler, Zeno (1967), *Verbs and times*, in *Linguistics in Philosophy*, Ithaca (New York)

TERMINOLOGY AS A SYSTEM
(Dictionary of linguistic terms)

ABSTRACT

This article comes as a continuation of the article with the same title which was published in the previous publications. In it, 18 language terms have been explained, which we come across in the field of literature, both in contemporary and traditional one. In our explanations, we have tried to preserve the particular characteristics that often reflect the original value they have, according to different linguistic theories or which might be revised by the Science of Albanian Language to different concepts. Our goal is to make a contribution, however modest, to the compilation of an Explanatory Dictionary of Linguistic Terms.

Orjeta BAJA

FIGURAT E STILIT

(Fjalor terminologjik shpjegues)

Shkronjat
D, E, H, I, K

- vijon -

derivacion, -i *m.* nga lat. *derivatio*, “prejardhje” (*fr.* *dérivation*, *it.* *derivazione*)

Figurë morfostilistike përftuar nga pranëvënia në një tekst e fjalëve të formuara me prejardhje (nga procesi i formimit të një fjale të re nga një tjetër ekzistuese me rrënjë të përbashkët, kryesisht përmes parashtesave a prapashtesave). Këto fjalë i përkasin së njëjtës familje morfologjike, p.sh. *Unë, plak, bisedova me një plak mbi pleqërinë.*

diaforë, -a *f.* shih **antanaklasë, -a**

elipsë, -a *f.* nga gr. *éllipsis*, “mungesë, lënie jashtë” (*fr.* *ellipse*, *it.* *ellissi*)

Figurë sintaksostilistike që ka të bëjë me heqjen e një fjale a gjymtyre të nevojshme, të nënkuptueshme nga konteksti (që supozohet se ekziston në një version të plotë të fjalisë), me qëllim që mendimi të bëhet më i përmbledhur e të shprehet më me forcë, pa e vështirësuar kuptimin. Ajo jep ngjyresë bisedore, rrit tempin e shtjellimit ose vlen si përftesë e heshtjes a lënies përgjysmë për efekt, p.sh., si në këto vargje: “*Fshati pëkarshi / me kishë e me varre / rrotull ca shtëpi...*” (A. Z. Çajupi). Mjaft shpesh me elipsë janë gjëgjëzat dhe fjalët e urta, p.sh.: *Këmbëhollë, kryet kasollë* (lakra); *I riu, si veriu; Më mirë një vezë sot, se një pulë mot etj.* Elipsa është e pranishme më tepër në shkëmbimet pyetje/përgjigje, në ligjërimin dialogjik, p.sh.: – *Ku po shkon?* – *Në shtëpi.* Këtu fjalia e dytë nuk është e pavarur nga pikëpamja sintaksore dhe semantike dhe duhet integruar me të më përparshmen. Pikërisht sepse elementi që mungon është i rekuperueshëm duke integruar elipsën me kontekstin, elipsa është një mjet kohezioni tekstual, d.m.th. krijon një lidhje mes pjesëve të një teksti. Thuhet: Përdor elipsën.

emfazë, -a *f.* nga gr. *émpphasis*, “forcë në të folur” (*fr.* *emphase*, *it.* *enfasi*)

Figurë fono-sintaksostilistike që konsiston në shprehësinë e theksuar emocionale të njësive gjuhësore në ligjërim, përmes theksimit të veçantë të tyre nga niveli fonologjik e deri në atë sintaksor, duke u dhënë fjalëve një vlerë që nuk e kanë zakonisht, duke e ngritur tonin nganjëherë më lart se duhet, p.sh., në fjalinë: “Ajo, **ajo po**, është një shoqe.”. Thuhet: Shqiptoi me emfazë.

enalog/ë, -a *f.* nga gr. *enallagé*, “shndërrim, ndryshim” (*fr.* *énallage*, *it.* *enallage*)

Figurë morfostilistike që konsiston në përdorimin në mënyrë jo të zakonshme të një pjese ligjërata në vend të një tjetre që duhej përdorur rregullisht, apo të një forme gramatikore (mënyrë, kohë, numër, gjini, vetë etj.) në vend të një tjetre me atë vlerë, duke krijuar kështu një trop gramatikor, p.sh., e tashmja në vend të së ardhmes: *Nesër jam aty*, me vlerën e së ardhmes: *Nesër do të jem aty*.

endiad, -i *m.* nga gr. *hèn dià dyoîn*, “një përmes dy” (*fr.* *hendiadys*, *it.* *endiadi*)

Figurë morfo-sintaksostilistike që përdoret për të shprehur një koncept të vetëm nëpërmjet dy termave të bashkërenditur mes tyre (dy emra ose mbiemra), p.sh.: *E solli fati dhe rasti*, për *E solli rasti fatlum*.

enumeracion, -i *m.* nga lat. *enumeratio*, “numërim” (*fr.* *énumération*, *it.* *enumerazione*) → **epitrokazma**

Figurë sintaksostilistike që del në pah gjatë grupimit të disa fjalëve që i përkasin një tipi gjymtyrësh, të bashkërenditura mes tyre me *asindet* ose *polisindet*; pjesa përmblylëse e një ligjërimi në të cilin gjërat e thëna kujtohen dhe përmblihen në një mënyrë të rregullt. Një veprim i ngjashëm mund të shtrihet edhe brenda periudhës, mes njësive predikative, për të dhënë përgjithësisht një ngjyrim shprehës të veçantë, duke përfutur periudha fjalish *sindete* dhe *asindete*. Kjo figurë i jep një ritëm thënies, prania e të cilit është elementi më i rëndësishëm në poezi, p.sh.: “*Jashtë meje / dashurojnë, vriten, lindin / miliona / po dhe brenda meje / dashuria, vrasja, lindja / me të njëjtin shkullm veprojnë.*” (M. Ahmeti). Më të goditura janë enumeracionet e shoqëruara me lidhëza e me parafjalë.

epanadiploz/ë, -a *m.* shih **anadiploz/ë, -a**

epanafor/ë, -a *f.* shih **anafor/ë, -a**

epanaleps/ë, -a f. nga gr. *epanálepsis*, “përsëritje, rimarrje” (fr. épanalepse, it. epanalepsi) → **antepifora**

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga përsëritja, pas një intervali të caktuar, e një mjeti të njëjtë (me një a më shumë fjalë) në fillim e në fund të një njësie, që mund të jetë: një grup i thjeshtë sintaksor, një frazë, një strofë ose një formulim i tërë (p.sh. një poemë), për të përforcuar a qartësuar një koncept, p.sh.: “**Fatum**, o shpirt, ti je nër gaze / Dhe nër mjerime je **fatum**.” (L. Poradeci).

epanastrof/ë, -a f. shih **anadiploz/ë, -a**

epanod/ë, -a f. nga gr. *epánodos*, “kthim prapa, rimarrje” (fr. épanode, it. epanodo)

Figurë sintaksostilistike, përkufizimi i së cilës nuk është krejtësisht i fiksuar dhe nuk është gjithmonë e lehtë të dallohet nga anadiploza. Epanoda konsiston në përsëritjen e një a më shumë fjalëve të parapërmendura, që duket se funksionojnë në mënyrë autonome sintaksorisht, për të zhvilluar idenë që përmban secila prej tyre, duke i pasuruar ato me detaje, p.sh.: “*Ai është budalla, fajtor e qesharak, budalla sepse..., qesharak sepse..., fajtor sepse...*”. Epanoda shënon formalisht një thënie shpjeguese; por, ajo i jep gjithashtu thënies një frymë oratorie dhe hyn shpesh në rezonancë me disa figura konvergjente. Në kuptimin e saj stilistik, ajo është një tip *anadiploze*.

epanortoz, -i m. nga gr. *epánorthosis*, “korrigjim, korrektim” (fr. épanortose, it. epanortosi)

Figurë sintaksostilistike me të cilën zbusim ose tërheqim atë që është thënë më parë; autokorrigjim nëpërmjet shtesës me një sintagmë, p.sh.: “*Është një njeri i zoti, çfarë them unë?, një gjeni!*”. Treguesi morfoliksik i epanortozës është shpeshherë ndajfolja modalizuese “më mirë”, që është këtu më tepër një konektor (mjet lidhës). Kjo figurë kthen dinamizmin e një mendimi të kapur në një kërkim të dukshëm të së vërtetës.

epentez/ë, -a f. nga gr. *epéthesis*, “ndërfutje, shtim” (fr. épenthèse, it. epentesi)

Figurë fonostilistike që konsiston në ndërfutjen në trup të një fjale të një tingulli ose të një rrokjeje për nevoja metrike të vargut, për arsye eufonie, lehtësie në shqiptim, për analogji etj., p.sh.: “*Nuseja n’obo - jo - rre, / karajfil shatorre, / Nuseja në shka - ja - lle, / Karajfil i bardhe.*” (Këngë popullore).

epifonem/ë, -a f. nga gr. *epiphónema*, “zë i shtuar” (fr. *épiphonème*, it. *epifonema*)

Figurë sintaksostilistike në formë thirrjeje të rëndë, me të cilën përfundon një ligjërim (poezi, tregim etj.); fjali thirrmore që shërben për t'i dhënë një përfundim bisedës me një emfazë të vërtetë, qoftë edhe brenda një përshkrimi situativ, p.sh.: “Gjatë gjithë kohës nuk m'u hoq nga mendja ajo që tregon Ekermani për Gëten, i cili, kur nusja e djalit i tha se leximi i Shilerit të vë në gjumë, u zemërua dhe u shkreh: të gjithë ju jeni tepër tokësorë para tij!” (G. Krasniqi).

epifor/ë, -a f. nga gr. *epiphorá*, “shtesë, përfundim” (fr. *épiphora*, it. *epifora*) → **epistrofa**

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga përsëritja e një fjale a grupi fjalësh në fund të dy a më shumë vargjeve të një poezie ose të disa fjalive në një vepër artistike në prozë, duke i lidhur ose përmbyllur së bashku mendimet e shprehura, p.sh.: “Më erren sytë **kur zë qaj** / Më mbytet shpirti **kur zë qaj** / Nga kaqe vaj / Nga vaji im, nga vaj i saj. / Edhe nis muret t'i **zërmas** / Ah, thonj-përgjakur **i zërmas** / Edhe **bërtas** / Po si e çmendurë **bërtas** / Ah, lesh-lëshuarë **bërtas**.” (M. Kuteli). Figurë simetrike e **anaforës**.

epilog, -u m. nga gr. *epílogos*, “pasthënie” (fr. *épilogue*, it. *epilogo*) → **epiforeza**

Është pjesa përmbyllëse e një vepre artistike, ku jepet zgjidhja e saj a përfundimi i ngjarjeve që shtjellohen në të. Takohet mjaft në fabula, ku shpjegon moralin ose mësimin që duhet nxjerrë nga subjekti i trajtuar, p.sh.: “Njerëzit e poshtër e të ligj, nuk bëhen kurrë miq!”. E kundërta: **prologu**.

epiforez/ë, -a f. shih **epilog, -u**

epifraz/ë, -a f. nga gr. *epíphrasis*, “shtesë” (fr. *épiphrase*, it. *epifrasi*)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në shtimin e një elementi (një shtese shpjeguese) në fund të një fjalie që duket e përfunduar në vetvete, me efekt afektiv; lloj paranteze, p.sh.: ... “Ça të them!...”.

epistrof/ë, -a f. shih **epifor/ë, -a**

epitez/ë, a f. nga gr. *epíthesis*, “shtojcë, mbivënie” (fr. *épithèse*, it. *epitesi*) → **paragoga**

Figurë metrike që krijohet duke i shtuar fjalës në fund një a më shumë fonema (joetimologjike), për të plotësuar vargun (duke rritur efektin). Epiteza takohet më tepër në poezinë popullore, p.sh.: “*Hani bukë e turp mos kini, krushkani / Si në shtëpi tuaj jinni, krushkani.*”

epitrokaz/më, -ma f. shih **enumeracioni**

epizeuks, -i m. shih **përsëritje, -a**

eufemiz/ëm, -mi m. nga gr. *euphemismós*, “shprehje e zbutur” (fr. *euphémisme*, it. *eufemismo*)

Fjalë ose shprehje që përdoret në vend të një fjale a shprehjeje të ashpër, të cilën nuk duam ose nuk duhet ta zëmë në gojë; fjalë a shprehje e shprehur në mënyrë të zbutur, pasi, në të kundërt, ashpërsia e tyre mund “të vrasë”, p.sh., përdorimi i foljeve: *shkoi, iku, (na) la* e i shprehjeve frazale: *ndërroi jetë, shkoi me të shumtit, u nda prej nesh* etj. për “vdiq”, apo *buzëlidhuri* për “i vdekuri”, *gojëlidhuri* për “ujku”, *nuk thotë të vërtetën* për “gënjen”. Eufemizmi mund të shkojë në **antifrazë** deri në përdorimin e një fjale a thënieje që shpreh të kundërtën e asaj që duhet të thuhet. Duke thënë se “*Ai është shumë i kujdesshëm*”, mund të jetë një eufemizëm për të treguar se *Ai është shumë frikacak*. Thuhet: Përdor një eufemizëm.

hipalagë, -a f. nga gr. *hypallagé*, “ndërrim” (fr. *hypallage*, it. *ipallage*)

Figurë stilistike e cila konsiston në shkëmbimin e marrëdhënies normale brenda një ndërtimi sintaksor të dy fjalëve që për nga kuptimi i takojnë sferave të ndryshme, me qëllim për të arritur efekte të caktuara, p.sh.: “*Të ecësh me krahun mbi supet tua / e të harrosh oshëtimën e kaltër / limonat mbi krye / peshkarexhat si zjarre të natës?*” (Xh. Spahiu).

hiperbat, -i m. nga gr. *hypérbaton*, “tejkalim” (fr. *hyperbate*, it. *iperbato*)

Figurë sintaksostilistike përfutur nga renditja e fjalëve në fjali në kundërshtim me rendin e natyrshëm e të zakonshëm të gjuhës (të rregullave të saj), duke shkaktuar një prishje të kohezionit sintaksor, me qëllim për të arritur efekte më të mëdha.

hiperbolë, -a f. nga gr. *hyperbállo*, “zmadhim përtej masës” (fr. *hyperbole*, it. *iperbole*)

Figurë stilistike që konsiston në ekzagjerimin e një koncepti përtej kufijve të normales, duke zmadhuar përmasat e qenieve, të sendeve, të

vetive, të dukurive etj., zakonisht nëpërmjet krahasimit, për të theksuar më shumë një ide ose për të bërë përshtypje më të madhe te lexuesi, p.sh.: *Ka një shekull që pres!*, *Për një sekond shkoj e vij*, apo fjalët: **gjigant** - për një burrë të madh, **pigme** - për një burrë të vogël. Hiperbolën e gjejmë shpesh në bisedat e përditshme, me thënie të tilla, si: *Ta kam thënë 1000 herë!*, si dhe ndër këngët, legjendat, rapsoditë popullore, poezitë, si në vargjet: “*Në jetën time kam bërë **qindra** kafaze / Por kurdoherë me porta të hapura / Bile dhe femininë e mbaj mend si pëllumb / Pezull mbi paqen mëngjezore.*” (F. Rreshpja). Thuhet: Flet me hiperbola. E shpreh me një hiperbolë.

hipostaz/ë, -a f. nga gr. *hypóstasis*, “lëndë e kondensuar” (fr. hypostase, it. ipostasi)

Figurë morfostilistike që përftohet nga kalimi (ndryshimi) i një fjale nga një kategori gramatikore në një tjetër (p.sh., emri në mbiemër e anasjelltas, ndajfolja në folje etj.). Si figurë stili, hipostaza tregon konkretizimin dhe personifikimin e një koncepti abstrakt, p.sh.: *Të lutem, ma ashtu pak këmishën!* Ndajfolja *ashtu* është përdorur në kuptim foljor: *laj, hekuros, var, palos* etj., sipas situatës ligjërimore komunikative.

hipotaks/ë, -a f. nga gr. *hypótaxis*, “vartësi” (fr. hypallage, it. ipotassi)

Figurë sintaksostilistike që konsiston në pasurimin e një fjalie me një pjesë tjetër në vazhdim dhe krijimin e raportit të varësisë ndërmjet këtyre njësive, që evidentohet nëpërmjet një shenje funksionale gramatikore (lidhëze). Kështu, në fjalinë: “*Dua të të qortoj se të kam mik*”, pjesa “*se të kam mik*” është e varur nga drejtuesja nëpërmjet lidhëzës “*se*”. Në letërsi, përdorimi i strukturave hipotaktike në ligjërim lidhet me persona të formuar mirë kulturalisht, për të shprehur mendime të abstraguara, ndërsa njerëzit e thjeshtë, me një kulturë mesatare, në biseda të zakonshme parapëlqejnë të shprehen me fjali e fraza parataktike, ku zotërojnë lidhjet e thjeshta me bashkërenditje. Hipotaksë ka në fjalitë në vazhdim: *Marija shkon në palestër që të stërvitet; Luigji e di se do të arrijë i pari; Besoj që Paola kishte të drejtë.* E kundërta: **parataksa**. Parataksa dhe hipotaksa jepen zakonisht të lidhura, pasi rrallë në ligjërimin njerëzor dalin struktura sipas njërit apo tjetrit model, por të përziera, p.sh.: *Një tjetri që ka qenë fqinj me Meron e që i kish rënë në qafë në të gjallë, i ka hedhur një kovë ujë në oxhak, është bërë si erë e i ka shuar dritën e pastaj nëpër të errët frap e frup!* (M. Kuteli).

hipotipoz/ë, -a f. nga gr. *hypotyposis*, “skicim, paraqitje e përgjithshme” (fr. hypotypose, it. ipotiposi)

Figurë stilistike që konsiston në përshkrimin e një personi, një fakti, një sendi, një ngjarjeje të veçantë, reale apo fantastike, një situatë, me një gjallëri e pasuri gjuhe, sa të na duket sikur e kemi të gjallë parasysht, p.sh.: “*Atje n’moje t’mjerueme t’rruzullimit / Zymtë e me’i hije t’trishtueshme, t’përmnershme / Lshue krahëve ’i havër t’zezë, si re thellimit / rrin deka e tmerrshme.*” (Gj. Fishta).

hipozeuks, -i m. shih paraleliz/ëm, -mi

inversion, -i m. shih anastrof/ë, -a

ironi, -a f. nga gr. *eironéia*, “përqeshje, tallje” (fr. ironie, it. ironia)

Mënyrë e veçantë të shprehuri që i jep fjalëve një kuptim të kundërt ose të ndryshëm nga ai i mirëfilltë, me qëllim kritik ose të ashpër. Duke u dhënë fjalëve, shprehjeve etj. një kuptim të kundërt nga ai që kanë në të vërtetë ose duke bërë sikur pranon të kundërtën e asaj që mendon (jo me qëllim për të gënjyer), shkrimtari përqesh e vë në lojë dikë a diçka, duke ia lënë lexuesit a dëgjuesit ta kuptojë vetë mesazhin e vërtetë që përçon dhe që duhet të nxirret nga përmbajtja, nga konteksti e toni i ligjëritimit. Edhe në të folurit e zakonshëm përdoren dendur shprehje ironike që kuptohen si të tilla nga toni i zërit e nga konteksti, p.sh.: *Na doli “mirë” kjo punë!, “Bukur” e paske bërë!*, për të pohuar të kundërtën, d.m.th.: *Na doli keq. E paske bërë keq.* Thuhet: Përdor ironinë.

kakofoni, -a f. nga gr. *kakós* “i keq” + *phonía* “tingull, zë”, “keqtingëllim” (fr. cacophonie, it. cacofonia)

Figurë fonostilistike që përftohet me përsëritjen e të njëjtit tingull, zanor a bashkëtingëllor, në dy-tre fjalë të njëpasnjëshme me efekt fonetik të rëndë e të papëlqyeshëm; përshtypje e pakëndshme e prodhuar nga takimi i tingujve disharmonikë e shumë herë të përsëritur. Mund të jetë një e metë, por ka raste në të cilat autori i përdor për efekte stilistike, satirizmi etj., p.sh.: *Vijnë tre trena të ri; Mbolli një pjeshkë në bjeshkë; Tri sëpata plaka presin tre plepa pleq* etj. E kundërta: **eufonia** (bukurtingëllimi).

kalambur, -i m. nga fr. *calembour*, “lojë fjalësh” (it. bisticcio)

Figurë semantostilistike, bazuar mbi fjalë a shprehje me përbërje tingullore të njëjtë ose të ngjashme, por me kuptime të ndryshme, nganjëherë krejt të kundërta, me funksion komik ose thelbësisht ironik, p.sh.: *Rrufe eja, moj rrufe eja / Eja, moj, të raftë rrufeja!*

katakrez/ë, -a *f.* nga gr. *katáchresis*, “keqpërdorim” (*fr.* catachrèse, *it.* catacresi)

Figurë semantostilistike që konsiston në përdorimin metaforik të një fjale për të treguar një realie në gjuhë që nuk ka një emërtim specifik (një fjalë të mirëfilltë). Për të shprehur këtë realie që duam të tregojmë, detyrohemi të përdorim një fjalë të afërt me të (një lloj metafore), p.sh.: *këmbët e tavolinës, krahët e poltronit, qafa e shishes, qafa e malit, dhëmbët e sharrës a kupë e qiellit*, si në vargjet: “*Kthellët për nën kupë të qiellvet / Nji tym i shpeshhtë është dyndun.*” (Gj. Fishta).

kiaz/ëm, -ma *f.* nga gr. *chiasmós*, “kryqëzim” (*fr.* chiasme, *it.* chiasmo o chiasma)

Figurë sintaksostilistike që përftohet nga përballja e dy shprehjeve konceptualisht të ngjashme, në mënyrë që termat e të dytës të jenë vendosur me renditje të kundërt kundrejt atyre në të parën; përmbysje rendi e gjymtyrëve, ndërrim i kryqëzuar i tyre, duke ruajtur ndërtimin sintaksor të përgjithshëm, p.sh.: “*Përktheu Ferrin e Purgatorin, ndërkaq përfundoi në burg, pa marrë vesh, nëse ishte Dantja që e çoi drejt burgut apo burgu drejt Dantes.*” (I. Kadare).

klimaks, -i *m.* nga gr. *klîmax*, “shkallëzim” (*fr.* climax, *it.* climax) → **shkallëzim**

Figurë sintaksostilistike, e cila përftohet duke e paraqitur ligjërimin në rritje graduale për nga forca e nga intensiteti; me renditjen e fjalëve në mënyrë të tillë që të prodhojnë një efekt të fuqizimit progresiv (shkallëzim ngjytës) të mendimit. Si një nga mjetet më të fuqishme të sintaksës poetike, klimaksi përdoret shpesh në poezi, por edhe në prozë, p.sh.: “*Të rrosh vetë, të rritet djali - i thanë me një zë të dy plakat. ... Gruaja e shkretë e kuptoi, e mori vesh lajmin e hidhur. Filloi të qante, t'ulurinte. Djali i'u afrua pranë dhe qëndronte si i hutuar.*” (M. Kokalari). E kundërta: **antiklimaks**.

konduplikacion, -i *m.* shih **përsëritje, -a**

konsonanc/ë, -a *f.* nga lat. *consonans*, “bashkëtingëllues” (*fr.* consonance, *it.* consonanza)

Figurë fonostilistike që krijon një lloj rime të gjymtë, në të cilën përsëriten tingujt bashkëtingëllorë, kurse zanoret ndryshojnë, p.sh.: “*Haj të themi njëzë / të bënë në dizë.*” (Këngë popullore). E kundërta: **asonanca**.

krahasim, -i *m.* (*fr.* comparaison, *it.* comparazione)

Figurë që konsiston në vënien përballë të dy elementeve (fjalëve) të

një thënieje nisur nga një pikë e përbashkët e tyre, duke u vënë në dukje fjala krahasuese me lidhëzën *si* kundrejt asaj që krahasohet. Krahasimi mbështetet në atë veprimtari psikike të njeriut që është shoqërimi i ideve, p.sh.: “*Shtëpi e vjetër kulmrrëzuar si fati im / Shtegu i mbuluar me lule-harresë / Shkoi dhe bardi plak me lahutë / Me sytë prej mermeri të verbër.*” (F. Rreshpja).

Vijon ...

BIBLIOGRAFI:

Belluscio, Giovanni – Rrokaj, Shezai:

- *Fjalor krahasues i termave të gjuhësisë* (shqip - italisht - frëngjisht - anglisht), “Arbëria”, Tiranë, 2011.

Dubois, Jean – Giacomo, Mathée – Guespin, Louis – Marcellesi, Christiane – Marcellesi, Jean-Baptiste – Mével, Jean-Pierre:

- *Dictionnaire de linguistique*, “LAROUSSE”, Paris, 2001.

Patota, Giuseppe (Direzione scientifica):

- *Il Dizionario medio Garzanti della lingua italiana*, Dizionario Interattivo Garzanti, De Agostini Scuola S.p.A., “Stabilimento di Lavis (TN)”, 2010.

Baja, Orjeta:

- *Terma të përbashkët të gjuhësisë me letërsinë (në funksion stilistik)*, në revistën “Buletini shkencor”, nr. 9-3, Ulqin (Mal i Zi), 2017.

Topalli, Tefë – Baja, Orjeta:

- *Glosar - (100 terma gjuhësorë-stilistikë e retorikë)*, në: O. Baja, “Shqipja përmes shkrintarit”, “Fiorentia”, Shkodër, 2014.

Leka, Ferdinand:

- *Fjalor i termave të letërsisë*, “INFBOTUES”, Tiranë, 2013.

Zheji, Gjergj – Xhafka, Natasha:

- *Fjalor enciklopedik letrar*, “Mihal Duri”, Tiranë, 2001.

Fromilhague, Catherine:

- *Les figures de style*, “Nathan”, Paris, 2000.

Kane, S., Thomas:

- *Si të shkruajmë shqip* (redaktor: Xh. Lloshi), “Qendra për Arsim Demokratik”, Tiranë, 2010.

Lloshi, Xhevat:

- *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, “Albas”, Tiranë, 2005, 2012, 2015.

Reboul, Olivier:

- *Introduction à la rhétorique*, “PUF”, Paris, 1998.

The figures of the style
(Explanatory terminological dictionary)

ABSTRACT

In the vocabulary we intend to bring, the presentation of the **Style Figures** will come alphabetically, aiming at that of the explanatory type, with theoretical and practical extension, in order to clarify the conceptual aspects of the terms.

This terminological explanatory dictionary on Style Figures is considered useful as a consulting tool to better understand the content of these terms, and to be mastered by a wide range of users, such as writers, publicists, teachers, researchers and students.

Anisa KOSTERI

LEKSIKU I KUVENDIT TË ARBËNIT NGA ATË VINÇENC MALAJ

Të flasësh për françeskanët dhe kontributin e tyre në identitetin, gjuhën e kulturën shqiptare, është me të vërtetë një përgjegjësi e madhe, për vetë faktin, se për to ka shumë për të studiuar e kryesisht për të rrëfyer.

Misioni i tyre ngulmues në ruajtjen e traditave, zakoneve, gjuhës e shkollës shqipe që dhe vazhdon të jetë pjesë kryesore e ekzistencës së tyre. Kjo, duke pasur gjithmonë parasysh se misioni i tyre që kurdoherë i ashpër, pasi persekutimi i shoqëroi gjithmonë. Motoja e tyre ishte gjithmonë “Për Atme e fe”.

I tillë ishte edhe një prej tyre, Atë Vinçenc Malaj.

Atë Vinçenc Malaj që meshtar dhe studiues i njohur shqiptar, që la një trashëgimi të pasur kulturore. Lindi më 1 dhjetor 1928 në Ljarje të Krajës. Vdiq më 4 shkurt 2000 në Tuz, ku edhe u varros. Zhvilloi një jetë plot me veprimtari të vyera, të cilat kanë zënë një vend me vlerë në albanologjinë shqipe, por jo vetëm. Studimet i kreu në liceun Illiricum. Në Zagreb kreu studimet filozofike e teologjike, ndërsa në Romë kreu studimet linguistike me të madhin e letrave shqipe Ernest Koliqi. Me Ernest Koliqin ka bashkëpunuar edhe në revistën “Shejzat”, por ajo që pati një vlerë të madhe ishte edhe bashkëpunimi i tyre në mbrojtjen e tezës së laurës, ku prof. Ernest Koliqi që edhe relatori i tij.

Atë Vinçenci mbrojti laurën me temë: “Kuvendi i Arbënit” i 1703, pasqyrë historike, teksti shqip dhe fjalorth, në vitin 1971-1972, në Universitetin e Studimeve në Romë, Fakulteti i letërsisë dhe i filozofisë. Përveç kësaj, ai studioi veprën e Pjetër Bogdanit, bëri studime rreth historisë së popullit shqiptar, kryesisht për figurën e Skënderbeut.

Vepra e tij shkencore “**Kuvendi i Arbënit 1703**”, është përkthyer në shqip nga muzikologu i mirënjohur, studiuesi prof. Tonin Zadeja. Studiues të tjerë para Malaj-t, janë marrë me këtë ngjarje historike kishtarë e kombëtare të shekullit XVIII, duke analizuar aspekte të veçanta, ku mbizotërojnë ato gjuhësore, ndërsa në veprën e tij, Malaj përpiket të nxjerrë në pah vlerat e këtij Sinodi me karakter juridik - kishtar dhe doktrinar, në

pikëpamje historike, linguistike dhe shkencore.¹

Vepra “Kuvendi i Arbënit”, Fjalori, doli si botim nën kujdesin e Botimeve Françeskane, Shkodër, me rastin e 20-vjetorit të kalimit në amshim të Atë Vinçenc Malajt.

Njihte shumë mirë latinishten e greqishten, gjuhë të cilat e ndihmuan shumë në studimet e arritjet e tij shkencore. Atë Vinçenci pati një kontribut edhe në fushë të bibliotekave, gjithmonë duke pasur parasysh se sa e apsur ishte edhe biblioteka e tij personale. La shumë artikuj e dorëshkrime, shtudime shkencore në fusha të ndryshme, të cilat ishin një kontribut i madh në gjuhën e kulturën shqipe.

Studiues të ndryshëm, shënojnë shumë vepra që kanë mbetur në dorëshkrim, ku veçojmë: “*Bibliografinë e plotë të At Zef Valentinit*” në bashkëpunim me studiuesin shkodran Willy Kamsi, “*Seria e dorëshkrimeve të shkruar në gjuhën serbokroate*”, “*Bibliografia për martirët e krishtërimin në trojet iliro-shqiptare*”, një bibliografi prej 250 zërash, për të cilën vetë Malaj deklaronte: “*Kjo është vepra ime më e madhe e jetës*”.² Qëllimi i veprës, sipas Malajt, ishte të pasqyronte pasurinë gjuhësore të gjuhës shqipe, e cila ishte pak e njohur.

Autori, si metodikë pune, së pari, ka regjistruar fjalët ose formën semantike të zërave të përdorur në tekstin shqip të Kuvendit të Arbënit, duke treguar edhe formën e sotme letrare dhe sinonimet e ndryshme të shqipes së folur. Pastaj, vazhdohet me domethënien në italisht, gjetjen e rrënjës së fjalës, variantet e sinonimet e përdorura në të njëjtin tekst.

Së dyti, i është kushtuar vëmendje e veçantë etimologjisë dhe burimit të fjalëve duke iu referuar Fjalorit Etimologjik të G.Meyer, studimeve linguistike të N.Jokl, C. Tagliavini, E.Çabej, H. Barić, P.Skok, Fr. Ribezzo, A. Pascu, M. La Piana etj., pa hyrë në analiza të hollësishme të interpretimeve të tyre etimologjike.

Së treti, për të pasur elementët origjinalë të gjuhës, të cilat pasqyrojnë fjalorin historik të gjuhës shqipe, është tentuar që fjala të sillet ashtu siç është përdorur në tekstin e Kuvendit të Arbënit Gjithashtu, At Vinçenc Malaj pothuajse çdo leme në tekst i ka vendosur edhe fjalën ose frazën e marrë nga autorë e vjetër si Buzuku, Matranga, Budi, Bardhi, Da Lecce etj., të cilët përbëjnë fondin më të rëndësishëm të gjuhës shqipe.

Në parathënien e dorëshkrimit, Malaj thekson faktin, se nuk ka qenë e thjeshtë të gjindet termi i saktë për fjalët e Leksikut, pasi, përveç për Buzukun e Matrëngën, nuk ekzistojnë fjalorë historikë dhe studime

¹ Klajd Kapinova, “Mes kryqit e Atdheut”, Shkodër, 2000, f. 264.

² Klajd Kapinova, “Mes Kryqit e Atdheut”, Shkodër 2000, f. 256.

specifike për veprat e tyre, as një leksik historik i shqipes, as një atlas lingvistik. Këtu duhet të ndalemi pak për një sqarim të shkurtër. Mjaft mirë dihet, se Kuvendi i Arbënit është një ngjarje me rëndësi në kulturën shqiptare, ku përveç çështjeve kishtare, jep mjaft të dhëna për historinë, gjeografinë, zakonet, shkollimin, onomastikën shqipe.

At Vincenc Malaj ka mbrojtur laurën me këtë temë në vitin akademik 1971-1972 në Romë, por ndërkohë studiuesi prof.dr. Kolë Ashta, kishte ndërmarrë një nismë të mbledhjeve të shënimeve, të cilat pasqyronin një renditje të thjeshtë të lëndës gjuhësore të Kuvendit të Arbënit. Puna e parë filloi më 1957, Vokalizmi në veprën “Kuvendi i Arbënit”³ ndërsa punimet e tjera vazhduan më 1978⁴, 1979⁵1980⁶, 1981⁷, 1982⁸ me titull “Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit”. Prof. Kolë Ashta u bazua tek vëllimi i përkthyer në shqip më 1706.

Siç dihet, Kuvendi i Arbënit pati botimin në latinisht si dhe përkthimin në shqip. Vëllimi latin pati këto botime: i pari më 1702, i dyti më 1803 e pastaj më 1868. Kurse vëllimi me përkthim pati këto botime: i pari më 1706 dhe i dyti më 1868.⁹ Kolë Ashta e ka mbledhur materialin me një dashuri të madhe, me punë të palodhur, me një shpirt të madh, të lirë e kërkues, madje duke rrezikuar edhe idenë, se puna e tij do gjente dritën e botimit ndonjëherë. Por ndodhi që, Sektori Shkencor i Albanologjisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ndërmorri angazhimin e botimit të veprës së tij, të plotë, ku sot përmbledhet në 7 vëllime. Konkretisht, Kuvendi i Arbënit, përfshihet në kolanën V. Pra, ajo që duam të theksojmë këtu, është, se me studimin e leksikut të Kuvendit të Arbënit u

³ Kolë ASHTA: Vokalizmi në veprën “Kuvendi i Arbënit” (1706), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, 1957/1.

⁴ Kolë ASHTA: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(I), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit 1978/1,2.

⁵ Kolë ASHTA: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706), (II) “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit, 1979/1,2 (25), (26).

⁶ Kolë ASHTA: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(V), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVII i botimit 1980/1, 2 (27), (28).

⁷ Kolë ASHTA: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(VII), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVIII i botimit 1981/1,2 (29).

⁸ Kolë ASHTA: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(VIII), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XIX i botimit 1982/1 (31), f. 91-113

⁹ Kolë Ashta, Leksiku Historik i Gjuhës Shqipe V, Shkodër, 2009, f.13.

morën thujse në një periudhë të afërt kohore, dy figura të ndritura të letrave shqipe, At Vinçenc Malaj e prof. dr. Kolë Ashta. Siç vihet re, secili prej tyre punoi në mënyrë të pavarur, por me kritere të ndryshme.

Ashta i ka bërë veprës një analizë gjuhësore të imët si nga ana didaktike, ashtu edhe nga ana gramatikore, ku vendin e zënë fonetika, morfologjia dhe fjalëformimi. Më tej, vendin kryesor e zë leksiku i Kuvendit të Arbënit, ku autori çdo fjale të caktuar, pasi i ka dhënë variantin në latinisht, i ka dhënë shpjegimin e saktë, e ka shoqëruar me frazën, ku është përdorur ajo në tekst, duke e shoqëruar edhe ndryshimet fonetike e morfologjike, që ka pësuar fjala me kalimin e kohës.

Ndërkohë, At Vinçenc Malaj çdo lemë të leksikut të Kuvendit të Arbënit e ka shoqëruar me përkthimin në italisht, pasi edhe vepra është në gjuhën italiane, atje ku ai ka bërë mbrojtjen. Pastaj, ka dhënë formën aktuale në shqip, si dhe gjetjen e rrënjës së fjalës. Gjithashtu, autori ka bërë një punë të vyer në përcaktimin e etimologjisë së fjalëve, duke marrë për bazë latinishten e greqishten. Duke qenë një françeskan, ai e mendonte shqipen si një gjuhë me rrënjë latine. Atë Vinçenci bëri një punë të thukët dhe të bollshme në informacion gjuhësor, pasi për çdo fjalë ai ka dhënë edhe rastet e autorëve që e kanë përdorur atë, duke e shoqëruar me shembuj në fraza a fjali të shkurtra. Ai iu referuaa gjigandëve të letërsisë së vjetër shqipe, si: Buzuku, Bardhi, Bogdani, Budi, albanologëve Meyer, Jokl, Tagliavini, Barić, Skok etj., si dhe të madhit E.Çabej. Po i ilustruam me shembuj si më poshtë:

coban (-i) s.m. *barí, blegë, blegëtuer, pastore. My.EW 448. TLAD 97. Çb.Stud.et. II 76. Šk.Rj.tur. 178 < tur. çoban < pers. šubān. La parola è entrata in tutte le lingue balcaniche. Sk.Et. Rj. I, 332. Bl. epilio, pecorario - çoban (86.78).*

- *çobantë (8.3), (28.20); si çobani i shpirtinavet (8.20), (29.25); për zanát të çobanvet (13.26) pastoralis officii; të çobanit (14.28); esapi i çobanit (15.19); çobantë e shpirtinavet (25.10), (35.6-7), (42.6-7), (53.27) pastores animarum; i përket çobanvet fort me u brigetuem (26.8); pritesësë e barijut, të luftonjëne çobantë e shpirtinavet (53.27); posi çobantë (69.18) sed ut pastores; pá ugiçin e pá çobani (90.27) sine pastore, cine duce.*

divanisht avv. *botnisht, pubblicamente, apertamente, visibilmente. Šk.Rj.turc. 220 < tur. divan < ar. dīwān - consiglio, assemblea, corte, reggia. Jung.Voc. 24 divanisht - ex cathedra, giuridicamente. Sk.Et.Rj. I, 410 divān.*

- *e me të marrë të shakramentavet divanisht (22.2) ac visibili*

sacramentorum participatione; pá u leçitunë divanisht (22.30) publice.

dijekëqí (-ja) s.f. *dredhí, sherrí, malizia, astuzia, vizio, ignoranza.* - Bz. *pá ëndonjë dijekëqí (12v.43).* Bd.DC *diekëqí të tij (49.25).* Bl. *malitia - dijekeqja (53).* Da L. *dijekeqisht - astutamente (200).* Bg. *dijekeqia - malizia (I, 140, 1).* Bd. *as artë as diekeqí Sc. 357.*

- *silla e ferravet e dijekëqia vet kollahi egërtohet (26.21) et ingruente herba vitiorum colluviae; të pështjellunë me dijekëqij të zakonit (48.3) execrabilis vitio consuetudinis glomerata; e sá të rrinjënë ndë kohë të dijekeqijsë (61.23) et post aetatem doli capacem; as me dijekëqij t'anë (66.6) ne nostro vitio; për punë të dijekëqisë e të padijesë s'anë (84.24); ngremuem ndëpër gjitha koha të dijekëqijvet (90.28) oberrant montibus vitiorum; për të luftue me dijekëqije (102.13); e gjith këta del prej fajit e dijekëqijet së mjeshtrave (107.30) magistrorum vitio oriuntur discrimina.*

Autori ka treguar, se është një njohës i thellë i fjalës shqipe, por edhe i gjuhës italiane, duke e gjurmuar atë deri në gjetjen e sinonimit përkatës. Mjaft leksema shpjegohen përmes fjalës në italisht, por edhe sinonimeve përkatëse.

Ai pasuron leksikun e shqipes me sinonime stilistikore ose semantike, ngaqë fjalët me burim popullor mund të hyjnë në marrëdhënie sinonimike me fjalë të tjera të leksikut të gjuhës standarde, por edhe të folmeve krahinore e dialektore. Kjo ndikon edhe në rritjen e fuqisë shprehëse të fjalëve përkatëse. Po i vërejmë si vijon:

me sinonime në italisht, të cilat janë më të shumta:

drû (-ni) s.m., **drû** (-ja) s.f. legno, legname, albero, pianta.

egrë avv. egër, severamente, con fermezza, rigorosamente, ferocemente.

erë (-a) s.f. aria, vento; odore, profumo.

fage (-ja) s.f. volto, faccia, viso, lato, aspetto, pagina, superficie.

dispot (-i) s.m. despota, principe, tiranno, padrone.

djalë (-i) pl. **djelm**, s.m. giovane, ragazzo, figlio, fanciullo.

me sinonime në shqip:

drý (-ni) s.m. pl dryj e dryna, çils, çilc, çelës, chiave.

gënjye (me) cf. **ngënjye**, **majshtrue**, **mashttrue**, **rrëjtë**.

Por, kemi edhe raste, ku shpjegimin e fjalëve e jep me ndërthurjen e dy gjuhëve, italisht e shqip.

farue (me, me u) v. farosë, me qitë farë, çfarue, shue, zhdukë, sterminare, devastare, distruggere, annientare.

famí (-u), pl. **famij**, s.m. fëmí, foshnje, bambino, bimbo, figlio, fanciullo,

prole.

fëlligjë (me, me u) v. fëlliqë, ndý, sporcare, lordare, macchiare, contaminare, profanare.

Onomastika e përdorur në Kuvendin e Arbënit del tepër e pasur përmes Àt Vinçencit, pasi ai jep edhe shpjegime të mëtejshme historike, kulturore e fetare ndaj tyre. Gjejmë mjaft emra toponimesh e antroponimesh, për të cilat autori duket mjaft kompetent në përcaktimin historik e fetar të tyre. Përmendim disa nga ato:

Bagdatshim (i- e) agg. dal nome Baghdad, oggi capitale del Iraq. Nel testo equivalente per Babilonia, capitale dell'antica regione fra Eufrate e Tigri, dove furono esiliati gli Ebrei. Babilonia è per Israele la città del male per eccellenza. Nel testo è comparata con l'oppressione turca in Albania. Come la liberazione dall'esilio di Babilonia per il popolo di Dio fu tanto attesa, così anche per gli Albanesi è l'annuncio o "buona novella" della visita e del Sinodo Provinciale. Bg. Romënë, Badatnë (II.156 n.3).

- Ndënë këta të Bagdatshimi robnije vizitoj né i lési prej së nalti (13.11) in ipsa Babilonicae captivitatis servitute visitavit nos oriens ex alto.

Barbullush (-i) top. paese nell'arcidiocesi di Scutari, nella regione di Bushati, composta da sette frazioni di abitanti musulmani e cattolici. Shqyp. 29, 146. Zm.Visita 56-57: ha la chiesa di S. Stefano Protomartire della quale si servono li vescovi per cattedrale. Era una volta abbazia con opulenti rendite, unita alla mensa arcivescovile d'Antivari.

- qi janë Barbullushi djoçezë së Shkodrësë(82.4-5).

Dioklé (-ja) top. Dioclea, Dioclia, Doclea, gr. Dioklea, Doklea, sl. Duklja, nome dell'antica metropoli nelle vicinanze dell'odierna Titograd (Podgorica) nel Montenegro, antica Zeta (Zenta, Zedda) all'estremità settentrionale del Lago di Scutari. Verso il VI s. (530) fu distrutta dai Avari. Già dal V s. sede del vescovo. Nel 980 fu di nuovo distrutta da Samuele Imperatore dei Bulgari. Sul principio del XI s. fu unita con la sede arcivescovile e metropolitana di Antivari chiamandosi perciò "Archiepiscopus Dioclenensis et Antibarensis e dal 1475 "Primas Serviae" e metropolita della regione d'Albania con 14 suffraganei. Cf. Farlati, *Illyricum Sacrum*, t. VII, p. 1 ss. Sk.Et.Rj. I, 455 Düklja. - Bg. A. Zmajevich argjiupeshkupit Tivarit Dioklie (Introduz.).

- Arkiepishkup i Ntivarit, i Dioklesë, Primat i gjith Rregjiní së Shurbisë (10.5), (17.8) Archiepiscopus Antibarensis, Dioclenensis, totius Regni Serviae Primas.

Durcë - Durëci, Durrës, Durës, Durazzo, Dyrrhachium, Dirachium, Duracium, Durahium, gr. Dyrrahion, Dyrrakion, ar. Adras, sl. Drač. Nome dell'antica città illirica Dyracchi con amessa colonia greca corinzio-corfiotica Epidamnon, tra le prime conquistate nell'Ilirico dai Romani (229 a.Cr.) che ne fecero il loro più importante scalo adriatico. Metropoli della provincia d'Epiro nuova, poi Thema di Dyrrachion. Quasi mai toccata dai barbari, mantenne sotto i Bizantini gli Angiò, Bulgari, Serbi e dinasti locali (Topia) e Veneti (1392-1501) i l suo antico splendore, perduto po quasi completamente durante la lunga dominazione turca (1501-1912). Sede metropolitana della Chiesa latina e greca dal IV s. Dal 992 fino al 1392 cambia 32 volte i padroni. Cf. Zm.Visita 137 ss. Farlati, Illyricum sacrum, t. VII 335 ss. Skok, Arhiv II, 1 111-113. Baldacci, L'Albania. Cordignano, La città e l'archidiocesi di Durazzo, in La Civ.Cat.dic 1930. - Bl. Dyrrhachium, olim Romanorum Colonia nunc. A. Durazzo, Durrëc (197). Bg. Çezari pushtoj e mbujti Pompejinë ndënë gjytet të Durëcit nd'Arbënë (I.181). Da L. Durc (4).

- upeshkupinjëvet të... e të Durcit, qi rri mbë vend t'upeshkupit t'Albanit (77.19) Dyrachiensem Archiepiscopatum jura obtinentem Albanensis Episcopatus; Provincja e Durcit (107.8) Dyrachiensis Provincia; arkiupehshkupin e Durcit t'ânë vëllá (109.4) Dyrachiensem.

Fand (-i) top. Ndërfanda; regione della Mirdizia con 6 villaggi. Ndërfandëna, parrocchia nella regione di Oroshi (Mirdizia) con 8 villaggi, tra gli fiumi di Fandi i Madh e Fandi i Vogel. Fandi - parrocchia della diocesi di Zadrime vicino a Oroshi.

- Kisha e Shën Mrijsë ndër Fandëna (78.4) Ecclesia S. Mariae de Nderfandina; të Fand të voglit (78.5) de Fandi vogoli; të Fand të madhit (78.6) de Fandi madhë.

Duke u nisur nga çfarë pasqyruam më sipër, për disa nga vlerat e punës së tij, mund të themi, se vepra meriton të vlerësohet e studiohet, së pari për leksikun e pasur të një gegërishteje të pastër që na sjell, për larmishmërinë e varianteve leksikore që ai përdor, si në gjuhën shqipe, aq më tepër në gjuhën italiane.

Së fundi, mendojmë që autori i kësaj vepre ka qenë në nivelin e dijeve albanologjike të kohës, përderisa ka vënë shënime kopetente etimologjike, duke grupuar fjalë dhe duke i gjetur prejardhjen e tyre nga latinishtja apo greqishtja. Në këtë mënyrë vepra e Atë Vinçenc Malajt ruan sot e kësaj dite vlera historike, jo vetëm në planin leksikografik, por edhe në atë gjuhësor e kulturor.

BIBLIOGRAFIA:

- Klajd **KAPINOVA**: Mes kryqit e Atdheut, Shkodër, 2000.
- Kolë **ASHTA**: Vokalizmi në veprën “Kuvendi i Arbënit” (1706), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, 1957/1.
- Kolë **ASHTA**: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(I), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit 1978/1,2.
- Kolë **ASHTA**: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706), (II) “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XV i botimit, 1979/1,2 (25),(26).
- Kolë **ASHTA**: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(V), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVII i botimit 1980/1, 2 (27),(28) .
- Kolë **ASHTA**: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(VII), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XVIII i botimit 1981/1,2 (29).
- Kolë **ASHTA**: Leksiku i nxjerrë nga “Kuvendi i Arbënit” (në botimin e parë më 1706)(VIII), “Buletin shkencor”, Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, viti XIX i botimit 1982/1 (31).
- Kolë **ASHTA**: Leksiku Historik I Gjuhës Shqipe V, Shkodër, 2009.

The lexicon of the Assembly of Arbën from Father Vinçenc Malaj***ABSTRACT***

Talking about the Franciscans and their contribution to the Albanian identity, language and culture is really a great responsibility, because there is a lot to study about them. Such was one of them, Father Vinçenc Malaj. He was a well-known albanian priest and scholar, who left a rich cultural heritage. His scientific work “Assembly of Arbën 1703” came out as a publication under the auspices of Franciscan Publications, Shkodra on the occasion of the 20th anniversary of passing into eternity of Father Vinçenc Malaj. The purpose of the work, according to Malaj, was to reflect the richness of the Albanian language, which was little known. The author, as a working methodology, first, has recorded the words or the semantic form of the voices used in the albanian text of the Assembly of Arbën, showing also the current literary form and the various synonyms of spoken Albanian. Then, it goes on to the meaning in Italian, finding the root of the word, the variants and synonyms used in the same text.

Alva DANI

PËRKTHIMI I “FJALËVE TE PAPËRKTHYESHME” NË LAHUTËN E FISHTËS

Procesi i të përkthyerit bën që një vepër të flasë me gjuhët e shumë kombeve, që lexuesi të njohë e të kuptojë edhe veçantitë shpirtërore të kombeve të vogla, dinjiteti letrar i të cilëve merr përmasa që jo rrallë herë kapërcejnë kufijtë gjeografikë. “Lahuta e Malësisë” është poema e madhe kombëtare që u përkthye në katër gjuhë të huaja, për të shtegtuar prej kohësh në bibliotekat e largëta, pranë lexuesve të huaj, si një monument i kulturës, i luftës dhe traditës së popullit shqiptar.

Në gjuhën gjermane, *Lahuta* përkthehet dhe botohet e plotë në Mynih, nga albanologu i njohur Prof. Maksimilian Lambertz¹, i cili do ta vlerësonte Fishtë si një *Dichtergenius* (poet gjenial). Në gjuhën angleze përkthehet nga albanologu tjetër shumë i njohur Robert Elsie² (në bashkëpunim me Janice Mathie-Heck), një projekt i tij shumë ambicioz, që u përmbyll në 2005-n. Së fundmi vjen edhe përkthimi tjetër i *Lahutës* në gjuhën frënge nga Abidin Krasniqi³, botuar në Paris, në vitin 2019, nga shtëpia botuese “L’Harmattan’s”.

Interesi për t’u përkthyer në gjuhën italiane ishte shumë më i hershëm. Ndoshta ishin vetë lidhjet historike me Italinë e përtej kufirit dhe marrëdhëniet kulturore dhe njerëzore që imponuan nevojën e përkthimit të kësaj epepeje kombëtare. Për Italinë, ndoshta Gjergj Fishta nuk ishte i panjohur; ai ishte propozuar nga Akademia italiane dhe mbante titullin e akademikut duke u bërë kështu anëtar i saj. Përkthimi i *Lahutës* në gjuhën italiane vjen fillimisht nga imzot Jul Bonati, gjatë qëndrimit të tij në Firence, por pas përndjekjes nga regjimi, nga ky përkthim, do të mbetej vetëm Kënga e pestë.

Ernest Koliqi, mik e njohës i mirë i Fishtës, i hyri gjithashtu punës për të sjellë përkthimin e plotë të *Lahutës*, por arriti të përkthente vetëm

¹ Gj. Fishta: *Die Laute des Hochlandes*, Übersetzt, eingeleitet mit Anmerkungen versehen von Max Lambertz, München 1958.

² Gj. Fishta: *The Highland Lute: The Albanian National Epic* (Lahuta e Malcis: eposi kombëtar shqiptar), Londër, 2005.

³ Gj. Fishta: *Le Luth des montagnes: Une epopée Albanese*, Paris, 2019.

Këngën II, III, IV dhe V të Oso Kukës dhe Këngën XII, XIII, XIV, XV të Marash Ucit, në vitin 1961, të botuara në revistën “Shejzat”. Për Koliqin, dihet tashmë, se është një njohës shumë i mirë i gjuhës dhe kulturës italiane, njohës i studimeve letrare dhe gjuhësore, i qasjeve mes dy letërsive dhe përkthyes i shumë autorëve dhe veprave klasike të letërsisë italiane. Përkthimi, pa asnjë dyshim përbën një vlerë të shtuar të personalitetit dhe figurës së tij shumëdimensionale.

Në këtë punim do të ndalemi tek përkthimi i këtyre këngëve nga gjuha shqipe, si gjuhë e nisjes, drejt gjuhës italiane, si gjuhë e mbërritjes. Të tilla sprova përkthimi Koliqi kaloi edhe me disa poezi të Naimit, të Çajupit, Mjedës e disa shkrimtarëve të tjerë, të përmbledhura në *Antologia della lirica albanese* (1963). Ky lloj përkthimi, duhet thënë se, nuk është aspak i thjeshtë, e aq më tepër kur kemi të bëjmë me një poemë kombëtare, ku çështja bëhet edhe më komplekse. Duket sikur poetët kombëtarë është gati e pamundur t’i përkthesh, ka elemente që gjithmonë rrëshqasin vargjeve, e fjalë a shprehje që humbin ngjyrën dhe vlerën, megjithëse në këmbim të një thelbi sa më të vërtetë e të pacënueshëm. Martin Camaj mendon se përkthimi i *Lahutës* në gjuhë të huaj, duke cituar Koliqin e Lambertzin, i hap rrugën studimeve gjuhësore dhe antropologjike “pse në këtë mënyrë gjuha jonë vëhet në lidhni me krejt pasunin e vet me gjuhët europjane aq të përpunueme, tue u përveçue qartas dhe shprehja origjinale e shqipes fishtiane”.

Jakob Marlekaj në revistën “Shejzat” të vitit 1961, në një numër të veçantë kushtuar 90 vjetorit të lindjes së poetit, do të shkruante: “Fishta e njeh gjuhën e popullit aq mirë dhe din t’a përdori me aq mjeshtëri, sa vishtirë dallohet çka ai i fali popullit dhe çka populli i fali atij”. Të përkthesh Fishtën, nuk do të thotë të përkthesh vetëm vargjet e një poeme, por do të thotë të përçosh në një gjuhë tjetër jetën dhe kulturën e një populli, luftën dhe përpjekjet e tij për liri shekullore, brengën e madhe për mësymjet e vazhdueshme dhe shpresën e patundur për një atdhe të lirë.

Dhe kush më mirë se Koliqi mund të kryejë këtë mision letrar e patriotik, kush më mirë se një poet e një studiues i rapsodive të maleve mund të rrëfejë historitë e *Lahutës së Malësisë!*

Duke iu referuar vargjeve të poemës dhe përkthimit të saj në gjuhën italiane, do të perceptojmë jo rrallë herë se diçka mbetet e papërkthyer, se kryesisht shprehjet popullore nuk arrijnë të transmetohen me të njëjtën forcë dhe me të njëjtin konotacion, se fjalë të caktuara kyçe të *Lahutës* dhe të mentalitetit malësor nuk mund të përkthehen për një popull me kulturë dhe mendësi të ndryshme nga e jona. Është e vështirë të gjesh në leksikun italian fjalë që transmetojnë në mënyrë të pacënueshme *besën* e malësorit,

kanunin e Lekës, *zanat e orët*, mitologjinë e shkruar e të pashkruar, llojet e ndryshme të pushkëve që përshkruan Fishta dhe një sërë shprehjesh, që përcjellin mallkimet apo urimet e popullit.

Ajo fjala që ndeshet më dendur mes vargjeve të *Lahutës* dhe që theksohet me forcën e një riti a zakoni shqiptar është fjala *besë*. Kjo fjalë tipike shqiptare nuk do të gjente lehtësisht të barasvlershmen e saj në gjuhët e tjera, pikërisht sepse është një betim i shenjtë shqiptar, është një fenomen që kërkon shpjegime të gjata në mënyrë që të jepet sa më i qartë mesazhi. Këtë bëri përkthyesi i saj në italisht Ernest Koliqi, në fund të çdo kënge të përkthyer nxori dhe perifrazoi kuptimin e çdo fjale të rëndësishme që lidhej me jetën malësore e të cilat jo vetëm një lexues i huaj që nuk do t'i kuptonte, por as edhe brezat e sotëm të të rinjve që lexojnë Fishtën nuk mund ta kuptojnë lehtësisht, pa konsultuar njëkohësisht fjalorin shoqëruar të *Lahutës* apo studime të caktuara që lidhen me leksikun e Fishtës. Kështu në fundin e këngës XIII të *Lahutës*, përkthyer dhe botuar në revistën “Shejzat” të vitit 1970, nr. 4-6, do të gjejmë një shpjegim në gjuhën italiane të fjalës *besa*, që Koliqi e përkthen në disa variante, por edhe në variantin *giuramento sacro*, për të cilin thotë se kemi të bëjmë me atë që quhet “... besa shqiptare, betim i shenjtë, të cilit shqiptari i qëndron gjithmonë besnik edhe duke rrezikuar vdekjen dhe shkatërrimin e familjarëve të tij dhe të gjithë pasurisë. *Besa* mund të jetë edhe një armëpushim rigoroz midis njerëzve që urrehen, për të luftuar krah për krah kundër armikut të përbashkët, derisa të zhduket rreziku. Pastaj rimerren në mënyrë të pashmangshme hakmarrjet e mbetura pezull gjatë *besës*”⁴.

Këngët e përkthyer nga Koliqi shoqërohen në përgjithësi me shpjegime të tilla të detajuara të fjalëve apo shprehjeve të caktuara në gjuhën italiane, shumë të nevojshme për lexuesin e huaj për të kuptuar ngjarjet dhe personazhet e njëpasnjëshme. Do të ndeshemi me disa variante përkthimi të fjalës *besë*, të cilat vërtiten rreth kuptimit të fjalës, rreth asaj që mund të përkojë dhe mund të përçojë në gjuhën e huaj. Po sjellim disa shembuj nga vargjet e disa këngëve të përkthyer nga Koliqi:

⁴ E. Koliqi, *Canto XIII, Lahuta e Malcis*, Shejzat, nr. 4-6, 1970, f. 158.

- Si shqyptari mbas lirijs⁵
E mbas *besës* e s'bardhes Fe
- me rujt *besë*, mos me çartë ndore
- Zoti mirë ka me punue,
N'kjoftë se *besën* s'kemi lshue
- Njehen dhent e njehen dhitë
Por jo trimat me armë lë.
Trimat lidhë me *besë e fe*.
- Pse thonë shkja *besë* nuk ka...
- Shoq në Shkodër thonë s'ká lanë⁶
Per kah *besa* e kah trimnija,

- Per ket *besë*, kallxou kuletën,
- ...
- Si Shqyptari mbas lirijs
E mbas *besës* e s'bardhes Fé⁷
Báte deken si me le;

in cui lo schipetaro per difendere
la libertà dei monti e la sua fede
e *le usanze dagli avi ereditate*
siate fedeli alla *parola data*
protegete chi cerca in voi difesa
Speriam che Dio ci assista se serbiamo
intatte *le virtù dagli avi ereditate*
Si contano le pecore e le capre,
ma non gli eroi nati con l'arma in mano
non i prodi che unisce *un giuramento*.
che non convien *fidarsi* dello slavo.
Di cui non trovi a Scutari un suo pari
Per *inpegno d'onore* e intrepidezza,

Basti, *parola mia*.

...lo Schipetaro per difendere
la libertà dei monti e la sua fede
e *le usanze dagli avi ereditate*,
andava a morte come a nascimento.

Këto shembuj na tregojnë se është e pamundur të gjendet një fjalë e barasvlefshme në gjuhën italiane dhe se kjo fjalë është gati e “papërkthyeshme”. Fjala *besë* vjen për lexuesin e huaj, si: *parola data*, *impegno d'onore*, *usanze dagli avi ereditate*, *virtù dagli avi ereditate*, *parola mia*, *giuramento* e variante apo shprehje të tjera të ngjashme që arrijnë vetëm të sqarojnë kuptimin e kësaj fjale, e cila nuk gjendet në gjuhën e huaj, e për më tepër në kulturën e huaj. Por mund të themi se *besa* është të gjitha këto fjalë të marra së bashku, me ngjyresën kuptimore të secilës prej tyre, pasi “kodi i mrekullueshëm i nderit, i besës e i krenarisë së shqiptarit i zhyt rrënjët e veta në zakonet që formojnë një vizion të tij vërtetë të veçantë për jetën”⁸.

Një tjetër fjalë që nuk gjen një të barasvlefshme në leksikon e gjuhës së huaj, por përkon me disa të ngjashme është fjala *kanû*. Fjalë shumë e përdorur në vargjet e Fishtës dhe element kyç kulturor për shpjegimin e shumë shprehjeve apo situatave dhe ngjarjeve mes

⁵ Kënga XII, *Marash Uci*, në Lahuta e Malcis, Botime Françeskane, Shkodër, 2010.

⁶ Kënga IV, Vranina, f. 34.

⁷ Kangë e dymdhetët, *Marash Uci*, f. 134.

⁸ N.Kulla, D.Thomollari, *Çelësa për të hapur thesarin fishtjan*, Plejad, Tiranë, 2006, f.51.

personazheve të *Lahutës*. Këtë të vërtetë të pamohueshme e shpjegoi thellësisht e në mënyrë shkencore, Zef Valentini, falë njohjes dhe studimeve të tij të shumta mbi *kanunin*. Prandaj ai është i bindur se “çelësin për të depërtuar në hapësirat më të fshehta të shpirtit shqiptar, ia dha pikërisht Kanuni i Lek Dukagjinit, Kodi i Maleve Shqiptare, që përmban rregullat e të drejtat e tyre zakonore”⁹. Edhe kjo fjalë pothuajse e papërkthyeshme, do të përkthehet në disa variante të cilat në thelb, përçojnë me shumë mençuri kuptimin e saj. Në shembujt e mëposhtëm do të shohim se si arrin përkthyesi ta përshtasë atë për lexuesin e huaj.

- Pse armët kryq i kemi vù¹⁰, Poiché incrociate sulla soglia abbiamo¹¹
si na e lanë të parët **kanû**, l’armi come **l’usanza** lo chiede.
- Na i ka lanun armët besnike Di portar ci concesse le armi fide
Për me rujt Fe e zakone a custodir la nostra santa fede
Për me mbajt **kanû’n** e t’parëve a mantener le avite **leggi** antiche
Me rujt erzín e shqyptarve: insieme al nostro onore di Albanesi:
- Na ka falun pagë e t’dheta Da imposte ci esentò balzelli e decime
Kanû n’vedí sa t’jetë jeta, Non ci impedì di camminare nel solco
E na, veç n’e paçim çartë del retaggio dei padri e con **le norme**
Ket **kanû** q ina lanë t’Parët, **delle montagne** regular la vita,
Se e kem’ shkue jeten n’lirí **norme** che nobilmente praticate
Ci han permesso di vivere sui monti.
- Tue lutë festat trashigüe, Solenizzando feste e pasque e sagre
Mort e darsëm me **kanû**, e sponsali ed esequie celebrando
Sikur t’parët na pa’n punue, coi prischi **riti e gli usi** nostri aviti.
- Mbas **kanûs** s’Lekë Dukagjinit, Giusta **la legge** di Lek Ducagino

Nga vargjet e cituara shohim se kjo fjalë e vetme në gjuhën shqipe, *kanû*, përkthehet në variantet: *usanza*, *legge*, *norma*, *riti e usi*, të cilat pa asnjë dyshim përcjellin aspektet thelbësore dhe më përfaqësuese të këtij kodi themeltar në jetën e malësorëve të veriut.

Lazër Shantoja në një letër dërguar Gjergj Fishtës më 1932 do të theksonte se “Nji qi nuk është shqiptar, qi nuk e ndien veten të tillë; qi nuk është rritë e s’ka jetue me këtë popull, ai mundohet kot: nuk U kupton. Ju jeni të papërkthyeshëm. Për me përkthye shkrimet t’Ueja, duhet me shkruë bri tyne të tănë historín, të tănë psychologjín e atij populli të maleve t’ona”¹².

Ka shumë shkrimtarë që mendojnë se të përkthesh është pothuajse e pamundur, mes tyre mund të përmendim Gëten, i cili në librin e tij *Viaggio in Italia* (Udhëtim në Itali), do të shkruante: “Veçantitë e secilës gjuhë janë

⁹ N.Kulla, D.Thomollari, *Çelësa për të hapur thesarin fishtjan*, Plejad, Tiranë, 2006, f.36

¹⁰ Kangë e tremdhetët, *Te Kisha e Shnjonit*, f. 142.

¹¹ Canto XIII, „Shejzat“, nr 4-6, 1970, f. 151-158.

¹² D.Lazër Shantoja, *Letër Fishtës*, f.396, Revista “Shejzat” nr. 11-12, 1961.

të papërkthyeshme: dhe në fakt që nga fjala më sublime deri tek ajo më e përlulura, gjithçka lidhet me karakteristikat përkatëse të kombit¹³. Edhe filozofi Benedetto Croce e pohon papërkthyeshmërinë duke thënë se "... megjithëse përkthimi nuk përshtatet asnjëherë me veprën origjinale, e cila, në vetvete mbetet e papërkthyeshme, ai sjell përjetimin që vepra origjinale ka shkaktuar në shpirtin e përkthyesit"¹⁴. Ndërsa teoricieni i përkthimit dhe profesori i semiotikës, Umberto Eco, do të analizonte të gjitha proceset ku kalon përkthimi, me shembuj konkretë nga veprat e përkthyer, duke filluar nga përkufizimi i termit përkthim. Sipas Eco-s, të përkthyerit nuk është thjesht "të thuash të njëjtën gjë në një gjuhë tjetër", sepse kjo do të ishte shumë ngushëlluese, por duhet të përpiqemi të kuptojmë se si, "edhe pse e dimë që s'thuhet kurrë e njëjta gjë, të mund të thuhet *pothuaj* e njëjta gjë". Dhe ajo që përbën problem nuk është çfarë do të thotë *e njëjta gjë*, por çfarë kuptojmë me *pothuaj*. "Të përcaktosh se sa mund të epet e deri ku shtrihet *pothuaj*, varet nga disa kritere që negociohen paraprakisht"¹⁵. Pra, sipas profesorit italian, shumë koncepte që qarkullojnë në traduktologji, si: ekuivalenca, përputhja me qëllimin, besnikëria ose nisma e përkthyesit qëndrojnë në bazë të negociatës, që do të thotë se duhet të përkthehet duke negociuar.

Dhe nga sa pamë në shembujt e mësipërm Koliqi përpiqet të qëndrojë besnik i synimit të tekstit, të asaj që transmeton apo sugjeron teksti në lidhje me gjuhën në të cilën është shprehur dhe kontekstin kulturor në të cilin ka lindur. Dhe ky arsytim është shumë i vërtetë edhe për mjaft raste të tjera përkthimi që ngjallin interes e që lidhen me mitologjinë. Poema fishtjane pasqyron një popull që bashkëjeton në mënyrë të pandarë me mitet dhe legjendat e veta. Të tilla janë *zanat* dhe *orët e malit*, *kulçedrat* e *lugetërit*, të cilat poeti i shndërron në personazhe që flasin, që urojnë, që mallkojnë e që shitojnë. Në tekstin e përkthyer ka raste, që këto fjalë nuk përkthehen, lihen ashtu siç janë në tekstin origjinal dhe herë të tjera anashkalohen dhe nuk përmenden fare. Ashtu siç ka edhe raste kur përkthehen në përmbajtjen e tyre dhe në mesazhin që synojnë të përcjellin, pa synuar përshtatjen e tyre. Po ndalemi konkretisht tek disa nga vargjet e këngëve të përkthyer, ku evidentohen këto personazhe mitologjike.

- E u permendte *Orë* e *Zana*, e di *Oreadi* narrava e *alprestri dee*
- E per *lugat* kur zëhet hâna, E parlava di *Lemuri* che appaiono

¹³ Ervino Pocar, *Necessità delle traduzioni*, në "Tradurre-Pratiche, teorie, strumenti" .

¹⁴ Po aty.

¹⁵ U.Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi*, Dituria, Tiranë, 2006.

- | | |
|--|---|
| e per lufte qi me drangona,
Bân <i>kulshedra</i> n’vise t’ona;
Edhe i njifte aj mâ s’miri
Sa <i>drangoj</i> janë robit t’njerit ¹⁷ | nelle eclissi di luna e d’aspri attacchi
che sul suolo albanese e contro <i>l’Idra
di sette teste</i> sferrano <i>i dragoni</i> ¹⁶ |
| • N’Veleçik po pigron <i>Zana</i> ¹⁸ ;
• Burrë i fortë e trim <i>si Zana</i> ¹⁹ .
• Lum oj <i>Zana e Veleçikut</i> ...
• Porse trima të fortë si Zana,...
• Ehi, <i>moj Zanë</i> , ty t’kjosha true! ²⁰
• Çpo ban <i>Zâna</i> n’mal tue kja!
• <i>Orën</i> çut po e ka Hoti
• Pra, le t’çohet m’kamë djelmnija:
<i>Oren</i> çuet pse e ka Shqypnija:
Me të vetë âsht Perendija.
• <i>M’Orë të bjeshkve</i> e m’krye t’fmis
del figlio
• <i>Orën</i> çuet por e ka Hoti
• Thonë âsht <i>Ora</i> e Malit t’Zi... | Sul Veleçik <i>la Zana</i> si lamenta
Uomo <i>animoso</i> e robusta fibra
<i>Zana del Veleçik</i> ...
Senza pari come <i>combattenti</i> ...
O <i>Zana mia</i> , ch’io sia sempre e ate sacro
<i>La Zana</i> ai monti ancor si scioglie in pianto:
Hoti <i>fu avventurato in ogni prova</i> .
Qundi la gioventù si armi a difendere
questo suolo che Iddio ci diede e ch’Egli
Ha in sua custodia. Iddio che ama i forti...
... <i>sulle dee della montagna</i> , sulla testa
del figlio
Hoti ebbe in guerra sempre <i>lieta sorte</i> .
dicon che <i>scudo</i> sia del Montenegro. |

Këto dhe shumë shembuj të tjerë na bëjnë të kuptojmë se aty ku është e pamundur të përkthehet apo të gjendet një e barsvlefshme duhet të negociohet. Përkthyesi e ka të pamundur të përkthejë çdo fjalë të vargut, aq më tepër në një poemë epike, ku veçoritë e gjuhës shqipe, vargu tetërokësh, rima kryesisht e përputhur, loja e mençur e fjalëve me një rezultat të shkëlqyer muzikaliteti, do ta bënin përkthimin një sfidë të vërtetë. Po t’u kthehemi vargjeve të mësipërme, ku kemi veçuar personazhet e mitologjisë shqiptare, do të vërejmë variante të ndryshme përkthimi për personazhin *Orë* (ora e maleve) të tilla si: *dee delle montagne* apo *scudo* apo *lieta sorte*, por edhe në variante ku përkthehet pothuajse me një varg të tërë përmbajtja apo kuptimi i fjalës si në rastin “*Hoti fu avventurato in ogni prova*”. Personazhet e tjerë, si *kulshedra* do të përkthehet *Idra a sette teste*, apo *Lugetërit* do të përkthehen *Lëmuri*. Arsyen e një përkthimi të tillë na e jep vetë përkthyesi në mes të shpjegimeve të tjera tematike apo historike. “Për të shmangur shpjegimet e tejzgjatura për lexuesin jo shqiptar, jam përpjekur që gjatë përkthimit të përdor terma lehtësisht të kuptueshëm *Kulshedra* është *idra* me shtatë kokë. Në jetën

¹⁶ *Canto XII*, „Shejzat“, nr. 1-3, 1970, f.53.

¹⁷ *Marash Uçi*, f. 134.

¹⁸ *Te kisha e Shnjonit*, f. 139.

¹⁹ *Marash Uçi*, f. 133.

²⁰ *Te ura e Rrzhanicës*, f.159.

mitologjike popullore shqiptare kulshedra jeton nëpër ujëra, në llucë apo në liqenet e nëndheshme të shpellave malore. Duke quajtur *idra*, *kulshedrën* do të evitojmë ngatërresën që mund të shkaktojë *drago* dhe *dragone...*”.

Pra, në këtë pikë, pasi përkthyesi ka sqaruar atë që Umberto Eco e quan “Përmbajtje thelbësore të një termi”, vendos të negociojë, për t’i qëndruar besnik synimeve të tekstit. Personazhi më i rëndësishëm mitologjik mbetet ajo që Fishta e quan *Zana e Frymëzimit* dhe të cilën ai e krijoi vetë sipas lëndës mitologjike që gjallonte në popull, duke i dhënë krahë për të fluturuar dhe lahutën në dorë për të kënduar. Prandaj është e natyrshme që kjo fjalë gjatë përkthimit të mbetet “e papërkthyeshme” dhe të lihet ashtu siç e solli poeti, *Zana*, pa pretenduar ta përshtasë atë me simotrat e saj romake apo greke, sepse “*Zana* e tij e Frymëzimit nuk është as *Diana* e romakëve që identifikohet me *Artemiden* e grekëve, sado që në thelb ka diçka të përbashkët me të, sepse simbolizon mbrojtjen e natyrës së virgjër”²¹. Në këtë proces përkthimi, duket se përkthyesi e shikon të arsyeshme dhënien e shumë detajeve në gjuhën italiane, ku shpjegon figurën e *Zanës* në mitologjinë shqiptare, rolin e saj në jetën e malësorëve dhe funksionin që kryen në vepër. Konkretisht Koliqi shkruan se *Zana* është një: “...gjysëmperëndëshë e maleve; gjenden tre të tilla në epikën popullore shqiptare... zakonisht janë të padukshme, kur shfaqen për njerëzit marrin pamjen e vajzave të mrekullueshme, të paprekshme dhe të gatshme të transformojnë në statuja prej guri ata që prishin vetminë e tyre... Këtu Poeti përdor termin *Zana* në kuptimin e *Muzës*, perëndeshës së frymëzimit.”²² Dhe përkthyesi edhe në gjuhën italiane vendos ta ruajë, pa asnjë kompromis dhe e thërret *Zana*, duke i qëndruar kështu besnik tekstit e duke mos e cënuar konotacionin që mbart kjo figurë në vargun e Fishtës.

Epoka kur ndodhin ngjarjet e kur luftojnë personazhet, si ato historike ashtu edhe ato mitologjike, është shumë e largët, që nga lufta e Vraninës e vitit 1858 (në ciklin e parë, *Cikli i Oso Kukës*) e deri tek kryengritja e malësorëve të vitit 1911 me Dedë Gjo Lulin (*cikli i gjashtë*), e për këtë përkthyesi, që e njeh shumë mirë kontekstin historik, gati e perifrason poemën në gjuhën italiane, duke sqaruar kontekstin historik, atë çfarë solli Kongresi i Berlinit për shqiptarët, kush ishte Marash Uci, apo fjalë të tilla si *Bajrak* e *Bajraktar*, apo termin *Pleq* dhe çfarë përfaqësonte ky term për malësorët. Për përkthyesin duket që është shumë e rëndësishme njohja e kësaj poeme dhe e poetit të saj nga lexuesi italian, si dëshmi e një kontributi me shumë vlera në letërsinë shqipe, në një kohë kur Shqipëria

²¹ Tonin Çobani, *Lahuta e malësisë. Ngjizja mitologjike dhe Fjalori i figurave mitologjike*, Botimet Fishta, Tiranë, 2012, f. 50 – 51.

²² Note, *Canto XIII*, “Shejzat”, nr. 4-6, 1970, f. 157.

ishte tërësisht e izoluar dhe pak kush e njihte kulturën dhe popullin e saj.

Koliqi si përkthyes i sprovuar zgjedh të jetë sa më besnik i thelbit dhe i përmbajtjes, por duke mos lënë pas dore peshën dhe ngjyrën e çdo fjale. Besnikëria, sipas Eco-s, është “prirja për të besuar se përkthimi është gjithmonë i mundshëm, ... është angazhimi për të identifikuar atë që për ne është kuptimi i thellë i tekstit dhe aftësia për të negociuar në çdo çast zgjidhjen që na duket më e drejtë”²³. E në këtë pikë, Koliqi shpalos një mjeshtëri të rrallë, të admirueshme edhe nga përkthyesit e sotëm. Shfrytëzoi teknikat e përkthimit për të bërë të mundur njohjen e koncepteve më thelbësore të traditës shqiptare, të asaj që është identitare, duke i shpërbërë ato, për të përdorur termin e Derridës (sipas të cilit, përkthimi është dekonstruksion) duke i çmontuar, në mënyrë që të jenë më të thjeshtë për t’u kuptuar nga *tjetri*, më të hapur për t’u njohur e për t’u vlerësuar, si pjesë e një kontributi letrar.

BIBLIOGRAFIA:

1. Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, Botimi XVI, Botime Françeskane, Shkodër, 2010.
2. Revista “Shejzat”, Canto XII, nr.1-3, 1970.
3. Revista “Shejzat”, Canto XIII, nr.1-4, 1970.
4. Revista “Shejzat”, Canto IV, nr 10-12, 1971.
5. D.Lazër Shantoja, *Letër Fishtës*, Revista “Shejzat” nr. 11-12, 1961.
6. N. Kulla, D.Thomollari, *Çelësa për të hapur thesarin fishtjan*, Plejad, Tiranë, 2006.
7. Tonin Çobani, *Lahuta e malësisë. Ngjizja mitologjike dhe Fjalori i figurave mitologjike*, Botimet Fishta, Tiranë, 2012
8. Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën gjë. Përvoja përkthimi*, Dituria, Tiranë, 2006
9. Ervino Pocar, *Necessità delle traduzioni*, në “Tradurre-Pratiche, teorie, strumenti”
10. Ernest Koliqi, *Antologia della lirica albanese*, All’insegna del pesce d’oro, Milano, 1963.
11. Jakob Marlekaj, *Poezija e popullit e poezija e Fishtës*, Revista “Shejzat” nr. 11-12, 1961.
12. Martin Camaj, *Shëndrrimi e përpunimi i thanjeve popullore në Lahutën e Malcis*, Revista “Shejzat” nr. 11-12, 1961.

²³ U.Eco, vepër e cituar, f. 390.

Translation of “untranslatable words” in *Lahuta e Malësisë* by Fishta***ABSTRACT***

Koliqi is already known to be a very good connoisseur of the Italian language and culture, a connoisseur of literary and linguistic studies, of the approaches between the two literatures and a translator of many authors and classical works of Italian literature. Translation, undoubtedly proves to be an added value of his multidimensional personality and figure. Ernest Koliqi, a good friend and a very good connoisseur of Fishta, managed to translate from Lahuta, only Songs II, III, IV and V of Oso Kuka and Songs XII, XIII, XIV, XV of Marash Uci, which in 1961 were published in the magazine "Shejzat". Koliqi chooses to be as faithful as possible to the essence and content, but without neglecting the weight and color of each word. He uses translation techniques to enable the recognition of the most essential concepts of the Albanian tradition, of what is identity, dismantling them, so that they could be easier to be understood by *the other*, more open to be recognized and appreciated as part of a literary contribution.

Klotilda HARKA & Emrije KROSI
Shezai RROKAJ

DISKURSI I GJUHËS FISHTIANE NË POEZINË “NJI LULE VJESHETET”

Kjo ndoshta asht poezija ma lirike e mbarë këtij libri, n'atë kuptimin e ngushtë qi merr fjala. Asht një lirikë qi zbulon shumë ndiesi të botës së mbrendshme të Poetit. Subjekti i saj paraqitet mjaft i pacaktuem. Mbas mendimit tim Poeti në këtë karm – në këtë trajtë si paraqitet sot hartimi – nuk pat një vehtje të caktueme. Ai ndoshta – shka ka të gjitha gjasët – së parit desht të shprehë ndiesit e dhimbjës për këtë apo atë vehtje të caktueme, por, në përshkrim të hartimit, erdh tue e çveshë prej çdo veçansije, e kështu e idealizoi aq sa, ai Shpirt i lum, për të cillin s' ishte kenë toka por Qielli, i bahet qendër n' atë ravë të thepisne, qi shekulli e një dishir Lirijet ia kishin shtrure gjallimit të tij. N'atë vorr zemra do t' i ndezej, si Lekës së Madh në vorr t' Akilit, kah punët e mbara e kah burrnija, e prej, se kishte me shkepun hovin kah punët e mëdha. Engjulli i Zotit, qi brij vorrit do t' i sillte fuqitë mizore, do t' ishte njëheri edhe Zana frymzuese e Poetit. E atëherë, pa u frigue do të prehte zhgjetat e zjarra, për t' ia lëshue njerzimit kundër vesit, e do të ndertojë kangët kreshnike për t' i diftue botës se shka vlejnjë armët në dorë të Shqiptarit. Kështu, shohim se me kangë të veta do të ndertojë mbi atë vorr një përmendore vertetë të madhnueshme, së cilës nuk do të kishte se shka me i ba rryma e moteve. Zanat do t' ia rrethojshin vorrin me lule e do të rritshin për rreth selvija. Shtegtari i lodhun, ulë me pushue do t' i uronte paqë e qetësi e do t' u flitte për të të bijvet, qi kanë me nxjerrë kangë e me i gdhenun emnin mbi lisa, tue e ba kështu të pavdekëshme.

At Viktor Volaj O.F.M. (1941)

* * *

*N' atë rrahe t'vdekunve mbrenda vorrit t' errshem
Tash pluhun jë. Ata dy sy t' janë errë,
Ku qiella prirej me sa hana e diella
Terthores s' eper m' sharte vrejnjë t' njerzimit!
T' janë sosun fjalët e ambla e plot urti,
E ai zâ t' asht kputë, i cili bite n' zemer*

Si kumbë lret t' tingllueshme, qi prej s' largu
 Ndihet tue ra, kur dora e prekë e mësueme!
 Ehu! Po; "**vdekja**, qi baras n' derë t' pallateve
 Trokllon, si n' trinë t' kolibavet," ku i vorfni
 Me lot njomë buken, ty edhe ajo ké dera
 T' trokllloi, e ti kalove, porsí vesa
 E natës kalon, kur dielli bjen me shndritun
 Mbi kobe t' dheut. Sot permbi vorr t' kanë bijtun
 Hithat e madergona! **Nji Kryq dëllijet**,
 Qi e pershpirtshme nji dorë ta vu té kryet,
 Nder to ka humb, as tjetër send trishtimin
E vorrit nuk t' a zbutë, posë vajit t' trishtueshem
 Të hutit t' natës, qi nëpër **curra t' malit**
 Dhimbshem në rreze t' hanës rrin tue gjëmue!...
 Ai grumbull gurësh, qi **n' vorr** t' randon persipër,
 Vetë gjaksorit t' pashpirt, qi mbyti nierium,
 Lugat i duken, n' hikje kah t' bjen **nget vorrit**,
 Edhe t' përqethët atë botë, i shkon n' per zemer.
 Nuk t' la tjetër? Jo! **N' prehen t' Amëshuemit**
 Pjesa ma e mirë e jotja ka fluturue
 Me gzue n' dritë t' qiejvet, ku pushon dëshiri
 Injeriut t' drejtë, si drita m' sy të kthjellët.
 Po, po, se pertej **vorrin** shpirti i njeriut
 Gjallon perjetë! Ky mendim i ambel
Vdekjen e zbutë e **vorrin** ban t' pelqyeshëm.
 Kur zemren faji s'e grisë. Prej këtij mendimi
 As vetë per ty s' lotova shumë, kur ndjeva
 Se **vdique**: Se n' ma t' miren lule t' motit
 E le ti ketë shkreti, ku shuen e Drejta
 E paudhnija, ku sundon mizore;
 Ku i zhyemi m' vese sod me dorë dhunuese
 Vesin shinon me Theta t' zi, e selija
 N' rrashta t' pergjakshme t' njerzvet n' kambë, ku mbahet.
 Ehu! Po, se **Shpirti i yt**, i kulluet si rrezja
 E diellit, qi **perfton lulet e erandshme**,
 Kur bora dehet, s' mujt me e bajtë qelbsinen
 E randë t' ktij sheklli t' zi; por fletët i rrahi
Kah jeta e dytë, ku Ai qi rruzullimin
 N' themel e dridhë veç me 'i vetimë t' qerpikut:
Amshon n' lumni shka Atij t' i ket perngja.
 S' kje toka, jo, per ty kje qielli!
 E tash, qi vetë jam tue ravisë këto karta,
 Ti, kushedi, **nëpër vërrije t' amëshueme**
 Shkon tue kerkue per **lila e drandofille**,
 Qi s' dinë me u fishkë e ndreq me ta kunora,
 Per me u lulzue; mandej, **nder t' zjarrtat valle**,
 Qi nëpër **vërrije rrinë tue këndue t' Parrizit**:
 Ku, **fletët e arta bashkë kryqzue me Engjëj**,
Këndon Zotit lavde nëpër ylbera t' qiellit;
 A, marrë krejt n' t' pam t' s' **hyjnueshmes faqe t' Zotit**,
 Porsi m' pasqyrë t' kulluet shqyrton shestimin
 E rruzullimit, vu prej s' eprës Mendje,
 E cila n' t' kenun sendet thirri t' tana

Prej hijeve t' thellueme t' asgjasendit,
 kur bani Ajo furinë me heshtë t' thellimit,
 E me 'i fuqi t' pamatun prapi terrin
 E pakthellimit, qi atje n' t' skajshmet megje
 T' këtij shekulli ndihet tmershem tue gjëmue,
 Kah per ledhe plandoset t' rruzullimit.
 E aty, n' atë dritë plot ambelsim dashunije,
 Qi pors lum' i kjarhtë prej **Atit t' Dritave**
 Gjithkah dikohet nëpër **verë t' Parrizit**,
 Shpirtnat e lum krejt n' rreze tue përshi,
 T' kthiellta ti i prirë t' vertetat, t' **cilat Hyji**
 Deshi t' muzgëta njeriut me ia lanun t' shkrueme
 Nder fletë t' hyjnueshme t' t' **amëshuem Ungjillit**.
 Oh! Sa e sa herë, kur n' mbrame shuen natyra,
 E tjetër s' ndihet, veçse rryma e përeronit,
 Qi përmallshem **gurgullon nëpër rrâjë e curra**,
 Unë, lodhë mbi letra t' t' dijsheve t' kahmotit,
 Mbas t' cilve fjalën rrij tue lëmue shqiptare,
 Dal në dritare me kundrue shatorren,
Qi i Lumi t' kthiellti ia vuni rruzullimit,
 E këqyri hyjt, qi thue, **se aq sy Zotit**
 Flakojnë mbi dhë – kushdi, per me felgrue
 Nierin, qi egrue ma fort prej tmerrit t' territ,
 Perbluen punë t' mbrapshta: – e atë botë mendoj per ty.
 E, ku t' a shoh ma t' flakshem tue xhixhëllue
 Nji yll, aty selinë unë them me vete,
 Ti do t' a kesh, e sytë m' atë yll pa nda
 Inguli, e m' bahet si me t' pa. Me emën
 Unë t' thrras atë botë nëper terr. Nji vaj bylbylit,
 Qi përmallshem nder gamba rrin tue kja
 Fatin e vet, a ndoshta, zogjt e dashtun,
 Jehonë m' i bahet t' grishunit; e m' duket
 Se bisedoj me ty!.. Nuk **vdiska** i miri,
 Jo kurr; e sidomos nja', i cili nji zemer
 E len mbrapa m' e ankue. Prej **vorrit t' errët**,
Gjumin e vdekjës ku ai ban, na i flet mendimit,
 Ambël edhe na nzitë kah punët e mbara,
 E n' mendjen tonë gjallon. – Kur **Aleksandri**
 Prej Bregut t' Matës ngallnjes u kap **kë vorri**,
 Ku shuen idhnimi i **Prijsit t' Mirmidonëve**,
 Qi atje nën Shë vorfnoi me aq djalë **Ekuben**,
 Iu ndez aty flakë zemra kah lumnija.
 Mbi **atë vorr**, po, u betue me ngulë flamurin
 N' skaj t' dheut, e prej selisë me i zdrypë mbretnit;
 E atëherë perpara tij tanë bota shuejti.
 Mue edhë, qi shekulli e nji dëshirë Lirie
 T' thepisun raven m' ia kanë shtrur gjallimit,
 Mue, po edhe zemra mbi **vorr tand** t' pervujtun
 M' ndizet kah punët e mbara e kah burrnia.
Permbi vorr t' and, po, nxâ të fortë me e mbajtun
Besen e dhanun – e miqesin e zanë;
Per Fé e per Atme n' ballë me i dalë rrezikut:
 Të ligështit doren me ia ngjitë e t' fortin

Mos me e gledhue; kur t' jet me u thanë e drejta.
 Mos me i shmangë sytë prej cakat, n' t' cilin mendja
 Dishron me u kapë, as kurrë mos me u ligstue
 Nder sa t' vishtira, qi t' na sjellin motet.
 Po, po! Se pré' atij vorri kam me shkepun
 Hovin kah punët e mëdha. **Ai Kryq dëllijet,**
Mneren e vorrit qi ta zbutë, Ai qanderr
 Ka me m' kenë nder salvime; **Engjëlli i Zotit,**
 Qi rojës besnik fuqit t' i pruen mizore,
Gjumin e vdekjës në vorr mos me t' turbullue,
 Dër qi të shkimen n' **qiellë e hana e dielli**
 E t' ngele moti e shekulli mbarë t' rroposet,
 E t' vjërë dita e gjyqit t' rruzullimit,
Ai ka per t' m' kenë Zana. E atëherë, pa u tutë
 Zgjetat e mprehta e t' zjarra kam me i mprehë,
 Qi kundra vesit do t' ia lëshoj njerëzimit:
Atëherë unë kangët kam me i ndertue kreshnike,
 Me t' cilat botës unë do t' ia la të shkrueme
Se shka vlej në armët besnike n' dorë t' Shqiptarit.
 E me kangë t' mija 'i permendar t' madhnueshëm
N' vorr tand kam per t' ndertue, të cilin moti
 Me fletë të ngrita kot ka per ta rrahë;
 Pse, si curr, qi n' mes t' detit rreh tallazi,
 Edhe ai ashtu do t' mbesë nder gjire t' motit
 Qi bumbullojnë mbi faqe t' rruzullimit.
E atëherë prej bjeshkve kanë me u djergun Zanat
 E me të njoma vjollca e drandofille
Vorrit kanë me t' vallue, e kanë me rritë
 Me shumë kujdes per qark **selvia t' blerta;**
 E shtegtarit mundqar, qi n' ato hije
 Ka me zanë vend, me ndalë pak gja t' dihamet.
 Kanë me kallzue se sa pjesë qielli vrâni
Vdekja n' atë vorr. E atë botë i largët shtegtari
 Të lehtë dhëun ka me t' urue, e t' paqta e t' buta
 Shinat e boren: e, kur n' male t' veta
 T' dredhojë kë stani, fëmijës ka me i kallzue
 Shka ndjeu per ty. E fëmija e tij asobote
Emnin tand kanë per t' këndue, e **vrini e bjeshka**
 Gjithmonë i ri, tue njehë furit e mnershme,
 Ambël prej emnit tand kanë me jehue.
 Me maje t' briskut kanë me **shkrue mbi lisa**
 Me shkrola t' njohtne veç e prej barijve:
 Kanë me u **rritë lisat,** perse sopata as rëja
 S'e prekin landen, ku asht ravisë ai emen:
 E tue u **rritë lisat** kanë me u rritun shkrolat;
 E kështu ma t' kjarta mbas disa qindvjetëve
Nipat ma t' vonët kanë me i këndue, e emni,
Sa t' bjerë dielli tokës ka me t' u këndue.

1909.

Gjergj Fishta njihet si poeti më i lexuar dhe më i komentuar deri tani.
 Pothuasje e gjithë kritika e ka rrokur aq imtësisht veprën e tij, për gati një

shekull (gati katër breza lexuesish), duke e shkoqitur deri në genin e tij nëpërtej Atit të Dheut, të Hyjit, dhe Poetit gjenial, dhe i gjithë universi letrar fishtian, shpaloj gjenezën e kombit shqiptar, duke zhveshur të gjitha lëkurët, që nga thellësitë e paganizmit, tek moderniteti, me paradigmen e tij letrare: Atme e Fë. T'i qasesh Fishtës në mënyrë moderne, është një sfidë letrare, sepse arti dhe vepra, kanë tejkaluar kohën, duke u universalizuar. Qasja ndryshe ndaj poezisë “*Nji lule vjeshtet*”¹ e Fishtës, padyshim është një ndër më të diskutuarat, përmes thënieve dhe kundërthënieve, por e vërteta e pamohueshme është se kjo poezi është poezia më lirike e poetit të madh. Dialogu elegjaik i autorit mes vdekjes dhe pasvdekjes, ndoshta e ka filluesën që nga Egjipti i Lashtë me “*Libri i të vdekurve*”² të (Azem Qazimi-t), ku tipologjia e lirizmit fishtian, ligjërimi i brendshëm nëpërmjet diskursit të gjuhës, larg mitizimit të atdheut, ky tekst përshkruan:

- a) *ndjenjën e mallit dhe dhembjes,*
- b) *ndjenjën e mërzi së thellë,*
- c) *humbjen e bukurisë (si lule vjeshte), që sipas studiuesit Aurel Plasari, ka një ravijëzim për një femër të humbur, “si ligjërim dialogues dhe monologues, për të dashurën e humbur që nuk kthehet më”³, por përfaqësia e tij fetare, na dialogon me një marrëdhënie metafizike me vdekjen, ku shenjon:*
 - *shenjat tekstore të objektives dhe subjektives,*
 - *tipose të lirikës personale dhe autoriale,*
 - *dëshmia letrare mes fizikes dhe metafizikes, që edhe sikur “të mos e kishte pengue, zhguni i fratit, Fishta shumë, shumë do të kishte ndërrue objekt... por kurrë qëndrimin e vet subjektiv”⁴,*

shkruan në vitet '30-të, (Mark Ndoja). Figuracioni dhe stili shpalojnë një topos tematik, se vetë poezia është një përsiatje për të bukurën, vdekjen, mallin, mungesën, për moralin dhe përjetësinë, për artin e fjalës dhe (për)jetësimin e vdekjes, për të arritur pavdeksinë, (nëpërmjet testamentit letrar) se lidhja me unin poetik, është simboli i qenies së dashur, bëhet e amëshueme, duke qartësuar më shumë simbolikën e lirikës, si *shkak dhe qëllim*, se “*lirika*”, në një pikëpamje është biseda e poetit me pasvdekjen”⁵. Për Prof. Ali Xhikun, jo vetëm rrafshina mes dy botëve po edhe monologu dhe dialogu, vertikalisiteti dhe horizontaliteti në

¹ Fishta, Gjergj (2012): *Mrizi i zanonet*, “Fishta”Lezhë, f. 198

² Qazimi, Azem (2011): *Libri i të vdekurve “Zenit”*, Tiranë, f. 3.

³ Plasari, Aurel (1996): *Fishta i dashuruar*, Tiranë, f. 8.

⁴ Ndoja, Mark: (1943): *Idealet karakterizues në lirikën e At Fishtës*, (shënime të shkurtra kritike), At Gjergj Fishta (1871-1940): “Luarasi”, Tiranë, f.223-224

⁵ Xhiku, Ali (2004): *Letërsi shqipe si polifoni*, “Dituria”, Tiranë, f. 133-134

hapësirën boshe të varrit, tingëllon si një thirrme: *n' atë rrahe t'vdekunve mbrenda vorrit t' errshem/Tash pluhun jé. Ata dy sy t'janë errë,/Ku qiella prirej me sa hana e diella/Terthores s' eper m' sharte vrejné t' njerzimit!/T'janë sosun fjalët e ambla e plot urti, kacafytja mes madhështisë dhe përjetësisë, jetës kalimtare dhe vdekjes absolute, përmes alter egos, duke kaluar shkallët e për(tej)jetës, sipas kritikut Sabri Hamiti “lufta kundër harrimit, kundër kalueshmërisë”⁶, është fuqia e emocionit të veçantë që përçon kjo lirikë e Fishtës, si më të mirat dhe më të fuqishmet e letërsisë sonë shqipe. Për (At Viktor Volaj-n), “asht poezija ma lirike e mbarë këtij libri, n' atë kuptimin e ngushtë qi merr fjala. Asht një lirikë qi zbulon shumë ndiesi të botës së mbrendshme të poetit. Subjekti i saj paraqitet mjaft i pacaktuem”⁷. Nëse duhet të nisemi për (mos)përcaktuesën që shkruan Volaj, se subjekti është i pacaktuar duhet fuqia e emocionit të veçantë që përçon kjo lirikë, si më të mirat dhe më e fuqishme e letërsisë sonë shqipe, duket si një “ngatërresë” apo “hutim” i kritikëve, se vargjet: *e vorrit nuk t' a zbutë, posë vajit t' trishtueshem/Të hutit t' natës, qi nëpër curra t' malit/Dhimbshem në rreze t'hanës rrin tue gjëmue!...*, nuk e zvogëlojnë dhimbjen për dikë, duke qartësuar subjektivitetin dhe forcën e tropeve gjuhësore, që nëpërmjet gjallërisë së figurave, aftësia e vetëdijes shkruese, në mënyrë specifike, vishet me perceptim ndiesor dhe shqisor. Nocionet “figura” dhe “simbole”, në kontekste të ndryshme kanë një lakore brenda lëvizjeve brendatekstore por jashtëtektore, lëvizjet e figurave lart-poshtë dhe brenda-jashtë, “Simboli është gjithashtu edhe nga sinominet e “fesë” - simboli i besimit”⁸, për Wellek dhe Waren, është një analogji me shenjës dhe asaj çka shenjohet prej saj, si një mënyrë shprehje me shenja të caktuara, kur simbolet fetare mbeten në lidhje të brendshme, midis “shenjës” dhe objektit të “shënjuar” siç janë: *varri, vdekja, jeta, amëshimi* etj, aftësia e Fishtës sipas Giuseppe Gradilone-s “për të asimiluar më shumë së jashtëmi, sesa së brendshmi”⁹.*

o **Diskuri biblik**, si shenjë e një “simbolizmi të pastër”, vjen nga nocioni “diskurs” (nga lat. discursus) e ka kuptimin e endjes, bredhjes, shpërndarjes. Ky nocion konceptohet *si bisedë, apo si shkoqitje logjike*, por shenjat e “diskursit biblik” për kritikun Ndue Ukajn, janë qartësisht të dallueshme *simbolikat fetare*¹⁰, figurat ndiesore të formuluar dhe të

⁶ Hamiti, Sabri (2009): *Letërsia modrene shqipe*, Tiranë, shih: letërsia filobiblike, f. 447.

⁷ Parathënia; nga At. Volaj, Viktor (1941): *Gjergj Fishta: mrizi i zanavet*, komentuem prej At. Viktor Volaj OFM, Shkodër, f. 198.

⁸ Wellke, Waren (2007): *Teoria e letërsisë*, përkth: Abdurrahman Myftiu, “Onufri”, Tiranë, f.200.

⁹ Giuseppe, Gradilone (1983): *L'influenza del classicism sull'opera di Gjergj Fishta, La letteratura albanese e il mondo clasiso*, “Bulzoni”, Romë, 93.

¹⁰. Ndue Ukaj (2004): *Diskursi biblik në letërsinë shqipe*, “AIKD”, Prishtinë, f. 49.

zhvendosura në një sitë të caktuar shenjash dhe figurash, që qëndrojnë si një raalitet transhedral mes rrafshit moral dhe filozofik, ashtu si edhe “diskursi personal” duke ruajtur *shenjat e psalmeve*, nëpërmjet vargjeve: ***ai Kryq dëllijet, Mneren e vorrit qi ta zbutë, Ai qanderr/Ka me m’ kenë nder salvime; Engjëlli i Zotit***. Interpretimi letrar në letërsinë shqipe ka shenja të elementeve të diskursit biblik, që ndërlidhin sistemet e veçanta të interkomunikimit, jo vetëm si situata të veçanta shkrimore të letraritetit, por edhe si mënyrë e ndërtimit dhe ligjëritimit letrar, sipas Roland Barthes, “*teksti është një endje citimesh që vijnë nga mijëra kultura*”¹¹. Kur studiuesi Stefan Çapaliku shtron për diskutim *frymëzimin kristian*¹², në letërsinë shqipe, frymëzimi që ndërlidhet me *kodet biblike*, është përfaqësues jo vetëm e ndërtekstorisë biblike, por edhe të një lloji *poezie varrezash*. Sipas Jolanda Kodrës, “*Nji lule Vjeshtet, kjo kangë tejet e gjallë e Fishtës, ban pjesë n’atë lloj poezije varrezash, që aq përkrhaje gjet n’ Angli prej Young, Gray, Hervei e Poupe, e prej së cilës n’Itali u frymzue prej Pindemontes, Foscolo e Leopradi*”¹³, me një leksik të pasur biblik, se lidhet me *qenien dhe përjetësinë e njeriut*, me *vdekjen dhe jetën*. Padyshim diskursi i krishterë nuk mund të shmaget, pavarësisht se struktura ligjërimore dhe esenciale si tekst, për Kujtim Shalën, stuktura e “*Nji lule vjeshtet*” mbështetet në strukturën e “*intershenjave, të simboleve në rikualifikimet e domethënieve*”¹⁴.

- *Kodimi/(de)kodimi biblik* me elementet dhe strukturat “*semio-narrative*”¹⁵, të Algirdas Greimasit, *zbulojnë subjektin e ndjesisë*. Kjo na pasqyron me tregimin autobiografik, që përshkruan *vdekjen e tjetrit*, ose që quhet ndryshe, *thanatografi*, duke shenjuar jo vetëdijen e tjetrit, por vetë enigmën e vdekjes, bashkë me modalitetet e qenies, që kanë të bëjnë me një marrëdhënie të qëllimshme mes jetës dhe vdekjes, mes fizikes dhe metafizikes që shenjohen në tekst, nëpërmjet vargjeve: *qi nëpër vërrije rrinë tue këndue t’ Parrizit:/Ku, fletët e arta bashkë kryqzue me Engjëj,/Këndon Zotit lavde nëpër ylbera t’ qiellit; A, marrë krejt n’ t’ pam t’ s’ hyjnueshmes faqe t’ Zotit*. Relativizimi mes *simbolikës së*

¹¹. Barthes, Roland (2008): *Vdekja e autorit*, “Rozafa”, Prishtinë, f. 16.

¹². Çapaliku, Stefan (1999): *Frymëzimi kristian në letërsinë shqipe*; shih: (Krishterimi ndër Shqiptarë), Simpozium Ndërkombëtar, Seksioni i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës, Tiranë, f.33. <https://kallnori.org/stefan-capaliku-shqiperi-frymezimi-kristian-ne-letersine-shqipe/>

¹³. Kodra, Jolanda (1943): *Atë Gjergj Fishat, 1871-1949*, “Luarasi”, Tiranë, f.297.

¹⁴. Kujtim M. Shala (2004): *Fishta përballë Fishtës*, Buzuku, Prishtinë, f.15.

¹⁵. Greimas, Algirdas (1966): *Semantique structurale*, Larouse, Paris, f. 31.

vërtetë dhe përdorimi konstant i *metaforave simbolike*, duke afruar tropet e poezisë, me nënndarjet: *figurat e afrisë* dhe *figurat e ngjashmërisë*, sipas logjikës asociative apo edhe personifikimit, se poezia fetare katolike, duhet të jetë për (Middleton J. Murry-en), “*medomos metaforike*”¹⁶, në formën e himneve fetare të neoklacizmit: metaforat simbolike të vdekjes: [t’vdekunve mbrenda vorrit t’ errshem!/ Nji Kryq dëllijet, N’ prehen t’ Amëshuemit/ Engjëlli i Zotit,/ nget vorrit,/krejt vdekja/se pertej vorrit/ Vdekjen e zbutë/ N’ vorr tand/ Vdekja n’ atë vorr, 16 herë fjala vorr dhe 8 herë fjala vdekje, 13 fjalë, për Hyjin, Parrizin, Kryqin, etj].

- *Kodimi/(de)kodimi i ligjërit personal*, rrok rrafshet tërësore të kohës letrare, jo si mungesë receptimi, me gjurmë autobiografike, por me “kontratën autobiografike”¹⁷, të (Philippe Lejuene-s) rrëfimi autentik, shtegon katërcipërisht në humnerën e kujtesës bashkë me *aktin autobiografik*, që aq përmallshëm “vajton”, deri në Zenitin e të gjithë qiejve për Ringjalljen Hyjnore, nëpërmjet shkrimit: se e para ishte Fjala, si një besatim i vjetër biblik, ku njeriu e sprovtoj me humbjen e pavdekësisë, (duke ngrënë pemën e gabuar të Dijes), por me forcën e fjalës së thënë sipas Fishtës, se “*gjuha nuk ekziston e ndarë nga kultura, domethënë nga mbushja e trashëguar shoqërore e përvojave dhe besimeve që përcaktojnë thurjen e jetës sonë*”¹⁸, për (Eduart Sipar-in) është brenda të njëjtit projekt autobiografik. Fishta, si frat françeskan, si politikan, kritik, poet, patriot, ashtu si shumë modele të tjera të letërsisë shqiptare, ka të bëjë me vërtetësinë e natyrës njerëzore, me kodime dhe dekodime që shënojnë disa modele të letërsisë sonë bashkëkohore, që identifikon vetveten sipas Lili Sulës “*herë mes shenjave indentifikuese edhe autoriale e pikërisht personale*”¹⁹, me qendëzim vetëpërcaktues të vetëdijes, duke sfiduar një lloj “*cogito-je*” term karteziar. Kjo me “*elemente postmoderniste*”²⁰, të Linda Hacionit, janë një *postalterego* e teorisë së intertekstualitetit në tërë rrafshet e shkrimit letrar të Fishtës, ka një *nyje lidhëse aksiomatike*, që ndërlidh dy kohë, dy botë, dy realitete, që lidh vdekjen dhe Amëshimin.

¹⁶ Murry, J.Middleton (1931): “Metaphor”, *Contries of dhe Mind*, second series, London, f.8

¹⁷ Lejuene, Philippe (1975): *Le pacte autobiographique, Nouvelle Edition Augmentée*, Seuil, f.361

¹⁸ Sapir, Eduart (1949): *Culture, language and Personality*, University of California Press, f. 136.

¹⁹ Sula, Lili (2012): *Poezia e Fishtës*, (për mbrotjen e gradës “dokto e shkencave letrare”), Tiranë, 64.

²⁰ Hutcheon, Linda (1989): *A Poetisc of Post- modernism: History, Theory, Fiction*, Toronto, f.180.

○ *Diskursi atdhetar* as nuk mitizon, as nuk çmitizon atdheun. Poeti këmbëngul më tepër për metaforizmin e brendshëm të tekstit artistik, duke përsëritur elementet e tekstit, që lexuesi duhet ta kuptojë ose shoqëria në epoka të ndryshme, si çështje artistike dhe çfarë nuk është, që të nënkutohet nga vargu: *mue edhè, qi shekulli e nji dëshirë Lirie/ Besen e dhanun – e miqesin e zanë;/ Per Fé e per Atme n’ ballë me i dalë rrezikut*, duke përshkallëzuar;

- a. *çmitizimin e atdheut*,
- b. *çmitizimin e heroit*, nëpërmjet vargut; *se shka vlej në armët besnike n’ dorë t’ Shqiptarit*, motivet e veçanta që anojnë nga e çuditshmja dhe befasuesia, nga mishërimi i *së vërtetës kristiane*, “nga e afërta tek e largëta” nëpërmjet analogjisë së të përditshmes, nëpërmjet *figurave intensive*, përmasa e zvogëluar e dukurive të jetës, nëpërmjet përkëmbimit të *metaforave, simboleve, epiteteve*, duke bashkuar tri kategoritë e figurave: *figura e thellë, figura radikale, figura ekspansive*.

○ *Diskursi mitologjik*, nëpërmjet *miteve dhe perëndive* që shkrihen në *mitet e heronjve*, çon në “*zhvendosjen e mitit*”²¹, të Northop Frajit nga interesi parësor (ideja e mendimit poetik), në eposin e vargut. Kjo për të gjetur lidhjet asociative, lidhjet tingullore, lidhjet dykumtimësore, që mbartin edhe peshën e diskursit mitologjik tashmë të njohur të Fishtës, të krijimit të *mitit vetjak*, ose mitit fishtian i ngjashëm me përmasën e Dantes. Për Friedrich Nietzsche, “*pa mitin, çdo kulturë e humbte karakterin e saj të gjallë krijues, humbte forcën e vet të natyrshme*”²². Në pamundësi për të shmangur vargun: *ai ka per t’ m’ kenë Zana* apo Eposin e Kreshikëve, *atëherë unë kangët kam me i ndertue kreshnike* bashkë me vargun tjetër: *e atëherë prej bjeshkve kanë me u djergun Zanat*, poeti ka ndërtuar një galeri *epitetesh, enumeracionesh, përsëritjesh, similitudash, krahasimesh, metaforash, anaforash, kostonancash, asonancash*, etj: *sa hana e diella / curra t’ malit/ ky mendim i ambel/ kur bora dehet/ si rrezja e diellit/ per lila e drandofille/ nder t’ zjarrrat valle/ nëpër rrâjë e curra/ vaj bylbylit/ n’ qiellë e hana e dielli/ e t’ paqta e t’ buta/ shinat e boren/ e vrrini e bjeshka/ shkrue mbi lisa etj].*

²¹. Fraj, Northop. (1990): *Anatomia e kritikës*, përkth: Avni Spahiu, “Rilindja”, Prishtinë, f. 3.

²². Nietzsche, Friedrich (2001): *Lindja e tragjedisë*, përkth: Jorgji Doksan, “Eugen”, Tiranë, f. 17.

• *Diskursi neoklasik*, një lloj tjetër qasjeje që ka afruar poezinë e tij me poezinë neoklasike të Mjedës, duke dalluar *mënyrën osianike* të të kënduarit, fundja tendencat neoklasike, janë një imitim i vetëdijshëm i shkrimtarëve augustianë të vjetër, Virgjili dhe Horaci. Bëhet fjalë për një rend moral dhe racional i kuptueshëm në univers, duke demonstruar modelin providencial të Zotit. Prapëseprapë kjo vjershë lirike për Tonin Çobani, “*Një lule vjeshtet*” “*është një këngë heroike*”²³, me një numër frazeologjik, ku në [160 vargje janë 11 njësi frazeologjike]: *T’ janë sosun fjalët/ ai zâ t’ asht kputë/ Me lot njomë buken./ permbi vorr t’ kanë bijtun/ një dorë ta vu té kryet/ në rreze t’ hanës rrin tue gjëmue/ i shkon n’per zemer./ kur bora dehet/ perbluen punë t’ mbrapshta/ Gjumin e vdekjës/ kah punët e mbara*].

○ *Diskursi kritik*. T’i qasesh Fishtës në mënyrë kritike, nuk është e lehtë, pasi Fishta është një ndër poetët më të njohur brenda një kohe shumë të shkurtër. Shumë ese, shënime kritike janë shkruar për një periudhë gati 10 - vjeçare, por me vendosjen e komunizmit, anatemizmi dhe ndalimi i tij, si bashkëpunëtor i fashizmit dhe letërsia e tij u etiketua “reaktionare” dhe “klerike” apo edhe një *poet i folklores*. Pas viteve ‘90-të, receptimi masiv i Fishtës deri në tekste shkollore, kur “çmenduria” e dashurisë kolektive shqiptare arriti deri atje, saqë, teksti fishtian u standardizua në bazë të normës së gjuhës së sotme shqipe, por a mund të ndryshohet areali i gjuhës së Fishtës, âmza e shijes së gjuhës së tij, tingëllima e âmël e gegnishtes?! Një dështim total, që specialistët e kësaj fushe janë *po aq fajtorë*, për heshtjen, fajtores është *po aq dhe Kritika* po ashtu, duke shprishur rendin e *harmonisë tingëllimore të polifonisë* së kryeveprës fishtiane. Sa për receptimin modern e ndërtojmë në bazë të emrave të mëdhenj të kritikës evropiane:

- Sipas Eco-s, teksti është i thurur me shenja e hapësira të bardha që duhen mbushur dhe ai që ka krijuar parashikonte, që ato të mbusheshin dhe i ka lënë të bardha për dy arsye; *para së gjithash* sepse teksti është një mekanizëm dembel (ose ekonomiqar) që jeton me vlerën e shtuar të kuptimit që i futet nga marrësi, *së dyti*, ndërsa kalon dalëngadalë nga fikcioni didaskalik në atë estetik, një tekst di t’ia lërë lexuesit iniciativën interpretuese . Një tekst kërkon “*që dikush ta ndihmojë të funksionojë*”²⁴, sipas Maria Pia Pozzatos. Dhe kjo lloj strategjie nuk kuptohet më si qëllim i

²³ Çobani, Tonin (1999): *Miti dhe antimiti fishian*, Lezhë f. 12.


²⁴ Pozato, Pia Maria (2005): *Semiotika e tekstit*, (metoda, autorë, shembuj) , SHBLU, Tiranë, f. 201.

autorit empirik po si një marrëveshje tekstuale, që quhet *Autori Model* (Fishta dhe lexuesi empirik), në lëvizjet e tekstit të shkëputura nga leximi

empiric. Të para si lëvizje të brendashkruara, të parashikuara në tekst, përputhen me atë që Eco e quan *Lexuesi Model* dhe mungesa kohë/hapësirë, krijon:

- *autorin empirik*, në terma të strategjisë tekstuale , formon ***Lexuesin Model***
- *lexuesin empirik*, në terma të strategjisë tekstuale, formon ***Autorin Model***.

Duke parë këtë strategji të Eco-s, do të ndërtojmë një grafik të një Lexuesi dhe Autori Model për lirikën e Fishtës:



Një tjetër koherencë e Ecos është e ashtuquajtura veprueshmëri (veprimtari) e tekstit ndaj lexuesit. Në fakt, autori jo vetëm e parashikon Lexuesin Model, por edhe e ndërton atë. Të parashikosh Lexuesin tënd Model, nuk do të thotë, të shpresosh të ekzistojë, por edhe të lëvizësh tekstin në mënyrë të tillë që ta ndërtosh atë, një tekst, jo vetëm pushon, por edhe jep kontributin e tij në ndërtimin e një kompetence.

KOMPETENCA AUTORIALE NË LIRIKËN E FISHTËS = PROJEKTIM I LEXUESIT MODEL
AUTORI = TEKSTI = LEXUES

- Përsa i përket “teorisë së receptimit të Iserit”²⁵, sipas teoricienit Wolfgang Iser në vitet ’60-të, në të gjitha sferat e teorisë së receptimit, teksti letrar ka lloje të tjera ligjërimi dhe në marrëdhënien tekst-lexues shumë herë merret si e mirëqenë. Procesi i leximit, për Iserin, ka "dy pole" brenda një teksti letrar: *poli artistik* i referohet tekstit të krijuar nga autori, *poli estetik* i leximit, realizuar nga lexuesi. Që të përmbushet akti i të lexuarit, lexuesi i nënkuptuar është *aktiv dhe pasiv*, aktiv sepse nxjerr përfundimin sipas teoricienit tjetër (Roman Ingarden), “ku lexuesi qartësisht *nxit imagjinatën ose “plotëson rreshta bosh” të pathëna nga autori*”²⁶, në strukturat e tekstit, që drejtojnë lexuesin drejt një “leximi” shterues

²⁵. Ise Wolfgang (1978): *The Act of Reading: A Theory of Aesthetic Response* . Baltimore and London: Johns Hopkins University Press, f. 45-48.

²⁶. Ingarden, Roman (1973): *The literary work of Art*, Evanston, III, f. 83.

dhe jo anasjelltas. Teksti është lënë në duart e lexuesit për të marrë fatin e tij. Meqenëse asnjë lexues nuk do të ketë “pamje të njëjtë”, teksti është i

detyruar të interpretohet në mënyra të ndryshme, gjë që i mundëson çdo studiuesi përshirë edhe kritikën, se teoria e receptimi të veprës e bën të qartë. Se në tekst, nuk zhvillohet vetëm sfondi socio-kulturor, por dhe ideo-shoqërore, përsëri për Roman Ingardenin, është procesi “*midis interpretimit-brendisë-shprehjes-kuptimit, si një vendosje të autorit brenda procesit të traditës*”²⁷, ku edhe veprimtaria intelektuale dhe emocionale e manifestuar në procesin njohës të tij, (në bashkëkohësi) akti i leximit, me të vërtetë ndikon në ngritjen e vetëdijes, që zhvillohet përmes procesit të leximit.

Koncepti “*horizonti i pritjes*”²⁸, i (Robert - Hans Jaus-it), se receptimi i mëvonshëm i një veprë letrare, është matja e një “distance estetike” për një vepër letrare, nga një brez tek një brez tjetër lexuesish, duke sjellë përshtypje krejt të tjera në kohë të ndryshme, për Fishtën nuk qëndron. Ndërthurja e kohës së shkuar, me lexuesin e ri mund të përmbushë konceptin e “horizontit të pritjes”, që për poetin është koha posturne, që fatmirësisht pati *kohën e leximit, të njohjes, të receptimit*, duke kuptuar që vepra është e pakohë ashtu si emri i Fishtës i gjithkohshëm në majën e epërme të letërsisë shqipe.

²⁷. Ingarden, Roman (1973): *The Cognition of the Literary ork of arts*, Evanston, III, f.185.

²⁸. Jaus, Hans-Robert (1982): *Toward an Aestheticon of Receprion*, Brighton, f. 5.

BIBLIOGRAFIA:

1. Barthes, Roland: (2008), *Vdekja e autorit*, “Rozafa”, Prishtinë.
2. Bruss Elisabeth W. (1976), *Autobiographical Acts: The Changing Situation of a Literary Genre*. Baltimore, London: Johns Hopkins Univ. Press.
3. Çapaliku, Stefan: (1999), *Frymëzimi kristian në letërsinë shqipe*; shih: (Krishterimi ndër Shqiptarë), Simpozium Ndërkombëtar, Seksioni i Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës, Tiranë. <https://kallnori.org/stefan-capaliku-shqiperi-frymezimi-kristian-ne-letersine-shqipe/>
4. Çobani, Tonin: (1999), *Miti dhe antimiti fishian*, Lezhë.
5. Fraj, Northop. (1990): *Anatomia e kritikës*, përkth: Avni Spahiu, “Rilindja”, Prishtinë
6. Gradilone Giuseppe: (1983) L'influenza del classicism sull'opera di Gjergj Fishta, *La letteratura albanese e il mondo clasiso*, “Bulzoni”, Romë
7. Greimas, Algirdas. (1966): *Semantique structurale*, Larouse, Paris.
8. Hutcheon, Linda: (1989), *A Poetics of Post- modernism: History, Theory, Fiction*, Toronto.
9. Hamiti, Sabri: (2009), *Letërsia modrene shqipe*, Tiranë.
10. Ingarden, Roman. (1973): *The literary work of Art*, Evanston, III.
11. (1973): *The Cognition of the Literary work of arts*, Evanston, III.
12. Ise Wolfgang. (1978): *The Act of Reading: A Theory of Aesthetic Response*, Baltimore and London: Johns Hopkins University Press.
13. Jauss , Hans-Robert. (1982):*Toward an Aesthetics of Reception*, Brighton.
14. Kodra, Jolanda: (1943), *Atë Gjergj Fishta, 1871-1949*, “Luarasi”, Tiranë.
15. Kujtim M. Shala: (2004), *Fishta përballë Fishës*, Buzuku, Prishtinë.
16. Lejuene, Philippe: (1975), *Le pacte autobiographique*, Nouvelle Edition Augmentée, Seuil.
17. Mark Ndoja: (1943), *Idealet karakterizues në lirikën e At Fishtës*, (shënime të shkurtra kritike), At Gjergj Fishta (1871-1940), “Luarasi”, Tiranë.
18. Murry, J.Middleton: (1931): “Metaphor”, *Contries of dhe Mind*, second series, London.
19. Nietzsche, Friedrich: (2001), *Lindja e tragjedisë*, përkth: Jorgji Doksani, “Eugen”, Tiranë.
20. Ndue Ukaj: (2004), *Diskursi biblik në letërsinë shqipe*, “AIKD”, Prishtinë.
21. Plasari Aurel: (1996), *Fishta i dashuruar*, Tiranë.
22. Pozato, Pia Maria: (2005), *Semiotika e tekstit*, (metoda, autorë, shembuj) , SHBLU, Tiranë.
23. Qazimi, Azem: (2011), *Libri i të vdekurve “Zenit”*, Tiranë.
24. Sapir, Eduart. (1949), *Culture, language and Personality*, University of California Press.
25. Sula, Lili: (2012), *Poezia e Fishtës*, (për mbrotjen e gradës “dokto e shkencave letrare”), Tiranë.
26. Volaj, Viktor: (1941), *Gjergj Fishta: mrizi i zanavet*, komentuem për At. Viktor Volaj OFM, Shkodër.
27. Wellke, Waren. (2007): *Teoria e letërsisë*, përkth: Abdurrahman Myftiu, “Onufri”, Tiranë.
28. Xhiku , Ali: (2004), *Letërsi shqipe si polifoni*, “Dituria”, Tiranë.

Fishta's linguistic discourse in the poem "An Autumn Flower"***ABSTRACT***

In this completely different approach, for Fishta's most famous but also most unknown lyric, "An Autumn Flower", we must first know not only all the critical writings, studies and scientific conferences on Fishta's lyrics, but also a very good knowledge of literary theories and world criticism, as this lyric itself is very complicated, not only with metaphors, but as overlaps of many elements, which need to be trimmed with great study accuracy. Therefore, the study must be seen in a multifaceted way, not only in the poetic-literary plane, but also in the individual plane of the poet, because many connoisseurs of Fishta's work call it, a poem dedicated to a hidden woman or girlfriend. Recognizing the poet and his religious liturgy in his written texts, this thesis collapses. But, this remains the best lyric of the poet this is not even discussed, which should be reviewed under another aspect, that of criticism.

Keywords: lyrical poetry, biblical discourse, biblical code, modern reception, critical reception, etc.

Karmen LAZRI, Zamira SHKRELI

**NDIHMEA E STUDIUESIT KOLË ASHTA PËR
TERMINOLOGJINË MBËSHTETUR MBI
FJALORIN E XHEVAT LLOSHIT**

Gjuhëtari Xhevat Lloshi i ka pasur parasysh arritjet shkencore të disa fjalorëve terminologjikë dhe shpjegues, hartuar para tij në vendin tonë, para dhe pas Luftës së Dytë Botërore; i ka vlerësuar ato, duke treguar edhe anët e mangëta të tyre, sidomos në planin shkencor special.

Ky qëndrim dhe vlerësim përherë nga pozita gjuhësore, pikësëpari, nga pikëvështrimi i fjalëformimit (pa lënë jashtë saktësinë metodike e shkencore sipas dijeve të dy fushave), duke synuar cili ka qenë boshti themelor i studiuësve dhe dijetarëve tanë për të ruajtur elementet e natyrshme të shqipes, pasi bëhet fjalë për dy dije që kanë lidhje shekullore e mjëravjeçare të njeriut: për njohjen e botës së gjallë bimore e shtazore, kaq të pranishme në jetën e njeriut, që kur ai u kthye në homo sapiens. Përveç kësaj, veprat leksikografike për termat në gjuhën shqipe janë lidhur përherë me hapësirën apo habitatin ku lindin dhe kultivohen bimët e kafshët, si Shqipëria e më gjerë. Çdo kërkimtari të disiplinave gjuhësore, qoftë edhe në punime si ky yni, i bie për detyrë të zbulojë ç'vend zë lënda e shqipes në fjalorë si këta dygjuhësh, shqip-latinisht dhe latinisht-shqip, siç është ai i Prof. Xhevat Lloshit dhe çfarë risie sjellin termat në procesin e shqipërimit të kësaj terminologjie aq të gjerë, siç janë flora dhe fauna e vendit tonë, si klasifikohen termat e një fushe speciale të shkencës, a zotërojnë në fjalor shqipërimet *ad litteram*.

Në fjalorë si ky, studiuesi duhet të shohë edhe përshtatjen gjatë shqipërimit, procesin e kalkimit të fjalëve terma, gjatë përfutimit të skajeve teknike me fjalë, dyfjalësha (sintagma) dhe me kompozita, duke mbetur në truallin e gjuhës, qoftë edhe në një sektor studimi të saj, siç mund të bëhet çështja e fjalëformimit për shprehjen e termave, një problem mjaft i ndërlikuar dhe i vështirë gjuhësor. Për studiuesit, pasqyrimi i kësaj terminologjie, vazhdon të mos jetë i lehtë, sepse, si shkruan Prof. Xh. Lloshi në parathënie, *trevat shqiptare në perëndim të Ballkanit, ndonëse nuk përbëjnë një sipërfaqe shumë të madhe, përmbajnë afër 40 përqind të bimësisë e të kafshëve të Europës, falë kjo larmisë gjeografike dhe*

*klimatike të zonës.*¹ Merret me mend ç'numër i pafund termash, variantesh dialektore e në të folme, gjenden e përdoren tek shqipfolësit e trevave të Shqipërisë, prandaj shkruan në hyrje të veprës së tij, se *Standardizimi i terminologjisë duke iu përqasur standardizimit evropian është sot detyrë shtetërore në Shqipëri dhe në Kosovë bashkë.*²

Për kushtet historike e politike dhe kushtet e zhvillimit të shkencës shqiptare, në një periudhë që përfshin gjysmën e parë të shekullit XX, niveli shkencor i veprave të tilla linguistike, përndryshe të përshkrimit të terminologjisë shqiptare në rrafsh të ndryshme të dijeve të kohës, ka lënë për të dëshiruar. Dhe arsyet dihen: vendi trashëgonte një prapambetje të thellë kulturore e arsimore dhe në ato dhjetëvjeçarë që përmendëm, nuk ishte e mundur të pritëshin punime ndryshe nga kërkesat speciale të terminologjisë. Megjithatë, me zhvillimet që mori shkolla dhe arsimi shqiptar në periudhën e ashtuquajtur të Pavarësisë Kombëtare (1912-1939), u bënë hapa të mirë në lëvrimin e gjuhës shqipe, në shtrirjen e rrjetit të shkollave në të gjithë vendin, edhe jashtë kufijve të sotëm politikë të Shqipërisë, d.m.th., në hapësirat shqipfolëse, hapa që çuan në shtimin e numrit të botimeve jo vetëm letrare, por edhe të atyre shkencore. Mirëpo, shkruan autori, *bie në sy një kundërti e plotë ndërmjet realitetit gjuhësor dhe qëndrimeve puriste.*³

Për të gjitha këto përpjekje, autori i Fjalorit që kemi në objekt të hulumtimit tonë për këtë punim, pohon në parathënien e veprës: *“Studimi i florës dhe i faunës shqiptare ka tashmë më shumë se një shekull që ka nisur nga specialistët e huaj dhe vendës. Ata kanë bërë përpjekjet e para për të përcaktuar fjalët shqipe me përgjegjëset e tyre në terminologjinë latine. Në mesin e shekullit XX, sidomos me ngritjen e instituteve të posaçme shkencore, kjo punë u zgjerua me kujdesin dashamirës të botanistëve dhe zoologëve shqiptarë, të cilët gjatë kërkimeve mbledhën edhe fjalët përkatëse të shqipes.”*⁴

Tradita shqiptare e studimeve dhe kërkimeve shkencore në fushë të leksikut (vendi ynë kishte nxjerrë leksikografë që nga shekulli i 17-të, Frang Bardhin), natyrshëm, është lidhur me trashëgiminë evropiane në këtë fushë, duke menduar, se dijetarët e pakët e të rrallë që u morën me interesa si këto të përshkrimit të florës e faunës shqiptare, sa u takon termave dhe

¹ Xhevat Lloshi, *Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve Shqip-Latinisht dhe Latinisht - shqip*, LOGOS A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, f. V.

² Po ai, po aty, f. VIII.

³ Po ai, po aty, f. VIII.

⁴ Po ai, po aty, f. VI.

emërtimeve, kanë qenë në niveleve të atilla sa ta njihnin e ta shfrytëzonin traditën kontinentale. Në këtë lëmë mund të përmendnim shkrimtarin më të mirë nga shkrimtarët e vjetër të Veriut, Pjetër Bogdanin, i cili, sipas Xhevat Lloshit, ka qenë i pari që e ka ndier vështirësinë stilistike për t'u shprehur një një shqipe shkencore, fakt që e ka dëshmuar edhe në parathënie të veprës së tij origjinale (1685), ku ankohej se “*gjuha jonë me dijet dyer ene fjalët*”(e përsërisim sipas autorit të Stilistikës së gjuhës shqipe), ai mendonte se në Shqipëri kishte pasur një shkencë dhe bashkë me rënien e saj, kishin humbur edhe termat e shkencës.⁵

Për këtë pohim historik e shkencor njëkohësisht, shprehemi se ekziston një lidhje ndërmjet përpjekjeve të arsimit dhe dijetarëve shqiptarë para dhe pas Luftës II Botërore, sa i takon edhe shkencës gjuhësore; aq më tepër, se dihet, që në nivelet mbi të cilat studiohet një gjuhë si shqipja, hulumtimet në planin fjalëformues kanë qenë ndër të parat në albanologji; dhe ato janë bërë para Luftës II Botërore, si nga veprimtari dhe organizatori i njohur i arsimit shqiptar, Mati Logoreci, prej publicistit e leksikografit Karl Gurakuqi, ashtu edhe filologut Mustafa Kruja.⁶

Si ngjarje kufiri për një zhvillim të shpejtë për studime gjuhësore, edhe në terminologji, ka qenë hapja e instituteve të larta shkencore, hapja e Universiteteve (Tiranë e Shkodër, 1957), ashtu edhe ngritja e Sektorit të Terminologjisë në gjuhën shqipe. Pra, për të arritur tek Fjalori ynë, i Florës dhe i Faunës, botuar nga Prof.Xhevat Lloshi, kanë kaluar një radhë veprash të kësaj natyre, të cilat kanë hedhur bazat teorike e praktike të kësaj dege të gjuhësisë.

Pas veprës madhore të Ilija Mitrushit, 1955, në vitin 1963 nga Sektori i Terminologjisë të Institutit të Historisë dhe të Gjuhësisë u hartua dhe u publikua “Fjalori i terminologjisë tekniko-shkencore 1. Terminologjia e Botanikës (shqip-rusisht frëngjisht)” dhe sipas recensentëve, është i pari i serisë së fjalorëve terminologjikë të shkencave të ndryshme që janë publikuar në albanologji, ku *termat nuk janë përkthim mekanik ose një kalkim i thjeshtë i fjalëve të huaja*.⁷ Është me rëndësi të theksohet se fjalori u hartua me kritere të drejta shkencore, të cilat mund të njihen sipas

⁵ Xhevat Lloshi, *Fjalori i emrave të bimëve dhe të kafshëve Shqip-Latinisht dhe Latinisht - shqip*, LOGOS A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, f. 201.

⁶ Mustafa Kruja, *Problema gjuhe*, Studime, OMSCA-1, Tiranë, 2000. (Janë studimet dhe vlerësimet, bashkë me kritikën, që u bënë këtyre autorëve M.Kruja, lidhur me Fjalorthët e tyre me neologjizma e fjalë të rralla, ku gjenden edhe mjaft terma nga fusha të ndryshme të dijës.)

⁷ Ferdinand Leka, *Studime mbi leksikonin dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972: “Mbi disa fjalorë të terminologjisë...”, f. 315.

pikave më poshtë:

- a. të shfrytëzohen sa më tepër mundësitë e mëdha që ka shqipja për të krijuar fjalë - terma dhe prirja që ka marrë zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë;
- b. të shfrytëzohen sa më mirë mënyrat dhe tipat më prodhues të formimit të fjalëve në gjuhën shqipe;
- c. të shqipërohen termat shkencorë ndërkombëtarë, duke përfshirë ato fjalë që janë jo vetëm të dy a më shumë gjuhëve neolatine, por edhe nga gjuhët e tjera;
- d. të rivlerësohen disa terma të vjetër të përdorur qysh në kohë të Rilindjes Kombëtare;
- e. të merret parasysh përhapja e termit në krahina të ndryshme si përdorim i folësve.

Fjalori ka gjithsej 1202 fjalë-terma, prej të cilave, sipas studiuesit F.Leka, 871 janë fjalë shqipe dhe vetëm 331 janë fjalë me rrënjë të huaja, përfshirë edhe ato që quhen internacionalizma, përndryshe, fjalë me prejardhje greke e latine, që gjenden në shumë gjuhë.⁸ Një vend të mirë në fjalor zënë fjalët kompozita, të krijuara me kriterë të shëndosha shkencorë, si: *petëlngjashëm*, *pjellëshumë* etj. Gjuhëtarët tanë, për këtë fjalor, janë të mendimit se në mjaft terma të botanikës vërtetohet edhe një herë parimi, se fjala shqipe është më prodhuese, i pranon më me lehtësi elementet afiksiale shqipe në krahasim me fjalën e huaj të huazuar, si b. f., nga emri *dell* burojnë: *dellëz*, *dellëzim*, *i*, *e* *dellëzuar*. Përveç kësaj, për këtë fjalor, shënohet, se kur formohen terma të rinj duhet t'u kushtohet vëmendje edhe anës fonetike; të shmanget me kujdes çdo homofoni që mund të sjellë ngatërresa në kuptimin dhe qartësinë e termave, si: *djegës* - *djegëza*, *kupës* - *kupëza*, ku çiftet pothuajse bien në homofoni⁹

Në radhë të studimeve gjuhësore në fushë të terminologjisë shqipe, pas citimit të mësipërm, të sjellim në disa pika ndihmesën e Prof.Kolë Ashtës edhe në lëmë të kësaj nëndisipline të studiuar nga leksikologjia dhe pikërisht, një shkrim të tij në revistën “Buletin shkencor” i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës, në vitin 1970, duke nënvizuar që në fillim, se në kërkimet tona gjuhësore rreth kësaj tematike, ky historian i shqipes së shkruar, mund të jetë i vetmi që në hulumtimin e vet zë fill me shpjegimin e termave “term” dhe “terminologji”¹⁰. Ai shpjegon që në krye të herës se

⁸ Ferdinand Leka, *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972: “Mbi disa fjalorë të terminologjisë...”, f. 316.

⁹ Po ai, po aty, f. 317.

¹⁰ Si një dukuri të veçantë të shkrimit të Ashtës, themi se emrin “term-i”, autori i njohur, e përdor në gjininë femërore “term-a”, prandaj dhe përcaktuesit e tij i përshtat me këtë gjini.

termë, vjen prej latinishtes “**terminus**”- është pjesa e fundit e një vendi, pra caku, kufini, skaji, porse në leksikologji është ajo fjalë e posaçme ose shprehje, që ka të bëjë ose me një punë të caktuar të veprimtarisë njerëzore në fushën e profesionit, pra fjalë profesionale, ose me një degë të veçantë të diturisë, pra fjalë të teknikës apo të shkencës e të artit. Pastaj terminus si e huaj u zëvendësua në shqipe me fjalën **skaj**.¹¹

Ai shkon më tej në paraqitjen e tij duke shënuar, se termi “terminus” në kompozim me fjalën greke **logos**, jep tërësinë e termave ose e skajeve të mbledhura bashkë si punë leksikografike, por në anën tjetër, quhet kështu edhe studimi i tyre si punë leksikologjike. Gjuhëtari ynë tregon, se një nga fushat ku shtohen termat janë “sfera bimore e shtazore”.¹² Këtë çështje që shtrohet para disa dhjetëvjeçarësh në gjuhësinë tonë, e shohim të konkretizuar aq qartë në Fjalorin e bimëve dhe të kafshëve shqip-latinisht të Xh.Lloshit, gjë që del në pah jo vetëm në formimet terminologjike të njohura e të panjohura deri më sot, por sidomos në këto drejtime:

- A. në fjalëformimin me ndajshtesa, kryesisht me prapashtesa, si: *vijëzak, micak, zemërka, mënishte, kunupicë, kungullush, kuqlorja, kupshorja, jargaveci, apo fieri kryqore (Polystichum acrostichoides)* ku fjala përcaktuese “kryqore” (kryq + or), është formim me parpashtesën - or, *qelbësi, fletraci, fillçi, fishkëllyesi, flokëza, freskori, genciana, gjarpërushja, etj.*
- B. në emërzime si: *lulëkuqja, lulëbardhi, luleverdha, lulëgjakja, gusharja, gushëspeci, gushkaltri, hundëmprehti, hundëgjati, hundëgypi, hundëshqiponja, këmbëpulëza, këmbëdelja, këmbëlehti, etj.*
- C. në formime kompozitash të reja, si: *lulezemra, lulevija, lulevesa, luleshurdha, gjethefik, etj.*

Kolë Ashta e ka quajtur fort të rëndësishme mbledhjen dhe renditjen e fjalëve popullore për t’i ngritur ato në terma, sepse duke e arritur këtë, arrihet njëkohësisht edhe pastrimi dhe pasurimi i leksikut të gjuhës, pa pasur nevojë përdorimin e fjalëve të huaja si terma në rrafsh të ndryshme të shkencës e teknikës. Kjo kërkesë e gjuhëtarit tonë, Ashta, mendojmë, se realizohet përgjatë gjithë Fjalorit të Xh.Lloshit, sidomos kur pranë termave shqip të faunës dhe florës së regjistruar, autori është ndalur në mënyrë të

¹¹ Si një dukuri të veçantë të shkrimit të Ashtës, themi se emrin “term-i”, autori i njohur, e përdor në gjininë femërore “term-a”, prandaj dhe përcaktuesit e tij i përshtat me këtë gjini, f. 329.

¹² Po ai, po aty, f. 330.

veçantë tek sinonimia, me çfarë këtu kuptojmë fjalësin terminologjik që përdoret në disa krahina shqipfolëse. Kushdo që njihet me terminologjinë e këtij fjalori të emrave të bimëve e të kafshëve, bindet për realizimin e kësaj kërkese në dhjetëra e qindra terma. Le të përcjellim këtu pak shembuj dëshmie të këtij drejtimi në termat e mëposhtëm, të ndjekur prej sinonimeve të shumta popullore, si:

- **lulja e balsamit** (*Hypericum perforatum*, *H. Vulgare*, *H. Androsaemum*) & agurdhura, baçibalçi, balsami¹³, bari i balsamit, bari i gjakut, bari i majasëllit, bari i të prerit, bari i rusave, bari i shurrëgjakes, baseni, çaji i malit, granabuta, lulebalsami, lulebasani, lulëgjakja, lulja e dregëzës, lulja e gjakut, lulja e majit, makthi i egër, perikoni.
- **njila** (*Tinca vulgaris*, *T.tinca*) & buzëprera, buzëtaku, çeresnica, gojëkutia, jelca, lina, njila gojëkutizë, skobuzi, tinga.
- **krap** (*Cyprinus carpio*) & buzëholli, ferracaku, karpushka, krap i kuq, krap i zi, marcaniku, pendëkuqi, sharani.

Shumë e shumë fjalë-terma janë nga ato që përdoren e njihen në krahina të ndryshme të hapësirës së shqipfolësve, jo vetëm nga peshkatarë e zona bregujore, por edhe nga njerëz me kulturë të zakonshme, nga tregu sigurisht. Këtë nevojë të vjeljes së leksikut popullor për ta bërë të përdorshëm në fushën e terminologjisë e ka shtruar edhe autori i Fjalorit të florës e faunës, në një studim të tijin të këtyre viteve, me titull “Dysorët e përftuar nga purizmi.”¹⁴

Pa u larguar nga kontributi i Kolë Ashtës për këtë degë të leksikut, ai shënon, se *terminologjia e tyre është aq e madhe me gjithë ato terma të sferës abstrakte, mendore*. Për pasurimin e shqipes në lëmë të terminologjisë, shkruan Çabej, kjo punë u krye në tri drejtime:


- me një përdorim të ri të brumit leksikal, që kish gjuha,
- me krijim fjalësh të reja, neologjizma,
- me huazime nga gjuhë të tjera.¹⁵ Të gjitha këto drejtime zhvillimi e pasurimi dalin në dukje duke hulumtuar në Fjalorin e termave të florës e faunës të Xh.Lloshit; mjafton të ndalemi tek emërtimet e një shpendi me emërtimin “**krahëthata**”, termi latin (*Accipiter gentilis*) me 4 sinonime, prej të cilave 3 me sintagma dypërbërësish: gjeraqina këmbëshkurtër, huta

¹³ ballsam (tq.) rrëshinë me erë të mirë, që kullon nga disa dru; bimë medicinale (T.Dizdari, Fjalor i orientalizmave, Tiranë, 2005.

¹⁴ Xhevat Lloshi, *Dysorët e përftuar nga purizmi*, Gjuha shqipe, 1/2011, Prishtinë, 2011, f. 25- 53.

¹⁵ Eqrem Çabej, *Albanologjia*”Dispensë, Tiranë, f. 117. (Citohet sipas shkrimit të mësipërm të K.Ashtës, f. 332.)

e pulave, huta pa vesh, krahathadra. Kurse lemat-terma në Fjalor janë të grupuara si më poshtë, të gjitha me dyfjalëshe:



Në këta shembuj për zërin “krahëthata” kuptimi ka kaluar nëpërmjet polisemisë: nga një fjalë popullore (krahajojmë: *purtekë e thatë (tharë), cung i tharë, gjitharë* etj., që kanë kuptim të drejtpërdrejtë), si term merr një kuptim të ri; fundi i fundit, asnjë gjeraqinë s’ mund të fluturojë me krahë të thatë(r). Ndryshimi i kuptimit të fjalës, polisemia, nënvizon Ashta, përbën një fakt në vete e ka ndodhur që nga kohët më të largëta, gjer në më të rejat gjatë zhvillimit historik të gjuhës brenda ligjërimit popullor.”¹⁶ Por këtu nuk u krijua ndonjë fjalë e re (neologjizëm), sepse për të qenë e tillë, fjala duhet të jetë e re si në trajtë e si në brendi. Rruga e ndryshimit të kuptimit ndër fjalë të gjuhës sonë, për ta pasuruar atë, njëkohësisht edhe terminologjinë shqipe, ka veçori kalimin nga konkretja në abstrakte. Për shembull, termi “**krapuliq**” është formuar në Fjalor nga autori, në analogji me atributin (mbiemrin e panyjshëm) “**cofaliq**”(një fjalë e njohur në të folmen e Gropës së Shkodrës, që mbart kuptimin: *njeri i ngathët, i pamundur për një punë a veprimtari, i ngadaltë* etj.), për të cilën jepen edhe fjalë të tjera në veprën e Xhuvani-Çabejt “Prapashtesat e gjuhës shqipe” dhe që ka kuptim zvogëlues e pejorativ, si: *krapuliq, skutëliq, gardhiq, kastroiq* etj.¹⁷ Të gjitha këto cilësi nuk kërkohen tek termi “**krapuliq**”, prandaj dhe themi se është një neologjizëm popullor, aspak me ngjyresë pjerative.


¹⁶ Kolë Ashta, *Terminologjia dhe vëzhgimi i saj në leksikografinë e sotme*, Buletin shkencor i Institutit të lartë dyvjeçar, Shkodër, nr. 9/ 1970, f. 332.

¹⁷ UT, IGJH, Aleksandër Xhuvani - Eqrem Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1962, f. 57.

Rrugë tjetër që vë në dukje Ashta, për pasurimin e terminologjisë, është **huazimi**, një tregues që Xh.Lloshi i është shmangur në një masë aq të madhe, me synimin që terminologjia shqipe të jetë shqip, në masën e kuptueshme dhe të drejtpërdrejtë. Megjithatë, në sfera të tjera të stileve të ndryshme, autori i Fjalorit mbron mendimin e shprehur nga shkrimtari i madh gjerman J.W.Goethe, se *forca e një gjuhe nuk është ajo që të refuzojë të huajën, por që ta përpijë atë*, kur shprehet: “Një nga përfundimet e mia të përgjithshme është se prishja e gjuhës vjen jo nga ndikimi i gjuhëve të huaja, por nga njohja e keqe e tyre. E quaj se ka nevojë të kalojmë nga kërkesa “mos e përdor këtë fjalë se është e huaj”, te kërkesa përdorni cilën fjalë të dëshironi, por ta dini se çfarë po përdorni.”¹⁸ Termat e huaj e huaja (ndërkombëtarizmat), për secilën degë të dijes, kanë depërtuar edhe në gjuhë të tjera evropiane të lëvruara me shekuj, por në vendin tonë prej vitesh, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, janë hartuar një seri fjalorësh terminologjikë; kështu që në ditët tona, albanologjia ka tashmë fjalorë të tillë në dy gjuhë, siç është Fjalori i florës e faunës që kemi marrë përsipër ta shohim në këndvështrimin e fjalëformimit terminologjik. Ai sjell një ndihmesë të madhe të shënuar në këtë fushë të leksikologjisë shqipe dhe, pse jo, edhe të etimologjisë së termave në gjuhën shqipe.

Neologjizmat, për të cilat shkruan Kolë Ashta, se vetëm ato mund të shërbejnë për një pastrim relativ të terminologjisë, në shkenca të caktuara, në Fjalorin e botës bimore e shtazore të Xh.Lloshit, duhet t’i shohim jo vetëm në dhënien shqip të termit bazë, por sidomos në speciet e tij, sipas kriterëve që në punimin tonë i kemi marrë herë pas here në shqyrtim. Për shembull, termi “**korbi**” (*Corvus corax*, I) dhe *Umbrina cirrhosa* II, del në të gjitha speciet e tij në habitatin shqiptar (shqipfolës) e më larg, dhe shumësia e këtyre llojeve e ka vënë autorin dhe në rrugë kërkimi edhe të neologjizmave, duke përfutur a gjeneruar terma të tillë, si:

¹⁸ Gjuha shqipe, 1/2011, Prishtinë, 2011, f. 21. (Citohet sipas Q.Muratit në shkrimin “Të ashtuquajturat fjalë të huaja dhe purizmi”, po këtu.



- Sa u takon neologjizmave, Kolë Ashta mendon se ka tri mënyra fjalëformimi në gjuhën shqipe, të cilat i përcakton:
 - A.** metodë e krijimit të neologjizmave prej fjalëve të prejardhura: *kryqësi i detit* (Senecio cinerario), *kulmaku bregdetar* (Juncus maritimus), *krapaniku* (Salmo truttacarpio), *kollopriftja*, *karajfili i hajthëm*, etj.
 - B.** neologjizma prej kompozitave: *ketri* (Sciurus vulgaris): *ketri bishterashkë*, *ketri bishluspak*, *kashtëfryza*, *kashtuqja*, *kallamboqi shtalakuq*, *kaçubja bishtmendafshe*, etj.
 - C.** neologjizma prej fjalës-term të përkthyer (*calque linguistique*), si: *kakëzogëza* (Anguis fragilis), *kakaduja gjokstrëndafiltë* (Cacatua rosecapilla), *jargavani gjethendryshëm* (Syringa diversifolia), *iriqëza gjetherrumbullakët* (Saxifraga rotundifolia), etj.

Lidhur me pikën “C” (atë të kalkimit), Xhevat Lloshi ka shprehur mendimin, se sot shumica e fjalorëve terminologjikë (edhe ai i I.Mitrushit¹⁹), kanë nevojë të ribëhen, duke iu përshtatur ndikimit terminologjik të anglishtes, që ka prekur shumë gjuhë të tjera evropiane. Edhe në fushën e emërimit të bimëve dhe të kafshëve kjo është e pashmangshme, sidomos po të kujtojmë se anglishtja ka përthithur emërtime nga të gjitha gjuhët e botës. Ai shtron aksiomën, se në fushë të terminologjisë, orientimi evropian latin dhe anglez është i mjaftueshëm për shqipen. Nuk ka nevojë, pra, të ndjekim terminologjinë e ndonjë gjuhe tjetër, e cila nuk ka dhënë ndihmesë në përpunimin e terminologjisë në shkallë botërore, siç është rasti me serbishten.²⁰

Në përmbledhje, përfundojmë si më poshtë:

¹⁹ Gjuha shqipe, 1/2011, Prishtinë, 2011, f. XXVIII. (Citohet sipas Q.Muratit në shkrimin “Të ashtuquajturat fjalë të huaja dhe purizmi”, po këtu.

²⁰ Po ai, po aty.

Të gjithë këta libra studimorë nga lëmi i biologjisë janë kryesisht nga bota bimore dhe asnjëri prej tyre nuk mund të quhet fjalor i mirëfilltë, hartuar sipas ligjeve gjuhësore të leksikografisë. Ata kanë fjalë-terma në shqip e latinisht, por dalin nga rrethi i një fjalori dygjuhësh, siç është hartuar Fjalori i Xh.Lloshit; termat e sjella mund të japin lëndë fjalësi për fjalorë të ndryshëm, prandaj dhe i rreshtuam këtu. Më mirë duhet thënë, se ata janë në tërësi libra tryeze, vademekum për profesionistë e specialistë, studentë dhe studiues të kësaj fushe, siç quhen. Në tekstin e fundit, më sipër, autorit i ka shpëtuar kujdesi për gjuhën, ka shumë fjalë të huaja dhe krijime jo të pranueshme për shqipen, si: të vrigullta, ndajgjethezat, karpele, parete etj. Vetëm Fjalori që kemi për objekt analize gjuhësore, fjalëformuese, është një fjalor i vërtetë, i cili lë vend për hulumtime rreth një teme të marrë përsipër nga fusha e gjerë e gjuhësisë, si: termi në shqip, termi i përkthyer, termi-emërtesë, termi i shprehur me grupe fjalësh (sintagma), e të tjera sythe. Por, një gjë duhet theksuar se, si çdo libër, edhe këta të mësipërm, kanë lëndë gjuhësore në faqet e tyre, dhe, në një mënyrë, shfaqin edhe një gjendje gjuhe: në drejtshkrim, leksik, tregojnë të dhëna për rrafshin morfologjik të gjuhës shqipe, sistemin e gjinive, përshtatjen midis përbërësve, të gjitha këto, për kohën kur u shkruan, këtu e gjysmë shekulli më parë; gjithashtu, edhe të dhëna nga lëmi i sintaksës mund të nxjerrim prej tyre, që nga vitit 1955 e deri në ditët tona, kryesisht për stilin shkencor në të cilin edhe janë shkruar.

BIBLIOGRAFIA

1. Xhevat Lloshi, Fjalor i emrave të bimëve dhe të kafshëve Shqip-Latinisht dhe Latinisht -shqip, LOGOS A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2010, f. V.
2. Mustafa Kruja, Problema gjuhe, Studime, OMSCA-1, Tiranë, 2000.
3. Ferdinand Leka, Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II, Tiranë, 1972: "Mbi disa fjalorë të terminologjisë...."
4. Xhevat Lloshi, Dysorët e përfutur nga purizmi, Gjuha shqipe, 1/2011, Prishtinë, 2011, f. 25- 53.
5. Eqrem Çabej, "Albanologjia" Dispensë, Tiranë, f. 117. (Citohet sipas shkrimit të mësipërm të K.Ashtës, f. 332.)
6. Kolë Ashta, Terminologjia dhe vëzhgimi i saj në leksikografinë e sotme, Buletin shkencor i Institutit të lartë dyvjeçar, Shkodër, nr. 9/ 1970, f. 332.
7. UT, IGJH, Aleksandër Xhuvani - Eqrem Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962, f. 57.
8. Gjuha shqipe, 1/2011, Prishtinë 2011, f. 21. (Citohet sipas Q.Muratit në shkrimin "Të ashtuquajturat fjalë të huaja dhe purizmi", po këtu.

**The contribution of the researcher K. Ashta for the terminology
based on the dictionary of Xh. Lloshi**

ABSTRACT

In the series of linguistic studies in the field of Albanian terminology, we bring through this paper the help of K.Ashta in the field of this subdiscipline studied by lexicology. This study aims to reflect the contribution of two prominent figures of Albanian lexicology such as: Xh. Lloshi and K. Ashta who belong to two different periods of language development, but who research and enrich Albanian through their dictionaries. The linguist Xh. Lloshi has taken into account the scientific achievements of some terminological and explanatory dictionaries, compiled before him in our country, before and after the Second World War; has evaluated them, pointing out their shortcomings, especially in the special scientific plan.

This attitude and evaluation always from the linguistic position, first of all, from the point of view of word formation (without leaving out the methodological and scientific accuracy according to the knowledge of both fields) aiming at what has been the basic axis of our scholars and scholars to preserve the natural elements of Albanian. In addition, lexicographical works on terms in the Albanian language have always been associated with the space or habitat where plants and animals are born and cultivated, such as Albania and beyond. Every researcher of linguistic disciplines, even in works like ours, it is the duty of each to discover the place of the subject of Albanian in dictionaries and what innovation bring the terms in the process of Albanianization of this wide terminology, such as flora and fauna of our country, how are the terms of a special field of science classified, do ad litteram Albanians own in the Dictionary. In the line of linguistic studies in the field of Albanian terminology, after the above citation, let us bring in some points the help of Prof. Kole Ashta who in one of his writings may be the only one who in his research begins with the explanation of terms "Term" and "terminology". Our linguist points out that one of the areas where terms are added is "plant and animal spheres". This issue that arises several decades ago in our linguistics, we see so clearly

concretized in the Albanian-Latin Dictionary of Plants and Animals by Xh. Lloshi, which is evident not only in the terminological formations known and unknown until today.

Evalda PACI

HISTORIA E NJË LIBRI PËRMES STUDIMESH DHE ARRITJESH TË REJA KËRKIMI

Me *Mesharin* (1555) historia e librit në gjuhën shqipe inicion një rrugëtim të mirëfilltë drejt kërkimit të një sërë faktorësh që do të ndikonin drejtpërdrejt në zhvillimet përkatëse gjatë Pesëqindës, me përhapjen graduale të kulturës së shtypshkrimit dhe nevojën për të disponuar liturgjiarë që të përmbanin disa modele të përfshira brenda tyre. Në traditën e studimeve mbi fillesat e dokumentimit të shkrimit shqip një vepër e tillë zë një vend të rëndësishëm, ndërkohë që vijon të jetë objekt i një vëmendjeje të spikatur nga studiues të periudhës në të cilën kjo e fundit ka parë dritën e botimit.

Një prej arsyeve për të cilat ndërmendet një libër i tillë, i gjendur pothuaj dy shekuj pasi ishte përpiluar dhe në kushte të një dëmtimi të qartë fizik, është pikërisht dhe përmbajtja e tij, evokuese e një konfigurimi të veçantë dhe unik, që sigurisht u bë dhe objekt i reformimit përmbajtësor të ndërmarrë prej Koncilit të Trentit. Modele të ndërthurura brenda një botimi të vetëm, pjesë e një praktike të ngulitur në përditshmërinë e liturgjisë së orëve dhe leximit të meshëve sipas një kalendari të përcaktuar gjurmohen në ndërtimin e tij, duke u shfaqur dhe me tipare veçanësie që do të vijnë duke u modifikuar në shekujt që pasojnë.

Ky konfigurim tekstor që përmbahet në librin e Gjon Buzukut ka bërë të mundur të gjejmë në të tipare ndërtimore që kanë të bëjnë me Oficen e Zojës, Psalmet, në veçanti ato pendestare, Litanitë e shenjtëve, pjesë nga Ritualit dhe Breviari, për t'ua lënë vendin më tej pjesës që mbizotëron në libër (*Mesharit*) e që janë tekste biblike nga Besëlidhja e Vjetër e ajo e Re, por dhe nga Apokalipsi dhe Aktet e Apostujve. Tekstet biblike mund të gjurmohen dhe në pjesën e parë të librit, për vetë strukturën që paraqiste Oficja e Zojës, por dhe në paragrafet pasuese, duke bërë të mundur të konstatoheshin ndryshime në tipare gjuhësore apo dhe të përmbajtjes në një vështrim qasës me të tjera pjesë të ngjashme që gjindeshin në pjesën e librit që i përket *Mesharit*.

Në pamje të parë, vërehen përkime të qarta me modele që qarkullonin në atë kohë, ndërkohë që një traditë e konsoliduar prej disa shekujsh e vinte dhe Oficen në një shkallë të qartë njohjeje dhe njëkohësisht funksionale në shërbim të liturgjisë së përditshme. Tekstet e

njëjta apo të ngjashme në përbërje të Offices, por më tej dhe në atë pjesë të librit që përkon me *Mesharin*, në disa raste me tipare të ndryshme në ndërtimin e fjalisë apo përdorimin e ndërtimeve gjuhësore bën të mendosh për disponim nga ana e autorit të disa varianteve tekstore dhe më tej për një përdorim praktik të tyre në proces të ushtrimit të liturgjisë së përditshme. Ndërtime të caktuara gjuhësore dëshmojnë që në këto tekste kishte gjetur vend dhe gjuha popullore, ndërkohë që nuk mungojnë as elemente të një leksiku më të specializuar, që dhe pse i papërpunuar në disa pasazhe të veprës, dëshmon faktin që dhe regjistrat terminologjikë të liturgjisë ishin në procese përpunimi dhe në lidhje me të tillë libra. Shkalla e lëmimit gjuhësor dhe e gjetjes së termave të përshtatshëm në introduktimin e pasazheve kryesore në veprë ndryshon nga një pjesë e librit në tjetrën, por dhe emërtesa të posaçme në përbërje të tij bëjnë të mundur të gjinden përkime me realizime të ngjashme të asaj kohe, por dhe të ndonjë shekulli më parë. Duke u gjendur modelet e sipërcituara të përfshira dhe të renditura brenda një libri të vetëm, përforcohet ideja që vepra në fjalë kishte funksion shërbyes në përditshmërinë e praktikës liturgjike, ndërkohë që nuk kanë munguar as hipoteza për vendin konkret në të cilin duhet të ketë qenë një instrument i vlefshëm në shërbesat fetare me gjasë të shpjeguara në gjuhën shqipe.

Hulumtimet rreth librit dhe historisë së tij nuk mund të mos shoqëroheshin me kërkime të tjera që kanë të bëjnë me tipografitë që përgjatë atij shekulli njohin një lulëzim në veprimtarinë e tyre botuese, por dhe mbi editorët që përveç ndjekjes së proceseve të përgatitjes së librave që duheshin shtypur, paraqiteshin dhe si njohës të mirë të kulturës librore dhe historikut të përpilimit të kësombllave. Një kontekst i tërë kulturor duket se shtjellohet në proces të kërkimit të hollësive konkrete në lidhje me periudhën në fjalë dhe zhvillimet e kulturës së njohjes së librit, edhe atij fetar e kishtar, për më tepër që dhe autorë të tjerë të së njëjtës traditë në lidhje me letërsinë shqipe mund të përfshihen në të njëjtat diskutime dhe vëzhgime. Mëtohet shpesh prej studiuesve të periudhës që mjedisi më i përshtatshëm për daljen në dritë të shtypit të librit të Buzukut të ketë qenë Venediku, ndërkohë që nuk mungojnë në lidhje me këtë fakt emra librarësh dhe botuesish që jo vetëm ishin të përfshirë në çështje editoriale dhe të kulturës së shtypshkrimit, por rezultojnë dhe të kenë një vijimësi në breza në të njëjtën veprimtari e ushtrim profesioni.

Një traditë e caktuar mund t'i lidhë emra konkretë të tyre me interesa botimi që kanë të bëjnë me Biblën dhe variante librash fetarë që i

shërbenin drejtpërdrejt praktikës së përditshme liturgjike.¹

Hollësitë që kanë të bëjnë me rrethanat e realizimit të veprave të caktuara e që cekin dhe traditën librare me referim historinë e vendit tonë mund të jenë më të qarta në lidhje me veprat e Marin Barletit, përpiluar së pari në gjuhën latine, duke qenë se dihet më shumë për qerthujt kulturorë në të cilët ky i fundit bënte pjesë dhe për mbështetjen që pati pasur në kohë të realizimit të veprave të veta mbi bëmat e Gjergj Kastriotit dhe Rrethimin e Shkodrës.²

Të dhënat mbi intelektualët me të cilët njihej autori ynë dhe përfshirja e tyre në botën librare e qarqet kulturore të kohës janë vënë në shërbim të kërkimeve mbi tipografë e editorë që mund të kishin rol dhe në shtypjen e librit të Gjon Buzukut, më të parit libër që njohim të shkruar deri më sot në gjuhën shqipe.

Vëzhgimet në lidhje me vendin e botimit, por dhe shtypshkronjën përkatëse ku u realizua *Meshari* u përqendruan natyrshëm në arealin venecian, pa përjashtuar dhe indicet që mund të deduktoheshin nga të tjerë parametra jashtëgjuhësorë, por që ndihmonin gjithashtu në zbardhjen e historisë së librit më të ndërmendur në studimet shqiptare, kryesisht në ato mbi letërsinë e vjetër shqipe dhe veprat themelore që e përfaqësojnë atë.

Vetë zbulimi i tij me gjasë rreth vitit 1743 përkon me një periudhë që shënon një kulmim të natyrshëm në veprimtarinë baritore të një prelati të shquar të historisë së kombit, emri i të cilit figuron dhe në cilësi autoriale mbi një variant doktrinar sa konciz, aq dhe të vlefshëm për të shpënë më tej vëzhgimet mbi historikun e receptimit të doktrinës së kërshenë në viset arbërore në shekujt që e pasojnë Pesëqindën. Gjon Nikollë Kazazi (1702-1752) e cilëson librin e Buzukut *si të vjetëruar e të dëmtuar*, duke bërë me dije dhe gjendjen fizike të atij ekzemplari, për të cilin as në këtë moment të zbulimit nuk duket se thuhet detaje konkrete mbi vendin ku duhet të ketë parë dritën e botimit. Në të vërtetë, ky moment shënon një hap të rëndësishëm në njohjen e librit shqip, por dhe dokumentohet falë letërkëmbimit të Kazazit me eprorë të Seminarit arbëresh të Palermos, në veçanti me Atë Gjergj Guzzetën (1682-1756), të cilit i dërgon dhe fragmente të kopjuara me dorë prej teksteve të *Mesharit*.⁶⁵

¹ Orlandi P.A., *Origine e progressi della stampa o sia dell'arte impressoria e notizie dell'opere stampate dall'anno M.CCCC.LVII sino all'anno M.D.*, Bologna, 1722.

² Nadin L., *Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto, përktheu Pëllumb Xhufi*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.

³ Bëhet fjalë për qarkullimin më të parë të njohur të teksteve të kësaj vepre, që në vështrimin e Kazazit cilësohet si një *Meshar* i vjetër, krejt i grisur nga kalimi i kohës. Shih në veçanti Petrota G., *Popolo, lingua e letteratura albanese*, Palermo, 1932, f.98.

Këto variante tekstore të sjella nga dora e Imzot Kazazit përbëjnë dhe një shtysë të mirë për të njohur terminologjinë me të cilën ky i fundit emërton pjesët përbërëse të librit, të cilin në tërësi e quan *Meshar* duke ditur krejt mirë që në të përfshiheshin dhe modele të tjera librore, mjaft të njohura në praktikën liturgjike kishtarë romane.

Nuk do të mungojnë as më vonë raste të shfaqjes së një interesimi të qartë nga ana e klerikëve arbëreshë për librin në fjalë, interesim që gjen shtysë dhe në faktet e sipërcituara, që dëshmojnë dhe për një ndërkëmbim të qartë mes njerëzish të letrave në të mirë të njohjes së historisë së librit liturgjik në gjuhën shqipe. Ndërlidhja e zhvillimeve mes viseve tona dhe atyre arbëreshe sigurisht do të ndihmonte në një njohje më të mirë të përpjekjeve për ta bërë kulturën e librit një mjet të domosdoshëm në përparimin e trevave përkatëse, të cilat dhe përmenden qartë në veprat e kësaj tradite letrare.

Në trajtesat e Eqrem Çabejt do të mund të gjindet i detajuar një historik i posaçëm në të cilin përshkruhet interesi i Imzot Skiroit ndaj librit dhe teksteve të tij, sprovat pas rizbulimit nga ana e tij për ta botuar pjesë-pjesë në revista shkencore të kohës, përpjekjet e Atë Justin Rrotës O.F.M. për ta sjellë në kopje fotografike në Shqipëri dhe më tej, për të bërë të kuptueshme disa pjesë të rëndësishme nga përmbajtja, shkrimet e Joklit në të përkohshmen *Hylli i Dritës* mbi këtë ekzemplar dhe problematikat që paraqet mosnjohja e vendit të botimit etj. Hapat e parë që u ndërmorën për ta përafuar në njohjen e përmbajtjes dhe si objekt një libër të tillë qenë vendimtare dhe sa u përket zhvillimeve të mëvona, që pa dyshim ruajnë një lidhje të qartë me sprovat që u shënuan në këtë periudhë të fillimit dhe gjysmës së parë të shekullit të kaluar.

Historiku i njohjes së kësaj vepre të rëndësishme për studimet tona gjindet i rimarrë pikërisht në këtë pjesë të veprës së Papas Petrottës, duke qenë se falë tij sillen dhe kujtime a pasazhe në të cilat libri i Buzukut citohet përmes copëzash që ishin transmetuar në proces letërkëmbimi që në kohën kur e kishte zbuluar për herë të parë në Romë Imzot Kazazi. Interpretimet e Imz. Crispit të cituara në veprën e sipërpërmendur të Papas Petrottës (*po aty*, f.98- 99) janë një dëshmi e vyer e faktit që disponoheshin të dhëna mbi librin e Buzukut dhe mbi mënyrën si ishte bërë e njohur ekzistenca e tij në rrethet arbëreshe. Paraqet rëndësi të veçantë dhe fakti që pikërisht në këtë paragraf të librit të Papas Petrottës kushtuar librit të Buzukut flitet qartësisht për ndërtimin dhe ndarjen e tij në pjesë kryesore, siç përshkruhej dhe nga Imz. Schirò, por çka është më me interes, parathuhet dhe ideja e një botimi të plotë që duhej të realizohej meqë Schirò kishte mundësuar dhe disponimin në kopje fotografike të tij. Në këtë periudhë lexohet një pritshmëri e madhe në receiptimin e teksteve të vjetra shqipe dhe një interes në rritje për njohjen dhe thellimin e studimit të tyre nga rrethet shkencore të specializuara.

Pjesët hyrëse të librit përbëjnë ndër të tjera dhe mundësi konkrete për të kryer qasje me realizime të së njëjtës kohë dhe që përdorshin në areale të afërta në pikëpamje gjeografike, por dhe përkatësisë si provinca në të cilat njihej ndikimi i kishës së Romës. Litanitë e Shenjtërve zgjuan që në krye të herës interesimin e filologut frëng Mario Roques, në atë kohë (1932 v.) i angazhuar qartë në pikëpamje të evidentimit të kësombllave e ekzemplarëve të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në biblioteka e arkiva, por dhe në atë të parashtrimit të kriterëve filologjike të botimit të tyre.⁴

Analizimi që filologu frëng u bën pjesëve që dallohen e pasojnë njëra-tjetrën në përmbajtjen e librit të cilit i mungonin faqet e para që me gjasë do të duhej të përmbanin indice që dhe sot e kësaj dite kërkohen për t'u sqaruar, përbën dhe një prej trajtesave më të mira mbi të dhe krejt kontekstin në të cilin duhet përfshirë në cilësinë e një ekzemplari që flet shumë për rrethanat e përhapjes së librit në Pesëqindën e më tej.⁵

Fillimi i shekullit të kaluar u karakterizua nga shfaqje të herëpashershme të interesit për librin, vendndodhjen aktuale, fatin e tij, domosdoshmërinë e sjelljes së tij në Shqipëri dhe nevojën e studimit më nga afër të teksteve që e përbëjnë atë.

Si pjesë e pandarë e këtyre përpjekjeve do të ndërmendnim Imzot Pal Schiròin, Gaetano Petrotan, Atë Justin Rrotën O.F.M., Eqrem Çabejn, Norbert Joklin, Mario Roques, të gjithë pararendës të një tradite që do të vijonte të bëhej më solide në drejtim të arritjeve konkrete në studimin dhe njohjen e librit të Gjon Buzukut.

Sjellja prej tyre e teksteve nga libri do të reflektohet në të përkohshmet më në zë të kohës, përfshirë ato me vështrim të qartë nga

⁴ Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.15. Në veçanti sa u përket Litanive të Shenjtërve, Roques vë në dukje përkime në emra të përveçëm mes tekstesh të ngjashme në traditën bosniake të librave të orëve në Pesëqindën dhe më tej në librin e Gjon Buzukut, bashkë me faktin që po te Buzuku do të mund të gjindet i ndërmendur dhe emri i një shenjtë tjetër françeskan, Shën Bonaventurës: Je dois noter encore deux faits qui sont importants pour l'intelligence de la tentative de Gjon Buzuk. Tout d'abord, si nous examinons les Litanies des saints contenues dans les deux livres d'heures bosniaques de Venise de 1512 et 1571, nous y constatons la présence de trois saints personnages qui ne figurent pas d'ordinaire dans les litanies de la même époque: saint Louis, sainte Claire et sainte Elisabeth, c'est-à-dire trois saints franciscains. Or non seulement ces trois saints figurent dans les Litanies de Gjon, mais on trouve encore dans celles-ci parmi les confesseurs et docteurs un autre saint franciscain, saint Bonaventure.

⁵ Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.11. Në analizën e hollësishme të filologut frëng nënvizohet fakti që vëmendja rreth librit të Buzukut pothuaj mungonte deri në atë kohë. Vërejtjet që jepen në paragrafin kushtuar *Mesharit* orientojnë ndaj një sërë çështjesh që kanë të bëjnë direkt me historinë e librit dhe atë të kulturës së librit në atë periudhë.

gjuhësia e krahasuar, historike dhe indoevropiane. Një kulmim të qartë disa dekada më vonë do ta shënojnë botimet e plota të librit, të realizuara përkatësisht në vitin 1958 (nga N.Ressuli) dhe 1968 (nga E.Çabej), në dy variante që përbëjnë një lëndë të mirë për t'u studiuar nga filologët dhe studiuesit e teksteve të vjetra shqipe.

Realizimi i këtyre botimeve kritike solli në vëmendje rëndësinë që merr në këto rase disiplina e tekstologjisë dhe ajo e filologjisë së tekstit, duke qenë se riprodhimi i një vepre të tillë lidhet mbi të gjitha me përzgjedhjen e kritereve të mirëfillta që janë premisë për ta bërë botimin shkencërisht të realizuar, pa cenuar integritetin përmbajtësor të tij. Realizimi i tyre për më tepër e përafron qartësisht lëndën e librit ndaj një orientimi më të lehtësuar për hulumtim e vëzhgime mbi tekstet e tij, duke u bërë këto të fundit në kushte të një konsultimi më konkret për shumë arsye.

Një punim shkencor që sheh dritën e botimit në fillim të viteve '60 të shekullit të kaluar e që ka për autor Martin Camajn (*Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shêjzat*) do të risjellë në vëmendje të studiuesve domosdosmërinë e vështrimit kompleks mbi veprën dhe pjesët që e ndërtojnë, aspektet grafematike që lidhen me receptimin e sistemit fonik të kohës, por dhe me të shkruarit si kulturë, ndikimet e mundshme nga gjuhë të tjera që autori mund t'i kishte njohur, por mbi të gjitha ndikime nga tradita të afërta, fakt ky që përbën dhe një nga linjat më të realizuara e të ndjekura prej tij.⁶

Prania e disa shenjave grafike të ndryshme nga ato të alfabetit latin qe një fakt i vënë në dukje që në krye të herës nga studiuesit e veprës, përfshirë filologun Mario Roques, i cili analizon çdo detaj që mund të shpjerë dhe në përkime të mundshme me arealin më të afërt gjeografik,

⁶ Në hyrjen e këtij punimi të Camajt (*Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi, Shêjzat*, Romë, 1960) vlejën për t'u nënvizuar vërejtjet që ai bën në lidhje me simbolet që figurojnë në filigranën e përdorur për librin e Buzukut dhe për lokalitetet në të cilat ka gjetur përdorim letra me të cilën ky i fundit është shtypur. Një fakt i tillë vë në dukje dhe se Camaj nuk ndante të njëjtat mendime me Roques në lidhje me çështje specifike siç ishte dhe vendi i mundshëm i botimit të këtij libri. Ndërkohë, në kreun sintetik kushtuar ortografisë në tekstet e librit të Buzukut në këtë punim të sipërcituar (*Capitolo I, Ortografia, po aty*, f.11-19) mund të gjinden të shprehura pikëpamje të ngjashme (me ndonjë ndryshim të vogël referencial) në lidhje me shenjat grafike të përdorura për tinguj të veçantë e që nuk rezultonte se mund t'i kishte gjuha latine apo ajo italiane. Për t'u thelluar më tej mbetet dhe vërejtja e shprehur nga Camaj (*po aty*, botim i cituar, f.17) mbi tipare të ngjashme a zgjidhje grafike të përafërta mbi fjalë të caktuara në tekste në këtë libër që bëjnë të supozohet me njohje të traditës gegjëse shkrimore kroate.

atë kroat e dalmatin.⁷

Botimet kritike e filologjike të realizuara në shekullin e kaluar janë një hap i rëndësishëm drejt studimit të thelluar të librit e bëjnë të mundur dhe përvijimin e punimeve mbi tekstet e tij, ndërkohë që nuk kanë munguar kërkime mbi shtypshkronjën në të cilën u realizua botimi i tij dhe editorin që bëri të mundur konkretizimin e tij. Të dhënat që u ofruan nga Lucia Nadin vitet e fundit e që përqendrohen në kërkime mbi tipografi të arealit veneto-padovan paraqiten konkrete e bindëse dhe mbi të gjitha përafrojnë mes tyre botime që kanë të përbashkëta tipare teknografike të qarta, përfshirë figurat e simbole të tjera ikonografike që janë tipike për shekullin në të cilin *Meshari* pa dritën e botimit.⁸

Me librin e Gjon Buzukut u pasurua historia e shkrimit shqip dhe studimet mbi letërsinë e vjetër shqipe, por plotësohet dhe panorama dokumentare mbi historinë e kishës shqiptare në shekuj që lidhen me promovimin e shtypshkrimit dhe kulturës së librit të shkruar. Dhe në rastin e librit të Gjon Buzukut, është e pashmangshme që kërkimet të orientohen ndaj zhvillimesh dhe risish të ndodhura në vendet tej Adriatikut, me gjasë në ato vise që u bënë dhe vatra të promovimit të kulturës tipografike dhe të editorisë në shekujt XVI-XVII.

Për ta parë më tej *Mesharin* si pjesë të pandarë të botimeve albanologjike, le të kemi parasysh së pari trajtesat e shumta që u përpiluan

⁷ Analizat në lidhje me këto elemente në dukje teknike nga ana e M.Roques bëjnë të mundur të njihen dhe tradita të tjera shkrimore që për arsye të caktuara arrinin të konkretizoheshin pikërisht në të njëjtat areale në të cilat është supozuar gjatë se mund të jetë realizuar dhe libri i Buzukut. Analizat e sipërcituara dhe që Roques i evidenton në proces të shtjellimit të një kreu të veçantë mbi librin e Buzukut përafrojnë mes tyre tipare dhe elemente grafematike që mund të jenë të veçanta në ndonjë pikëpamje, por mund të jenë dhe të ngjashme me alfabetin latin. Qasja që Roques u bën varianteve të shtypura të librave të orëve që përdorshin dhe në arealin dalmat nuk është e rastësishme, duke qenë se ky i fundit mëton të gjejë lidhje mes rrethanave në të cilat vepra të caktuara e me tematikë të përafërt gjetën mundësi për të parë dritën e shtypit.

⁸ Dhe në këtë drejtim vlejë për t'u marrë në konsideratë interpretimet e bëra nga Roques në lidhje me imazhe e figura që rezultojnë në hyrje të paragrafeve të caktuara të librit, duke qenë se ky i fundit dallonte mes tyre dhe elemente të shtuara në momente të mëvona në përmbajtjen e librit. Evidentimi i ikonave apo imazheve që përmban libri, dhe pse në dukje paraqitet modest në pikëpamje përgatitjeje mundëson gjithashtu qasjen ndaj teknikash e metodash të ngjashme, më saktë, ndaj botimesh të së njëjtës kohë e që mund të orientojnë ndaj një rrjeti botuesish që operonin në areale konkrete. Me gjasë, shtypshkrimi po merrte një zhvillim më se të afirmuar në arealin venetopadovan, por gjithsesi duhet pasur parasysh se indekse të caktuara mbi botime, kësomblla e variante librorë sjellin në vëmendje dhe zona të tjera të Gadishullit Italik që u përfshinë nga një priirje e qartë për t'u afirmuar në drejtim të kulturës së librit të shtypur.

mbi të dhe historikun përkatës që me vetë mungesën e indiceve të domosdoshme e bëjnë më të madhe kërkimin për të ditur më shumë rreth rrethanave konkrete që mundësuan daljen në dritë të shtypit të tij; le të kemi parasysh dhe studimet e pasura në lëmë të dialektologjisë historike dhe leksikut historik të shqipes, historinë e letërsisë së vjetër shqipe dhe atë të botimeve doktrinare në gjuhën shqipe, që marrin shtysë prej ekzistencës së këtij ekzemplari unik.

Më së fundi, theksojmë lidhjen e natyrshme që krijohet me zhvillimet në arealet tej Adriatikut në pikëpamje të kulturës së shtypshkrimit dhe botimeve të librave me destinacion lokalitete a komunitete ku flitej e kultivohej gjuha shqipe. Një mendim i tillë mbështetet më konkretisht në lidhje me mëtimin që autori vetë, i gjendur mes detyrës për të përfunduar një vepër me funksion të qartë shërbesash dhe misionit si famullitar, duhet të ketë pasur lidhje të qëndrueshme me bashkësi në vise të caktuara, në të cilat paraqitej domosdoshmëri dhe praktika e liturgjisë në gjuhën tonë.

Paraqiten mjaft të pasura studimet dhe kërkimet mbi librin dhe autorin, përfshirë dhe mëtimet për të gjurmuar të dhëna rreth personalitetit të këtij të fundit, i cituar shpesh dhe si shkrimtar, më saktë, si një ndër shkrimtarët e parë që i japin shtysë zhvillimeve të kulturës së shkrimit ndër shqiptarë. Krahasimi me gjendjen e dokumenteve të supozuara që mund të kenë ekzistuar para Pesëqindës, jo domosdoshmërisht të ngjashme me këtë vepër e bën më të afërt autorin dhe përpilimin e tij me interesimin e një rrethi të gjerë studiuesish, të cilët janë përpjekur të zbërthejnë në çdo mënyrë të mundshme brendinë e pashënies me të cilën mbyllet *Meshari*, libri që tradita e lidh me emrin e Gjon Buzukut.

Mungesa e një profili të plotë mbi autorin e *Mesharit* lidhet me pamundësinë e gjetjes së të dhënave konkrete mbi vendin ku duhet të ketë përpiluar ai veprën e tij dhe më saktë, me destinacionin që duhet të ketë pasur ndërkohë që merrej me përfundimin e një ndërmarrjeje të tillë, mjaft të vështirë dhe në vështrimin e tij, të shprehur në përmbyllje të punës së lodhshme.

Është supozuar më se një herë mbi mundësitë e përgatitjes së një liturgjiari a sakramentari që do t'u shërbente bashkësive që flisnin shqipen e që me gjasë dhe jetonin jashtë kufijve të atëhershëm të viseve tona. Një mundësi e tillë mund të merret parasysh duke qenë se migrimet në drejtim të Gadishullit Italik përbënin një dukuri të njohur në studimet historike mbi periudhën, për më tepër dhe kanë gjetur hapësirë të konsiderueshme dokumentimi dhe trajtimi nga gjurmuesit e kohës, kryesisht të albanologjisë. Janë një sërë faktorësh që favorizonin të tilla shpërngulje dhe

kësisoj dhe ekzistenca e elementit shqiptar në viset italice, por dhe e klerikëve që kanë shërbyer në ato vise përbën një fakt që duhet marrë në konsideratë dhe në lidhje me gjurmimet mbi *Mesharin* dhe historikun e tij. Vetë struktura e librit përbën një indic që mund të shërbejë për të vërtetuar funksionin kompleks shërbestar për të cilin duhet të ishte hartuar, bashkë me faktin që i përmbahet një modeli që synonte që në dorën e meshtarit të gjindeshin të bashkëngjitur disa libra praktikë, që njëkohësisht ishin dhe pasqyrë e përmbajtjes së tekstit biblik, shumë i rëndësishëm si orientim njohës ndaj një korpusi më madhor, siç ishte Vulgata latine.

Në Pesëqindën, por dhe më vonë, në akte sinodale e koncile të rëndësishme flitet qartë për njohje modeste të një pjese të konsiderueshme nga ana e klerikëve të gjuhës latine, por dhe teksteve të lutjeve e më tej, të pjesëve më të thelluara për nga brendia.

Ndërkohë, siç dhe është konstatuar disa herë nga studiuesit e teksteve të librit të Buzukut, këto të fundit shpesh paraqesin mangësi në pikëpamje përpilimi a plotësie të fjalive, ndërkohë që sa i përket terminologjisë dhe elementeve që gëzojnë një rëndësi të veçantë pikërisht për introduktimin e paragrafeve a pjesëve më të rëndësishme të veprës, duket qartë që kjo e fundit i përket ritit latin dhe një tradite të konsoliduar në kuptimin e kulturës liturgjike që transmetohet përmes saj.

Një diskutim i gjerë është shtjelluar rreth mundësive të ndalimit të qarkullimit të këtij libri në rrethet kishtarë të kohës, duke pasur parasysh jo vetëm vetë direktivat e Koncilit të Trentit në lidhje me lejimin e botimeve në gjuhë të ndryshme nga latinishtja, por dhe masat e mëtejme që në veçanti në lidhje me të tilla variante librare ishin konkrete dhe të detajuara sidomos në dekadat që pasuan përmbylljen e punimeve të këtij koncili. Kërkime të shumta u bënë në biblioteka e manastire, në arkiva e fonde private, nën qëllimin për të kataloguar libra të tematikave të përcaktuara, ndër të cilat mbizotëronte ajo fetare e shkencore. Dukuria e verifikimit të brendisë së librave të tillë njihet fort mirë në traditën e studimeve mbi historinë e librit të shtypur në Evropë e më saktë, në viset më afër Selisë së Romës dhe ndikimit të saj.⁹

Pikëpamjet mbi parametrat që duheshin marrë parasysh në proces të shqyrtimit të veprave të tilla jo përherë qenë të njëjta, ndërkohë që dhe vetë verifikimet në fjalë përfshinin fonde bibliotekare masive të urdhrave e kongregatave më në zë të kohës. Një procesi të tillë me gjasë mund t'i ishte nënshtruar dhe libri i Buzukut, duke qenë përmbajtja e tij e përafërt me atë

⁹ Borracini R.M., *Libri e censura. L'applicazione dell'Indice clementino nelle biblioteche del TOR della Marca Anconitana, (dal Cod.Vat.Lat.11279)*, Giuffrè editore, 2012.

të librave të tjerë që u bënë objekt hetimi nga ana e hierarkisë kishtare të paracaktuar për procese të tilla. Ndërkohë, dhe në trajtesa të tjera i jemi përmbajtur idesë se vetë modeli nën të cilin paraqitet i konfiguruar libri i Buzukut, mund të ketë qenë objekt rishikimi pikërisht në periudhën që pasoi vitin 1555.

Vetiu lindin disa pyetje:

Të ketë qenë arsye e mosqarkullimit brendia konkrete e librit në gjuhën shqipe? Të ketë qenë gjithashtu arsye modeli i zbatuar në strukturimin e një vepre të tillë?

Të ketë pasur të tjera motive që nuk lidhen drejtpërdrejt me autorin e veprës, por me tekstet që mund të kishin qenë më të plota në përmbajtje dhe referim? Të jenë hulumtuar mjaftueshëm arkivat a bibliotekat që mund të përmbajnë dhe kësomblla të ngjashme, siç dhe supozohej vite më parë, në studimet e thelluara mbi librin dhe historinë e tij?

Në aktet e verifikimit të librave që mund të përfshiheshin në indekse të posaçme bëhet fjalë dhe për stampatorët apo botuesit e veprave. Madje, në një procedurë të tillë shihej fare qartë që kërkoheshin me hollësi të dhëna mbi autorin a autorët, titullin e veprës dhe vendin e botimit, personat që mbikëqyrnin a merrnin përsipër shtypjen e librit, më saktë, botuesit e tyre. Tematika e veprave që u bënë objekt i përfshirjes në të tilla indekse është një tjetër argument që merret në konsideratë në një diskutim të tillë, ndërkohë që nuk kanë munguar raste kur rishikimet kanë pasur të bëjnë dhe me pjesë të veçanta të tyre, jo me krejt përmbajtjen.

Na duket bindëse një trajtesë dhe një argumentim që pason më tej rrethanat e ndalimit të një libri si ai i Buzukut, nëse ai ka parë dritën e shtypit në një kontekst tipik favorizues për librin e shtypur, siç ishte Venediku gjatë Pesëqindës.

Studiuesja Lucia Nadin, njohëse e mirë e këtij konteksti dhe gjurmuese të dhënash konkrete që kanë të bëjnë dhe me historinë e shtypshkrimit në një areal interesant si Venediku dhe Padova, orienton ndaj një vështrimi të ri në lidhje me *Mesharin* dhe komunitetin që duhet të ketë qenë i interesuar për përdorimin e tij. Rrethana jetësore të një botuesi që jetonte në Venedik mund të kenë qenë shtysë dhe për ndalimin e një libri të tillë, i cili shihet qartë që ishte i paracaktuar për një bashkësi shqipfolëse. Duke u parë me vëmendje ky interpretim i studiueses Nadin në lidhje me librin dhe historinë e mundshme të realizimit të tij në një nga tipografitë më në zë të Venedikut gjatë Pesëqindës, natyrshëm plotësohet një element i një mozaiku që deri vonë mbahej me të njëjtat elemente

interpretimi e argumentimi.¹⁰

Sa i përket mendimit të shprehur nga disa studiues që libri i Buzukut mund të jetë ndaluar si rrjedhojë e rishikimit të përdorimit në praktikën kishtare të veprave të së njëjtës natyrë e që ishin përpiluar në gjuhët popullore, duhen marrë parasysh gjithë zhvillimet që pasuan përmylljen e punimeve të Koncilit të Trentit e që paraqiten në të vërtetë si hapa të mëtejme ndaj konkretizimit të vendimeve a dekreteve që u diskutuan gjatë në këtë koncil, qoftë dhe në lidhje me breviarët, ritualet dhe mesharët.

Personalitete që dolën në skenë pas përfundimit të këtij koncili dhe që kishin një përgatitje të spikatur teologjike, u morën gjerësisht dhe me përcaktimin përfundimtar të një varianti të Vulgatës latine që duhej të ishte e ndrequr dhe korrekte në pikëpamje filologjike dhe përmbajtësore, ndërkohë që korrigjime të domosdoshme u ndërmoren dhe më tej, gjithnjë nën objektivin e disponimit të një Vulgate të përshtatshme për përdorim në praktikën kishtare dhe për vetë besimtarët katolikë. Vetë çështja e Vulgatës latine dhe e inkoherecave që u konstatua se ajo përmbante që në kohë të zhvillimit të Koncilit mbetet një argument për t'u marrë në konsideratë dhe nëse bëhet fjalë për referencialitetin e teksteve të librit të Buzukut, përfunduar së hartuari sipas të dhënave të vetë autorit të saj në vitin 1555.

Në një vështrim më të thelluar të periudhës postridentine, duket qartë që sa ishte e rëndësishme mbarëvajtja e vetë Koncilit, aq ishte vendimtare dhe rimarrja e dekreteve dhe aktualizimi i një sërë çështjesh e problematikash, që u bënë gjatë objekt diskutimi dhe në proces të zhvillimit të këtij të fundit. Ndërprerja e këtij koncili bëri që dhe çështje të caktuara të zgjatëshin në kohë, duke u dokumentuar dhe si faktorë mosmarrëveshjes apo mospërputhjes në pikëpamje e mendime të pjesëmarrësve në këtë event me rëndësi të madhe historike.

Çështja e saktësisë së teksteve të caktuara nga Vulgata përbën një prej më të mprehtave që u rimor pas mbylljes së punimeve të Koncilit të

¹⁰ Nadin L., *Ancora sul Meshari di Gjon Buzuku: nuovi dati e nuovi scenari*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2015. Një studim i tillë përbën një kontribut konkret dhe në lidhje me të dhënat mbi prelatë me prejardhje shqiptare që kanë jetuar në zonën venedikase dhe që kishin një veprimtari të lidhur qartë me editorinë dhe kulturën e shtypjes së librave. Emra të përveçëm që dalin dhe në këtë artikull dhe që autorja i ka përmendur dhe në sprova të mëparshme të saj në lidhje me argumente të ngjashme në të vërtetë shpjen natyrshëm dhe në të tjera episode që mund të kenë lidhje me rrethanat e shtypjes së librit të Gjon Buzukut. Interpretimi i detajuar mbi bashkëlidhje të mundshme në interesa dhe rrethana mes personazhesh e episodesh na shpjen më drejtpërdrejt në njohjen e historisë së librit të Gjon Buzukut, përfshirë dhe në interesat studimore më të fundit nga studiuesja Nadin.

Trentit, ndërkohë që dhe lejimi i përdorimit të teksteve kishtarë në gjuhët e vendeve në të cilat praktikohesh besimi dhe liturgjia do të vihet re se do të bëhet në referim ndaj doracakësh më të përmbledhur, ndër të cilët kishin përparësi variantet doktrinare, me autor kryesisht Roberto Bellarminon S.I.

Vite më parë i jemi referuar në veçanti çështjes së autorësisë së veprës komplekse që emërtohet më së shumti *Meshar*, duke u paraqitur kështu në vetë funksionalitetin për të cilin duhet të jetë përpiluar: të ishte një *vademecum* i domosdoshëm për meshtarin a klerikun, i cili do të duhej të kishte me vete një instrument të vlefshëm në shumë rrethana: edukimin kateketik; kryerjen e riteve celebrative themelore në liturgji, përfshirë pagëzimet dhe vënien e kurorës; leximin e lutjeve në proces të meshës, ato pas kungimit në veçanti; të lexonte e të kishte të gatshme pjesët biblike që lidheshin me mbarë kalendarin vjetor kishtar, me ndarjet përkatëse që gjinden të sigluara në pjesë të posaçme në përbërje të librit të sipërcituar. Liturgjia e Pashkëve mbetet ndër më interesantet në këtë vështrim, qoftë dhe sa u përket pjesëve ungjillore që rezultojnë në të dhe krejt terminologjisë që zbulohet në paragrafet a pasazhet që i prijnë teksteve të gjata të Pasionës.

Gjithnjë në referim ndaj çështjes së autorësisë në këtë vepër do të duhet të konsiderojmë që mjaft tekste të përzgjedhura nga autori duhet të kenë qenë me kohë pjesë e një praktike të ushtrimit të detyrës së meshtarit e një fakt i tillë mund të deduktohet dhe nga një sërë tiparesh e veçanësisht që bien në sy ndërkohë që krahasohen mes tyre pjesë të ngjashme e që mund t'i përkasin të njëjtit ungjill, por ndërkohë paraqiten me ndryshime që shpjegohen me variante të ndryshme të disponuara nga autori.

Për një libër që rezulton me indice të pamjaftueshme që në zbulimin më të parë të tij është më se e domosdoshme që të dhënat që kërkohen të mund të nxirren dhe prej vetë përmbajtjes së tij. Një fakt i tillë orienton ndaj një studimi të thelluar tekstor e përmbajtësor, por nuk përjashton as mundësitë që duke u konkretizuar konteksti në të cilin autori duhet të ketë ushtruar funksionin a misionin e tij, të mund të kërkohet më tej mbi atë vetë dhe gjithë mjedisin që favorizoi daljen në dritë të shtypit të librit.

Nga ana tjetër, duke mos pasur shumë të dhëna dhe mbi rrethanat konkrete në të cilat u zhvillua puna e autorit, por dhe mbi gjendjen e shkrimeve shqipe para se të dilte në dritë kjo vepër e plotë në pikënisje, është e vështirë dhe të ndahen pjesë që mund të jenë me të vërtetë kontribut i tij si shqipërim a përshtatje nga të tjera pjesë, që mund të kenë qenë të përdorura dhe para se ky i fundit t'i përfshinte në liturgjarin e tij.

Në proces të një sprove për ta përshkruar veprën dhe për të interpretuar përpjekjet e autorit për të sjellë një punë të arrirë dhe në

pikëpamje të lexueshmërisë apo konsultimit, e gjejmë me vend të japim një konsideratë dhe në lidhje me emërtesat e mundshme që i jepen kësaj vepre, megjithëse një cilësim i hershëm që ka rezultuar i cituar në proces të një letërkëmbimi mes prelatësh tashmë ka fituar njëfarë miratimi në rrethet e studiuesve.

Në traditën paraprijëse studimore mbi librin dhe autorin është marrë në shqyrtim dhe çështja e emërimit më të saktë që mund t'i jepej këtij të fundit. Dhe pse libri në fjalë përmban disa modele që pasojnë njëri-tjetrit në një ecuri të arsyetuar, më së shumti është preferuar të emërtohet *Meshar*, dhe pse pjesa që i përket ritualit të Meshës e teksteve që lidhen me të nuk përbën krejt brendinë e tij. Përputhja e pjesëve të para të këtij libri me modele që mund të përdoren dhe më vete në raste të caktuara risjell në vëmendje dhe faktin që bashkimi i disa korpuseve tekstore në një libër të vetëm duhet të ketë pasur dhe një qëllim funksional të qartë në vështrimin e porositesit a porositesve të tij. Në të vërtetë, pikërisht në lidhje me një model të tillë dhe gërshetime tekstesh që dhe kur janë të njëjta paraqesin ndryshime të qarta për një sy të vëmendshëm, mund të shtrohen diskutime më të thelluara që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me historinë e librit në fjalë dhe me vetë paracaktimin e tij për përdoruesit e kohës.

Një vështrim kritik të kësaj çështjeje ndërmori dhe Mario Roques (1875-1961), filologu e romanisti që dha një kontribut të çmuar mbi tekstet e vjetra shqipe, qoftë dhe duke i renditur ato në një përmbledhje që evidenton tipare e karakteristika ndërtimore të tyre.

Duket fare qartë që Roques njihte jo vetëm traditën e përdorimit të veprave të tilla, por dhe të tjera aspekte që kishin të bënin me çështje të realizimit të tyre në tipografi e shtëpi botuese. Një fakt i tillë ilustron nga vetë pluridimensionaliteti me të cilin filologu frëng sheh një vepër përfaqësuese si ajo e Buzukut, duke ofruar dhe një panoramë kulturore të pasur për tipografët e kohës dhe tipare teknografike që duket se i njihte mirë në lidhje me periudhën dhe veprat që prodhoheshin gjatë saj.

Emërtimi që Roques i jep librit të Gjon Buzukut, mbetet dhe sot e kësaj dite shumë i afërt me natyrën e librit dhe me vetë modelet që njiheshin në qarkullim në atë kohë. *Livre d'heures et missel*/ libër orësh dhe meshar, është një emërtim që përfshin dy pjesë të rëndësishme të tij, duke qenë se liturgjia e orëve synohet të përmbahet në libër, po ashtu dhe pjesa e *Mesharit*, duke qenë se siç mund të konstatohet duke hulumtuar në tekste e kapituj, kalendari liturgjik vjetor gjen një konkretizim të qartë dhe në këtë vepër.¹¹

¹¹ Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.10: *Livre d'heures*

Një përkufizim i tillë nga ana e Roques, njohës i mirë i një konteksti të tërë që lidhet me kulturën e librit, por dhe me vështirësitë që paraqiste deri në atë kohë njohja e mirëfilltë e një tradite botimesh mbi shkrimin shqip dhe evidentimin e këtij të fundit, bëhet plotësisht i besueshëm dhe falë interpretimeve që jepen në një radhë logjike dhe sa i përket ndërtimit të librit të Buzukut dhe rendit që duket se kanë në të pjesë të caktuara, të cilat Roques i zbërthen dhe në pikëpamje të plotësisë tekstore në të cilën do të duhej të gjindeshin. Për një sërë arsyesh, gjykimet e filologut frëng i qëndruan kohës dhe vijojnë të ofrojnë një orientim të qartë ndaj njohjes së vetë librit dhe të një panorame kulturore me të cilën ai vesh gjithë interpretimet që jep në lidhje me Pesëqindën, por dhe me shekujt që pasuan daljen në dritë të shtypit të kësaj vepre.

Dallimi nga ana e tij e pjesëve përbërëse të librit ndihmon dhe në pikëpamje të sqarimit të mënyrës së numërimit të fletëve të tij, por mbi të gjitha në drejtim të një terminologjie që lidhet me krejt brendinë e veprës dhe arsyetimin përmbajtësor të saj. Sipas tij pjesa që i përket *Mesharit* ndahet nga pararendësja (*Exorcista catechuminum*) me një numër të munguar faqesh, ndërkohë që dhe në këtë pjesë vëmendje duhet treguar ndaj evidentimit të fletëve dhe numërimit të tyre.¹²

Njohja e mirë e modeleve që ndërthuren në këtë libër dhe e vetë traditës që qëndron si kontekst mbështetës në lidhje me të bën të mundur që Roques të jetë orientues i qartë dhe ndaj kërkimit të këtyre pjesëve, bashkë me evidentimin e faqeve që siç dhe është vënë në dukje edhe më vonë, janë numëruar në proces shtypit në një mënyrë jo fort të saktë.

Rikthimi nga ana e Roques te termi *livre d'heures* do të vijë natyrshëm në përfundim të një analize kontekstuale që buron nga njohja e një sërë ekzemplarësh të ngjashëm që lidhen me një traditë që cek dhe vendet kroate, në të cilat ishte i gjallë dhe përdorimi i librave të kësaj natyre.¹³

Paraqet interes dhe fakti që ky i fundit argumenton që dhe libri i Buzukut ndjek një traditë të ngjashme, të paktën sa i përket çështjes së përpilimit të një libri orësh në gjuhën shqipe.¹⁴ Në veçanti librat e orëve

et missel traduits par Gjon Buzuk. - Imprimé, 1554-1555.

¹² Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Paris, 1932, f.11.

¹³ Roques M., *po aty, vepër e cituar*, f.15.

¹⁴ Roques M., *po aty, vepër e cituar*, f.15: Nous serions ainsi amenés à penser que Gjon Buzuk doit aux Slaves catholiques romains de Bosnie, de Dalmatie ou de Serbie, non seulement quelques caractères graphiques, non seulement le recours, direct ou non, à la typographie vénitienne, mais peut-être aussi l'idée de donner à ses compatriotes un livre d'heures composé dans leur langage national. Cela ne serait pas sans importance pour

përbëjnë një prej modeleve më të trajtuara në studimet mbi traditën librore në Evropë edhe në shekujt që i prijnë Pesëqindës, duke qenë se janë përherë bartës tekstesh e figurash që shpesh kanë qenë dhe të personalizuar në raste të veçanta. Libri i orëve përbën një mjet të domosdoshëm në praktikën e përditshme klerikale, por dhe një model libror që reflekton elemente bazike të një kulture fetare e shpirtërore për përdoruesit e tij.¹⁵

Vërejtjet që jep Mario Roques mbi vendin (gjithnjë për t'u sqaruar) ku duhet të ketë shërbyer autori i librit në të vërtetë përkohë dhe me natyrën e të dhënave biografike që fatmirësisht kemi arritur të disponojmë në lidhje me autorët e tjerë që pasojnë në dekadat e shekujt e mëvonë, gjithnjë në referim ndaj analet dhe korpusesh madhore që ofrojnë informacione të vjera mbi klerikët shqiptarë që shërbyen në seli të ndryshme të provincave të atëhershme.¹⁶

Besojmë se duhet marrë në konsideratë dhe mendimi që libri i Buzukut duhet të ketë qenë i paracaktuar për bashkësi që mund të ishin të ngulitura në vise të tjera, jashtë Shqipërie. Ky mendim, por dhe opinione të tjera që nuk shprehen jashtë analizave të thelluara të teksteve të veprës në të vërtetë janë mbështetur dhe më vonë, në studime të periudhave pasuese, por që kanë marrë parasysh dhe interpretimet që veçanërisht në vitet '20-'30 të shekullit të kaluar u konkretizuan në studime të posaçme apo artikuj shkencorë mbi të njëjtin argument.¹⁷

Në një vështrim sintetizues mbi studime dhe arritje në lidhje me ndriçimin e një konteksti kompleks që ka të bëjë me një nga librat më të ndërmendur në gjurmimet mbi historinë e shkrimit shqip dhe fillesat e tij, kontributi i dhënë nga Mario Roques, filolog dhe përpilues trajtesash konkrete në lidhje me historinë e veprave të letërsisë së vjetër shqipe zë një vend të veçantë për shumë arsye. Analizat tekstore që pasurojnë gjithë trajtesën e tij mbi veprën dhe tiparet grafike që tërheqin natyrshëm vëmendjen e një filologu në të vërtetë janë një linjë e saktë metodike dhe në rast krahasimesh të mundshme që lind nevoja të kryhen nëse kërkohet të

l'histoire de l'usage liturgique des langues nationales dans l'Église catholique.

¹⁵ Në vështrimin tonë ka rëndësi dhe ç'konceptonte vetë Roques me emërtimin e tij mbi të quajturin *livre d'heures*, duke qenë ky i fundit ndër më të përdorurit në trajtesën e tij mbi librin e Buzukut.

¹⁶ Zhvendosja e klerikëve nga një seli në tjetrën, qoftë dhe e prelatëve që mbulonin role të një rëndësie hierarkike në atë kohë mund të vërtetohet në veçanti në lidhje me Pjetër Bogdanin, i cili referon në lidhje me detyrat e tij dhe në Prefationën e veprës së tij *Cuneus prophetarum* (Patavii, 1685).

¹⁷ Shih sërish artikullin e sipërcituar mbi *Mesharin* e Gjon Buzukut nga L.Nadin në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2015.

gjejmë bashkëlidhje me tradita të tjera që i përafrojnë me librin tonë koha dhe konfigurimi gjeografik konkret.

Mbi të gjitha, gjykimet që ai jep mbi domosdoshmërinë e njohjes së saktë të kësombllave të veprave, mbi vendndodhjen e mundshme të secilës në arkiva e biblioteka, mbi nevojën për t'i evidentuar në një panoramë historike, por dhe analitike dëshmojnë interesin e qartë që ai ushqente dhe për tekstet e vjetra shqipe, që e shpreh në mënyrë konkrete dhe me sprovën serioze të ndërmarrë në lidhje me *Dicionarin latinisht-shqip* të Frang Bardhit dhe tipare të ndërtimit të tij si vepër leksikografike e një shekulli të rëndësishëm për zhvillimin e kulturës së shkrimit shqip. Do të jetë pikërisht periudha në të cilën konkretizohet në artikuj e parathënie dhe ky interes studimor i filologut frëng, një moment kohor me rëndësi dhe për sistemimin e njohurive në kontekst evropian mbi ecurinë e realizimit të veprave më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, të pandashme me të drejtë nga ecuria e kulturës së librit dhe në këtë kornizë të domosdoshme historike. Plotësimi i një kuadri informativ në lidhje me një traditë tashmë të afirmuar vepërzash e ekzemplarësh nga letërsia e vjetër shqipe reflektohet si sprovë dhe në këtë vepër gjurmimesh të filologut Mario Roques, ndërkohë që kontribute të tjera po aq të rëndësishme që mbajnë autorësinë e murgjve bazilianë të Grottaferratës, Papas Petrottës apo Atë Justin Rrotës O.F.M. do të përkojnë në kohë me realizimet e tij.

Autorësia e librit të Gjon Buzukut mbetet gjithashtu një prej çështjeve më me interes sa i përket panoramës studimore që lidhet me të. Diversiteti i tekstit konstatuar qartësisht prej studiuesve më të afërt të kësaj vepre në pjesë themelore të saj i shërben në një mënyrë të drejtpërdrejtë dhe thellimit të diskutimit mbi këtë argument. Tekste të ngjashme nga përmbajtja, por me tipare gjuhësore që dëshmojnë konsultimin e burimeve të ndryshme bëjnë të mundur të shtrohen diskutime e të mendohet se në dorë të autorit kishte disa mundësi zgjedhjeje.

Së pari, duhet konsideruar fakti që autori vetë u shërbye me tekste që ekzistonin më herët dhe që me gjasë ishin pjesë e një praktike liturgjike, celebrative dhe kishtarë. Një vëmendje të qartë në këtë drejtim duhet të gëzojnë himnet dhe këngët që vijnë të jenë popullore për nga njohja dhe përdorimi dhe në ditët e sotme. Një numër jo i vogël trajtash me prejardhje latino-romane, shpesh dhe të papërpunuara në pikëpamje të përbërjes fonetike mund të përforcojnë mendimin se të tilla tekste ishin pjesë e përdorimeve në një areal me përkatësi gjeografike në Gadishullin Italik, por njëkohësisht i shërbejnë dhe interpretimit mbi nevojën për t'i pasur pjesë të një repertori celebrativ pikërisht përmes njohjes së tyre.

Në trajtesat tona më të fundit në lidhje me këtë libër dhe vetë kontekstin në të cilin duhet të ketë parë dritën e shtypit kemi nënvizuar dhe ndikimin e mjaft zhvillimeve të kohës, që orientuan dhe ndaj prirjeve të reja në kulturën e librit. Paqartësitë që kanë ekzistuar prej kohësh e shtrojnë sërish nevojën për të kryer gjurmime konkrete në lokalitete e qendra në të cilat kultura e shtypshkrimit kishte marrë një zhvillim të natyrshëm disa vite më parë se të dilte nga shtypi ky libër kaq i vyer.

Një libër si i Gjon Buzukut, i qartë në përmbajtje dhe paracaktim përdorimi gjithsesi do të reflektonte qoftë tiparet e kohës, ashtu dhe elemente të një vetëdijeje që ka të bëjë dhe me vetë zhvillimet e sipërcituara.

Si çdo vepër e rëndësishme që mbetet më së pari produkt i një kohe të caktuar, të ngarkuar në zhvillime e ndryshime, natyrshëm dhe në vështrimin tonë vijon të përbëjë një objekt që paraqet interes dhe zgjon kuriozitetin për njohjen e hollësive të tjera që përbëjnë në të vërtetë imazhin e plotë mbi historinë e një ekzemplari të rrallë. I pashkëputshëm nga një kulturë komplekse e kohës që përfshinte natyrshëm dhe botimet e librave dhe kësombllave të rralla në shumë pikëpamje, ky libër ofron një hapësirë të gjerë diskutimi në pikëpamje të historisë së vet, por dhe vetë kuadrit historik që e solli në jetë.

BIBLIOGRAFI

- Ageno Brambilla F., *L'edizione critica dei testi volgari*, Antenore, Padova, 1984.
- Antonelli R., *Interpretazione e critica del testo*, në *Letteratura italiana, Vëllimi IV*, Einaudi, Torino, 1985.
- Bainton R., *La riforma protestante*, Einaudi editore, Torino, 2000.
- Baldacchini L., *Il libro antico, (nuova ed. aggiornata)*, Carocci editore, Romë, 2001.
- Barbieri E., *Guida al libro antico. Conoscere e descrivere il libro tipografico*, Le Monnier, Firenze, 2006.
- Bogdani P., *Cuneus prophetarum (Çeta e profetëve), botim kritik përgatitur nga A.Omari*, ASHSH, Tiranë, 2015.
- Bonora E., *La Controriforma*, Laterza editore, Roma-Bari, 2001.
- Camaj M., *Il "Messale" di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë, 1960.
- Camaiani P.G., *Interpretazioni della Riforma cattolica e della Controriforma*, në *Grande Enciclopedia filosofica, VI*, Milano, 1964.
- Carmassi P., *Libri liturgici e istituzioni ecclesiastiche a Milano in età*

- medioevale (studio sulla formazione del lezionario ambrosiano)*, Aschendorff Münster, 2001.
- Carrez M., *Le lingue della Bibbia (dai papiri alle bibbie in stampa)*, Edizioni Paoline, Romë, 1987.
 - Crupi G., *Gli incunaboli italiani in lingua volgare: preliminari di una ricerca*, La Sapienza Editrice, 2012.
 - Çabej E., *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2, 1959.
 - Demiraj B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe "Doktrina" e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
 - Demiraj B., *Dictionarium latino-epiroticum (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum*, Botime Françeskane, Shkodër, 2008.
 - De Virgilio G., *Teologia biblica del Nuovo Testamento*, Edizioni Messaggero Padova, 2016.
 - Ehrmann Bart D., *Il Nuovo testamento, un'introduzione*, Carocci editore, Roma, 2015.
 - Felici L., *La riforma protestante nell'Italia del Cinquecento*, Carocci editore, Roma, 2016.
 - Firpo M., *Riforma protestante ed eresie nell'Italia del Cinquecento*, Editori Laterza, Bari, 2008.
 - Fischer G., *Teologie dell'Antico Testamento*, San Paolo Edizioni, 2015.
 - Fragnito G., *Cinquecento italiano. Religione, cultura e potere dal Rinascimento alla Controriforma*, Il Mulino, Bologna, 2012.
 - Fragnito G., *La Bibbia al rogo: La censura ecclesiastica e i volgarizzamenti della Scrittura*, Il Mulino, Bologna, 2015.
 - Fuiano M., *La stampa nel Cinquecento: breve prospetto*, Libreria Scientifica, 1967.
 - Genesin M., Matzinger J., *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta*, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, a cura di A.Ndreca, Urbaniana University Press, Romë, 2017.
 - Mansaku S., *L'orientation culturelle et religieuse des Albanais au moyen âge et les débuts de l'écriture de la langue albanaise*, në *Studia Albanica*, 2006.
 - Menchi S.S., *Le traduzioni italiane di Lutero nella prima metà del Cinquecento*, në *Rinascimento*, n.17, 1977.
 - Paci E., *Pikëpamje të Zamputit mbi vendin e "Mesharit" në historinë e letërsisë së shkruar shqipe*, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2014.
 - Paci E., *Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi*, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.
 - Paci E., *Cenni ed osservazioni linguistiche sul primo libro scritto in lingua*

- albanese(1555)*, në *Studia Albanica*, 1-2, 2014.
- Paci E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
 - Paci E., *Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe (përmbledhje studimesh filologjike dhe tekstologjike)*, Botime Françeskane, Shkodër, 2020.
 - Petrotta G., *Saggio di bibliografia albanese (1500-1930)*, Palermo, 1931.
 - Prospero A., *Il Concilio di Trento: una introduzione storica*, Piccola Biblioteca Einaudi, Torino, 2001.
 - Prospero A., *L'inquisizione romana : letture e ricerche*, Edizioni di Storia e Letteratura, Romë, 2003.
 - Roques M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, L.O.P.Geuthner, Paris, 1932.
 - Schmidt H.A.P., *Liturgie et langue vulgaire: le problème de la langue liturgique chez les premiers réformateurs et au Concile de Trente*, Aedes Universitatis Gregoriana, Romë, 1950.
 - Zamputi I., *Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzikut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, në *Studime filologjike* n.3, 1986.
 - Zamputi I., *Les circonstances historiques de la parution du "Missel" de Gjon Buzuku et sa place dans la littérature albanaise*, në *Studia Albanica*, n.1, 1988.
 - Zamputi I., *Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe*, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

The story of a book through new research studies and achievements

ABSTRACT

In the history of studies on old Albanian texts we distinguish some works in terms of importance and content particularity, one of them is the book of Gjon Buzuku (1555), often mentioned in relevant studies about his structure, as well as his linguistic and literary features that make it remarkable. A work as complex as Buzuku's also draws attention to the context of cultural developments which must have been the impetus for its compilation, while albanological studies have not lacked in-depth studies on the basic subsystems that can be traced within it. In this synthetic commentary about the history of books in the Albanian language during the

sixteenth century, we reconsidered concrete contributions that objectively address the circumstances in which a work of this kind has been realized, the first known to date from our studies.

Alfred ÇAPALIKU

PUBLICISTIKA E KOLË THAÇIT

“... me kso mendimesh ndihmohet shqyptari per perparim t’ atdheut.”

Gjon Luigj Bazhdari

Shkodra me tradita në fletorizëm qysh nga vitet ‘70 të shekullit XIX i përtëriu dhe i shkëlqeu më fort ato në vitet e para të Pavarësisë. Gjatë harkut kohor 1913 - 1920 nisën botimin në atë djep kulture njëzet e katër organe shtypi: gazeta, revista të përmuajshme, almanakë vjetorë, periodikë, buletinë dhe kalendarë. Fletorja pioniere e kësaj periudhe kohore qe e përditshmja “Taraboshi”, e botuar krejtësisht në gjuhën amë brenda trojeve shqiptare, në Shkodër, më 26 shtator 1913. Ajo ndoqi traditën e gazetave “Shkodra” (1909 - 1910), “Koha” - “Bashkimi” - “Koha” (1910 - 1911), “Dilli” (1910 - 1911) dhe “Hana (1911 - 1912). Përmes rotativave të shtypshkronjave jezuite dhe françeskane, me teknikën e linotipit, me germat prej plumbi, funksionoi sistemi i shtypit politik, shoqëror, letrar, pedagogjik, fetar, si dhe ai miks, drejtuar ndaj shtresave heterogjene të lexuesve. Historiani i gazetarisë prof. Hamit Boriçi, më 1997 në Tiranë, e tipizon fenomenin:

“Larmia e shtypit, si lloj e përkatësi sociale, ishte një prej tipareve dalluese të gazetarisë së Shkodrës për këtë fazë, në dallim nga qytetet e tjera të Shqipërisë. Rrethet tregtare të qytetit arritën të botonin “Kalendarin tregtar” (1916); ato arsimore, revistën pedagogjike “Agimi” (1919); ndërsa grupet e vajzave e të grave përparimtare, të përkohshmen “Gruaja shqiptare.”” (1)

Në këtë ngjeshje të sfondit kulturor, në nëntor - dhjetor të 1914-ës, Kolë Thaçi u shfaq duke u fshehur pas pseudonimit, dukuri sa pragmatike aq edhe mode në ato vite të para të Pavarësisë. Ai debutoi te revista “**Perparimi**” në Shkodër, me pseudonimin “**Sh. P.**”. Thaçi hyri në gazetari jo që ta përdorë si mjet jetese, por për ta ushtruar si liri mendimi. Ai e zhvilloi veprimtarinë publicistike si profesionist me komunikim të qartë duke sjellë vazhdimisht diçka të re. Pasuria e leksikut të Kolë Thaçit shihet te dinamizmi i fjalëve të reja formuar me brumin e shqipes që

futi natyrshëm e pa sforcim në shkrime, si dhe tek aktivizimi i fjalëve të rralla të traditës gjuhësore, lënë në harresë nga zhvillimet e shpejta të fillimshkullit XX.

Organi i institucionit fetar të jezuitëve, revista e përmuajshme “Perparimi”, si botim më vete në shumë faqe, me profil të përcaktuar tematik e problemor, qarkulloi në Shkodër në vitet 1914 - 1916. Ajo u themelua e u redaktua nga shkrimtari At Gjon Luigj Bazhdari SJ (1877 - 1915). Pas vdekjes së tij, punën cilësore me të përkohshmen e vazhdoi At Anton Maria Xanoni SJ, Prefekt dhe shkrimtar (1863 - 1915). Por fatkeqësisht edhe ai veproi tepër shkurt, mbasi u shua paprimas. Shiritë kurorash të pafundme iu vendosën atij personaliteti në banesën e fundme, më 17 shkurt 1915, ku spikatën edhe radhët e shkruara me bojë varaku:

“Ndoc Xanoni. Atdhetar i flakët, shkrimtar i vlerët. Në shenjë të binduemit, këtë kunorë ia kushtojnë: Ndoc Çoba, P. Gurakuqi, Kolë Thaçi, L. Gera.” (2)

Veprimtarinë drejtuese, misionare dhe letrare të At Xanonit e përfundoi me sukses At Francesco Genovizzi SJ (1864 - 1935), Sundues i Kongregacionit t’ Ejve. Në fakt kjo e përmuajshme fetare - kulturore - historike - letrare - pedagogjike - folklorike - etnografike e klerit jezuit të Shkodrës, ishte pjesa e dytë e organit periodik “Elçija i Zembrës s’ Jezu Krishtit”, numri i parë i të cilit u publikua në Shkodër në mars 1891. Në fundin e 1916-ës revista “Perparimi” u mbyll.

Shkrimi premierë në gazetari i Kolë Thaçit, eseja me titullin që tingëllonte si proverbial: **“Nji gjak, nji mënde, nji zëmer” (1914)**, u parapri nga një shënim inkurajues për stilin e autorit dhe mbështetës për idetë e shprehura prej tij. Aprovimi i thukët vinte prej Drejtimit të redaksisë, At Gjon Luigj Bazhdarit:

“U lutena kndojtorve t’ onë m’ e kndue fund e maje jo nji herë por dy a trii, me qellim qi me xjerrë fryt e me e shndoshë gjithicilli nesh mënden e zëmren t’ onë, n’ daçin me t’ vertetë me kë në nji komë i lumnueshem e mos me ju perkrahë verbnisht na vetë njatyne qi donë fiken e Shqypniis s’ onë.” (3)

Qysh në shkrimin e parë të Kolë Thaçit ra në sy paraqitja e shkathët e realitetit me fjalë të zgjedhura dhe me shprehje të figurshme, që duke zbërthyer përmbajtjen zgjeronin horizontin e lexuesve. Përmes meditimit të thellë Kolë Thaçi shpreh kësisoj në mënyrë emocionale dukurinë e re mbas shpalljes së Pavarësisë: “Nji gjak, nji mënde, nji zëmer”. Ai jep qëndrimin e tij emocional si dëshmitar okular dhe si interpretues i

besueshëm i asaj që pasqyron. Në fushën e eseistikës Kolë Thaçi u paraqit me llojin e gjatë të esesë të fokusuar në një problem të shtjelluar në dy pjesë, si te “Perparimi” dhe “Dashtnija per jetë” (1915); “Militarizm e die” (1916). Por më tepër ai profilizohet në llojin e shkurtër, bazuar në një çështje duke e trajtuar në mënyrë konçize, në disa paragrafë, si te “Koha”, “Shkaku i t’rritunit t’Komit”, “Dy fjalë mii karakter”, “Nevoja e punës” (1915); “Nevoja e mirëvetiis”. Këtë mozaik ai e botoi tek revista “Perparimi” gjatë tre viteve. Aty shpalosen mjetet e pasqyrimin letrar, si përshkrimi i figurshëm, dialogu hipotetik, meditimi poetik, pyetjet retorike, përgjithësimi publicistik, ndërtimi dinamik i situatave jetësore. Mendimi i ri shqiptar i dekadës së dytë të shekullit të njëzetë do të gjejë kështu te Kolë Thaçi edhe shkrimtarin, edhe sociologun.

Stili i veçantë në gazetari i Thaçit shihet në konceptimin e realizimit të modelit të parë eseistik me kohezion të plotë qysh tek **“Nji gjak, nji mënde, nji zëmer”**.

Në nisje tërheq lexuesin përmes parashtrimit psikologjik analitik sqarues:

“Por atdheu është nji trup, degët e t’ cillit jemi na ... Nji gjak kena e domosdo do t’ kena edhe nji mënde e nji zëmer: nuk është rrezik se hupë gjaku n’ kjoftë se mëndja e zëmra bashkohen nder nee per me ja maajt doren e me i dalë zot si na perket... n’tym e m’ndjegull njifet burrnia si çmimi i arit n’zjarm.”

Më pas përfshin lexuesin përmes shtjellimit artistik sintetik përgjithësues:

“Është e diitun, po thâm se gjithicilli nder nee, qi do t’punojm per atme, kaa barrë fort t’rânda mii krye;por sikuer mas t’vrântit del dielli, ashtû edhe mas mûundit vjen puna e mirë e ngushllimi, persë atdheu nuk len paa ja shperblye djersen e t’ birve t’ vet : pra sikursë gzojm t’mirat ashtû edhe barren do t’a baarim.

... Kush s’e don barren

Edhe t’ miren t’a lâan; t’ shkojn me banue

Neper shtigje pyllore

Si lypc i keq, e atÿ per nen lisnaje

Me ‘j grusht lênd t’ thaata e me j’ shpellinë me krânde

T’jetojn vetun e lîir njashtû si i kânde.

(Metastasio - Att. Regolo - Att. II - Scena I.”. Faqe 180.

Shihet qartë se mënyra e organizimit të esesë lirisht e pa fusnota dhe realizimi i saj me tërësinë e mjeteve shprehëse ka një karakter të mirëfilltë letrariteti. Kolë Thaçi qe një nga firmat më të angazhuara, më dinjitoze dhe

më të spikatura në revistën “Perparimi”. Ai bashkëpunoi me atë organ duke trajtuar tema pikante shoqërore, ku shkrihej psikologjia me pedagogjinë, etika me filozofinë, politika me atdhedashurinë. Këto janë tri shtyllat e prurjes së tij në publicistikë. Kulturologu Kolë Thaçi vazhdoi përmes publicistikës së tij letrare, traditën eseistike në gjuhën shqipe të nisur me Naum Veqilharxhin tek “E parathënme për djemtë e rinj shqiptarë”, 1845, me Pashko Vasën tek “Shqypnia dhe shqyptarët”, 1879 dhe me Sami Frashërin “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”, 1899. Eseja diturore e Kolë Thaçit trajton çështje e shtron probleme, shpjegon objekte dhe sqaron fenomene, duke mbajtur qëndrim pro apo duke dalë kundër. Eseja enciklopedike e tij shpalos një përvojë dhe përmes saj analizon një proces. Shpesh eseja, siç ka sintetizuar në një tekst universitar studiuesi Tonin Çobani: “... *parashtron një teori a dije të fituar përmes leximeve etj.*” (4)

Një nga këto trajtesa të kulturës jetësore, që zgjoi një interesim të madh tek lexuesit titullohej “**Perparimi**”. Shpalosja e esesë, për shkak të argumentimit të ngeshëm dhe të interpretimit të hollësishëm, u botua me vijim në atë revistë në numrat e janarit dhe të shkurtit të vitit 1915:

“Perparimin, mäs mëndimit t’ onë mûndena m’ e gjetë m’ një sere pûnësh m’ nieri qi zhdrivillohen kàmë kàmë porsi shkallë njëna mii tjetren paa u ndalë e paa u kthye mbrapa ; por kufijue prej fuqijet qi kaa nieri n’ vetvedi e prej ligjve me t’ cillat lidhen e sùndohen fuqit e shpirtit t’ tii.” F. 2 - 3.

Është një meditim tipik i Thaçit i organizuar në publicistikë letrare, ku përmes aryetimeve logjike paraqitet herë si përjetues faktesh reale dhe herë të tjera si parashikues ngjarjesh që ndiheshin në ajër. Ja esenca optimiste e devizës thaçiane:

“Shka mûndet me ndollë mbas sodit na nuk e diim; por nder kohë t’ kalueme nuk janë zhdrivillue sakt màa teper ndiesiinat komtare sa nder dit t’ soçme. E ky à perparim! Tuj u zhdrivillue fuqit e shpirtit, kaa nevojë nieri me u ushqye me msime t’ verteta e t’ mira e jo me punë t’ liga, t’ çartuna e t’ dâmshme.” F. 20 - 21.

Në esenë historike dhe kulturore “**Koha**”, paraqitur në numrin 4 të prillit 1915 të po kësaj reviste, bashkëpunëtori i saj, i fshehur në siglën Sh. P. , nocionin e kohës e zhdrivillon në funksion të ndërgjegjes së zgjuar kombëtare:

“T’ja diim djetin kohës e t’mundohena me baa kryegjajet ket visar kaq t’bukur ... Atnit t’onë, tuj paa kaq ndrrime n’jetë t’vet, rriin e shikjojnë palë shka po ban djelmnia; Shqypnia si nanë e dashtun pret ndimë prej birve t’vet; bota na shikjon a jemi t’zotët m’u parasue me kome tjera t’Europës.” F. 75.

Përmes lirizmit Kolë Thaçi shpreh në mënyrë spontane botën e brendshme të njeriut dhe komunikon lirshëm e me çiltërsi në publik. Tek eseja sintezë **“Shkaku i t’rritunit t’Komit”**, maj 1915 të revistës në fjalë, autori Sh. P. shpalos profilin pedagogjik të mësuesit të dikurshëm para nxënësve të kolegjit saverian, por tashmë didakti u drejtohet breznive të rritura:

“Komi shqyptaar t’ diin me njoftë atdheedashtniin e t’a shkyejn at pelhurë paa-diejet qi e kaa mlue deri tash vonë. Ky mjet e kjo mndyrë e securët per me rritë e me naltsue komin t’onë është mirvetia e fmive, mas s’cilles rrjedh qetimi nder konaqe e prej kndej” e mira e lulzimi i atdheut.” F. 90.

Shkrimi eseistik vijues **“Dy fjalë mii karakter”**, i botuar në numrin e gushtit 1915 të “Perparimi”, zbulon qartë profilin psikologjik të poetit të ardhshëm Kolë Thaçi:

*“Populli i ynë qi nder kuvende e kaa gojen plot me mndyrë t’folunit, me t’thanuna t’bukura e me fjalë analogjike, perdoron shum herë n’kuvend një fjalë bujare qi, edhë mos e pastë krejt veshtrimin e fjalës **karakter**, fort per t’vertetë i avitet, e munden me thënë se është një fisit me të, tuj e krye bukur mirë t’pershtypunit e asajë cilltii. Kjo fjalë e perdorueme kso doret prej popullit është burrnia”. F. 105.*

Tek eseja diturake **“Nevoja e punës”**, që doli në gusht të 1915-ës po në atë organ shtypi, autori e vlerëson aktin e gjuhës shprehëse, si veshje të mendimit:

“Kuer thona se ndriron nieri e komet, merret vesht se i ndrrojn t’gjitha njatò sênde qi i perkasin si, po e xâam, giûha e kandsimet etj. persë giûha nuk është gjâa tjeter veç se mndyra me kallxue mendimet, e kândsimet a qeefet janë pelqimi i punve me shtetin e permbrênshe t’onin.” F.138.

Në rreshtat e esesë elegante **“Dashtnija për jetë”**, dalë tek “Perparimi” në numrat vijues 10 dhe 11 të vitit 1915, Sh. P. zgjeron pikat e horizontit diturak të lexuesve:

“Një nder msimet mâa t’para t’cillat do t’stolisen mëndja e zêmra e një nierit t’vjeftshem, është dashtnia për jetë, e cilla do t’kuptohet ashtû si natyra, vetë na e paraqet, due me thanë, t’paa-peqatme prej shnierzimit e prej vesit.” F. 169.

Konkluzioni i publicistit është konkret për karakterizimin e kësaj dukurie humane: *“Dashtnia për jetë t’vetveedit, kuer është e rregullueme me ligjë e me arsye si*

duhet, është âma e punve t' nalta, fisnike e t' mrekullueshme prej t' cillave rrjedhin paa dyshim lumnia e rreligjionit, lulzimi i atdheut e t' mkâmunit e qindresa e shpiave.” F. 189.

Eseja diturake “**Nevoja e mirëvetiis**”, e botuar në shkurt 1916 në faqet e po asaj reviste nga Kolë Thaçi është një shkrim i natyrës etike që trajton qartë rëndësinë e vetëkontrollit individual dhe të vetëpërbajtjes njerëzore, si rregull bazik sjelljeje:

“E shka do t' thona veças per nevojë t' mirëvetiis (moralitetit - shënimi im: A. Ç.) qi kâa zëmra e nierit? Nierit qi mirëveti nuk ka por lëndron e tallet vetun n' trashim e n' t'padie, si kaa per t' muejt m' e begatë zëmren me ndiesii bujare tuj njoftë sidomos detyrët e paa njehuna qi ndollin per ç' do gjurmë qi ndrrohet?” F. 21.

Artikulli eseistik “**Militaritarizm e die**”, i botuar me vijim në numrin prill e maj 1916, e përmyll bashkëpunimin e publicistit Sh. P. me “Perparimin”. Në kolonat e shkrimit autori mendon se virtyti ushtarak është i bashkëlidhur dhe i përngjitur me atë të dijes e të dinjitetit edhe në flakët e Luftës së Madhe:

“Thotë Platoni se vertyti i vertetë ushtarak nuk është aspak ndrÿshej prej atii t' pergjithshem e t' unjishem qi pershiin n' vedvedi t' gjitha verytet tjera t' veçanta e t' pjesëshme; prejse një ushtarë per me kenë i mirë e i vjefshem n' zyre t' vet, jo veç do t' jeen i foort e i qindrueshem, por edhe i drejtë, i ndalun, i çitruem e i urtë; do t' kenë një farë kndimit e aratimit veshtrues njashtu si t' a lypin shkalla e gjytniis s' kohve e si t' a vëen porosi e n' perdorim ligjët e vëndimet ushtarake.” F. 38.

Në fund Kolë Thaçi respekton mendimin e lexuesve duke i personalizuar ata:

“Por knduesat e dashtun mûnden edhe prej vedit me i kûndrue e me i peshue njoftimet e nevojshme me dritë t' arsyes s' natyrës, sepsë t' vertetat janë t' shndritshme si diell e s' munden mâa me u terratisë : mûnden me kûndrue e me njoftë se militarizmi kuer paska per shoqe t' paadame dien maka nalt e nalt fort edhe moralin e kënen e gjytniis...” F. 52.

Tematika e larmishme e Thaçit të “Perparimi”, ashtu si ajo e bashkëpunëtorëve të tjerë të njohur të atij organi, sipas prof. dr. Hamit Boriçit, hulumtues mjaft i njohur i medieive shqiptare, në një shkrim botuar në Tiranë më 2 gusht 2004: “*nuk është elaboruar akoma, madje as nuk është cekur në ndonjëfarë mënyre.*” (5)

Kontributi publicistik i Kolë Thaçit duket sporadikisht edhe në dy revista të tjera që botoheshin aso kohe në Shkodër.

Tek revista e përmuajshme fetare, kulturore e letrare e Kolegjit të Jezuitëve “**Lajmtari i Zemërs s'Jezu Krishtit**”, e cila drejtohej nga A. Francesco Genovizzi S. J., në mars të vitit 1916 Kolë Thaçi botoi vështrimin panoramik përgjithësues “**Veprimi i Lajmtarit n' kto 25 vjet**”, ku si vlerë kryesore të së

përkohshmes spikat:

“E mas pikpamjes letrare na mûndena me thânë paa frigë se gabojm, se kjò Perkohshme kjë e vetmja qi per saa vjet u ènd neper Shqypniî n’at giûhë t’amel qi flasim qi çiltas e ballafaqe qindroj me vepra e jo me fjalë kundra marazit t’annikut t’ giûhës s’ onë e kje e vetmja qi per shum vjet shkoj tuj qitë n’ djelmniî faren e njoftimeve e t’ dishireve per nji letratyre t’ ree e t’ lulzueshme.” F. 46.

Ndërsa tek faqet e revistës **“Agimi”** me tematikë shoqërore, letrare, pedagogjike, satirike, e cila drejtohej nga publicisti Karl Gurakuqi, në prill të vitit 1922 Kolë Thaçi u paraqit me një artikull të shkruar në formën e një proze poetike. Eseja e titulluar **“Nji kujtim mbi ditën 19 Marc 1922”** u jep përgjigje të qartë pesë pyetjeve bazë të gazetarisë: Kush? Ku? Kur? Pse? Si? . Aty publicisti Kolë Thaçi portretizoi një dëshmor të ri të atdheut, duke vënë theksin kryesisht tek gjesti patriotik, meqë adashi i tij malësor Kolë Nushi erdhi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të mbronte tokën shqiptare dhe të sakrifikohej për flamurin kuq e zi. Portreti i Kolë Nushit përveç tipareve fizike spikat thelbësoren e botës së brendshme, vlerat e larta shpirtërore dhe cilësitë e ngulura morale. Trajtesa e ndjerë dallon nga esetë e mëparshme, sepse bazohet mbi një ngjarje konkrete dhe reale. Ky shkrim prekës, që i bën jehonë aty për aty një akti shembullor vetëmohimi të ndeshur shpesh në historinë tonë të lashtë e të re, ka funksion propogandues dhe mobilizues:

“Zymt e errtë pushote mbrenda atij vorr të Rrmajit nji djaloç, të thuesh se s’ kish mâ uzdajë se rët e Taraboshit fatos do të ju davaritshin flamurit të Shqypes s’ onë. E sot? Çou ti sot Kolë Nushi e kundrò mbi kalà të Rozafatit at flamur, qi ti e pate aq për zëmer, se valvitet me kreni të pa-shoqe neper qiell pa rë të Shkoders s’ onë. Nguli ata sy zhgjetë, o Gegë kreshnik, mbi Tarabosh e shif se mbi të shetit me gzim ushtari ... i Shqypnis; sot në ket ditë, ai mal, qi aq fort i duel zot Shkoders së vet, a tue kqyrë me galdim kalàn e Gencit, Flamurin e Kastriotit e betohet se per pà u bà rrafsh me Buen e Liqë, nuk do të dahet kurr e kurr prej tij, por kà për t’ i dalë zot sa të jët shekulli. Sot nuk âsht mâ zymt e vrantë ftyra e atij djali. Shef syni i tij i shndritshem në ftyrë të zbët se gjith kund neper Shqypni mbretnon flamuri i jonë e se per të rrahin zemrat e të tanë shqyptarve.” F. 213 - 214.

Publicisti Kolë Thaçi botoi gjithsej njëmbëdhjetë shkrime gazetareske me vlerë në lëmin kulturor, historik dhe shoqëror, në një volum të përmbledhur prej gjashtëdhjetë faqesh, tek tetëmbëdhjetë numra revistash të ndryshme. Albanologu Gaetano Petrota nga Hora e Arbëreshëve, më 1931 në Palermo, ia vlerësoi kështu:

“Mjaft të mira dhe krijime të shkëlqyera të prozës morale didaktike janë artikujt “Nji gjak, nji mënde, nji zëmer”, “Perparimi” dhe “Koha””. (6)

Më 1941, në Tiranë, tek libri shkollor **“Shkrimtarët shqiptarë. Pjesa II.”**, hartuesi i tekstit për gjimnazistët Karl Gurakuqi, bashkëkohës i Kolë Thaçit

dëshmon se ai qe bashkëpunëtor edhe i gazetës “Koha” - “Bashkimi” (1910 - 1911), e cila dilte në Shkodër nën drejtimin e Dom Ndoc Nikajt. Por shkrimet e Kolë Thaçit aty, si dhe në kolonat e ndonjë fletoreje tjetër të asaj periudhe, nuk identifikohen dot për shkak të anonimitetit të justifikuar, vënë re shpesh në shtyllat e shtypit shqiptar. Eseja artistike e Kolë Thaçit, si shkrim i çliruar nga korniza e përcaktimeve shkencore, përcjell sa pikëpamjet e autorit aq edhe dhe përvojën e përgjithshme njerëzore. Ajo ka parametrat e përmbledhur në mënyrë teorike nga studiuesit Hamit Boriçi e Zylyftar Bregu: “ ... strukturë e zhdërvjelltë, hartuar me elemente letrare, shpesh me retorika të lira, që e afrojnë autorin me lexuesin ... ” (7)

Retorika e përdorur në gamën publicistike të tij, si autor i njohur dhe i paraqitur shpesh në revistën “Perparimi”, do t’i vlente Kolë Thaçit në vitet e ardhshme tek fjalimet e mbajtura në parlamentin shqiptar, si deputet. Ndërsa eleganca e shprehjes në komunikim, e fituar qysh kur ishte edukator i nxënësve tek Kolegji Saverian, do t’i nevojitej atij edhe tek paraqitjet vjetore të buxhetit shtetëror apo në ligjërimet e shpeshta kuvendore para Këshillit Kombëtar, si ministër i financave. Kolë Thaçi u rrit si figurë poliedrike në palestrat kulturore të qytetërimit perëndimor. Përveç mjeshtrit të fjalës në gazetari, qe profesionist në komunikimin poetik, përkthyes nga italishtja me rroben shqipe, hartues juridiksioni, ekonomist financiar, duke u shfaqur në këto profile si purist i gjuhës amtare. Oratoria në shqip tek ai qe një epërsi personale. Fjalën e gjuhës burimore e qëndisi me durim e me pasion gjer në detajin fin të fioriturës artistike e të ornamentit letrar. Studiuesi Kolë Ashta, më 1942 në Shkodër shprehet kështu për veçoritë e tij:

“Thaçi njifet edhe si prozatur me shkrojlart SH. P. - Artikujt e të botuem në “Perparimi” rrejnë një vlerë letrare. Nder shum numra të ksaj së përkohshme prozat e tija vehen porsi kryeartikuj. Në ket prozë t’ arsyetueme vrehet kultura e të edhe një heri vlera e një gjuhe së pastër e përdorun mjeshtrisht.” (8)

Ai qe në të njëjtën gjatësi vale me Arthur Benson- in, më 1913, tek “Arti i eseistit”:

“Eseisti është në mënyrën e tij specifike një interpretues i jetës, kritik i saj. Ai nuk e sheh jetën si historian a filozof, si poet a romancier; gjithsesi ka shumëçka prej të gjithëve së bashku.” (9)

Kolë Thaçi qe bashkëmohatar me At Vinçenc Prennushin OFM që e nisi veprimtarinë publicistike më 1909, tek revista “Elçija i Zemers J. Krishtit”.

Të dy publicistët e kulturuar, ashtu si ansambli botues laik - klerikal i kohës, zbatonin me devotshmëri një program informues - formues në çdo shkrim të tyre. Në formë të kanonizuar ai program do të dilte në mars të 1940-ës:

“Ma i pari mjet propagande, të të shtrimuni veprimi, të të ruejtuni të visareve të Fes e të dokeve të mara, si dhe të një perparimi të njimenditë për Atdhe asht Shtypi i mirë... kishte për të kenë një gabim i randë, mos me dashtë t’ia mbushim mendën vedit për shka mundet, për si din e sa mrrin me ba Shtypi i mirë, Shtypi i ynë.” (10)

Publicisti Kolë Thaçi, me intuitë profesionale e përçoi kërkesën themelore të manifestit model, një çerek shekulli para se ai të publikohej. Shkrimet e tij poliforme vazhdimisht pasqyrojnë te lexuesit e çdo moshe vlera të qëndrueshme. Duke e specifikuar kontributin e shtypit fetar në Shqipërinë e pavarur gjatë dekadës së dytë e të tretë të shekullit të njëzetë, publicisti veteran prof. dr. Hamit Boriçi shprehet se ajo publicistikë ushqente te lexuesit besimtarë: *“...ideale atdhetare dhe kombëtare.”* (11)

REFERENCA:

1. Hamit Boriçi: “III. Pavarësia. (Pjesë e parë 1913 - 1924)”. Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848 - 1997). Tiranë, 1997, f. 41.
2. Jup Kastrati: “Anton Xanoni”. Rev. “Shkodra” (Almanak). Shkodër, 1962. Nr. 1 (2), f. 108.
3. Drejtimi (Gjon Luigj Bazhdari): “Zëdhënie”. Rev. “Perparimi”. Shkodër, 1914. Nr. 11 - 12, f. 161.
4. Tonin Çobani: “Klasifikimi i esesë”. Eseistika. Tiranë, 2013, f. 13.
5. Shih Markus W. E. Peters: “Shtëpia botuese më e vjetër e Shqipërisë dhe kontributi i saj për Lëvizjen Kombëtare arsimimin dhe kulturën”. Tiranë, 2016, f. 12.
6. Gaetano Petrotta. “Kolë Thaçi (1886)”. Popolo, lingua e letteratura albanese. Palermo, 1931 - IX, p. 384.
7. Hamit Boriçi, Zylyftar Bregu: Doracak i gazetarit. (Fjalëshpjegues). Tiranë, 2000, f. 19.
8. Kolë Ashta: “Një vegim i veprimtaris letrare të një shkrimtari shqiptar. Kolë Thaçi”. Rev. “Kunbona e së Diellës”. Nr. 38, f. 457.
9. Shih Tonin Çobani: “Hyrje”. Eseistika. Tiranë, 2013, f. 7.
10. Vinçenc Prennushi: “Me rastin e 50 - vjetorit të “Lajmtarit të Zembrës së Krishtit””. Rev. “Lajmtari i Zembrës së Krishtit”. Shkodër 1940, Nr. 3, f. 67.
11. Hamit Boriçi: “III. Pavarësia. (Pjesë e parë 1913 - 1924). Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare (1848 - 1997). Tiranë, 1997, f. 50 - 51.

Publishing work of Kolë Thaçi (45-54)***ABSTRACT***

Kolë Thaçi debuted at “Perparimi” magazine in Shkodra (1914) with the nickname “Sh.P”. He entered in the field of journalism not to use it as a way of living but to use it as a freedom of thoughts. He developed the journalism work as a profession, in clear communication by bringing new things. The rich lexicon of Kolë Thaci is noticed at the dynamism of new words and formed by the structure of Albanian language that he introduced naturally and without effort in the writings as well as in the use of the rare words of the linguistic tradition which were left in oblivion by the rapid developments at the beginning of the XX century. Kolë Thaci published eleven valuable journalistic articles in the cultural, historical and social fields, in a volume of sixty pages in eighteen different magazines. “Nji gjak, nji mendje, nji zemer – The same blood, one mind one heart”, “Përparimi – The Progress” and “Koha – The Time” etc. are very good and excellent didactic and moral articles.

Gëzim PUKA

PRURJE LETRARE E STUDIMORE NGA SHQIPTARËT PËRTEJ KUFIRIT

1. Pesha e rëndë e “Moteve” të poetit Ali Gjeçbritaj

“Motet” është vëllimi poetik i poetit krajan Ali Gjeçbritaj, që tejçon anekënd tek lexuesit shqipfolës frymëzimin, ndjenjën, mendimin, meditimin e një udhëtari të palodhur nëpër labirintet e figurshmërisë dhe imazheve lirike.

“Motet” është dëshmi e një përpjekjeje të gjatë ndër dekada për të hedhur ura në kufijtë gjeografikë, si dhe për të mbijetuar kulturalisht përmes artit të fjalës. Mishërimi dhe rigjallërimi shpirtëror i unit lirik, po ashtu intimiteti që ia beson lexuesit, nuk ka se si të mos shpërblehet me një pranim të hareshëm të këtij zëri origjinal në skenën shqiptare të poezisë.

Ali Gjeçbritaj është poeti që ka thithur me ëndje nektarin e Naimit, Poradecit, Migjenit, si dhe ka shijuar ëmbëlsinë e vargut popullor. Të lexosh dhe të ndërmendësh vargjet e tij, nuk ka se si të mos ndërgjegjësohesh për përtypjen dhe kënaqësinë e skajshme, që i sjellin poetit jehet e poezisë shqipe.

Kjo është një përmbledhje e poezive të shkruara në mote dhe stinë të ndryshme. Janë vargje të një rrugëtimi ekzistencial, ku ngjarje të mëdha dhe të vogla gërshetohen me gëzimet, dashuritë, kujtimet, dështimet. Këtu është edhe ëndrra për të zbuluar një identitet të veçantë brenda hapësirës së paanë të intimitetit njerëzor, që nga e para dhe deri tek më e fundit frymëmarrje. Lirikat janë të renditura në cikle që mbajnë tituj, duke na njoftuar për idenë e pasur të temave, që poeti ka zgjedhur të trajtojë, si: *Nata me hënë, Botë mashtrimi, Heshtja që flet, Gurët e truallit tim.*

Poezia e Ali Gjeçbritaj shpall thyrjen e shoqërisë ndër vite, ajo përvijon shpërthimet vetjake dhe kolektive, trajton vetminë, mallin, përkuljet e shpirtit nga plagët e kohëve tona. Ndaj nuk ka se si të mungojë në të kujtimi për të parët, thirrja që vjen nga kujtesa e trashëguar. Tematikisht autori lundron me një energji lasgushiane në njëmendësinë shqiptare, duke pasqyruar me mall dhe brengë vendlindjen dhe krenarinë për prejardhjen:

“Buzuku me Mesharin në dorë/ Shpërndan uratë e pagëzon fëmijë/

*Nuset me mozaikun e bjeshkës në kokë/ Stolisen bukuri veshur mrekuilli/
Udha zigzage kah shtegu i vashës/ Na shpie tek Labeatët/ Në Arbnesh në
qendrën Ilire/ Gjurmët asnjëherë nuk u fshinë/ Liqeni i labeatëve dhuron
shkëlqesinë/ Udhëtojnë brezat në varg motesh/ Mikun e pritëm me ngrohtësi
në vatër/ Me bukë kripë e zemër në sofër/ Asnjëherë se nisëm duarbosh.”
(nga poezia Mozaik Kraje)*

Më tutje e ndiejmë të filozofojë me fjalën e bukur shqipe. Nisur nga një qasje meditative, për poetin, bota është një paraqitje. Njeriu që e rrëfen këtë të vërtetë e di mirë se nuk njih as diell, as hënë, as tokë, por ka dy sy që shohin diell e hënë, si dhe një dorë që e prek këtë tokë.

*“Sot doli në qiell hëna e re/ Me cepa kthyer kah deti/ Ky çerek do jetë me
shi/ Toka ka etje i duhet lagështi/ Do shkojmë për kafe te miku im/ Djalë ka
lindur në atë shtëpi/Me hënë të re kafja duhet pirë. (nga poezia Hëna e re)
E më pas të admirojë bukuritë e natyrës: “Lulet nuk flenë/ Kur drita zbardh/
Ato thithin vesën/ Që natyra ua fal me dashuri...” (nga poezia Lulet)*

Dashuria është një tjetër temë, që nuk mund t’i mungojë këtij vëllimi me plot ndjenjë: *“Dikur/ Sytë e saj/ Lëshonin shkëndija./ Dikur/ Letra e saj/
Ishte plot dashuri./ Dikur ia recitoja/Lorkën, Eseninin/ Petrarkën, Naimin./
Dikur/ Dashuronte si Zhulieta/ Sot/ Më falni që e dashuroj/ Si Romeo/ Më
falni.” (nga poezia Rrëfim)*

Liriku e ka kuptuar se ka aq shumë gjëra për t’u zbuluar në botën e brendshme. Asnjë varg nuk vjen në formë thirrmore, por edhe as në mënyrë të pëshpëritur. Është një varg i fortë dhe i goditur, që kushdo mund ta dëgjojë dhe çdo mendje mund ta kuptojë. Fjala kërkohet me mund dhe përpjekje, për të kënaqur shijen e lexuesit. Gjëçbritaj me sigurinë dhe përvetësimin e mirë të ligjërimit poetik mbërrin të hyjë në thellësinë e formave të mëdha jetësore e shoqërore, duke na dhënë një përmasë pasqyrimi, ëndërrimi, si dhe një mesazh thellësisht njerëzor. Ndërgjegjësimi për rënien brenda kësaj përmasë të përvijuar, do të kuptohet si ai ishulli i vetmisë, në të cilin arratisen njerëzit që përjetojnë mundimet e artit.

*“Në këtë ishull/ Ëndrra është shpresë/ Krijohet mozaik./ Ky ishull është/
Bujtinë për udhëtarin e vonuar/ Ku qielli i hapur është strehë./ Këtu në
mbrëmje lind dashuria/ Për ëndrrat e bukura,/ Për hijet magjepse,/ Për
mallin e jetës së pashuar./ Këtu mbyllet në thellësi/ Rreth boshtit magjik
hareja./ Këtu në gjumë/ Me shpresë për nesër/ Udhëtari i vonuar/ E kalon
natën” (nga poezia Ishulli i shpresës)*

Në disa raste duke prekur me sy vargjet e përmbledhjes, na ngjan se gjendemi para një peizazhi dhe përjetojmë kënaqësinë nga gjëra që i kemi para syve tanë, futemi brenda kësaj bote imagjinare dhe komunikojmë me të.

“Anijet velbardha na bartin përtej detit/ Na shpërndajnë anë e kënd si era polenin/ Lotët që derdh qielli mbushin sytë e nënave/ Shpirtrat lahen nga loti i pastër/ Na duket se shkojmë në derë të paraajsës/ Në buzë që dridhen na është skalitur frika” (nga poezia Anijet velbardha)

Në këtë fjalë të parë për librin, qëllimisht nuk po ndalemi në pahnxjerrjen e vlerave të shprehësisë stilistikore, pasi nuk po pretendojmë t’i shterojmë idetë, apo t’i bëjmë atij një kritikë komentare. Megjithatë, kjo s’do të thotë se prej vargjeve të poetit të mos befasohemi nga përdorimi i bukur i metaforës, krahasimit, simbolit, asonancës, ndonjëherë edhe rimës e më së shumti edhe ritmit, përmes të cilit fjalët lidhen dhe tingëllojnë shumë bukur.

Ali Gjeçbritaj përdor vargun e lirë, por në disa raste nuk ngurron t’i japë muzikalitet poezisë përmes vargut të matur apo përdorimit të strofave, duke dëshmuar në këtë mënyrë përpjekjen krijuese, jo vetëm prej rrugëtimit të gjatë tematik, por edhe prej atij formal. Ai është rritur e burrëruar nga pesha e rëndë e moteve dhe e vargjeve.

Të gjithë ata lexues, që e duan dhe e përpijnë me dëshirë poezinë, do të vërejnë se njohja e mirë teorike e poetit për vargun shqip, nuk e ka zbehur aspak spontanitetin dhe origjinalitetin e veprës. Krejtësisht e kundërta ka ngjarë, magjia e këtyre vargjeve nuk është zvogëluar nga rrekja e vazhdueshme mjeshtrërore për t’i përpunuar ato.

Mund të theksohet se pesha e rëndë e mundimeve lirike tek “Motet” e poetit Ali Gjeçbritaj, jep po atë kënaqësi që sjell një punë e lodhshme, por shumë e dobishme.

2. Libri në prozë i Jaho Kollari “18+”

Jaho Kollari (autor nga Ulqini) është bërë i njohur më parë prej vëllimit me poezi “Poeti i mijëvjeçarit të tretë”. Libri në prozë “18+” duket i frymëzuar nga ngjarje apo ndodhi të jetës së vetë autorit, i cili sjell përshkrime të mrekullueshme referenciale për një zone etnike dhe një popullsi që nuk ka zënë akoma vendin e duhur në historinë tonë, në të njëjtën kohë përmes këtij libri shfaqet edhe kredoja e një krijuesi të dashuruar me vendlindjen. Shkrimi i tij me një stil të drejtpërdrejtë është i mbarsur me ndjenja të fuqishme, që e befasojnë dhe tërheqin lexuesin. Përmes këtij libri perceptohet shqetësimi, zemërimi dhe zhgënjimi i personazheve. Protagonistët e këtyre historive vënë në dukje një dobësi të madhe, ata kanë një ndjenjë thyerjeje shpirtërore që i bashkon dhe mbase kjo i bën edhe të veçantë. Titujt e copëzave tërheqin vëmendjen së bashku me datat e shkrimit të tyre: *Orkestra e çakorduar deri në vyshkje dhunonte*

një evergreen (2016); Efekti i topit të borës (1994); Homeri (1994); Secili pret radhën e vet të heshtjes (1997); Panelisti (1994); 18⁺ (1994); Lloftari (1994); Halli (1994); Genti (1998); Mbledhëtari (2006); Big Brother (1994); Eni (1990); Borxhi (1993); Bredhje pas identitetit, -njerk(ë)dheu i tretë Prolog; Mëmëdhe quetë toka; Epilog (2015); Zënka (1998); Valdanosi (1997); Gëzimi (2000); Dhunimi (2004); Trimëria (1999); Kalimerja (1998); Hafija (1999); Vrasja (1998).

Narracioni i Kollarit apo përmbledhja e tregimeve të tij ndjek disa hapa nga rrethana nistore e bashkëkohësisë “*Orkestra e çakorduar deri në vyshkje dhunonte një evergreen*”; duke kaluar tek një thyerje e ekuilibrit si tek “*Halli*”; “*Mbledhëtari*”; “*Big Brother*”; “*Eni*”; “*Borxhi*” etj., si dhe tek disa zhvillime ngjarjesh me personazhe të përfshira në peripeci përmirësimi apo përkeqësimi; tensioni rritet përmes elementeve rrëfimore dinamike tek: “*Zënka*”; “*Dhunimi*”; “*Trimëria*”; “*Kalimerja*”; “*Hafija*”; “*Vrasja*”. Ndërsa situata përfundimtare e strukturës së narracionit, ajo që do të duhej të ishte diku në mbyllje të librit, na shfaqet diku nga mesi i tij nën titujt: “*Bredhje pas identitetit, -njerk(ë)dheu i tretë*”; “*Prolog*”; “*Mëmëdhe quetë toka*”; “*Epilog*”.

Rrjedha e ngjarjeve dhe gërshetimi i tyre nuk i korrespondon logjikës dhe kronologjisë. Narratori shpesh na shfaqet në mes të ngjarjeve. Lëvizshmëria në boshtin kohor krijon efekt tek lexuesi në aspektin e gjallërimit të rrëfimit. Shpesh na ofrohen prolepsa përmes të cilave rrëfimtari na paralajmëron për ngjarje që do të vijnë më pas. Po citoj këtu **Zënka**: “*Atë mbrëmje pas një hezitimi të rëndë, i struktur në një qoshe të shtëpisë ku ndizte cigare pas cigaresh, Shaqë Mani zuri t'i rrëfej të shoqes dhe të birit se ç'kishte ndodhur sot atje në Mëhallë të Re:*

-Nuk di si do të bëhej puna e Demit. Atë që dëgjova sot nuk ishin isharetë të mira...

-Ç'ka ngjarë?!-pyeti me gjysmëgojë e shoqja e Shaqës.

-Mjaft dhe për së tepërmi. Kam frikë se ai djalë (fjala ishte për Demin) do ta marrë në qafë, në rend të parë veten dhe familjen e vet, e pastaj edhe tërë farefisin!

E shoqja e Shaqës u drodh pas këtyre fjalëve, kurse të birit kjo nuk i bëri përshtypje, meqë ishte hala i vogël ta kuptonte seriozitetin e situatës, por e ndiente me tërë qenien e tij tensionin psikik të prindërve.

Ndërsa disa faqe më pas, tek skica e titulluar “*Vrasja*” kemi: “*Kjo që ngjau, pra, vrasja e Demit, nuk qe diçka krejt e papritur për Shaqë Manin dhe farefisin e tij. Megjithatë, Shaqës i vajti zemra deri në fund të barkut nga brennga, por nuk u trishtua e tremb. Demi, vëllai i tij i vogël, kaherë*

ishte fërkuar vrazhdë me Selë Bajrakun. Zënka e tyre, pra, e kishte zanafillën qysh se Sela ishte vendosur në Ulqin.”

Pjesët rrëfimore u referohen ndodhive që përbëjnë historinë e ngjarjes dhe janë sekuenca të natyrës dinamike. Citoj nga Panelisti: *“Përparim Avashi ishte shndërruar në një vraposh të vërtetë dhe me një laps e bllok në dorë mbledhte mendimet nga publiku, siç i mbledhin topat ata vogëlushët rreth terrenit të tenisit. Tek e pa, Fitim Qederit iu mbërthye në ngërç buzagazi. Ky në asnjë mënyrë nuk mund ta pranonte shëmtinë t'i hajnohej zanati sy më sy.”*

Kollari ndërthur sekuenca përshkruese që lidhen me ambientin, personazhet, objektet, sjelljet domethënëse dhe që duken si sekuenca statike, por të tilla janë edhe sekuencat meditative, që ftojnë në rrëfim mendimet e personazheve ose të rrëfimitarit për ngjarjet. Citoj nga *“Prologu”*:

“Gjyshi im, ta zëmë, duke mos e larguar këmbën nga Ulqini, kishte qenë qytetar i nëntë shteteve!?! I lindur, pra, në Ulqin në fillim të viteve gjashtëdhjetë të shek. XIX dhe vdekur në po të njëjtin qytet në fund të viteve katërdhjetë të shek. XX, ai ishte qytetar i Perandorisë Osmane, i Malit të Zi, i Austro-Hungarisë, i Mbretërisë SKS, përkatësisht, Jugosllavisë mbretërore, pastaj i Italisë, Gjermanisë, përkatësisht, Shqipërisë dhe, në fund, i Jugosllavisë komuniste!

Babai im kishte përjetuar Austro-Hungarinë, Mbretërinë SKS, Jugosllavinë e midis Luftërave Botërore, Italinë, Gjermaninë, Shqipërinë dhe, në fund, Jugosllavinë e pas Luftës së II-të. Pra, edhe ky ishte shkapetur nëpër shtatë shtete, pa e larguar çapin prej qytetit të lindjes!

Unë për veten time, kisha lindur në Jugosllavinë e pasluftës, ku isha rritur e shkolluar (pjesërisht), pastaj shkolluar dhe pjekur në Jugosllavinë e pastitos, pata përjetuar edhe një Jugosllavi të tretë, të ashtuquajtur, federale, me dy njësi, ku njëra ishte bërthama dominuese, e tjetra një satelit lozonjar dhe qesharak sa s'bën më. Që e gjithë kjo të mos mjaftojë (pra, të qenit qytetar i disa shteteve pa e larguar këmbën nga vendlindja) unë vajta një hap më tej: e braktisa qytetin tim në fillim të viteve nëntëdhjetë të shek. XX. Tani ia nis, pra, shtjellimi i ngjarjes, si dhe rikthimi i problematikës së shpërnguljeve individuale e kolektive, braktisjeve dhe ekzoduseve, hemorragji, kjo, që vazhdon sot e gjithë ditën.

... Çudi e Zotit dhe e robit që ne u shkullëm të gjallë nga ai lokal gjakpirësish dhe një ditë më vonë u larguam nga shteti i ëndërrave boshe.”

Alternimi i dialogut dhe përshkrimit përbën ritmin e rrëfimit. Vlen të theksohet se në tekstin e Kollarit nuk ka një rregullsi apo një ndarje të saktë se ku duhet të fillojë njëra dhe ku duhet të mbarojë tjetra. Është e

rëndësishme të kuptohet se pas rrjedhës së ngjarjeve të historive që tregohen, fshihet një stil i mirë narrativ.

Një tjetër përbërës që është për t'u shënuar tek ky tekst letrar është aspekti kohor. Narratori nuk rrëfen ngjarjet në rrjedhën si ata ndodhin, por përdor teknikën e analepsës dhe prolepsës. Në planin e gjatësisë kohore ai operon me teknikën e përmbledhjes përmes shkurtimit të kohës së rrëfimit përballë kohës së ngjarjes. Citoj nga teksti i titulluar “Eni”: *“Kaloj edhe ky sezon. Turizëm s'pati aq shumë. Pati, megjithatë, mjaft fjalë të këqia, rrena, mashtrime, hajni, kurvni, punë tjera të ndyra...”*

Personazhet e Kollarit qëndrojnë dhe përzihen në kufirin mes tipave të personazheve që përshkruhen nga narratori nga një pikëvështrim i jashtëm dhe nga personazhe ku narratori jep hua pikëvështrimin e tij. Gjendja e personazhit të Kollarit nuk ka kohë dhe hapësirë. Një njeri i nëpërkëmbur në shumë pikëpamje, me një ankth të vazhdueshëm, i përjashtuar dhe i padobishëm. Kjo prozë karakterizohet nga një stil pa asnjë lloj zbukurimi. Tek kjo prozë ndeshim tjetërsimin e njeriut të sotëm nga ritmet e jetesës sipërfaqësore.

Duhet bërë një ndarje midis autorit dhe narratorit, të cilit i është dhënë e drejta të rrëfijë. Shpesh narratori di aq sa dinë edhe personazhet e tij. Ai identifikohet me personazhe të ndryshëm dhe pozicionohet sipas këndvështrimit të tyre, duke u përfshirë kështu brenda historisë. Në këtë rast mund të flasim për fokalizëm të brendshëm, i cili përqendrohet më shumë tek analizat e ndërgjegjes. Tek “18+” parakalojnë personazhe që përgjatë viteve dalin me të njëjtat emra dhe të njëjtat karakteristika në faqet e këtij rrëfimi. Janë disa njerëz që nuk po arrijnë të jenë me hapat e kohës dhe qëndrojnë mënjane në kthina apo periferi të ngjarjeve.

Mbase është me vend opinionin e ngritur se fundmi në shtyp për sistemin letrar shqiptar, nga ku duket se brenda këtij sistemi letërsia shqiptare e diasporës ka krijuar një profil të saj, që nuk është ndikuar shumë nga letërsia që bëhet në Tiranë dhe në Kosovë.¹ Në këtë kontekst duhet ta shohim apo ta soditim pa asnjë kompleks edhe krijimtarinë e Jaho Kollarit, duke e veçuar si një tekst letrar të spikatur.

Autori do t'u lërë një mesazh atyre që do ta lexojnë. Citoj: *“Duke kundruar situatën nga një këndvështrim asnjëherës, por me një lidhshmëri shpirtërore, kam vënë re se, në këtë çerek shekulli, prej arratisjes sime dhe prej kohës së shpërbërjes së njëmendizmit politik, trevat etnike, sidomos Ulqini me rrethinë, kanë ecur një hap para e dy prapa! Ky konstatim i imi,*

¹ Shih: Ndoja, Leka: “Pse vuan letërsia e diasporës në ditët tona?!”, Gazeta Shqiptare, e diel, 15 maj 2016.

lexuesve do t'i bëhej më i qartë dhe më i plotësuar, sa më tepër që t'i depërtohej në thelb kësaj shkrese. Meqë, gjatë këtyre 25 vjetëve, është lindur dhe rritur një brez, i cili, po e gjitha të shprehej në një mënyrë figurative, gjendej midis dy brigjeve, në një anije që lundron në një det të shqetësuar. Njërin breg e kishte braktisur qëmoti, por kurrsesi të arrihej ai tjetri, për t'u ankoruar barka dhe të zbarkohen në një tokë të premtuar.”

Teksti letrar i Kollarit qoftë me elementet biografike, historike, filozofike apo imagjinare, na ripohon se fjala e thjeshtë, që vjen përmes këtij libri, është e vërtetë për nga ndjeshmëria, ironia dhe bukuria.

3. “Bekim Fehmiu”, një monografi për Uliksin shqiptar



“Bekim Fehmiu: Odiseu i Kosovës” titullohet monografia e gazetarit të njohur Fahri Musliut. Ky libër sjell të botuara për lexuesin tekste, metatekste, foto të rralla, vlerësime të hapësirës shqiptare, ballkanike dhe botërore për figurën e aktorit Bekim Fehmiu. Nën këtë titull vijnë konsiderata me vlerë të kineastëve, aktorëve, regjisorëve, akademikëve, gazetarëve, kritikëve nga mbarë bota e artit dhe e kulturës. Autori Fahri Musliu me

“përvujtninë” e tij prej studiuesi, na shfaqet si një prej hulumtuesve më të shquar të jetës dhe veprës së Bekim Fehmiut. Nga kjo vepër studimore mund të citojmë disa rreshta që bëjnë përshtypje nga parathënia e titulluar “*Ne i kemi borxh Bekimit*”.

“Bekimi ka qenë një shqiptar i madh në çdo aspekt, dhe mbi të gjitha njeri dhe intelektual i madh. Dhe atdashedashurinë e tij e ka dëshmuar me rezultate konkrete duke e shkruar emrin e shqiptarit me shkronja të arta në majat e kinematografisë botërore. Bekimi si aktor nuk i ka takuar askujt, por miliona adhuruesve, ai i takon tërë botës siç u takojnë edhe të gjithë artistët e tjerë...”

Kjo qasje e sinqertë ndaj figurës së Bekim Fehmiut është një nga më tërheqëset në mbarë historinë e monografive biografike shqiptare. Dëshira për të komunikuar me një lexues sa më të gjerë e bën veprën studimore të Fahri Musliut një shembull domethënës për kërkuesit shkencorë, të rinj apo me përvojë qofshin.

Bekim Fehmiu do të mbahet mend gjatë për role të larmishme në filma, si: “Mbledhësit e puplave”, “Aventurierët”, “Dezertori”, “Java e zezë”, “E dashura ime Libera”, “Salon Kiti”, “Leja për vrasje”, “Xhinxhis Kan”, “Protesta”, “Edukata speciale” etj., por pa harruar shkëlqimin në

rolin e Uliksit tek seriali i famshëm “Odisea”.

Përmes këtij libri na rrëfëhet se Bekim Fehmiu ia doli si star kinemaje të fitonte dashurinë e miliona spektatorëve, të cilët sigurisht panë tek personazhi i tij diçka që kishte kuptim për të gjithë, diçka që shkon përtej caqeve të tërheqjes vetjake ose të artit vetjak.

Për ilustrim mund të bashkëndahet një mendim i shkrimtarit të njohur bashkëkohor triestin, Claudio Magris, i nyjëtuar në një veprimtari promovuese në Universitetin e Shkodrës, i cili duke prezantuar veprën e tij “Danubi” do të shprehej: *“Besoj që për të treguar se si kanë lindur disa prej librave të mi, është thelbësore të nisesh nga përvoja që unë kam me kufirin. Tek “Danubi” kam bërë atë që kam mundur. Jeta është realisht një udhëtim dhe “Danubi”, bëhet romani i një personazhi në të cilin gjej vetveten, jo vetëm duke u zhytur në botën e brendshme, por edhe duke dalë jashtë saj për të gjetur botën që na rrethon”*.

Do të shtoja se pyetja e madhe që shtrohet është nëse individi mund ta përshkojë jetën e tij duke u rritur pozitivisht, si dhe duke ruajtur vetveten. Në këtë mënyrë udhëtimi na shërben për t’u kthyer në shtëpi duke konfirmuar personalitetin tonë. Motivi i udhëtimit në veprat më domethënëse të letërsisë botërore do t’ju ndërmendë pa dyshim edhe Odisenë e Homerit. Mrekullisht Odisea i letërsisë është përjetësuar në celuloid nga Bekimi ynë, i cili me jetën e tij dëshmoi se është një thyrës i madh i kufijve.

“Karriera e Bekim Fehmiut, - shkruan Marko Kostiq në librin që u prezantua, - ndoshta është përshkrimi i drejtë i karakterit shqiptar, i atij që kur njëherë arrin rezultatin e dëshiruar, i ofron shkëlqimin reflektues edhe serbëve, jugosllavëve, romakëve dhe amerikanëve”.

Bekim Fehmiu është i vetmi aktor që në Perëndim ka xhiruar mbi 20 vjet duke thyer “perden e hekurt”, thuhet në këtë libër. Ai e ngriti interpretimin dhe artin e tij mbi politikën, e cila si pjesë e njëmendësisë ballkanase shumë shpesh i ka bërë “karshillëk” artistëve të sojit të tij. Aktori ishte protagonist i kulturave të hapura, besnik i sferës së lirisë, që arti predikon. Sa shumë stonon rrugëtimi i tij real dhe fantastik, me ecajaket tona brenda njëmendësisë ballkanike. Aty ku ndërkombëtarizohen ligësitë dhe prapësitë e një politike të mbrapshtë, natyrisht nuk ka vend për artistin vetmitar.

Vetë titujt e artikujve të mbledhur anembanë janë shumë tërheqës, por jo më pak të tillë janë edhe nyjëtuesit e këtyre mendimeve, të cilët i përkasin qiejve të artit dhe shmangin me dashje dhe me përçmim fobinë ndaj të huajit. Do ta vlerësoja këtë libër pikërisht edhe për këtë lloj

dialogjizmi në diskurs. Ai është në koherencë të plotë me strategjinë jetësore të personazhit-aktor, Bekim Fehmiut, i cili me udhëtimin e tij prej Uliksi në këtë botë, na rrëfeu se arti dhe kultura depërtojnë dhe nuk ka forcë fizike që t'i ndalojë.

Një nga artikujt e përfshirë në monografi dhe që përkëdhel vëmendjen shkodrane, është edhe ai i Besi Bekteshit me titull: *“Kur Bekimi e vizitoi Shkodrën”*. Bëhet fjalë për vitin 1972, ku na dëshmohej një shënim i Bekim Fehmiut në fletët e muzeut të atëhershëm: *“Jam i lumtur që mbas 30 vjetëve gjendem në Shkodër, në qytetin ku kam kaluar vitet e para të fëmijërisë sime, rrënjët kishin qenë të thella dhe të pashpërngulta”*.

Studimi voluminoz dhe shterues i autorit Fahri Musliu për kontributin e vyer të Bekim Fehmiut në kinematografinë botërore i ka pa dyshim refleksionet edhe për kulturën shqiptare. Vepra e tij përbën një nga shtyllat e burimeve bibliografike për këtë aktor të famshëm.

“Odiseu iu kthye Itakës. Bekimi u nis nga Prizreni në vitin 1956, në ujërat e panjohura e arriti kulmin në profesion dhe u bë njëri nga aktorët më të mëdhenj shqiptarë të të gjitha kohërave, me përmasa botërore...E luajti aktin e fundit të dramës që quhet jetë, por prapa perdes, pa publik: skenarist, regjisor dhe aktor kryesor i së cilës ishte ai vetë. Dhe sërish u kthye në Prizren, në urnën me hirin e trupit të tij që, sipas dëshirës së tij, të hidhej në lumin Bistricë, përmes tij do të derdhej në Drin e Bunë dhe do të arrijë në Detin Adriatik, në Jon e Egje për të vazhduar më tej nëpër Mesdhe, Oqeanin Atlantik e ujërat e tjerë të botës. Nuk ishte i askujt ekskluzivisht, ka qenë i vetvetes dhe i secilit...Odiseu iu kthye Itakës: Ujit, Dheut dhe Qiellit të Prizrenit të cilin e ka dashur aq shumë... Ishte kjo estetika e jetës dhe e vdekjes së aktorit të madh...Mbeti heshtja me të cilën Bekimi ka jetuar gjatë 20 vjetëve të fundit. Dhe kujtimi i amshueshëm. ”

Kjo monografi, e konceptuar dhe e shkruar me kaq shije, është një akt dorëzanie për përjetësimin dhe ndriçimin e këtij ylli të kinemasë shqiptare e botërore.

BIBLIOGRAFI:

- GJEÇBRITAJ, Ali: “Motet” (përmbledhje me poezi), Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore, Podgoricë, 2021, 138 f.
- KOLLARI, Jaho: “18+” (prozë), Shtëpia botuese “Didi&Oli”, Ulqin, 2016, 131 f.
- MUSLIU, Fahri: “Bekim Fehmiu: Odiseu i Kosovës” (monografi), Shtëpia Botuese Siprint, Prizren, 2015, 605 f.
- MAGRIS, Claudio: Danubi, Shtëpia Botuese “Albas”, Tiranë, 2016, 432 f.

Literary and study feed by albanians overseas***ABSTRACT***

“Motet” by the poet Ali Gjeçbritaj is a collection of poems written in different times and. They are verses of an existential journey, where events, be they big or small, are intertwined with joy, love, memories, failures.

The prose book “18+” of Jaho Kollari seems to be inspired by events or happenings of the author’s own life. His writing is in a straightforward style and imbued with powerful feelings. Through this book, the reader perceives the anxiety, anger and frustration of the characters.

“Bekim Fehmiu: Odiseu i Kosovës” is the title of the monograph of the well-known journalist Fahri Musliu. This book brings the reader published texts, metatexts, rare photos, assessments of the Albanian, Balkan and world space concerning the character of the actor Bekim Fehmiu. Concerning this title, valuable considerations of filmmakers, actors, directors, academics, journalists, critics from around the world of art and culture are given.

Sokol AXHEMI

GJEOGRAFIA SOCIALE DHE POLITIKAT SOCIALE NË KUADRIN E PANDEMISË COVID - 19 NË SHQIPËRI

Hyrje

Optika studimore e tematikës sociale në gjeografi është jo vetëm e larmishme, por edhe mjaft dinamike. Shkolla të ndryshme gjeografike evropiane, amerikane dhe më gjerë vlerësojnë larmishmërinë dhe dinamikën e tematikës sociale ndikuar nga vetë zhvillimet që pësojnë raportet sociale në shoqëri të caktuara. Një gjë e tillë shkon sinkron zhvillimeve që pësojnë në tërësinë e tyre hapësira sociogjeografike, grupet sociale, vendet sociale dhe funksionet sociale respektive. Zhvillime të tilla janë mjaft aktive dhe dinamike në njësi të ndryshme administrative, shtete, regjione, apo edhe në aspektin global. Krahas tyre mjaft intensive paraqiten edhe problemet sociale që shfaqen, bashkëshoqëruar edhe me efektet e tyre, sidomos në grupet e shumta sociale, të cilët janë aktivë dhe veprojnë me qasjet e tyre të ndryshme, nën ndikimin e faktorëve gjeografikë, ekonomikë, socialë, politikë etj. Mjaft të theksuara dhe me ndikim evident dhe tepër të shprehur në grupet sociale, paraqiten këto probleme sociale në situata të veçanta në aspektet globale dhe lokale në hapësira të ndryshme sociogjeografike.

Në këtë këndvështrim ndikuar nga shfaqja e Pandemisë Covid -19 në 2020-2021 në aspektin global, veçanërisht e evidentuar në vendin tonë, kemi synuar të paraqesim disa konsiderata tona shkencore në kuadrin e Gjeografisë sociale. Në mënyrë të përgjithshme, jemi fokusuar në nevojën dhe domosdoshmërinë e aktivizimit dhe dinamizimit të politikave të ndryshme sociale, referuar grupeve sociale në rrisht apo të prekura nga kjo Pandemi Covid - 19. Kemi tentuar në mënyrë të veçantë të orientohemi në analizën tonë drejt grupeve sociale në rrisht të hapësirës sociale të vendit tonë, pasi edhe efektet bashkëshoqëruese janë paraqitur mjaft sensitive, duke krijuar mjaft probleme sociale.

Grupmosha të ndryshme të popullsisë u afektuan nga kjo situatë e pazakontë. Një gjë e tillë ishte mjaft e pranishme (në mënyrë të veçantë

mosha e tretë dhe të rinjtë), kategori të caktuara sociale në fushën e arsimit (nxënës, studentë, mësues, pedagogë); shëndetësisë (pacientë, mjekë, infermierë, sanitarë); ekonomisë (punëtorë, biznesmenë); grupe sociale të marginalizuara etj., u përfshinë nga problematika mjaft shqetësuese të karakterit social, ndaj të cilave shprehet nevoja dhe domosdoshmëria e ndërhyrjes me anë të politikave të ndryshme sociale.

Një panoramë e tillë në kuadrin e analizës gjeografike sociale është tentuar të realizohet duke u fokusuar pikërisht tek aktivizimi i politikave sociale nga ana e funksionit social të pushtetit. Tendencat e aktivizimit të këtyre politikave sociale, sidomos në grupet sociale të moshës së tretë, të të rinjve, në arsim, shëndetësi dhe shtresat e marginalizuara paraqiten nga studiues të ndryshëm të shkollave ndërkombëtare të Gjeografisë sociale, si hapat e nevojshëm në situatat e shfaqjes së problemeve të tilla akute sociale. Sugjerimet dhe rekomandimet tona synojnë orientimin e zhvillimeve pozitive në hapësirën sociale të vendit tonë, me ndikim të drejtpërdrejtë në tërësinë e grupeve sociale, që ndjenë peshën dhe rrezikun e pranisë së këtyre problemeve sociale.

Pandemia Covid - 19 dhe problemet sociale të shfaqura.

Ashtu si në aspektin global, edhe në Shqipëri, padyshim që situata e pandemisë Covid - 19 ka shfaqur një sërë problematikash të karakterit social, me efekte të ndjeshme sociale në grupet dhe kategoritë e ndryshme sociale të popullsisë. Hapësira sociogjeografike e vendit tonë u ndje nën këto efekte sociale, që në fillimet e marsit 2020, ku në mënyrë graduale shpërndarja gjeografike e rasteve përfshiu tërësinë e njësive administrative të vendit, ndonëse rastet më të shfaqura ishin dukshëm në qytetet e mëdha. Më poshtë po paraqesim një evolucion të të dhënave statistikore, të paraqitura në periudha të ndryshme nga ana e buletineve informative të Ministrisë së Shëndetësisë në vendin tonë.

Periudha	Testimet e realizuara	Rastet e konfirmuara	Nr.vdekjeve	Nr.pacientëve në spitale
31.03.2020	1671	243	15	77
31.08.2020	820	133	4	225
30.12.2020	2681	581	4	285
28.02.2021	3805	952	21	662
8.05.2021	4516	89	3	99

Tabela 1. Të dhëna statistikore mbi situatën e Covid - 19 në periudha të ndryshme. Burimi MSH.

Zhvillimi dhe evolucioni i kësaj pandemie Covid - 19 u shoqërua me ndikime të drejtpërdrejta dhe të shumanshme në jetën dhe jetesën e popullsisë, në aktivitetet ekonomike dhe sociale të tyre, në fushën e shërbimeve, në kufizimin e mjaft prej funksioneve themelore sociale (siç ishin ato të banimit, prodhimit, shkëmbimit, argëtimit).

Në kuadrin e këtyre problematikave të shfaqura duhet të vlerësojmë ndikimin mjaft të shprehur në drejtim të grupeve të veçanta sociale të popullsisë, siç ishin moshat e treta dhe të rinjtë, si dhe shtresat e marginalizuara, të cilat ndjenë shumë shpejt peshën e përballjes me situata mjaft të vështira, sidomos në aspektet sociale, ekonomike, psikologjike etj. Nga ana tjetër situatat e shfaqura shëndetësore ndikuan mjaft në fushat e arsimit dhe të shëndetësisë, lidhur ngusht me grupet sociale respektive që janë të pranishme në hapësirën sociale të këtyre fushave. Sektori i ekonomisë ishte ndër më të prekurit, gjë që ndikoi shumë në lindjen dhe zhvillimin e mjaft problemeve sociale, siç ishin papunësia apo mbyllja e vendeve të punës, falimentimi i bizneseve, sidomos biznesit të vogël, vështirësitë financiare nën peshën e detyrimeve të ndryshme të karakterit fiskal e bankar, mosplotësimin e detyrimeve kontraktuale në marrëdhëniet me partnerët në vendet e ndryshme të botës nga kompanitë e mëdha vendase dhe të huaja që realizojnë aktivitetet e tyre ekonomike në Shqipëri etj. Më poshtë po mundohemi në mënyrë analitike të paraqesim disa nga momentet kryesore shqetësuese me pasoja të rëndësishme sociale në tërësinë e këtyre grupeve dhe kategorive sociale, të cilat ndjenë peshën dhe efektin e Pandemisë Covid - 19.

Moshat e treta të popullsisë të vendit tonë, ashtu si edhe ato në rang global, në bazë të informacioneve shkencore shëndetësore ishin moshat më të riskuara në kuadrin e kësaj Pandemie Covid - 19. Efektet kryesore sociale me të cilat ato u shoqëruan paraqiten kryesisht: në kufizimin total të lëvizjes së tyre (izolim), pamundësisë për të kryer aktivitetet e tyre të përditshme, humbjet e jetës, përkeqësim të treguesve shëndetësorë e deri diku jetësorë, kufizim të funksioneve të tyre sociale etj. Tregues të tillë e shfaqën këtë grup social si mjaft të ekspozuar dhe tepër të evidentuar ndaj domosdoshmërisë nga ana e funksionit social të pushtetit, për të ndërtuar një qasje të shpejtë sociale ndaj tyre. Një ndërhyrje e shpejtë do të barte në vetvete qëllimin e kufizimit në minimum të problematikës sociale ndikuese në jetesën e mirëqenien e tyre. Vlerësojmë se në kuadrin e peshës specifike të tyre në tërësinë e popullsisë së vendit tonë, ato zënë një vëllim të konsiderueshëm, me shpërndarje gjeografike mjaft të gjerë në kuadrin e njësive administrative të Shqipërisë. Theksojmë se ndikuar edhe nga

fenomenet migrative mjaft të përhapura në vendin tonë, një pjesë e moshës së tretë jetojnë pothuajse të vetmuar, për faktin e largimit të fëmijëve të tyre në vende të ndryshme evropiane dhe me gjerë. Nga ana tjetër kufizimi i lëvizjes së lirë për moshat e treta shfaqte edhe problematika të furnizimit me mjetet e domosdoshme për jetesë dhe ato të karakterit shëndetësor.

Një grup tjetër social mjaft i ekspozuar ndaj Pandemisë Covid - 19 ishin edhe të rinjtë. Problemet sociale me të cilat ato u përballën ishin të orientuara nga dimensionimi i gjerë i funksioneve të tyre sociale, si në aspektin e banimit, prodhimit, shkëmbimit dhe argëtimit. Mbyllja e institucioneve arsimore nga njëra anë për të gjithë ata të cilët ndiqnin ciklet e ndryshme të shkollimit, kufizimi dhe mbyllja e aktiviteteve prodhuese dhe të fushës së shërbimit, në të cilin ishte punësuar një pjesë e grupit social të të rinjve nga ana tjetër, derivuan edhe me izolimin e zgjatuar e më pas me kufizimet e funksionit social të pushtetit, ndikuar nga situatat e zhvillimit të Pandemisë Covid -19 në Shqipëri. Tërësia e këtyre masave ndikoi dukshëm në lindjen dhe zhvillimin e mjaft problematikave sociale të ky grup social mjaft dinamik dhe tepër aktiv në hapësirën sociogjeografike të vendit tonë. Në mënyrë të veçantë problemet kryesore ishin më të ndjeshme në fushën e arsimit, të punësimit dhe krijimit të të ardhurave, si dhe të argëtimit dhe komunikimit brenda vetë grupit social, me njëri -tjetrin dhe jashtë tij. Situata të tilla problematike u vunë re kudo në vend, por në aspektin e shpërndarjes gjeografike ato u ndjenë më shumë në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Vlorë, Shkodër, njësi administrative, në të cilat vihet re edhe një përqendrim më i madh i popullsisë dhe me prezencë të institucioneve universitare brenda shtrirjes territoriale të tyre. Njëkohësisht, një ndikim të konsiderueshëm patën edhe problematikat sociale të shfaqura, të cilat ishin më akute, sidomos në zonat rurale në raport me zonat urbane, ndikuar nga tiparet e zhvillimit ekonomik, social dhe infrastrukturor me të cilat ballafaqohen zonat rurale.

Në mënyrë konkrete, në fushën e arsimit, disa nga problemet themelore sociale më të shfaqura ishin ballafaqimi i grupit social të të rinjve me platformat online të të mësuarit. Platforma të tilla, gjithnjë e më shumë po bëheshin aktive edhe në aspektin global, ndikuar nga situata e Pandemisë Covid - 19. Mungesa e një eksperience të tillë në vendin tonë, aksesimi i kufizuar në mbulimin me internet të njësive administrative të ndryshme të Shqipërisë, kufizimi në tërësinë e mjeteve dhe pajisjeve që duheshin për realizimin e kësaj forme mësimdhëniejeje (telefon, tablet, laptop, kompjuter), niveli i kufizuar ekonomik i mjaft prej familjeve shqiptare për qasjen e fëmijëve të tyre në këtë format të ri të të mësuarit, paraqiten si ndër problematikat kryesore dhe themelore që grupi social i të

rinjve u ndesh gjatë kësaj periudhe Pandemie Covid 19, në fushën e arsimit.

Në aspektin e funksionit social të prodhimit, grupi social i të rinjve u ndesh më një problematikë sociale mjaft shqetësuese. Mbyllja e aktiviteteve ekonomike dhe të fushës së shërbimeve, ndikoi në humbjen e vendeve të punës nga mjaft të rinj e të reja. Një gjë e tillë u shoqërua me një ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e këtij grupi social, por edhe të familjeve të tyre, duke marrë në konsideratë situatën ekonomike të familjeve shqiptare. Gjithashtu, një pjesë e grupit social të të rinjve, ishte i pranishëm në qendrat e mëdha urbane të vendit, si: në Tiranë, Durrës, Vlorë, Fier, Elbasan, Shkodër etj., realizonin në mënyrë të dyanshme: shkollimin dhe punësimin, gjë që ishte e shoqëruar ng ata edhe me prenotimin e mjaft vendeve sociale të banimit në këto qendra urbane. Një gjë e tillë rriti në mënyrë direkte problemet sociale me të cilat ky grup social duhej që të përballej në aspektin e vështirësive të shumta ekonomiko-financiare që u shfaqën para tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme.

Funksioni social i argëtimit, padyshim që përfaqëson një nga funksionet themelore të grupit social të të rinjve kudo në aspektin global. Kufizimet që ndodhen në jetën normale në vendin tonë, izolimi disamujor, mungesa e frekuentimit të mjaft prej vendeve sociale (bare, restorante, pube, disko, palestra, salla koncertale, kinema, teatro, pallate sporti, stadione etj.) çënoi elementet rekreative argëtuese të këtij grupi social. Situata të tilla bënë të mundur edhe shfaqjen e problematikave të sjelljeve sociale të tyre, mbylljen në vetvete, mospërshtatjen me situatat e reja, stresin, që u evidentua në mënyrë periodike nga specialistë të fushës, sidomos sociologët dhe psikologët.

Grupet sociale të mësuesve dhe të pedagogëve shfaqën problematikën e tyre në këtë situatë pandemie. Vlerësojmë humbjet e jetëve të disa mësuesve dhe pedagogëve nga sistemi arsimor parauniversitar dhe ai universitar, rrishtu i sëmundshmërisë për shkak të kontakteve që realizonin në procesin mësimor të përditshëm për shkollat funksionale me mësim në klasë, mungesa e eksperiencës në formatet e reja online, problematikën në realizimin efektiv dhe cilësor të mësimdhënies, qasja më e kufizuar drejt metodave të mësimdhënies, mungesa e pajisjeve efikase të të teknologjisë etj., janë disa nga elementet problematike, ndër më spikaturit me të cilat u ndesh ky grup social.

Mjaft shqetësuese dhe problematike në kuadrin e kësaj pandemie Covid - 19 u paraqit sidomos fusha e shëndetësisë në vendin tonë. Mungesa e mjeteve të duhura për diagnostikim e mjekim, nënfinancimi i sektorit të shëndetësisë, momenti në të cilin u shfaq një pandemi e papritur e tillë, e

panjohur që qëndronte në lidhje me ecurinë e saj dhe tiparet specifike bashkëshoqëruese, kapacitetet e kufizuara mjekësore, sanitare e hospitalore, ishin disa nga problematikat sociale me të cilat u përball sistemi ynë shëndetësor. Grupet sociale dhe kategoritë sociale që ishin apo u bënë pjesë e kësaj hapësire sociale, në mënyrë të veçantë (mjekët, pacientët, sanitaret, infermierët etj.) u afektuan nga kjo situatë duke reflektuar edhe efekte të ndryshme sociale. Rreziku në përballjen ndaj kësaj Pandemie Covid - 19, humbjet e jetës, lodhja, shqetësimet individuale dhe familjare, problematikat e funksionimit të sistemit, ishin disa nga efektet sociale, që shfaqnin grupet sociale të mësipërme, të cilat ndjenin drejtpërdrejt nevojën dhe domosdoshmërinë për ndërhyrje.

Spektori i ekonomisë ishte ndër më të prekurit nga kjo Pandemi Covid -19 në vendin tonë. Mbyllja e aktiviteteve ekonomike, punishteve apo ndërmarrjeve të ndryshme, mbyllja e mjaft bizneseve kryesisht pjesë e biznesit të vogël, kufizimi i raporteve prodhuese dhe marrëdhënieve kontraktuale eksport-import, pati ndikim të dukshëm në grupet sociale dhe kategoritë sociale të këtij sektori. Humbja e mjaft prej vendeve të punës apo kufizimi i tyre në bazë të protokolleve shëndetësore, krijoi mundësinë e zgjerimit të shkallës së papunësisë në vend. Nga ana tjetër, kategoritë sociale të biznesmenëve dhe prodhuesve u përfshinë në problematika sociale, që kishin të bënin me raportet dhe bilancet e tyre bankare e fiskale, gjë që nuk i ndihmonte ata për të gjeneruar mundësi për mbështetjen ndaj punonjësve të tyre. Një pjesë e këtyre bizneseve u përfshinë nga falimentimi gjë që ishte mjaft e shprehur kryesisht në njësitë kryesore administrative urbane të vendit. Njësitë administrative që e patën një kosto të tillë ekonomike gjatë kësaj periudhe ishin Tirana, Durrësi, Shkodra, Fieri, Korça, Elbasani.

Politikat sociale. Aktivizimi dhe dinamizimi i tyre.

Tërësia e problemeve sociale dhe efekteve bashkëshoqëruese sociale të paraqitura në çështjen e mësipërme, ndjenë nevojën dhe domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave të caktuara, të cilat duhet të përfshihen në kuadrin e një plani aktiv e tepër dinamik të politikave sociale. Në aspektin shkencor teorik, Gjeografia sociale në kuadrin e objektit të saj shkencor, ndër të tjera, evidenton si një nga detyrat studimore të saj, pikërisht politikat sociale. Madje studiues të ndryshëm gjeografë, që kanë hulumtuar raportet sociale, problemet sociale dhe efektet e tyre, vlerësojnë rolin dhe kontributin e politikave sociale. Nëpërmjet aplikimit të tyre kufizohen problematikat e shfaqura, minimizohen efektet sociale në hapësirën sociogjeografike dhe grupet sociale, orientohen drejt zhvillimeve

pozitive tendencat e shprehura në drejtim të raporteve sociale, hapësirës sociogjeografike, grupeve sociale, vendeve apo funksioneve sociale. Njëkohësisht nëpërmjet aplikimit të politikave sociale bëhet e mundur shfaqja e mundësive perspektive pozitive të situatave sociale të grupeve sociale përbërëse të një njësie të caktuar administrative, shteti apo regjioni specifik.

Nën këtë optikë synojmë edhe ne të paraqesim një këndvështrim të aplikimit të politikave sociale nën shfaqjen e Pandemisë Covid - 19 në vendin tonë, të marra në studim gjatë periudhës mars 2020 - maj 2021. Ndërrhyrja e funksionit social të pushtetit u shpreh në kuadrin e masave të ndërmarra në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe të ekonomisë, me efekte të shfaqura edhe në kuadrin e aktivitetit të grupeve të ndryshme sociale, të cilat u prekën nga Pandemia Covid - 19, në forma dhe dimensione të ndryshme. Aplikimi i këtyre masave u evidentua si në drejtim të suporteve ekonomike, ndonëse të kufizuara, ashtu edhe të aktivizimit të masave të tjera të karakterit social, ekonomik, sidomos për grupet sociale në nevojë, shtresat e marginalizuara, punonjësit e kategorive dhe të sektorëve të ndryshëm, për bizneset e vogla etj. Gjithashtu u vu re në mënyrë graduale një rritje në fushën e investimeve në shëndetësi me fokus masat shëndetësore ndaj mbrojtjes së popullatës nga Pandemia Covid - 19. Patjetër, që në momentet e analizës së ekspertëve të fushave të ndryshme në lidhje me këto masa, janë të pranishme aprovimet dhe disaprovimet, mbështetjet dhe kundërshtitë, ndikuar edhe nga raportet politike prezente. Gjithsesi një debati të tillë publik mund t'i shërbente mjaft mirë një transparencë që mund të bëhej në lidhje me masat e ndërmarra, suportet financiare dhe zërat përkatës nga ana e funksionit social të pushtetit.

Masat e ndërmarra	Politika sociale e aplikuar	Grupi social përkatës
VKM.nr.236,dt.19.3.2020	Asistencë e shtresave në nevojë	moshat e treta, shtresat e marginalizuara
VKM 254,dt.27.3.2020	Ndihma financiare (paga e luftës)	punonjësit e punësuar dhe me asistencë
VKM.nr.207, dt. 10.03.2020	Bonus financiar në shëndetësi	sanitare, infermiere, mjeke
VKM nr. 371, dt. 06.05.2020	Bonus financiar	personeli i institucioneve të

		përkujdesjes shoqërore
VKM nr. 608, dt. 27.07.2020, e ndryshuar	Punësimi i individëve	Personat e dalë të papunë gjatë periudhës së pandemisë
VKM nr.908, dt.18.11.2020	Rimbursimi i ilaçeve covid-19	pacientët
VKM nr. 856, datë 4.11.2020	Ndihmë financiare	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Tabela Nr.2. Aplikimi i politikave sociale ndaj grupeve sociale sipas masave përkatëse (S.Axhemi).

Në fushën e arsimit masat e marra në mënyrë konkrete në radhë të parë për të realizuar një siguri të shëndetit të nxënësve dhe studentëve aktivizuan ashtu si edhe në kuadrin global mësimin online dhe të kombinuar online dhe në klasa për cikle të ndryshme të shkollimit. Për t'i ardhur në ndihmë në mënyrë të veçantë ciklit parauniversitar u realizuan mësimet aktive në median vizive. U ofruan platforma të ndryshme dhe dinamike për të nxitur forma të ndryshme të komunikimit ndërmjet mësuesve dhe nxënësve. Në arsimin universitar kemi praninë e disa platformave në kuadrin e mësimin online. Megjithatë në kuadrin e politikave sociale në këtë drejtim funksioni social i pushtetit duhet të kishte bërë të mundur aktivizimin e paketave të mbështetjes financiare në kuadrin e pajisjes së nxënësve dhe studentëve me mjete dhe pajisje kompjuterike, me qëllim që ky lloj i mësimin të ishte efektiv. Njëkohësisht vëmendja duhet të ishte orientuar edhe në drejtim të marrëveshjeve me kompanitë e ndryshme të telefonisë dhe internetit, me qëllim sigurimin e akordeve mbështetëse e mundësive në kuadrin e ofertave, që mund t'u ishin ofruar grupeve sociale të nxënësve, mësuesve, studentëve dhe pedagogëve.

Politikat sociale në fushën e shëndetësisë duhet të ishin më të evidentuara dhe më të drejtpërdrejta në aspektin e ndikimit të tyre, qoftë në institucionet shëndetësore dhe hospitalore, ashtu edhe te qytetarët e prekur me Covid - 19. Masat e marra për rritjen e kapaciteteve hospitalore, eficiencën e shërbimeve të urgjencës dhe vizitave në shtëpi, trajnimeve periodike të stafit mjekësor dhe infermieror, bonuseve të dhëna ndaj mjekëve që përballëshin direkt me situatat kritike hospitalore, rimbursimet e barnave, vaksinimet, ishin disa nga hapat e politikave sociale që u realizuan nga ana e funksionit social të pushtetit. Gjithsesi, në marrjen e këtyre masave në kuadrin e politikave sociale, mjaft efektive do të ishin edhe ndërhyrjet në mjete e pajisje e aparatura të domosdoshme në lidhje

me trajtimin e të sëmurëve, procedura më pak burokratike për rimbursimin e faturave financiare të grupit social të pacientëve të prekur me Covid 19, një menaxhim më strikt dhe rigoroz i institucioneve shëndetësore dhe aktiviteteve private në fushën e shëndetësisë, farmacisë, infermierisë, për të shmangur mjaft abuzime, që realizoheshin në këtë situatë të vështirë shëndetësore.

Grupet sociale të moshës së tretë ishin nën detyrimin e shoqërisë e në mënyrë të veçantë funksionit social të pushtetit për t'u suportuar. Në këtë drejtim duhet vlerësuar funksioni social i pushtetit lokal e deri diku ato të nivelit qendror, të cilët ndërtonan politika të veçanta suportuese për moshën e tretë. Këto politika të karakterit social konsistuan në krijimin e paketave individuale ushqimore dhe shëndetësore, ku nëpërmjet shumë vullnetarëve dhe punonjësve socialë iu dërgoheshin në shtëpi të moshuarve. Njëkohësisht pati tendenca të këtyre masave të karakterit social edhe për shtresat e marginalizuara të shoqërisë, sidomos për familjet në nevojë apo grupet e kategorive invalide të popullsisë, ndonëse vetë këto grupe sociale shfaqën ankesa e kontestime të ndryshme gjatë kësaj periudhe, që lidheshin kryesisht me numrin e kufizuar të suporteve ekonomike të planifikuara dhe shpërndarjen gjeografike. Gjatë fillimit të vitit 2021 kur edhe Pandemia Covid - 19 shfaqti shifra dhe problematika të larta si në numrin e rasteve të të infektuarve dhe të të shtruarve në spitale, funksioni social i pushtetit ndërhyri në kuadrin e politikave sociale me anë të paketave rimbursuese, ndaj të cilave opinioni publik shfaqti disaprovim për mënyrat burokratike dhe procedurat rimbursuese që duheshin realizuar për ta bërë efektive këtë masë të karakterit socialekonomik.

Gjatë situatës së Pandemisë Covid - 19 si rezultat i mbylljes së vendit dhe karantimit të plotë për një periudhë disajavore, mjaft prej kompanive dhe bizneseve mbyllën aktivitetin e tyre. Siç e theksuam edhe në çështjen e mësipërme punonjësit dhe biznesi i vogël ishte në situatë mjaft të vështirë ekonomike për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhurat e tyre të jetesës. Në këtë drejtim në kuadrin e politikave sociale mbështetëse ndaj këtij grupi të ri social të të papunëve, funksioni social i pushtetit aplikoi disa masa të karakterit ekonomik dhe fiskal. Drejtimet kryesore në të cilat konsistuan këto masa ishin, së pari, dhënia e pagave për kohën e papunësisë, së dyti, ndaj biznesit dhe kompanive mbështetje administrative ndaj shtyrjes së pagesave dhe detyrimeve bankare dhe fiskale që ato bartnin gjatë kësaj periudhe.

PËRFUNDIME

Duke marrë në konsideratë mjaft nga paraqitjet analitike të trajtuara

në çështjet e mësipërme mund të arrijmë në disa përfundime, të cilat kanë të bëjnë me problematikat sociale të shfaqura gjatë periudhës së Pandemisë Covid - 19 në vendin tonë. Vlerësojmë se përfundimet e paraqitura shkojnë sinkron situatave të krijuara në hapësirën sociogjeografike të Shqipërisë, duke shprehur njëkohësisht nevojën dhe domosdoshmërinë e aplikimit në vazhdimësi të politikave sociale nga ana e funksionit social të pushtetit etj.

Së pari, vendi ynë u përball me një situatë mjaft të vështirë gjatë periudhës mars 2020 e në vazhdim gjatë vitit 2021, si rezultat i kësaj pandemie. Infektimet e evidentuara, numri i viktimave, situatat shëndetësore të shfaqura në shërbimet hospitalore dhe në familjet shqiptare patën efekte të dukshme në hapësirën sociale. Në mënyrë të veçantë ndikimet më të shprehura në zhvillimet e popullsisë i ndjenë: grupet sociale të moshës së tretë; grupet sociale aktive në fushën e arsimit, sidomos mësuesit, pedagogët, studentët, të rinjtë e moshës shkollore (të cikleve të ndryshme); grupet sociale që ishin të pranishme në fushën e shëndetësisë, si: mjekët, infermierët, pacientët; grupet sociale që u afektuan në fushën e ekonomisë dhe të biznesit, punëtorët, punonjësit e ndryshëm, kategoritë sociale të biznesmenëve dhe sipërmarrësve etj.

Së dyti, tërësia e grupeve sociale të përfshira në analizën tonë, shfaqën tipare dhe karakteristika specifike, të nxitura në mënyrë të veçantë nga aktivizimi dhe veprimtaria e faktorëve socialë, ekonomikë dhe politikë. Nën efektin e këtyre faktorëve sjellja e tyre sociale ndryshon nga njëri grup tek tjetri, nga njëra kategori sociale tek tjetra, duke nxitur edhe vetë brenda tyre aktivitete dhe veprimtari sociale tepër diverse. Nga ana tjetër, vihet re edhe shfaqja e mjaft problematikave sociale, të shoqëruara edhe me lindjen dhe zhvillimin e mjaft konflikteve sociale. Më të shprehura sipas fushave të ndryshme paraqiten problemet e lidhura me papunësinë, pamundësinë e sigurimit të të ardhurave të mjaftueshme për jetesë, mungesën e përballimit të faturave financiare e fiskalo-bankare, në fushën e ekonomisë, pamundësinë e ndjekjes së mësimin online, mungesën e pajisjeve dhe mjeteve praktike për platformat online, mungesën e eksperiencës metodike në këtë drejtim, në fushën e arsimit. Në fushën e shëndetësisë më të shprehurat ishin ato që lidheshin me financimet e sektorit, rimbursimin e faturave financiare të ilaçeve, përballimin e punës hospitalore etj.

Se treti, janë të nevojshme dhe të domosdoshme ndërhyrjet e funksionit social të pushtetit me anë të masave të ndryshme, në kuadrin e politikave diverse të karakterit social. Në këtë drejtim kemi të pranishëm një aktivizim të këtyre politikave, të cilat ishin të shfaqura në mënyrë të veçantë në fushën e shëndetësisë (me anë të rritjes së financimit dhe buxhetimit direkt për pajisje, shpenzime spitalore, vaksinime, pagesat bonuse për stafet

hospitalore etj). Në drejtim të moshës së tretë dhe të shtresave të marginalizuara u hartuan programe të veçanta të masave sociale në kuadrin e politikave sociale që realizonin mbulimin me ushqime dhe ilaçe të këtyre grupeve sociale. Në fushën e ekonomisë me anë të krijimit të sistemit të pagesave, nën emërtimin “pagat e luftës”, shtyrje dhe lehtësime të detyrimeve bankare dhe fiskale. Në fushën e arsimit ndërhyrja me anë të masave konkrete ishte e kufizuar dhe e shprehur në mënyrë simbolike nga funksioni social i pushtetit.

Se katërti, kemi mendimin se ndërhyrja me anë të politikave sociale duhet të vazhdojë edhe gjatë kësaj periudhe që vazhdon Pandemia Covid - 19, lidhur ngusht me ecurinë dhe dinamikat që e karakterizojnë atë. Mjaft prej aktiviteteve ekonomike dhe fusha e shëndetësisë, ndiejnë nevojën dhe domosdoshmërinë e një kujdesi të veçantë, ndikuar nga zhvillimet bashkëshoqëruese dhe efektet socialekonomike, të cilat janë të pashmangshme. Është detyrë e funksionit social të pushtetit, identifikimi i grupeve sociale të prekura dhe të ndikuara, me qëllim eliminimin e efekteve sociale dhe ekonomike me të cilat ato ballafaqohen.

BIBLIOGRAFI :

- Axhemi, Sokol: Gjeografia sociale, Tekst mësimor universitar. Tiranë, 2008.
- Ministria e Shëndetësisë, Buletinet informative të Covid 19 të periudhave të ndryshme.
- VKM nr. 236, dt.19. 3. 2020, “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid – 19”.
- VKM 254, dt.27.3.2020 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19”.
- VKM nr.207, 10.03.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”.
- VKM nr. 371, dt 6.5.2020 “Për dhënie shpërblimi për personelin që shërben në institucionet e përkujdesjes shoqërore rezidenciale publike, që janë në përgjegjësi administrimi të shërbimit social shtetëror dhe të bashkive”.
- VKM nr.908, dt.18.11.2020 “Për miratimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me covid-19, që do të financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor”.
- VKM 608, dt. 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e covid-19”.
- VKM Nr. 856, datë 4.11.2020 “Për ndihmën financiare të disa prej kategorive kryesore të ndërmarrjeve, të cilat zbatojnë protokollin e sigurisë, në kuadër të parandalimit e të kontrollit të pandemisë covid-19”.

Social geography and social policies in the context of the Covid 19 pandemic in Albania

ABSTRACT

The optics study of social issues in geography is not only diverse, but also quite dynamic. In this perspective, influenced by the appearance of the Covid Pandemic 19 in 2020-2021 in the global aspect, especially evidenced in our country, we aimed to present some of our scientific considerations in the framework of Social Geography. In general, we have focused on the need and necessity of activating and dynamizing various social policies, referring to social groups at risk or affected by this Covid Pandemic 19. We have specifically tried to orient our analysis towards social groups, parts components of the social space of our country, as the accompanying effects are very sensitive, creating many social problems.

Different age groups of the population were affected by this unusual situation. Such a thing was quite present (especially the elderly and young people), certain social categories in the field of education (pupils, students, teachers, pedagogues), health (patients, doctors, nurses, sanitary) economics (workers, businessmen), marginalized social groups, etc, were involved in very worrying social issues, to which is expressed the need and necessity of intervention through various social policies.

Such a panorama in the framework of social geographical analysis has been attempted by us, focusing precisely on the activation of social policies by the social function of power. The tendencies of activation of these social policies, especially in the social groups of the elderly, young people, in education, health and the marginalized group are presented by various researchers of the international schools of Social Geography, as necessary steps in the emergence of such acute social problems. Our suggestions and recommendations aim at orienting positive developments in the social space of our country, with a direct impact on the entirety of social groups, which feel the weight and risk of the presence of these social problems.

Alida AVDULLARI, Fatmira RAMAJ

BASHKËPUNIMI POLITIK SHQIPTARO- JUGOSLLAV NË VITET 1945-1948

Hyrje

Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore (29 nëntor 1944), Shqipëria e gjeti veten nën drejtimin e Frontit Nacional Çlirimtar dhe qeverisë së dalë prej tij. Vendin kryesor në këtë qeveri e zinin komunistët. Përsa i përket politikës së saj të jashtme, ajo nuk dukej shumë e qartë për shkak të zhvillimeve që po vazhdonin ende në arenën ndërkombëtare. Si në takimin e tre të mëdhenjve, në Jaltë, ashtu dhe në 9 tetor 1944 në Kremlin gjatë takimit të W. Çurçillit me J.Stalinin, megjithëse Shqipëria nuk u përmend, llogaritë për Ballkanin ishin bërë.

Ja si shprehet Çurçilli në librin e tij: *“Le të rregullojmë punët tona në Ballkan. Mora gjysmë letre dhe shkrova: Rumania 90 përqind influencë sovjetike, 10 përqind të tjerët. Greqia 90 përqind ndikim britanik 10 përqind influencë sovjetike. Jugosllavia 50 përqind ndikim sovjetik 50 përqind influencë britanike. Hungaria po kështu. Bullgaria 75 përqind influencë sovjetike 25 përqind të tjerët. Këtë fije letre ia dhashë Stalinit, i cili në këtë kohë e kishte dëgjuar përkthimin. Ra një heshtje e vogël. Pastaj ai mori lapsin bojë blu, dhe vuri mbi letër një shenjë të madhe me laps ma ktheu. Për rregullimin e kësaj çështjeje, u desh jo më shumë kohë se sa duhej për ta shkruajtur.”*⁶⁷ Fakti që Shqipëria nuk u përmend do të thoshte se Jugosllavisë i lihej dorë e lirë për të vepruar atje. Megjithëse sipas biografisë të kryeministrit britanik, Martin Gilbert, ai në një bisedë në 11 tetor 1944 me Idenin u kujtuan se Shqipëria ishte lënë jashtë nga lista e përqindjes dhe propozoi që ajo të ndahej 50 me 50 përqind.⁶⁸

Por pavarësisht këtyre zhvillimeve, marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë ishin miqësore. Ato e konsideronin njëra - tjetrën bashkudhëtare të një rruge plot rreziqe dhe që tashmë kishin dalë fitimtare. Kështu në një takim pune i plotëfuqishmi ekonomik jugosllav në Tiranë, Sergei Kraigeri fare hapur është shprehur *“Shqipëria është një sahat ajo*

⁶⁷ Winston. S.Çurçill, *Lufta e Dytë Botërore*, Kujtime: vëll.4, Tiranë: Fan Noli, 2006, f. 305-306.

⁶⁸ Paskal Milo, *Të vërtetat e fshehura Incidenti i Kanalit të Korfuzit*, Tiranë: Toena, f.26.

*s' mund të punojë me lloj-lloj veglash. Mund të jenë më të mira e disa më të këqija të tjerat, por ato që do të jenë, të jenë të një marke! Jo ca jugosllave e ca të një prodhimi tjetër. Gjërësa te ju është hedhur një bazë jugosllave të gjitha, çdo të ngrihen mbi të duhet të jenë vetëm jugosllave”!*⁶⁹

Ndihma jugosllave në punët e qeverisë shqiptare u duk qysh në fazat fillestare të ekzistencës së saj. Si për shembull pjesëmarrja në themelimin e Partisë Komuniste të dy jugosllavëve, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha, prania e vazhdueshme e të dërguarve jugosllavë në Shqipëri jo vetëm para lufte, por dhe pas saj. Njohja e menjëhershme e qeverisë shqiptare nga ajo jugosllave (prill 1945), fakti që materialet e çdo plenumi apo mbledhjeje duhej të studioheshin më parë nga jugosllavët, e tregojnë qartë këtë “ndihmë” apo “ndërrhyrje” të tyre në punët e brendshme të qeverisë shqiptare. Pasi siguroi pozitën e veta dhe të qeverisë së tij lideri komunist kishte shprehur dëshirën për një vizitë në vendin fqinj i cili konsiderohej si një “vëlla” i popullit shqiptar.

Vizita e parë dhe e fundit e E.Hoxhës në vendin fqinj të Jugosllavisë u realizua në 23 qershor - 2 korrik 1946. Në këtë vizitë lideri komunist shqiptar shoqërohej nga zv/presidenti i Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë Myslim Peza, gjeneral major Bedri Spahiu, ministri i Drejtësisë Manol Konomi, ministri i Ekonomisë Nako Spiro, Nesti Kerenxhi, kolonel Manush Myftiu, Vasil Konomi, Ferik Hado dhe Sadik Bekteshi. Megjithëse shumë pak dokumente ekzistuese flasin për bisedimet e kryera midis mareshalit J.B.Tito dhe liderit E.Hoxha gjatë kësaj vizite të tij në Beograd, një fakt që përmendet pothuajse nga të gjithë autorët lidhur me këtë ngjarje, është nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.⁷⁰ Bisedimet ndërmjet dy palëve u zhvilluan në një atmosferë miqësore, u diskutuan çështje të ndryshme për dy vendet dhe u arrit në një akord të plotë për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke

Përfaqësuesit e Shqipërisë dhe të Jugosllavisë vendosën të konkludojnë një Pakt Miqësie dhe Ndihme Reciproke. Ky traktat i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke u nënshkrua në 9 korrik 1946. Një pakt i cili konfirmoi, vullnetin e popujve të të dy vendeve për të mbrojtur së bashku dhe në të ardhmen lirinë dhe independencën e tyre.⁷¹

Sipas dispozitave të këtij traktati të dy vendet angazhoheshin që të mbronin njëra-tjetrën në rast sulmi dhe cënimi të pavarësisë së tyre. Të dyja

⁶⁹ Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, 320.

⁷⁰ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente, AQSH, Tiranë, 1996, f.43.

⁷¹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente, AQSH, 1996, 46.

palët do të zgjidhnin në bazën e miqësisë së sinqertë të gjitha çështjet e përbashkëta lidhjet ekonomike, kulturore do të realizoheshin në marrëveshje të veçanta.⁷²

Ky traktat nga pala shqiptare u nënshkrua nga gjeneral-kolonel Enver Hoxha kryeministër, Ministër i Mbrojtjes Kombëtare dhe Ministër i Punëve të Jashtme, kurse për Jugosllavinë nënshkroi Ministri i Punëve të Jashtme, zoti Stanoje Simiç.⁷³

Traktati gjeti një jehonë të gjerë në shtypin shqiptar të kohës. Kështu në 14 korrik 1946 në gazetën “Bashkimi” shkruhej: *Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë është pasqyra e gjallë e vullnetit të popujve të të dy vendeve... marrëdhëniet e popullit shqiptar me popujt e Jugosllavisë ishin të atilla që mund të themi me siguri se me traktatin u bë “de jure” ajo që popujt e këtyre dy vendeve kishin bërë “de facto” gjatë LNÇ...*⁷⁴

Ky traktat nuk do të ishte i vetmi në aspektin e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por ai do t'i hapte rrugën dhe shumë marrëveshjeve, akordeve apo traktateve në vitet në vijim. Vitet e para të pasluftës marrëdhëniet midis dy qeverive ishin të ngushta, të dërguarit jugosllav interesoheshin pothuajse për çdo gjë që ndodhte në Shqipëri. Viti 1946 qe viti i nënshkrimit të një sërë marrëveshjesh në fushën ekonomike të cilat ecnin me të njëjtat ritme ndoshta më shpejt se ato në fushën politike dhe ushtarake. Partia Komuniste Shqiptare duke e ndjerë veten më inferiore priste gjithmonë këshillat e propozimet e qeverisë jugosllave për çdo hap që do të hidhte. Kjo duket qartë dhe në përmbajtjen e plenumit të jashtëzakonshëm të Komitetit Qendror të PKSH, 18 - 20 dhjetor 1946.

Lideri komunist shprehej se “...gjatë zhvillimit të marrëdhënieve në mes partisë sonë dhe asaj jugosllave këto u bënë marrëdhënie midis partish “motra” si Jugosllavia, si ne kishim si dritë Bashkimin Sovjetik”. Domethënë të dyja partitë e orientuan vijën e tyre drejt Bashkimit Sovjetik.⁷⁵

Krisjet e para mes palëve

Ngjarjet dukej se po shkonin mirë derisa në korrik 1947 i dërguari i Partisë Komuniste Jugosllave pranë PKSH-së, Savo Zllatiç, akuzoi

⁷² Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej- AMEPJ), Komiteti Qendror (Udhëheqja), Dosja 112, Viti 1946, f. 2-3.

⁷³ AMEPJ, KQ, Dosja 112, Viti 1946, f.4.

⁷⁴ Gazeta *Bashkimi*, 14 korrik 1946, f.4.

⁷⁵ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente ... f. 69.

udhëheqjen se në parti po kristalizohej një vijë e dytë “antijugosllave”. Sipas tij (Savo Zllatiç) nuk po zbatoheshin në praktikë të gjitha propozimet e dhëna nga Jugosllavia, tjetër thuhej nga qeveria jugosllave e tjetër veprohej nga ajo shqiptare, kryesisht këto akuza ishin në fushën ekonomike, por Zllatiç theksonte se çështjet politike me ato ekonomike ishin të pandashme.⁷⁶

Akuza e tij bazohej kryesisht në vonesën e unifikimit të çmimeve shqiptare me ato jugosllave, çështjen e pagave, sipas specialistit jugosllav, pagesat duheshin bërë në dinarë, në mënyrë që populli të shikonte se ky ishte rezultati i ndihmës jugosllave, vonesën e barazimit të monedhës, ajo ishte shtyrë për shkak se bujqit e kishin të vështirë të mësoheshin me këtë ide, çështjen e tregtisë, të koordinimit të planit etj.⁷⁷

Pas kësaj, E.Hoxha dha shpjegimet e tij ndaj çdo akuze të bërë nga i dërguari jugosllav duke pohuar se arsya kryesore e këtyre vonesave kishte të bënte me probleme të dorës së dytë, si: padija, **neglizhenca**, moskuptimi dhe kjo jo vetëm nga ana e shqiptarëve, por dhe jugosllavëve.

Savo Zllatiç, vazhdoi të këmbëngulë se këto gjëra duheshin cilësuar “si një vijë e dytë”, sepse kur të vinin gjëra më të rënda, më vonë do të ishte e vështirë t’u bënin ballë.

E gjithë kjo “padi” në fakt ishte një presion për të shpejtuar zbatimin e Konventës Ekonomike dhe protokolleve përkatëse shqiptaro-jugosllave, të nënshkruara në 27 nëntor 1946, që ishin një konkretizim i vijës së dy partive komuniste për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Mospranimi nga ana e E.Hoxhës në korrik të 1947 i një vije të dytë ‘antijugosllave’ dhe vërejtjet e tij lidhur me këtë vijë nuk përbëjnë një kundërshtim të rrugës për bashkimin me Jugosllavinë. Përkundrazi mendimet e tij rreth padisë për krijimin e një vije të dytë antijugosllave në PKSH synonin të bindin jugosllavët se udhëheqja shqiptare ishte e vendosur që bashkimi të ndërtohej sa më parë dhe marrëveshjet të zbatoheshin sa më mirë dhe sa më shpejt, dhe në PKSH nuk kishte një vijë antijugosllave që të pengonte arritjen e objektivave të caktuara.⁷⁸ Në këtë kohë E.Hoxhës i erdhi ftesa për të shkuar në Moskë. Kjo vizitë e E.Hoxhës në Moskë zgjati nga data 14 deri në 26 korrik 1947.

Takimin dhe bisedën me Stalinin lideri komunist e zhvilloi në 16 korrik 1947. Nga kjo bisedë Stalini i kishte pohuar se “*Nuk është i kënaqur populli juaj nga marrëdhëniet me Jugosllavinë? Ne nuk mund t’ju ndihmojmë dot drejtëpërdrejt. Ndihmat tona ne mund t’ju japim nëpërmjet*

⁷⁶ Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë: 8 nëntori, 1982, 304, 312.

⁷⁷ AMEPJ, KQ, Dosja 3, Viti 1947, f. 3 – 4.

⁷⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave 1945-1948*, Dokumente, AQSH, 1996, f.105.

*Jugosllavisë...ju do t'i bëni punët me anën e Jugosllavisë dhe ne do t'ju ndihmojmë. Është shumë mirë që ju keni Jugosllavinë aleat në kufi. Shqipëria është një vend i vogël dhe ka nevojë për ndihmë. Nuk mundeni dot vetëm.*⁷⁹

Pra, kjo tregon, se megjithëse në takimin e tyre, tre të mëdhenjtë, nuk e përmendën Shqipërinë dhe nga kjo bisedë del qartë se Jugosllavisë i ishte lënë dorë e lirë për të vepruar në Shqipëri.

Kjo vizitë e E.Hoxhës në Moskë nuk u prit mirë nga jugosllavët. Këtë fakt e tregon dhe sjellja e jugosllavëve ndaj përfaqësuesve të qeverisë shqiptare pas kësaj vizite.

Kjo vizitë e E.Hoxhës në Moskë e thelloi pakënaqësinë e jugosllavëve ndaj udhëheqjes shqiptare. Në shtyp u tha se E.Hoxha shkante në Moskë për një "vizitë miqësore", por përbërja e delegacionit, ku përveç kryeministrit merrnin pjesë dhe ministri i Brendshëm, ministri i Drejtësisë, zëvendësministri i Jashtëm, tregonin se vizita ishte e një rëndësie të veçantë. Ata shkuan në Moskë për të biseduar me sovjetikët edhe për mosmarrëveshjet që kishin me jugosllavët. Përfaqësuesit e delegacionit pohonin se "ne nuk u vumë në dukje jugosllavëve qëllimet e vajtjes, që ishin jo vetëm miqësore, por edhe për çështje të tjera. Ne shkonim në Moskë me një mendim në lidhje me jugosllavët." Gjatë vizitës së E.Hoxhës në Moskë sovjetikët nuk i ftuan jugosllavët për t'u bërë palë apo për të qenë të pranishëm në bisedimet shqiptaro-sovjetike. Të gjitha këto ngjallën një zemërim të madh në Beograd.⁸⁰

Pas kthimit, E.Hoxha, njoftoi për rezultatet e vizitës jo vetëm S.Zllatiçin, por në të njëjtën kohë ngarkoi dhe Tuk Jakovën, ambasadorin shqiptar në Beograd, të takonte Titon dhe ta informonte rreth vizitës. Megjithëse Tuk Jakova ia bëri me dije këtë gjë zëvendësministrit jugosllav jo vetëm njëherë, Tito nuk e priti. Vendosija e lidhjeve të drejtpërdrejta të Tiranës zyrtare me Moskën u konsiderua nga drejtuesit jugosllavë në Shqipëri si gërryerje në zonën e tyre të influencës.

Këshilltarët dhe specialistët jugosllavë në Shqipëri shpreheshin hapur se 'pas kthimit të Komandantit nga Moska kishte filluar një ftohtësi ndaj Jugosllavisë, nuk flitet për Titon, as shkruhet as fotografitë nuk shihen përveçse ato të Enverit dhe Stalinit dhe lëshohen parrullat Enver-Stalin'.

Tito i shqetësuar nga afrimi sovjeto-shqiptar si dhe nga rezistenca e Nako Spiros për mosrealizimin e qëllimeve jugosllave në ekonominë shqiptare, në mesin e gushtit 1947, iu drejtua vetë ambasadorit sovjetik në

⁷⁹ Marrëdhëniet shqiptaro - jugosllave 1945-1948, Dokumente, AQSH, 1996, 117.

⁸⁰ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.107.

Beograd, Lavrentiev të cilit i shprehu pakënaqësinë e tij, se ministri i ekonomisë shqiptare N.Spiro po pengonte bashkëpunimin mes dy palëve dhe sipas tij nuk duhej të lejohej një mosmarrëveshje ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Për këtë arsye, ai mendoi të thërriste E.Hoxhën dhe Koçi Xoxen në Beograd dhe t'u propozonte atyre të largonin e të mënjanonin nga puna N.Spiro.⁸¹

Dukej sikur N.Spiro ishte nyja gordiane, që kishte futur në kolaps marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Ajo që nuk thuhej në akuzën jugosllave dhe që fshihte thelbin e saj, ishte lidhja e fshehtë e Nako Spiros me sovjetikët. Duke goditur N.Spiro, eliminohej figura kryesore e lidhjeve ekonomike shqiptare me Bashkimin Sovjetik, dhe u jepej një mësim drejtuesve të tjerë shqiptarë se lidhjet me Jugosllavinë ishin alternativa e tyre e vetme.

E.Hoxha nuk kishte gjetur mbështetje në Moskë për ankesat e tij mbi ndihmën e pamjaftueshme jugosllave. Nga 6-18 nëntori 1947 Savo Zllatiç zhvilloi disa bisedime sekrete me Enver Hoxhën dhe Koçi Xoxen.⁸² Në takimin e 8 nëntorit 1947 me Enver Hoxhën, S.Zllatiç shprehej se në *“Shqipëri ekzistonte një vijë, një qëndrim, një orientim që nuk është i pajtueshëm me atë që është vendosur në plenumin e gjerë të dhjetorit 1946...”*⁸³ Si përfundim, Koçi Xoxe dhe Enver Hoxha, ranë në ujdi që përgjegjësia e akuzës së Komitetit Qendror të PKJ t'i ngarkohej vetëm Nako Spiros.⁸⁴

Në këto rrethana, më 18 nëntor 1947, Enver Hoxha mblodhi Byronë politike dhe i kërkoi Nako Spiros si njeriu përgjegjës i ekonomisë së vendit të raportonte për qëndrimet antijugosllave të manifestuara në ekonominë shqiptare. Nako duke parë atmosferën e rënduar dhe mjaft delikate kërkoi një ditë kohë për përgatitje. Anëtarët e Byrosë Politike pranuan me vështirësi.

Të nesërmen, N.Spiro u takua me të ngarkuarin me punë të përkohshme sovjetik në Tiranë A.N.Gagarinovi, ku i parashtroi situatën dhe e quajti jo korrekt qëndrimin e E.Hoxhës që i “njohu tërësisht si të drejta akuzat e jugosllavëve” se Nako Spiro ishte ‘frymëzues i tendencave antijugosllave në Shqipëri’. *Kjo më kërcënon mua me vdekje*, i tha ai Gagarinovit. Por ky i fundit nuk dha asnjë premtim dhe nuk mori asnjë angazhim. Pas kësaj mbledhjeje Nako Spiro vrau veten, gjë që krijoi alibinë

⁸¹ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.108-109.

⁸² *Po aty*, f.109-110.

⁸³ AMEPI, KQ, Dosja 3, Viti 1947, f.15.

⁸⁴ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.110.

se akuzat e PKJ ishin të drejta.⁸⁵

Gjatë muajve nëntor - dhjetor 1947, u mbajtën një varg mbledhjesh të Byrosë Politike që i dhanë vijën plenumit të ardhshëm të Komitetit Qendror të PKSH. Në këto mbledhje, kritikant ndaj Nakos pas vdekjes ishin të ashpra dhe denigruese. Vetë Enver Hoxha do t'u paraprinte kritikave ndaj Nako Spiros dhe lidhjeve federative me Jugosllavinë. *“Ne deklaronte ai duhet të shikojmë bashkëpunimin tonë tash e në të ardhmen, ne po ndërtojmë ekonominë e vendit tonë në baza federative dhe kjo nuk duhet të interpretohet se ne humbasim lirinë, sovranitetin, indipendencën siç mendonte Nako Spiro... bashkimi e vëllazërimi duhet të jetë i ngushtë në të gjithë sektorët”*.⁸⁶

Në këtë frymë u diskutua dhe në plenumin VIII të Komitetit Qendror të PKSH-së, i cili u mbajt në shkurt-mars 1948. Të gjitha diskutimet u përqendruan në dënimin e Nako Spiros duke pohuar se *“ekzistonte një fraksion në Komitetin Qendror të PKSH-së me në krye Nako Spiro... Nako Spiro bënte që teknikët jugosllavë të likuidoheshin... ai vrau veten si armik dhe si tradhtar... Jugosllavia na ka ndihmuar shumë dhe të mendosh për shkëputjen është vetëvrasje... ne si komunistë jemi për një bashkim të plotë”* etj.⁸⁷

Vetë Enver Hoxha arriti t'ia dalë mbanë kësaj situate, duke u pozicionuar herë si flamurtar i rrugës federative dhe i dënimit të Nako Spiros, dhe herë duke bërë autokritikë se nuk ishte treguar vigjilent, pasi Nako kishte dhe ndihmën e tij, dhe se, me dashje apo pa dashje, ai kishte ndihmuar në fraksionin në parti.⁸⁸

Ndërkohë që në dokumente tregohet qëndrimi i vërtetë i Enver Hoxhës ndaj këtij problemi dhe kësaj çështjeje, në librin e tij *‘Titistët’* çështja trajtohet me një tjetër frymë, ja si është shprehur Enver Hoxha pas vdekjes së Nako Spiros: *“Kritika e jugosllavëve u pranua si e drejtë “jo vetëm kaq, por pikëpamjet e drejta të miat, të Nakos dhe të shokëve të tjerë, u kthyen të gjitha kundër nesh dhe u shfrytëzuan për të vënë në dukje mosbesimin tonë ndaj vijës së drejtë të Komitetit Qendror të PKJ’*...⁸⁹

Por siç vumë re sa më lart, në punimet e plenumit, lideri komunist ishte shprehur ndryshe. Plenumi VIII i Komitetit Qendror të PKSH shënoi një fitore të plotë të jugosllavëve .

Rastësia e solli, që atë ditë kur Stalini në Moskë, hidhte firmën në

⁸⁵ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.111.

⁸⁶ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.111.

⁸⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente, AQSH, 1996, f.245-246.

⁸⁸ *Po aty*, 246 - 247.

⁸⁹ Enver Hoxha, *Titistët*, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 357.

letrën e 27 marsit drejtuar Komitetit Qendror të PKJ-së, po atë ditë, në Tiranë, Enver Hoxha firmoste Rezolucionin e Plenumit të Komitetit Qendror të PKSH, ku legjitimohej politika drejt bashkimit federativ të Shqipërisë me Jugosllavinë dhe përcaktoheshin detyra konkrete për realizimin e kësaj politike nga udhëheqja politike shqiptare.⁹⁰

Reflektimi i udhëheqjes shqiptare dhe tentativat për bashkimin federativ

Në funksion të këtij qëllimi ishin paraqitur në 5 dhjetor 1947 disa teza nga Savo Zllatiç në emër të Komitetit Qendror të PKJ-së për udhëheqjen shqiptare. Sipas tij, për marrëdhënie më të mira, *në sektorin ushtarak*, bashkimin ushtarak, duhej që të tre vendet të shkonin në një bashkim sa më të fortë. (Jugosllavia, Bullgaria, Shqipëria).

Në sektorin ekonomik, ekonomia shqiptare nga shkakut e prapambetjes nuk ishte në gjendje të zhvillohej më vite. Ndiqma jugosllave nuk do të kishte pamjen e një ndihme parazite, por të bashkoheshin e të ndihmonin njëri-tjetrin. “*Ndiqma jugosllave do të jetë e madhe, por ne mendojmë që do t’ia arrijmë qëllimit kur të bëjmë një bashkim ekonomik.*”⁹¹ Më tej përfaqësuesi jugosllav shpjegonte se plani ekonomik ishte vënë në baza federative ç’ka do të thoshte se i mbronin format e jashtme të independencës, Ministrinë e Jashtme, por themelet ishin federative. Kjo mënyrë do t’u siguronte të shkonin sa më shpejt përpara. Si do të veprohej më vonë? Do funksionin si një shtet apo jo? Kjo duhej parë duke marrë parasysh vullnetin e popullit, partisë dhe Komitetit Central (Bullgaria mund të rronte edhe vetë, por Shqipëria jo).⁹²

Po kështu ai jepte dhe direktivat për çështjen e shoqërive të përbashkëta. Këto shoqëri do të kishin karakter të përbashkët, për Komisionin e Koordinimit dhe për planet 1 dhe 5- vjeçare. Të gjitha këto u diskutuan në mbledhjen e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PKSH-së në 7 dhjetor 1947. Në fjalën e tij gjatë kësaj mbledhjeje lideri komunist pohonte se “*Në sektorin ushtarak ne do të jemi bashkë...në kulturë bashkëpunimi është më i rëndë... sektori i ekonomisë është më i rëndësishëm... ndiqma e Jugosllavisë themi që do të jetë e madhe, por përpyekjet e të dy palëve do të na çojnë në një bashkim ekonomik... ndiqma jonë ka për qëllim që të shkrihen të dyja fuqitë...Duke punuar në baza federative, praktikisht ne shkojmë drejt bashkimit të vërtetë, pavarësisht se*

⁹⁰ Ana Lalaj, *Shqipëria dhe Informbyroja*, Studime historike, Tiranë, 2009, 3/4, f.111.

⁹¹ AMEPJ, KQ, Dosja 3, Viti 1947, f. 20.

⁹² AMEPJ, KQ, Dosja 3, Viti 1947, f.21-22.

*nga ana formale do të ruhet shteti me Ministri të Jashtme... Komiteti Central Jugosllav thotë se ndihmën që jep nuk e bënë për presion, por e bënë për t'u zhvilluar mbi baza të përbashkëta federative për të shkuar kështu bashkarisht në socializëm... Partia jonë kështu duhet ta kuptojë çështjen.*⁹³

Pra, në këto fjalë të liderit komunist, dukej qartë se PKSJ-ja dhe qeveria e drejtuar prej saj, tanimë i kishin të qarta synimet e tyre, bashkimi dhe imitimi i çdo përvoje në Jugosllavi do të zbatohet me përpikmëri në çdo fushë të jetës politike, ekonomike dhe ushtarake në Shqipëri.

Një takim tjetër midis Mareshalit Tito dhe liderit komunist është zhvilluar në 12 dhjetor 1947, kur Enver Hoxha shkoi për një vizitë zyrtare në Bullgari. Ata kaluan në Beograd ku biseduan atje gjatë qëndrimit për një natë. Në këto bisedime tema kryesore ishte ekonomia shqiptare, ndihma e pashtershme e Jugosllavisë dhe ideja e bashkimit ekonomik dhe fushat e tjera.⁹⁴

Gjatë kësaj vizite të tij, Enver Hoxha, nënshkroi disa traktate në kuadrin e një politike të përbashkët midis tri vendeve: Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë.⁹⁵

Kjo situatë e vëllazërimit midis tre popujve vazhdoi dhe në fillimin e vitit 1948. Nga fjala e Enver Hoxhës në projektligjin e planit të vitit 1948, lideri komunist pohonte se “*populli shqiptar do të eci në rrugën e paqes dhe të përparimit, shkon i bashkuar dhe i vëllazëruar me popujt e Jugosllavisë së Mareshalit Tito dhe të Bullgarisë së Dimitrovit në një rrugë të vetme, në një rrugë të përbashkët ... dy popujt tonë në një bashkim të shëndoshë nderin të gjitha energjitë për realizimin e planeve të tyre shtetërore,*”⁹⁶

Në mars të vitit 1948 vazhdonte miratimi i rezolucionit të Plenumit VIII të Komitetit Qendror konstatonte se “*... pa lidhjet e ngushta, bashkëpunimin dhe ndihmën e vlefshme që popujt e Jugosllavisë dhe PKJ i kanë dhënë popullit tonë dhe Partisë sonë kurdoherë, nuk do të ishin të mundshme fitoret tona... Prandaj vetëm në këtë rrugë është siguruar ekzistenca jonë dhe vetëm në këtë rrugë të përbashkët ne do të ecim përpara për ndërtimin e socializmit.*”⁹⁷

Deri në mars marrëdhëniet vazhdonin të ishin të mira, por më tej, situata nuk vazhdoi njësoj. Në prill 1948, Tito në përgjigjet e dy letrave,

⁹³ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave*, Dokumente, AQSH, 1996, f.139-140.

⁹⁴ *Po aty*, f.147-148.

⁹⁵ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente, AQSH, 1996, f.148.

⁹⁶ Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi.14/Arkivi i Partisë, Dosja.82, Viti 1948, f.4.

⁹⁷ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*. vep.e përmend. f. 424.

që i kishte dërguar lideri komunist në të cilat akuzonte jugosllavët për ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë, ai (Tito) shprehej se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve kishin filluar të keqësoheshin kohët e fundit. Shkaku i këtij keqësimi nuk ishte një, por ishin disa arsye, si: mungesa e besimit të duhur nga ana e qeverisë shqiptare në sinqeritetin e përfaqësuesve jugosllavë kundrejt Shqipërisë; se me fjalë nga pala shqiptare pranoheshin sakrificat materiale që kishte bërë Jugosllavia, kurse në praktikë veprime ndryshe.⁹⁸ Përgjigjja nga udhëheqja shqiptare qe e menjëhershme.

Në të tilla rrethana në 25 prill u mbledh Byroja Politike e Komitetit Qendror të PKSH-së, diskutimet në këtë mbledhje u bënë në një frymë ndryshe, sepse në 27 mars 1948 Stalini i kishte dërguar Titos dhe Komitetit Qendror të PKJ-së një letër ku e padiste udhëheqjen jugosllave për largimin nga marksizëm-leninizmi dhe për një varg aktesh antisovjetike. Enver Hoxha ia bëri me dije anëtarëve të Byrosë Politike përmbajtjen e kësaj letre dhe u kërkoi të mbanin qëndrim. E gjithë Byroja u bashkua me paditë që Stalini i bënte Titos dhe mbi këtë bazë duhej të bëhej analiza e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, dhe të përcaktohej qëndrimi i PKSH-së lidhur me këto marrëdhënie.

Qëndrimi do të ishte pa mëdyshje prosovjetik dhe antijugosllav, por do të tregohej kujdes e maturi për shkak të kompleksitetit dhe të karakterit shumë të ngushtë të këtyre marrëdhënieve.

Veprimi i parë i Enver Hoxhës ishte dërgimi i dy letrave Titos ku i akuzonte përfaqësuesit jugosllavë në Shqipëri për ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë në ekonomi dhe në ushtri. Me kalimin e kohës qëndrimi i Enver Hoxhës ndryshoi duke ia veshur vetë Titos dhe Komitetit Qendror të PKJ-së çdo veprim dhe u përpoq ta nxirrte veten si të pafajshëm në këto veprime, madje si luftëtar i vendosur kundër titizmit dhe shovinizmit jugosllav, por e vërteta qëndron ndryshe dhe në dokumentet arkivore del qartë se Hoxha ishte luftëtari më i zellshëm për ta bashkuar Shqipërinë me Jugosllavinë mbi baza federale.⁹⁹

Kjo gjë duket e qartë dhe në një mbledhje të Byrosë Politike në 22 janar 1948 ku lideri komunist ishte shprehur se “*Sekretar i Përgjithshëm i Partisë është Titoja dhe ne jemi dy sekretarë (E.Hoxha dhe K.Xoxe)*. Pra fundi i këtyre marrëdhënieve nuk mundi të shkonte sipas parashikimeve të Jugosllavisë, pasi synimet e saj, për ta gllabëruar Shqipërinë mbetën pa u realizuar. Nga ana tjetër dhe PKSH-ja me udhëheqësit e vet, të cilët synonin

⁹⁸ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*. vep.e përmend., f. 467.

⁹⁹ *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente AQSH, 1996, f.471, 480.

të ndërtonin socializmin duke shkuar drejt bashkimit me Jugosllavinë në çdo aspekt të jetës politike, ekonomike dhe ushtarake duket se “shpëtuan” nga rrethanat ndërkombëtare.

PËRFUNDIME

Sa më sipër konkludjmë se raportet shqiptaro-jugosllave ishin një kapitull i rëndësishëm në politikën e jashtme të shtetit shqiptar pas Luftës së Dytë Botërore. Duket se këto raporte fillimisht patën një shtrirje në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore, por parë në tërësinë e tyre gjatë viteve 1945-1948 ato dalëngadalë u kthyen në raporte jo të drejta. Kjo aleancë nuk do të ishte e barabartë mes palëve që në momentin kur Jugosllavia hodhi idenë e bashkimit të Shqipërisë me të dhe kthimin e saj në një republikë të shtatë të Fedaratës Jugosllave. Nevoja imediate e shtetit shqiptar për ndihmë ekonomike e favorizoi dhe më tepër këtë ide të fqinjët jugosllav. Në këtë kontekst bashkëpunimi nga njëri vit në tjetrin u vendos mbi këtë shtyllë, pra atë të bashkimit federativ në kuadrin e një Federate Ballkanike, pjesë e së cilës do të ishin Greqia, Bullgaria dhe Shqipëria. Federata Jugosllave nëpërmjet përfaqësuesve të saj i bëri me dije palës shqiptare bashkimin doganor, politik dhe atë ushtarak, pas diskutimesh e konsultimesh mes tyre qeveria shqiptare pothuajse u bind për këtë proces. Ngjarja e cila nuk lejoi finalizimin e këtij projekti ishte acarimi i marrëdhënieve mes Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë, konflikti mes Stalinit dhe Titos në vitin 1948 shpëtoi pushtetin e liderit komunist E. Hoxhës, por dhe shmangu gllabërimin e Shqipërisë nga Federata Jugosllave. Prej këtij viti aleanca mes fqinjëve u prish dhe partneri i ri i shtetit shqiptar do të ishte BS, duke zëvendësuar aleatin jugosllav.

Referenca

Burime arkivore

- (Udhëheqja), Dosja 112, Viti 1946.
- AMEPJ, Komiteti Qendror.
- AMEPJ, KQ, Dosja 3, Viti 1947.
- AQSH, Fondi.14/Arkivi i Partisë, Dosja.82, Viti 1948.

Dokumente të botuara

- *Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948*, Dokumente AQSH, 1996.

Periodikë

- Gazeta *Bashkimi*, Tiranë, 1946.

LITERATURË BIBLIOGRAFIKE

- Churchill, Winston. *Lufta e Dytë Botërore*: Kujtime, Vëll.4, Tiranë: Fan Noli, 2006.
- Hoxha, Enver. *Titistët*, Tiranë: “8 Nëntori,1982.
- Lalaj, Ana.*Kosova-rruga e gjatë drejt vetëvendosjes*, Tiranë: Mësonjëtorja e parë, 2000.
- Milo, Paskal. *Të vërtetat e fshehura Incidenti i Kanalit të Korfuzit*, Tiranë: “Toena”, 2010.

Albanian-Yugoslav political cooperation during 1945-1948***ABSTRACT***

After the Second World War, Albania was insecure and without a certain orientation in its foreign policy. This was, at least, the first impact from the results of international conferences that established world balances. But, over time, it became clear that one of the most important partners in foreign policy was our neighbor Yugoslavia. In fact, representatives of the Yugoslav Communist Party (YCP) had been present at key moments since the founding of the Albanian Communist Party. YCP was ready to help the new Albanian state, which faced a series of economic, political and military difficulties. The immediate recognition of the Albanian government by the neighboring state and the signing of the Pact of Friendship and Mutual Assistance (July 9th, 1946) were the starting point of the Albanian-Yugoslav alliance. It was an alliance which started with a *revanche* and aimed for the unification of Albania with Yugoslavia, the return to a Yugoslavia's seventh republic. This was claimed to be realized step by step starting with the customs union between the two countries, then the close political and military cooperation.

What i undertake to present in the paper is the picture and the course of relations between the two countries during 1945-1948. What were the relations between the two parties initially? Some of the highlights of this alliance as well as the reason why this friendship faded in 1948?

**TOMOR OSMANI “GRAMATIKA E GJUHËS SHQIPE TË TRADITËS” (REFLEKSIONE)
(Botime Shkodra, Shkodër, 2020, 296 f.)**

Megjithëse një vit i vështirë për botën mbarë, edhe atë akademike, viti 2020 nuk e ka ndaluar punën e studiuesit të njohur prof. dr. Tomor Osmanit i cili vjen me një botim të ri nga fusha e albanologjisë që mban titullin “Gramatika e gjuhës shqipe të traditës” (Refleksione). Objekt i punës studimore është bërë hulumtimi i disa manualeve të vlefshme gramatikore që përfaqësojnë denjësisht traditën shqipe në këtë lëmi. Vepra është e organizuar në tre krerë ku studiuesi mund të gjejë një informacion të vlefshëm për rrugëtimin e një numri të konsiderueshëm të gramatikave shqipe të traditës, të përpiluara nga albanologë shqiptarë e të huaj. Ashtu siç e thekson edhe vetë studiuesi në parathënie, këto gramatika janë rivështruar duke bërë plotësime, zgjerime e saktësime për të krijuar kështu një panoramë të plotë rreth veprës dhe autorit të saj. Trajektorja historike përfshin gramatikat nga shek. XVIII deri në shek. XX, që nga gramatika e parë në dorëshkrim e vitit 1710, për ta përmbyllur me gramatikën e botuar *postum* të At Justin Rrotës. E gjithë vepra është një qasje e re e dijetarit shkodran ndaj këtyre gramatikave pak ose aspak të njohura në mjediset albanologjike.

Kreu i parë përfshin tri gramatika të shek. XVIII duke nisur me atë që nga shumë studiues njihet si gramatika e parë e gjuhës shqipe (1710), për të vijuar me veprën e misionarit italian Françesko Maria da Leçe (Francesco Maria da Lecce) “Vërejtje gramatikore për gjuhën shqipe” (“Osservazioni grammaticali nella lingua Albanese”, Romë, 1716) dhe gramatikën e gjuhës shqipe të viti 1776.

Prof. T. Osmani ka përfshirë një material të përditësuar rreth gramatikës në dorëshkrim të vitit 1710 duke krijuar një panoramë të përgjithshme për veprën, autorin, mendimet e shprehura nga studiues të tjerë dhe sigurisht autori ka dhënë edhe konsiderat e tij. Trajtesat gramatikore nisin me një parashtrësë për sistemin shkrimor për t’u ndalur më gjerësisht në thelbin gramatikor të veprës. Në lidhje me rëndësinë e kësaj gramatike studiuesi Tomor Osmani shkruan “është një tekst shumë i vjetër me moshë 309- vjeçare për gjuhën shqipe” që “tregon se në këtë fushë tradita gramatikore mund të jetë më e vjetër se ky dorëshkrim, që në të ardhmen mund të pasurohen me gjetje të reja” (T. Osmani, 2020:18). Këtë metodologji Osmani e ka ndjekur në vijueshmëri. Me mprehtësi ai ka evidentuar përparësitë, kufizimet e gramatikave të hartuara sidomos nga

autorë të huaj, vendin që ato zënë në historinë e gramatologjisë shqiptare dhe rëndësinë që marrin për kohën kur u botuan dhe qarkulluan.

Në kreun e dytë “Shekulli XIX” autori ka veçuar dy gramatika të shkruara në italisht, dy të botuara në frëngjisht dhe të vetmen gramatikë të shkruar në gjuhën shqipe, “Shkronjëtores e gjuhës shqipe” botuar në Bukuresh më 1886 nga atdhetari Sami Frashëri. Është marrë në analizë gramatika e arbëreshit të njohur Jeronin de Rada “Grammatica della lingua Albanese” botuar në Firence në vitin 1870, si e para gramatikë e hartuar nga një arbëresh. Si specialist i historisë së alfabeteve të shqipes, për albanologun Osmanin kjo gramatikë merr vlerë ndër të tjera edhe si dëshmi e një prej varianteve alfabetike të përdorura nga De Rada, por edhe si dokument i gjendjes gjuhësore të botës arbëreshe gjatë asaj periudhe.

Shqipja ka tërhequr vëmendjen edhe të diplomatëve të huaj, siç është rasti i francezit Ogyst Dozonit (Auguste Dozon) i cili botoi në Paris më 1879 “Manual i gjuhës shqipe” (Manuel de la langue shqipe ou Albanese). Duke u ndalur në vlerat gramatikore që mbart kjo vepër T. Osmani e vlerëson atë si të parin manual ku janë përfshirë lokucionet parafjalore, por edhe si një “gramatikë-arkivë për të shkuarën që mund të shfrytëzohet edhe sot nga studiuesit e gjuhës shqipe në disa segmente të saj” (T. Osmani, 2020:56). Po në frëngjisht është shkruar edhe gramatika e atdhetarit shkodran Pashko Vasa “Grammaire Albanaise, e botuar në Londër në vitin 1887. Kjo gramatikë ka rëndësi për historinë e shqipes dhe dialektologjinë historike, sipas studiuesit tonë.

E vetmja gramatikë e shkruar në gjuhën shqipe është gramatika e Sami Frashërit, një prej figurave kryesore të lëvizjes kombëtare shqiptare. Ai është vlerësuar nga studiuesit si njëri prej themeluesve të gramatologjisë në gjuhën amtare, prandaj dhe gramatika e tij është trajtuar më gjerësisht nga autori ynë dhe studies të tjerë të shqipes.

Mjaft i pasur është kapitulli i tretë i veprës ku janë trajtuar gramatikat e hartuara gjatë shek. XX. Janë rreth pesëmbëdhjetë gramatika të marra në analizë nga mjeshtri i shqipes Tomor Osmani, por po të mendojmë se shumica e tyre ka pasur edhe ribotime, numri i tyre dyfishohet. Me mjaft interes janë sidomos gramatikat e hartuara pas viteve '40 të shekullit XX, të cilat për shkaqe të ndryshme nuk arritën të njiheshin mirë në Shqipëri ose edhe mbetën në dorëshkrim, prandaj ky kapitull mban një peshë të konsiderueshme në këtë vepër themelore albanologjike. Janë vendosur sipas rendit kronologjik gramatikat e botuara në gjuhën shqipe, në gjermanisht, italisht etj. nga albanologë shqiptarë e të huaj. Janë ndriçuar figura, ngjarje e vepra gjuhësore të kësaj periudhe që kanë lënë gjurmë në pasurinë gjuhësore e kulturore të shqipes. Kështu në fund të shek. XIX dhe

fillim të shek. XX një veprimtari të pasur në gjuhën shqipe pati edhe shoqëria “Bashkimi”. Anëtarët e kësaj shoqërie janë bërë të njohur edhe në fushë të gramatologjisë e leksikografisë shqipe. Vepra e marrë në analizë “Gramatika ia folmarmia shqyptare...” e botuar në vitin 1901 i atribuohet dom Dodë Kolecit, njërit prej anëtarëve aktivë të kësaj shoqërie. Studiuesi i njohur Tomor Osmani tërheq vëmendjen e gjuhëtarëve të rinj për një rivlerësim të kësaj gramatike dhe të analizave që i janë bërë asaj, në syrin e trashëgimisë albanologjike në përgjithësi.

Një tjetër gramatikë e traditës është “Grammatica della lingua albanese” e Gapër Jakova Mërturit (Frascati, 1904). Një hapësirë më vete edhe në këtë rast gjuhëtari shkodran i lë alfabetit të këtij autori, duke e përqsuar me variantin e sotëm, për të vijuar me në një analizë të hollësishme të gramatikës. Veprimtarinë gjuhësore të Gapër Jakova Mërturit gjuhëtari Tomor Osmani e ka gjurmuar para dhe pas botimit të kësaj gramatike, duke na krijuar një panoramë të plotë botuese e studimore të këtij autori, sidomos në lëmë të ortografisë shqipe.

Dhjetëveçarit të parë të shek. XX i përket edhe gramatika e Gjergj Pekmezit “Grammatik der Albanisichen Sprache” e botuar në Vienë në vitin 1904 dhe “Gramatika Shqyp” e hartuar nga Anton Xanoni (Shkodër, 1909), dy gramatika të çmuara për shqipen. Edhe këto janë konsideruar si gramatika të traditës ndaj dhe janë vlerësuar me kujdes.

Dijetari Tomor Osmani i ka dhënë një hapësirë të konsiderueshme kontributit për shqipen të misionarit italian Antonio Buseti, i cili pati një veprimtari të pasur meshtarie dhe albanologjike në Shqipëri. Nga ky autor kemi trashëguar “Grammaticchetta della lingua Albanese” (Shkodër, 1910), “Pratica e grammatica della lingua Albanese...” (Shkodër, 1914) dhe “Grammatica Albanese” (botim i dytë Shkodër, 1933), të dyja vepra të analizuar hollësisht në veprën që kemi në dorë. Një tjetër albanolog italian që ka tërhequr vëmendjen e studiuesit Tomor Osmani është Anxhelo Leoti (Angelo Leotti) i cili ka botuar dy gramatika duke u bazuar herë në dialektin toskë e herë tek ai gegë. “Gramatica elementare della lingua albanese” (dialeto toscano, 1915) dhe “L’Albanese parlato. Cenni grammaticali vocabolario albanese-italiano-italiano-albanese (dialeto ghego, Milano 1916) janë gramatikat e tij të analizuar me vëmendje që nga alfabeti i përdorur, metodologjia, struktura e deri tek vlera e tyre.

Një grup më vete përbëjnë gramatikat e hartuara nga autorë shqiptarë, si “Viti premtar i gramatikës” i Sotir Pecit e botuar në Korçë (1912), “Gramatika e gjuhës shqipe” e Gaspër Mikelit (Shkodër, 1916), “Gramatika e gjuhës shqipe” e Kiço Konomit (Korçë, 1921), “Gramatikë e gjuhës shqipe” e Koço Tasit (Vlorë, 1923), “Gramatik” e gjuhës shqip në

toskërishtet” e Jani K. Mingës (Vlorë, 1925). Ndërsa gramatika e Karl Gurakuqit u botua në italisht (“Grammatica albanese dell’ uso moderno”, Palermo, 1958) dhe u përdor si tekst për mësimin e shqipes. Sigurisht në këtë traditë të pasur gramatologjike një vend të shënuar zë vepra “Manuale di lingua Albanese” e autorit mjaft të njohur arbëresh Françesko Solano (Francesco Solano). Sipas gjuhëtarit T. Osmani “Në hartimin e gramatikës shqipe Françesko Solanoja eci në hullinë e disa autorëve arbëreshë dhe shqiptarë, që kishin punuar e jetuar në një mjedis arbëresh duke paraprirë me vepra të kësaj natyre (T. Osmani, 2020:239). Në historinë e gramatologjisë shqipe veçohet “Gramatika shqipe” (“Albanian Grammar...”, Harassowitz Verlag, 1984) e hartuar nga Martin Camaj si e para gramatikë që përfshiu tri varinatet e shqipes, gegërsishten, toskërishten dhe arbërishten. Studimi mbyllet me gramatikën e Justin Rrotës “Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore (Shkodër, 2006) e analizuar me kujdes nga studiuesi Tomor Osmani, i cili është ndalur në disa trajtesa me karakter morfologjik, si më pak të njohura nga pjesa tjetër e gramatikës.

Kjo vepër e re e studiuesit të palodhur Tomor Osmani ka një rëndësi për albanistikën, për historinë e gramatologjisë shqipe dhe çel rrugën për hulumtime të reja të kësaj natyre. Çdo albanolog që do të hulumtojë në këtë libër mund të gjejë informacione të plota për vepra e autorë, qasje ndërdisiplinore, gjedhe metodologjike. Secila prej gramatikave përbën në vetvete një model për analizimin e një gramatike, si për metodologjinë e përdorur, bibliografinë e pasur dhe përfundimet e nxjerra. Mjeshtri Tomor Osmani vjen gjithmonë me gjetje të reja, fusha hulumtuese që kërkojnë vëmendjen, dorën e mendjen e maestros.

Profesorit i urojmë shëndet e vepra të tjera studimore në dobi të albanologjisë.

Mimoza Priku

NJË VËSHTRIM NË KOHË I KOLANËS “STUDIME SHQIPTARE”, 1993-2020

Në historinë e bukur që mishëron institucioni kërkimor-shkencor e universitar, Universiteti ynë “Luigj Gurakuqi”, padyshim se botimet nën drejtimin e Qendrës së Studimeve Albanologjike, janë fryti më i qartë e më konkret i përpjekjeve në lëmin e filologjisë së derdhur ndër vite nga profesorët atdhedashës e dijedashës, të cilët kanë shërbyer e shërbejnë në auditoret e kësaj vatre të vler të historinë e Shqipërisë e të qytetit tonë. Sot, një pjesë e tyre janë në mesin tonë duke vazhduar çdo ditë me punë papushim, e një pjesë tjetër kanë kaluar në Amshim, duke lënë modelin e jetës e stilit e studimit për ne, e brezat që do të vijnë.

Qëllimi kryesor në punën kërkimore-shkencore të QSA ka qenë hulumtimi, analizimi, e vlerësimi përmes shpalosjes analitiko-sintetike i ngjarjeve e figurave të ndritshme në historinë e gjuhës shqipe e letërsisë, të njohura e të analizuar në periudhën e errët të Diktaturës, ndonëse në disa raste edhe jo drejt, por edhe ata, të cilët sistemi diktatorial i instaluar në vendin tonë për rreth 50 vjet, i përjashtoi e ndaloi të ishin të njohur, të studiuar në mjedisin shkollor, universitar, e më gjerë, në jetën e popullit tonë.

Nën kujdesin e posaçëm të studiuesve të palodhur, të profesorëve të nderuar, të cilët themeluan këtë bërthamë pune hulumtuese, një prej periodikëve të suksesshëm në fushë të studimeve filologjike, është Kolana “Studime Shqiptare”. Emërtimi i zgjedhur i përgjigjet më së miri qëllimit të punës së themeluesve të kësaj bërthame me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare në fushën e studimeve humanistike pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore të Universitetit të Shkodrës, duke përfshirë në botim 6.688 faqe kërkimi e analize në fushë të shqipes si gjuhë e shpirtit, mendjes dhe e kulturës.

Deri në ditën e sotme kanë dalë në qarkullim 29 numra, është në proces botimi numri 30.

Në vazhden e botimit të numrave të saj, Kolana ka qenë një tablo e gjallë e punës kërkimore- shkencore e studiuesve filologë kombëtarë e ndërkombëtarë, kushtuar figurave e ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së letrave shqipe. Në bordin e saj drejtues gjenden emrat e studiuesve, filologëve e profesorëve më në zë nga Universiteti ynë, UT, e bota arbëreshe, katedra të mësimin të shqipes në Europë, si dhe nga QSA

kombëtare. Ky fakt shpreh qartë rëndësinë e këtij Botimi në rang kombëtar e ndërkombëtar, si dhe seriozitetin shkencor, me të cilin Qendra e studimeve albanologjike e Universitetit tonë ka ushtruar kërkimin e saj, duke u bërë kështu një vatër shkencore gjithmonë e ndezur në zejen e bukur të kërkimit e të shpalosjes së ngjarjeve e figurave të spikatura në historinë e gjuhës, shpirtit e kulturës.

Mendojmë se është vërtet shumë shprehëse e domethënëse, që i pari numër i kolanës “Studime Shqiptare”, i është kushtuar të Madhit e të Përndriturit, fort të dashtunit tonë, profesor Martin Camaj. Redaksia e këtij numri e përbërë prej profesorëve të nderuar: Stefan Çapaliku, Nuri Gokaj, Tefë Topalli, Alfred Çapaliku, Ardian Marashi, kanë punuar me kujdes e pasion për të mbledhur e kujdesur sipas fushës artikujt e studiuesve nga USH, ASHSH, Universiteti i Kalabrisë, në Itali, bota fetare e kulturore e qytetit tonë. Autorët kanë analizuar e vlerësuar, jo vetëm penën e ndihmesën e vlerë të profesor Camajt, por edhe figura, fenomene apo ngjarje që i përkasin historisë së shkrimit e përdorimit të shqipes, të cilët lypeshin shkruar e rishkruar në periudhën e re të Demokracisë së brishtë, që sapo kishte lindë në vendin tonë.

Duke shfletuar Kolanën SSH, vërejmë se numri 2 e 3, është punuar nën kujdesin e prof. dr. Stefan Çapaliku, aso kohe drejtor i Departamentit të Letërsisë në Universitetin tonë. Këto dy numra i janë kushtuar kryesisht fenomeneve e figurave të spikatura në fushë të letërsisë shqipe. Numri 2 i Kolanës mban titullin “Për një histori të re të letërsisë shqiptare”. Artikujt e këtij numri janë punuar prej profesorëve e studiuesve të Departamenteve të Letërsisë USH e Universiteti i Prishtinës.

Numri 3 i Kolanës, në vijim të shpalosjes së temave më të mprehta në fushë të letërsisë shqipe, i është kushtuar figurës së jashtëzakonshme në historinë e letërsisë sonë, prozatorit penëartë e profesorit të shquar të gjuhës shqipe, të përndriturit Ernest Koliqi, në përvjetorin e njëzetë të kalimit të tij në Amshim.

Numri 4, Kolana SSH, u përgatit për botim nën kujdesin e prof. dr. Nuri Gokaj (aso kohe drejtor i Departamentit të Gjuhës shqipe) e prof. dr. Tefë Topalli, duke iu kushtuar njërit prej sintaksologëve më të spikatur në fushë të shqipes, atë Justin Rrota, në rastin e 30- vjetorit të kalimit në Amshim.

Në këtë numër do të gjeni artikujt e studiuesve nga Departamenti i Gjuhës shqipe, i Letërsisë së USH, si dhe akademikë shqiptarë, të cilët kanë parashtruar vlerat e penës së atë J. Rrotës në sistemet e nënsistemet e gjuhës e në strukturat e përfuara nga mjeshtëria e filologut fort të lëvruar.

Numri 5, i kushtohet njërit prej albanologëve të shquar, Gustav Mayer, organizuar me rastin e 145 - vjetorit të lindjes. Studiues nga USH, UT, ASHSH, morën pjesë në prezantimin e figurës e kontributit të Mayerit në hulumtimin e zbulimin e rrënjëve të gjuhës sonë.

Poetit tonë Kombëtar, françeskanit të madh, akademikut të spikatur, atë Gjergj Fishta, iu kushtua numri 6.

Në rastin e 55- vjetorit të kthimit të tij në shtëpinë e Atit Qiellor, (dhjetor 1995) profesorë e studiues nga Departamenti i Gjuhës shqipe, i Letërsisë, i Historisë i USH, i kushtuan një vëmendje të përkushtuar shfletimit sa më të plotë e më të thellë të penës së Fishtës.

Një numër i veçantë, numri 7 i Kolanës SSH, i kushtohet studiuesve italianë për gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare. Ky numër është punuar në nderim të figurës së albanologut italian Karlo Taliavini (Carlo Tagliavini). Në artikujt e këtij numri, përveç profesorëve e studiuesve punëtorë të Departamenteve të Gjuhës shqipe e të Letërsisë të USH, janë edhe emra të mirënjohur në studimet albanologjike në Itali. Veprimtaria e albanologëve italianë në fushë të gjuhës, letërsisë e kulturës sonë është pasqyruar përmes figurave të caktuara, por edhe veprave të tyre, thuajse edhe të panjohura deri më hapjen e proceseve demokratike në vendin tonë.

Në numrin 8, të kësaj kolane, vërejmë artikujt kushtuar një ndodhie me vlerë të jashtëzakonshme në historinë e shkrimit e të ekzistencës së gjuhës sonë shqipe, Komisia Letrare e Shkodrës. Në këtë numër janë përfshirë 12 artikuj të punuar nga emra të spikatur në fushë të kërkimit të gjuhës shqipe nga USH, UE e ASHSH (në atë kohë ISA në Tiranë).

Numri 9 i kushtohet një personaliteti të spikatur në fushë të gjuhësisë shqiptare, profesor Eqrem Çabej, në rastin e 90 - vjetorit të lindjes së tij. Studiuesit nga USH, ASHSH, kanë sjellë me saktësi shkencore e përkushtim vlerat shumëplanëshe në fushë të historisë së gjuhës sonë të profesorit të nderuar E. Çabej.

Artikujt ndalen në analizë të kontributit të Çabejt në të gjitha rrafshet e gjuhës shqipe, atë etimologjik, leksikor, morfologjik, historisë e gjuhës, dialektologji etj.

Numri 10, nën titullin “Gjuha e ligjërimi në shkollë”, përfshin 21 artikuj të punuar nga studiuesë e profesorë të USH, UE, ISA E ISP (sot ASHSH). Artikujt trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me dokumentacionin shkollor të gjuhës shqipe në shkollë, veçanërisht në dritën e metodave të reja bashkëkohore, si dhe me ndryshime konceptuale në mësimin e shqipes prej moshës 6-14 vjeç. Artikujt janë grupuar në dy seksione: a) probleme teorike të gjuhës amtare në shkollë; b) probleme didaktike e të dokumentacionit.

Në numrin 11 të Kolanës gjejmë artikuj të punuar nën titullin “Gjuha dhe shkrimtari”, rezultat i një pune kërkimore-shkencore ideuar e drejtuar nga QSA, në kuadrin e një pune trevjeçare. Autorët janë profesorë të Departamenteve Gjuhë shqipe e Letërsi në USH, si dhe anëtarë të ASHSHS. Objekt i kërkimit e analizës janë bërë penat e autorëve të ndryshëm e pasuria që sjellin ata në korpusin e gjuhës shqipe.

Në kuadrin e vëmendjes së posaçme që QSA ka pasë për figurat e ndritshme në historinë e gjuhës shqipe e kulturës sonë, një prej shprehjeve më konkrete është numri 12 i SSH, kushtuar albanologut të shquar austriak, Norbert Jokli. Në këtë numër kushtuar veprimtarisë së Joklit, janë përfshirë mbi 50 artikuj të punuar nga studiues e profesorë të FSHSH të USH, të UE, UP, si dhe akademikë e profesorë të FFUT, e studiues italianë e amerikanë. Në vijim të nderimit e vjeljes së ndihmesës së shquar që të huajt kanë dhënë ndër shekuj në fushë të shqipes, është hartuar edhe numri 13 i serialit, ku gjejmë të analizuar ndihmesën e dijetarëve francezë në gjuhën, letërsinë e kulturën shqiptare. Në faqet e këtij numri studiuesit i kanë kushtuar një punë të posaçme figurave të tilla, si: F. Pouquevill, H. Boissin, A. Boue, K. Monteco, A. Meillet, M. Roques, (në kujtim të 40 - vjetorit të largimit të tij kësaj jete), Ch. Gut, L. Benloew. Janë pena të departamenteve të Gjuhës shqipe, Letërsisë, Gjuhës frënge të USH, por edhe akademikë shqiptarë, njohës të botës frënge në lëmë të shqipes e kulturës së popullit shqiptar.

Një ndër qëllimet më të spikatura në punën kërkimore-shkencore të QSA ka qenë e është hulumtimi, studimi, analizimi i gegërishtes në të gjitha format e ekzistencës saj, e shkruar dhe folur, duke kërkuar modelimin e gegërishtes letrare, sigurisht kjo nëpërmjet vëzhgimit të autorëve të trevës së Veriut. Këtij argumenti i përkasin artikujt e përmbledhur në numrin 14 të SSH. Në këtë numër janë 34 artikuj të profesorëve e studiuesve nga departamentet Gjuhë shqipe, Letërsi, Histori, USH, Universiteti i Prishtinës e ASHSH.

Në thellim të argumentit të mësipërm, duke e shtrirë funksionalitetin dhe rëndësinë e gegërishtes në identitetin e pasurimin e gjuhës shqipe në të gjitha format e shprehjes së saj të folur e të shkruar, si p.sh. në fushën e përkthimit, studiuesë e profesorë të nderuar nga USH, UT e nga universitete italiane, kanë vjelë elemente gramatikore në sistemet e nënsistemet e gjuhës në artikujt e tyre të mbledhur në numrin 15 të SSH. Janë 18 artikuj, ku përmes analizave vërehet qartë pasuria morfemore, fonetike, leksikore, sintaksore e gegërishtes, e vendosur e gjitha kjo edhe në kuadrin e veprave të caktuara letrare të shkruara në gjuhën shqipe, por edhe në fushë të përkthimit të penave të huaja në gjuhën tonë.

3. Më 2010, numri 16 i SSH, i kushtohet një figure të shkëlqyer të filologjisë shqiptare, prof. dr. Selman Riza - gjuhëtar i shquar. Në këtë numër përfshihen materialet e Konferencës Shkencore organizuar me rastin e 100-vjetorit të lindjes së gjuhëtarit të ndritur. Në këtë botim pasqyrohen 14 artikuj kushtuar vështrimit e vlerësimit të punës së profesor Rizës në të gjitha sistemet e gjuhës shqipe, (morfologji, sintaksë, histori e gjuhës shqipe, mendim gjuhësor) e në kontributin e tij në studimin e autorëve të vjetër. Autorët janë profesorë të departamentit të Gjuhës shqipe e të Letërsisë, si dhe anëtarë të ASHSH.

Më 2011, dalin 3 numra të Kolanës, përkatësisht numri 17, 18, 19.

Numri 17 i SSH, është punuar në kujtim të 85-vjetorit të lindjes së të Madhit e të Përndriturit Martin Camaj. Artikujt e këtij numri janë punuar nga studiues të mirënjohur të gjuhës shqipe e letërsisë të USH, përkatësisht të departamentit të Gjuhës shqipe e të Letërsisë, nga USHT, ASHSH, si dhe Universiteti i Mynihut, Gjermani. Në Konferencën e organizuar me këtë rast, mësojmë nëpërmjet botimit në fjalë se ishte e pranishme edhe bashkëshortja e profesorit Camaj, zj. Erika Camaj. Artikujt përshkruajnë e vlerësojnë figurën komplekse e penën e skalitur të profesor Martin Camajt, në këndvështrim gjuhësor e letrar, duke u ndalur në veçoritë e stilit, mendimit e shkrimit të tij, si një prurje e kulluar në historinë e shqipes si gjuhë e shkruar dhe e folur.

I 18 -ti numër i SSH u përgatit në vigjilje të 70-vjetorit të kalimit në Amshim të Poetit Kombëtar Atë Gjergj Fishta. Ky botim mësojmë se u përgatitë nën kujdesin e drejtores së departamentit të Letërsisë, prof.as.dr. Ledri Kurti, me pjesëmarrjen e pedagogëve, studiuesve e emrave më të njohur të USH, ASHSSH, e UT. Përgatitja e këtij numri ka mbledhë rreth vetes ndihmesën e don Marjan Lumçit e don Nikë Ukgjinit, si shprehje konkrete e vizionit të hapur të bashkëpunimit të USH – FSHSH me të gjithë palët e interesuara në lartësimin e figurave e ngjarjeve mbarëkombëtare.

Në vijim të vitit 2011, doli numri 19, SSH, kushtuar 100-vjetorit të Fjalorit të shoqërisë “ Bashkimi”, monument i pasurisë së fjalës shqipe. Në këtë numër kanë paraqitur kërkimet e analizat shkencore profesorë të USH, (departamenti i gjuhës shqipe, departamenti i letërsisë), të UT, QSHA.

Studiuesit kanë vëzhguar këtë gurrë të mendimit e shpirtit të popullit shqiptar, Fjalori i Bashkimit, siç quhet rëndom, në vlerat e tij leksikore, semantike, drejtshkrimore, morfo-semantike, stilistike i krahasuar me fjalorë të tjerë të pararendës.

ISA ose QSA, emërtimi i sotëm, si dhe departamenti i Gjuhës shqipe USH, në bashkëpunim me Universitetin e Kalabrisë, me mbështetjen

e Kryetarit të Komunës Vaccarizzo në Itali, z. Aldo Morino, i kushtuan një konferencë shkencore ndërkombëtare arbëreshëve, lidhjeve shqiptaro-arbëreshe me qytetin e Shkodrës, me titull “Shkodra, arbëreshët dhe lidhjet italo-shqiptare”. Me punimet e kësaj konference ndërkombëtare, ku morën pjesë emra të shquar të gjuhësisë shqiptare në Shqipëri, Itali e Kosovë, Qendra përgatiti numrin 20 në Kolanën e Studimeve Shqiptare.

Në kuadrin e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Pavarësia e Shqipërisë dhe albanologjia”. U bashkuan në realizimin e kësaj veprimtarie departamentet e Gjuhës shqipe, Letërsisë e Historisë së FSHSH të USH në bashkëpunim me QSA. Kuntimet e saj u pasqyruan nën kujdesin e QSA-së në botimin e një numri të posaçëm të Kolanës SSH numër 21. Artikujt e këtij numri janë një pasqyrë filologjike e ngjarjes së madhe të Pavarësisë së Shqipërisë, përgatitur nga emra të njohur të Universitetit tonë, UT, Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Universitetit të Arteve, studiues nga Italia e Gjermania.

Revistës zëmadohe “Hylli i Dritës”-votër kulturo shqiptare, AKADEMI SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, e themeluar dhe e drejtuar nga Etërit e Përndritur Françeskanë të Shqipërisë, nën udhëheqjen e të Madhit Atë Gjergj Fishta, nën moton “Ubi Spiritus Domini, ibi libertas” II.ad. III.17- Ku asht shpirti i Zotit, aty asht liria), QSA i kushtoi numrin 22 të Kolanës SSH, në rastin e 100-vjetorit të daljes në dritë të këtij Monumenti të gjuhës e kulturës shqiptare. Në këtë përvjetor u mbajt një konferencë shkencore ndërkombëtare, ku studiuesit pjesëmarrës nga Shkodra, Tirana e Prishtina, e vështruan HYLLIN në pikëpamje gjuhësore, kulturore, historike e shpirtërore në botën shqiptare të shqiptarëve kudo janë.

Në faqet e këtij numri mësojmë se QSA e Universitetit të Shkodrës, në veprimtarinë e saj ka ditur të ftojë në bashkëpunim institucione të rëndësishme të jetës fetare e diplomatike të qytetit tonë, duke shprehur më së miri frymën e lirisë së mendimit akademik. Bie në sy mbështetja financiare dhënë nga Konsulli i Nderit i Austrisë, z. Gjergj Liqejza, si dhe përkujdesja e Arqipeshkvisë së Shkodrës, të cilët mundësuan botimin e punimeve kushtuar kësaj Akademie.

Në numrin 23 të Kolanës, mësojmë se vëmendja e kërkimi i studiuesve është ndalë në përvjetorin e 200-vjetorit të lindjes së rilindasit Jeronim de Rada. Në këtë përvjetor, janë mbledhur studiues, emra të spikatur të filologjisë shqiptare nga Shkodra, Tirana, Kosova e Italia, të cilët nën drejtimin QSA e Departamentit të Letërsisë, pranë FSHSH, kanë

analizuar veprimtarinë e kontibutin e De Radës në rrafshe të ndyshme të shkrimit e mendimit të tij.

Në shfletimin e numrave të Kolanës, të bie në sy se në metodologjinë e QSA të Universitetit tonë, pikë e rëndësishme ka qenë ndjekja e ngjarjeve dhe e figurave që kanë shënuar themelet e perspektivat e gjuhës, letrave e mendimit filologjik shqiptar. Kështu, në numrin e radhës, kërkimi e studimi është ndalë në vëzhgimin e mendjeve të ndritura të kulturës shqiptare, si: atë Anton Xanoni, pader Justin Rrota, don Ndoc Nikaj, z. Faik Konica, i Lumi imzot Vinçens Prennushi, z. Hilë Mosi e z. Haki Stërmilli.

Në vazhden e hulumtimit të penave prodhimtare në fushë të historisë së gjuhës shqipe, QSA ftoi studiuesit e nderuar kombëtarë e ndërkombëtarë të ndalen në një Konferencë shkencore kushtuar veprimtarisë së prof. dr. Tomor Osmani, i cili i kushtoi gjithë jetën, sot e gjithë ditën, albanologjisë shqiptare, duke qenë në mes të tjerave, edhe njëri prej themeluesve e drejtuesve të përkushtuar të QSA e botimeve që kanë dalë ndër vite në FSHSH të Universitetit të Shkodrës. Punimet e kësaj konference janë përfshirë në numrin 26 të Kolanës SSH. Kujtojmë me nderim, se profesor Tomor Osmani mban titullin “Profesor Emeritus”, si dhe “Mjeshtër i madh”.

Numri 27, i kushtohet një ndodhie monumentale në historinë e popullit shqiptar “Komisia Letrare -100 vjet më pas dhe mendimi albanologjik”. Artikujt e botuar janë një pasqyrë e përimtuar falë studiuesve kombëtarë e ndërkombëtarë e vlerës së jashtëzakonshme, që mishëron ky Monument madhështor në historinë e Shqipërisë e Albanologjisë.

Numri 28 i Kolanës SSH, i është kushtuar vëzhgimit përmes analizave gjuhësore, letrare e historike të fenomeneve gjuhësore në autorë hungarezë të përkthyer në gjuhën shqipe, të penave letrare hungareze, të figurave e raporteve shqiptaro-hungareze, që kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve të nderuar shqiptarë e të huaj.

Në numrin 29 të Kolanës, nën titullin “Gjurmime albanologjike”, janë përmbledhur 35 artikuj punuar nga studiuesë e profesorë të Universitetit të Shkodrës, Departamentet e Gjuhës shqipe, Letërsisë, Historisë, si dhe nga Unversiteti i Prishtinës, Universiteti i Tiranës e ASHSH. Analizë e penave të studiuesve janë bërë ndihmesa e figurave të shquara, si: Mati Logoreci, Ndre Logoreci, Dhimitër Kamarda, don Ndre Mjeda, Injac Zamputi, Arshi Pipa, Martin Camaj, atë Benardin Palaj, Lefë Nosi. Figurat e përndritura janë analizuar në këndvështrim bibliografik, në analizim të vlerave gjuhësore që mbartin veprat e tyre, duke i përimtuar në sisteme e nënsisteme të gjuhës sonë.

Kështu mbyllet rrugëtimi ynë në fletët e shumta të një prej periodikëve më prodhimitarë në listën e botimeve të Universitetit të Shkodrës, si dëshmi e një pune të vazhdueshme kërkimore e shkencore, ideuar e drejtuar nga QSA.

Bora Logu

Olimpia KAKARRIQI

BIBLIOGRAFI E ANTIKUARIT TË BIBLIOTEKËS SË UNIVERSITETIT “LUIGJ GURAKUQI”, (1508 - 1944)

Bibliotekat janë pjesë e një shoqërie dinamike, komplekse dhe të hapur ndaj informacionit. *“Ato shërbejnë si porta drejt dijes, mendimit dhe kulturës, duke ofruar mbështetje për vendimmarrje të pavarur, zhvillim kulturor, studim dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës për individë dhe grupe”*. Misioni i tyre është i përbashkët, ndërsa qëllimet janë të ndryshme. Qëllimi i bibliotekave universitare është sigurimi i shërbimit informativ dhe i huazimit të literaturës në përshtatje me nevojat e studentëve dhe të personelit mësimdhënës e administrativ.

Edhe biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, si një nga bibliotekat më të rëndësishme në rang kombëtar i përgjigjet kërkesave të përdoruesve të saj, studentëve, pedagogëve, studiuesve e të tjerë. Në fondet e bibliotekës gjenden koleksione të pasura me libra, në të cilët përfshihen të gjitha fushat e shkencës. Fondi i librit të rrallë apo fondi Arkiv është një nga fondet më me vlerë të kësaj biblioteke. Koleksionet e këtij fondi, libra dhe periodikë, përfshijnë botime të viteve 1508 – 1944, të shkruar nga autorë shqiptarë dhe të huaj, botuar jashtë dhe brenda kufijve të Shqipërisë. Tematika e këtyre koleksioneve përfshin materiale të shumta në fushën albanologjike.

Një rëndësi të veçantë zë Antikuari, që përfshin 35 libra të rrallë, botime më së shumti të autorëve të huaj. Këto kopje të rralla janë pjesë e trashëgimisë kulturore mbarëkombëtare, pasi përfshijnë studime e shkrime mbi gjuhën, historinë, letërsinë, etnografinë, fenë, folklorin e kulturën kombëtare në përgjithësi.

Libri më i vjetër që e hap këtë koleksion është "Historia de vita et gestis Scanderbegi..." i autorit Marin Barleti, botuar në vitin 1508. Pjesë e këtij koleksioni janë edhe dy kopje unike në Shqipëri, "Breve compendio della Dottrina Christiana...", përkthim i Gjon Nikoll Kazazit, botuar në vitin 1743, në Romë nga Propaganda Fide dhe, "Dell Historia Vinitiana" i Marco Antonio Sabellico, botuar në Venecia, në vitin 1558.

Me vlera të rralla janë botimet e Margarita Sarrochi, të Francesco

Maria da Lecce, Jean Paul Duponcet, Georgius Bartholdus Pontanus, Edvard Brown, Thomas Smart Hughes, Alphonse de Beauchamp, Hyacinthe Hecquard, Johann Georg von Hahn etj.

Në përshkrimin bibliografik të këtij koleksioni kam zbatuar rregullat e katalogimit bazuar në standardet ndërkombëtare të ISBD (International Standard Bibliographic Description) dhe ato anglo-amerikane të AACR2 (Anglo-American Cataloguing Rules). Gjithashtu jam konsultuar me botimet “Albanica I” dhe “Albanica II” të Bibliotekës Kombëtare, Tiranë si dhe me materialet e ish-drejtuesve të bibliotekës universitare, Willy Kamsi e Gjovalin Çuni.

1508

1. Barletius, Marinus. Historia de vita et gestis Scanderbegi Epirotarvm principis... / Marinus Barletius. - Cum Privilegio. Impressum Romae per B. V., S.a. – 4 fl. pa num., 1fl. portr., CLIX, 159 fl. : 2 fl. të bardha pa num. ; 29cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut, princ i epirotëve...*”

Autori jepet në krye të Parathënies: “Marini Barletti Scodrensis de vita & gestis Scanderbeg...”

Mendohet që vepra të jetë botuar rreth viteve 1508 - 1510 në Romë.

1558

2. Sabellico, Marco Antonio. Dell’ Historia Vinitiana : con la giunta de gli Epitomidi nuovo tradotti dal Latino / Marco Antonio Sabellico. – Vinecia : Giovanni de’ Rossi, 1558. – 45 fl. pa numër, 470 f. ; 16 cm.

Kjo vepër përfshin edhe historinë e vërshimit të turqve në Shqipëri si dhe luftën e Skënderbeut për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Ky botim është i kompletuar me pasqyrën e lëndës si dhe me përmbledhjet e shkurtuara, të përkthyera nga latinishtja.

Kopje e vetme në Shqipëri. Botimi i parë i kësaj vepre gjendet në gjuhën latine (Biblioteka Kombëtare dhe Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër)

Shek. XVI

3. Incipit Liber Statvtorvm Padvae de Ratione: reddenda tam in ciulibus, quam in criminalibus caufis. – Venetiis, [shek. XVI]. – 319 f. ; 15 cm.

Libri i statuteve të Padovës me të dhëna statistikore si për çështjet civile ashtu edhe për ato penale. Librit i mungon kopertina dhe frontespici, kështu nuk njihet autori, shtëpia botuese, vendi dhe viti i botimit. Mendohet se i

përket shek. XVI. Në faqen e fundit ka të shkruar: "Venetiis Apud Cominum De Tredino Montisferrati"

1578

4. *Chronicorum Tvrcicorum, in quibus tvrcorum origo, principes, imperatores, bella, praelia...*

- *Impressum Francoforti ad Moenum : apud Iohannem Feyrabendt, Impenfis Sigifmundi Feyerabent, M.D.LXXVIII, 1578.*

2 Tom. ; 34 cm.

Tom. 1: 3 fl. pa num., 112 fl. : me il., 3fl. pa num.

Tom. 2: *Chronicorum in quibus diversorum regnorum, vrbivm, insvlarvm...*

- *Francofvrti ad Moenum : ex Officina Georgij Coruini, impensis Sigismundi Feyrabendii, M.D.LXXVIII, 1578. - 4 fl. pa num., 255 f. : me il.*

Titulli i përkthyer në shqip: "*Kronikat turke...*". Vëllimi I, i ndarë në tre libra, përfshin veprat e Filip Leoniçerit dhe të Johan Aventinit, ku jepen të dhëna për vërshimin e turqve në Ballkan dhe pushtimin e tokave shqiptare nga sulltan Murati II, Mehmeti II dhe Bajaziti II. Të dhëna biografike për Skënderbeun (f. 18 - 21, 25, 27, 129).

1578

5. *Chronicorum Tvrcicorum, in quibus vita, indoles, et adversvs tvrcas...Tomvs tertivs. - Impressum Francoforti ad Moenum, 1578. - 4 fl. pa num., 271 fl. : me il., 5 fl. pa num. ; 34.5 cm.*

Titulli i përkthyer në shqip: "*Kronikat turke...*". Vëllimi i tretë përfshin veprat e Marin Barletit "Historia e Skënderbeut", që mendohet të jetë ribotim i vitit 1537, dhe "Rrethimi i Shkodrës". Në fletën e titullit të këtij vëllimi jepet portreti i Skënderbeut.

Vepra është e pajisur me gravura të ndryshme mbi luftërat shqiptaro - turke të shek. XV.

1609

6. **Pontanus, Georgius Bartholdus.** *Scanderbegvs hoc est vita et res strenve feliciterque; gestae, Georgii Castrioti... / Georgius Bartholdus Pontanus. - Hanoviae: Typis Wecheliani apud Claudium Marnium & hered. Ioan. Aubrii, MDCIX, 1609. - 12 fl. pa num., 293 f. ; 16 cm.*

Titulli i përkthyer në shqip: "*Skënderbeu: jeta bëmat dhe ngjarjet e suksesshme të Gjergj Kastriotit...*"

Në kurriz të fletës së titullit jepet një portret i Skënderbeut me diçiturën: "Scanderbechvs".

1623

7. Sarrochi, Margerita. La Scanderbeide poema heroica... / Margerita Sarrochi. – Roma : Per Andrea Fei, Con Licenza de' Superiori, MDCXXIII, 1623. – 8 fl. pa num., 250 f. në dy kolona ; 21.5 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Skënderbeida. Poemë heroike e znj. Margarita Sarroki...*” Ky ribotim përbëhet nga 23 këngë. Ka gabime në numërimin e faqeve.

1664

8. Budi, Pjetër. Dottrina Christiana Composta per ordine della fel.me. Di Papa Clemente VIII... / përkth. Pjetër Budi. – Roma: Nella stampa della Sac. Cong. de Prop. Fide, Con licenza de' Sveriori, 1664. – 288 f. ; 14 cm.

“*Doktrina e Krishterë...*”, përkthyer në gjuhën shqipe nga hirësia e tij at Pjetër Budi nga Guri i Bardhë.

1685

9. Brown, Edvard. A Brief Account of some Travels In divers Parts of Europe... / Edvard Brown. – The second editions with many additions. – London : Prented for Benj. Tooke, at the Sign of the Ship in St. Paul's Church-yard, MDCLXXXV, 1685. – 2 fl. pa num., 22 f., 19 fl. me il. ; 32 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Raport i shkurtër i disa udhëtimeve në pjesë të ndryshme të Evropës...*”

Përshtypje udhëtimi nga Kosova dhe Maqedonia. Të dhëna për Prishtinën, Manastirin, Shkupin, Vranjën, Lekovcin...

1709

10. Duponcet, Jean Nicolas. Histoire de Scandebeg roy d' Albanie / Jean Nicolas Duponcet. -Paris: Chez Jean Mariette, ruë S. Jacques, aux Colonnes d' Hercule, 1709. – 12 fl. pa num., 590 f., 4 fl. pa num. ; 17 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Histori e Skënderbeut, mbret i Shqipërisë, nga hirësia e tij at Dyponse*”.

Kjo vepër konsiderohet si një variant i shkurtuar i Historisë së Barletit për Skënderbeun. Ajo ka njohur një botim tjetër po në të njëjtin vit, nga e njëjta shtëpi botuese, me ndryshime të pakta në zbukurimet në fillim të çdo kapitulli dhe në radhitjen tipografike.

1716

11. Da Lecce, Francesco Maria. Osservazioni grammaticali Nella Lingua Albanese del P. Francesco Maria Da Lecce Min.Oss.Rif.Esprefetto

Apostolico delle Missioni di Macedonia. Dedicato agli Eminenzissimi e Reverendissimi Signori Cardinali Della Sagra Congregazione di Propaganda Fede / Francesco Maria Da Lecce. – Roma : Nella Stamperia della Congregazione di Propaganda Fede, Con licenza de superiori, 1716. – 6 fl. pa num., 228 f. ; 22.5 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Vrojtime gramatikore në gjuhën shqipe nga At Françesko Maria Da Leçe...*”

Vepra konsiderohet si vepër e parë tërësore që njihet për gramatikën e gjuhës shqipe dhe është shkruar me alfabetin e Bogdanit.

1743

12. Kazazi, Gjon Nikollë. Breve Compendio della Dottrina Cristiana. Tradotta in lingua Albanese per l' utilità e istruzione dei Fanciulli di quella Nazione. Da un Nazionale del Regno di Servia. Alunno della Congregazione / Gjon Nikollë Kazazi. – Roma : Nella Stamperia della S. Congregazione de Propaganda Fide. Con licenza de' Superiori, MDCCXLIII, 1743. – 1 fl. pa num., 46 fl. ; 13 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Përmbledhje e shkurtër e Doktrinës së Krishterë. Përkthyer në gjuhën shqipe...*”

Kopje e vetme në Shqipëri.

1762

13. Cornelli Nepoti Vitae excellentium imperatorum. Brevioribus Adnotationibus Illystratae. - Romae: Typis Sacre Congregationis De Propaganda Fide Svsperiorvm Permessv, 1762. - XXXII, 380 f. ; 18 cm.

Jeta e imperatorëve të mëdhenj.

1815

14. Holland, Henry. Travels in the Ionian Isles, Albania, Thessaly, Macedonia, &c. : during the years 1812 and 1813 / Henry Holland. – London : Printed for Longman, Hurst, Rees, Orme and Brown, Paternoster - Row, 1815. – X, 552 f., 13 fl. me il.; 28cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Udhëtime në ishujt Jonianë, në Shqipëri, në Thesali, në Maqedoni etj.: gjatë viteve 1812 dhe 1813*”.

Udhëtim nëpër Shqipëri në itinerarin Janinë - Libohovë - Gjirokastër - Kardhiq - Tepelenë - Apoloni - Vlorë - Selenicë dhe kthim. Përshkrime dhe mbresa gjatë këtij udhëtimi.

1820

15. Hughes, Thomas Smart. Travels in Sicily Greece and Albania :

illustrated ëith engravings of maps scenery plans & c. / Thomas Smart Hughes. – London : Prented for J. Maëman, 1820. – 2 vol. : me il. ; 28 cm.
Vol. 1 : XII, 532 f., 10 fl. me il.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Udhëtime në Sicili, në Greqi dhe në Shqipëri*”.
Vëllimi i parë ka shtatëmbëdhjetë kapituj. Në to trajtohen mbresa të autorit nga arbëreshët e Greqisë; mbresa nga udhëtimet në Prevezë, Artë, Janinë, Sul, Çamëri; mbresa nga takimi me Ali Pashë Tepelenën.

1820

16. Hughes, Thomas Smart. Travels in Sicily Greece and Albania : illustrated ëith engravings of maps scenery plans & c. / Thomas Smart Hughes. – London : Prented for J. Mawman, 1820. – 2 vol. : me il. ; 28 cm.
Vol. 2 : VIII, 393 f., 6 fl. me il.

Vëllimi i dytë me pesëmbëdhjetë kapituj përfshin: jetën ekonomike, politike, dhe shoqërore në Pashallëkun e Janinës; ndarjen gjeografike, etnike dhe administrative të Shqipërisë; përshkrime të zakoneve, dokeve dhe mënyrën e jetesës së shqiptarëve si dhe tablo të udhëtimeve në Janinë, Libohovë, Gjirokastër etj.

1821

17. Hughes, Thomas Smart. Voyage à Janina en Albanie, per la Sicile et la Grèce / Thomas Smart Hughes. – Paris: Librairie de Gide Fils, 1821. – 2 Tom. ; 21.5 cm.

Tome premier : 326 f., 1 portr.

Titulli i përkthyer shqip: “*Udhëtim për në Janinë, në Shqipëri, përmes Sicilisë dhe Greqisë*” / Traduit de l’anglais par l’auteur de Londres en 1819.
Libri është i përkthyer nga anglishtja në frëngjisht dhe përshkruan mbresat e udhëtimit të autorit në Janinë, Shqipëri, Siçili dhe Greqi.

1821

18. Hughes, Thomas Smart. Voyage à Janina en Albanie, per la Sicile et la Grèce / Thomas Smart Hughes. – Paris : Librairie de Gide Fils, 1821. – 2 Tom. ; 21.5 cm.

Tome second : 351 f.

Titulli i përkthyer shqip: “*Udhëtim për në Janinë, në Shqipëri, përmes Sicilisë dhe Greqisë*” / Traduit de l’anglais par l’auteur de Londres en 1819.
Libri është i përkthyer nga anglishtja në frëngjisht dhe përshkruan mbresat e udhëtimit të autorit në Janinë, Shqipëri, Siçili dhe Greqi.

1822

19. Beauchamp, Alphonse de. Vie d’Ali Pacha, visir de Janina, surnomme

Aslan, ou Le Lion / Alphonse de Beauchamp. – Paris: Chez Villet, Libraire et Commissionnaire, 1822. – 346 f., 1 portr.; 20cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “Jeta e Ali Pashës, vizir i Janinës, i quajtur Asllan ose Luan”. Në libër përshkruhet hollësisht jeta e Ali Pashë Tepelenës dhe një histori e shkurtër e Shqipërisë që në kohët e hershme deri në fillim të shek. XIX.

1825

20. Papadopulo - Vreto, Andrea. Memoria su di alcuni costumi degli antichi Greci : tuttora esistenti nell' isola di Leucade nel mare Jonio / Andrea Papadopulo - Vreto. – Seconda Edizione. – Napoli: Dalla Stamperia Francese, 1825. – 63 f. ; 20 cm.

Titulli i përkthyer në shqip: “*Kujtesë mbi disa kostume të grekëve të vjetër: akoma ekzistues në ishullin e Leukadës*”. Ky botim është i rishikuar, korrigjuar dhe shtuar nga vetë autori.

1834

21. Schiró, Giovanni. Rapporti tra l'Epiro e il regno delle due Sicilie, Memoria I. : Epoca antica / Giovanni Schiró. – Palermo: Dalla tipografia del Giorn. Letterario, 1834. – 35 f. ; 20 cm.

Titulli shqip: “*Marrëdhëniet midis Epirit dhe Mbretërisë së dy Siçilive, Kujtime I.: Epoka antike*”. Pellazgët, zhvendosjet e tyre nga Gadishulli Ballkanik në Itali dhe e kundërta. Gjuha shqipe, prejardhja e saj nga pellazgjishtja e lashtë.

1842

22. Best, J.J. Excursions in Albania: Comprising a description of the wild boar, deer and woodcock shooting in that country: And a journey from thence to Thessalonica & Constantinople, and up the Danube to Pest / J. J. Best. – London: H. Allen and Co., 1842. – XII, 359 f., 1 hartë; 34 cm.

Titulli shqip: “*Ekskursionet në Shqipëri: përfshirë një përshkrim gjuetie të dërrit të egër, drerit dhe të shapkës në këtë vend*”. Dy udhëtime në Shqipëri gjatë viteve 1838 dhe 1839. Udhëtimi i parë: Korfuz - Filat - Janinë - Artë - Prevezë - Korfuz dhe udhëtimi i dytë: Korfuz - Sarndë - Delvinë - Janinë - Selanik. Përshkrime dhe mbresa nga udhëtimi.

1847

23. Dorsa, Vincenzo. Su gli albanesi ricerche e pensieri / Vincenzo Dorsa. – Napoli : Tipografia Trani, 1847. – 170 f. ; 20 cm.

Titulli shqip: “Për shqiptarët kërkime dhe mendime”. Autori ia kushton

veprën kombit shqiptar “Alla mia nazione divisa e dispersa ma una”, “Të ndarë e të shpërndarë por një”. Libri është i ndarë në XX kapituj dhe trajton njohuri historike, gjeografike, etnografike, folklorike, gjuhësore për shqiptarët dhe arbëreshët.

1847

24. Discorso del Consigliere di Stato Angelo Masci sull' origine, i costumi e lo stato attuale degli Albanesi del regno di Napoli / Masci, Francesco. – Terza edizione. – Napoli : Stabilimento Tipografico di Gaetano Nobile, 1847. – 82 f. ; 20cm.

Titulli në shqip: “Diskutimi i Këshilltarit të Shtetit Angelo Masci mbi origjinën, zakonet dhe gjendjen aktuale të shqiptarëve në Mbretërinë e Napolit”.

1853

25. Hahn, Johann Georg. Albanesische Studien / Johann Georg von Hahn. – Wien : Aus der kaiserlich-königlichen Hof - und Staatsdruckerei, 1853. – 2 v. ; 26cm.

V. 1: 347 f.

V. 2: 169 f.

Vëllimi i parë përfshin: - Vështrim gjeografiko-etnografik i Shqipërisë, - Përshkrime udhëtimi, - Zakone dhe doke të shqipëtarëve, - A janë shqiptarët autoktonë?, - Alfabeti i shqipes, - Pjesa historike.

Vëllimi i dytë përfshin: - një studim gjuhësor të dialektit toskë, - Pjesë leximi nga dialektet toskë dhe gegë.

1858

26. Hecquard, Hyacinthe. Histoire et description de la Haute Albanie ou Guegarie / Hyacinthe Hecquard. – Paris : Arthur Bertrand, 1858. – XVII, 516 f., 2 harta ; 21 cm.

Titulli shqip: “Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë Veriore ose Gegërisë”. Autori, një prej konsujve francezë në Shkodër, me këtë vepër pasuron fushën e studimeve albanologjike.

1858

27. Broughton (Lord). Travels in Albania and other provinces of Turkey in 1809 & 1810 / Lord Broughton. – New Edition, revised and corrected 1858. – London: John Murray, 1858. – In two volumes; 22cm.

Vol. 1: Journey through Albania. – Xi, 544 f.

Vol. 2: Journey through Albania. – Vii, 528 f.: 2 harta, 2 f. nota muzikore

Titulli shqip: “Udhëtime në Shqipëri dhe provinca të tjera të Turqisë”. Në volumnin e parë gjendet një faksimile e një letre të Ali Pashës me firmën e tij, kurse në volumnin e dytë gjenden dy faqe me nota muzikore të një këngë greke.

1872

28. Kristoforidhi, Kostandin. Abetar shqip prei Konstantinit Kristoforidit Elbasanasit. – Konstandinopol: Ndë Shtypa-shkronjë të A. H. Boyaxhianit, 1872. – 32 f. : me il. ; 19 cm.

1873

29. Wassa (Effendi), P. Rose e spine / P. Wassa Effendi. – Costandinopoli: Stamperia di A. Coromila, 1873. – 78 f. ; 20 cm.

Titulli shqip: “Trëndafilë dhe gjëmba”, libër me poezi. Autori: Pashko Vasa.

1879

30. Alfabetare e Gluhësë Shqip. – Konstandinopojë: Ndë shkronjështypjet të A. Zelicit, 1879. – 2 f. pa num., 136 f.; 18 cm.

Kjo Abetare njihet si “Abetarja e Stambollit”, me autorë Jani Vreto, Sami Frashëri, Koto Hoxhi dhe Pashko Vasa.

1881

31. Pétrovitch, Georges T. Scanderbeg (Georges Castriota) : Essai de bibliographie raisonnée. / Georges T. Pétrovitch. – Paris: Ernest Leroux (Vienne : Typ. Adolphe Holzhausen), 1881. – 187 f. 19 cm.

Bibliografia e arsyetuar e Petrovitch-it radhit më shumë se dyqind vepra, në nëntë gjuhë të ndryshme, që i dedikohen heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Mbetet vepra më e plotë nga pikëpamja bibliografike.

1888

32. Meyer, Gustav. Kurzgefasste Albanesische Grammatik: mit lesestücken und glossar / Gustav Meyer. – Leipzig: Druck und Verlag von Breikopf & Härtel, 1888. – 105 f. ; 22 cm.

Një përmbledhje e gramatikës shqipe nga Gustav Meyer, pjesë leximi dhe një fjalor në fund të librit.

1897

33. Dozon, Auguste. Manuel de la langue chkiye ou albanaise: grammaire – vocabolaire - chrestomathie / Auguste Dozon. – Paris: Ernest Leroux,

1897. – 348, 104 f. ; 24 cm.

Manual i gjuhës shqipe: gramatikë – fjalor – krestomaci.

1924

34. Šufflay, Milan v. Städte und Burgen Albaniens : hauptsächlich während des Mittelalters / Milan v. Šufflay. – Wien und Leipzig : Hölder – Pichler – Tempsky A. – G., 1924. – 82 f. ; 30cm.

Titulli shqip: “Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë: kryesisht në Mesjetë”

1936

35. Migjeni. Vargjet e lira / Migjeni. – Tiranë: Shtypshkroja “Gutenberg”, 1936. – 84 f. ; 19 cm.

Kjo kopje është pa kopertinën origjinale, pasi është një nga librat që u censuruan në shtypshkronjën “Gutenberg”. Përmban “kangët” origjinale të shkruara nga autori Millosh Gjergj Nikolla (Migjeni).

Kangët e ringjalljes. Kangët e mjerimit. Kangët e përndimit. Kangët e rinis.

**Nekrologji
Njazi Kazazi
(1948-2021)**

“Njeri puno, mos pusho kurrë” - NAIMI



Kjo thënie e rilindasit shqiptar, Naim Frashëri, u gjend në një bllok ruajtur me kujdes, me shënime nga letërsia e huaj, në vitin e largët 1969, prej dorës së të përndriturit profesor Njazi Kazazi.

Në arkivën e pasur të ndërtuar e ruajtur me përkushtim prej profesorit, dora e bijës së tij fort të dashur, zgjodhi jo pa qëllim të na prezantonte bujarisht këtë “cikërrimë letrare”, që është si një *sumum* për të stilizuar shkurtimisht stilin e jetën e profesor Njaziut.

Profesor Kazazi u largua kësaj jete në të hyrë të pranverës 2021, më 10 mars, rreth orës 9³⁰. Ai ishte didakt i njohur, profesor i dashur dhe “Mësues i Merituar”.

Lindi në qytetin e Shkodrës. Kreu shkollën e mesme pedagogjike “Shejnaze Juka”, e studimet e larta në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës, në degën Gjuhë shqipe e letërsi, më 1975. Ka punuar mësues në Pukë, Gruemirë (Malësi e Madhe) për 26 vite, duke shërbyer me pasion e përkushtim. Më pas, shërbeu si metodist në Kabinetin Pedagogjik të rrethit Shkodër, duke ushtruar pranë këtij institucioni të rëndësishëm në jetën shkollë të kohës, detyrën e drejtorit në vitet 1983-1990. Veprimtaria e tij e spikatur e didaktit vijoi me detyrën e përgjegjës të sektorit të kontroll-kualifikimit në Drejtorinë Arsimore të Shkodrës. Më 1993 e deri më 2018, ka qenë pedagog-didakt pranë Departamentit të Gjuhës shqipe, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, titullar për disiplinat “Didaktikë e gjuhës shqipe”, “Metodikë e kërkimit shkencor”, “Organizim e drejtim arsimit”, “Shkrim akademik”.

Profesor Njaziu ishte një edukator shumë i mirë i studentëve të degës Gjuhë shqipe e Letërsi në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, si dhe atyre të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në universitetin tonë, të cilët kanë pasë fatin të marrin leksione prej tij. Te profesori, ata veçonin me respekt përgatitjen dhe metodën e mësimdhënies. Për veprimtari të spikatur në fushë të mësimdhënies e të kërkimit shkencor, më 1999, fitoi titullin “*Profesor i asociuar*”, kurse më 2004, mori titullin “*Profesor*”.

Me disiplinën e hekurt në punë, me përkushtimin pa kushte për formimin e mësuesit të ri, me kërkimin skrupuloz në rrënjët e historinë e didaktikës shqiptare në fushë të gjuhës shqipe, me vëmendjen e kujdesshme ndaj njeriut koleg, student, bashkëpunëtor, profesor Njazi Kazazi la modelin e qytetarit atdhedashës, e profesionistit të kuar për të gjithë ata, të cilët patën fatin me e njohë nga afër atë. Prodhimi i tij gjuhësor e didaktik gjendet në dhjetëra artikuj e studime në revista shkencore periodike brenda e jashtë vendit, si p.sh. në revistën “*Univers*”(organ i ISHMQI), ku analizohen e vlerësohen figura e kontribute të shquara në fushë të shqipes e kulturës sonë.

Prodhimtaria kërkimore-studimore, përfshin kumtime në konferenca e veprimtari shkencore ndër vite. Vepra e kontributi i Profesor Kazazit përfshihet në botimet e mëposhtme:

- “*Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*”, botim i MASH, Tiranë, 2000 (në bashkëpunim me prof. dr. Sh. Osmani).
- “*Universiteti i Shkodrës ndër vite, 1957-2002*”, Historiku, Shkodër, 2002 (Grup autorësh).
- “*Botime në USH, 1957- 2002*”, Shkodër, 2003 (në bashkëpunim me Gj. Çuni).
- “*Bibliografi e Buletinit shkencor të USH “Luigj Gurakuqi*”, Shkodër, 2005, (në bashkëpunim me prof. dr. M. Hoti, Gj. Çuni).
- “*Në gjurmët e një didakti*”, Instituti i Kurrikulës dhe i Standardeve, Tiranë, 2005.

- “*Faik Luli- jeta e veprimtaria*”, monografi, Shkodër, 2006, (në bashkëpunim me I. Dizdari, I. Hoti, A. Mesi).
- “*Universiteti i Shkodrës në 50-vjetorin e tij, 1957- 2007*”, Shkodër, 2007, (Grup autorësh).

Tekste universitare:

- “*Udhëzues metodik për punën kërkimore-shkencore*”, Shkodër, 2000.
- “*Organizim dhe drejtim arsimit*”, Shkodër, 2003 (në bashkëpunim me N. Zhabjaku).
- “*Udhëzues për punën kërkimore- shkencore*”, Shkodër, 2003 (në bashkëpunim me prof. R. Gurakuqi”).
- “*Hyrje në metodikën e punës shkencore*”, Tiranë, 2004 (në bashkëpunim me prof. Gj. Shkurtaç, prof. Y. Çiraku).
- “*Didaktikë e gjuhës shqipe*”, Tiranë, 2005 (në bashkëpunim me N. Garuci, N. Zhabjaku).
- “*Shkrim akademik*”, Tiranë, 2007 (në bashkëpunim me I. Hoti, M. Hysa).
- “*Metodikë e kërkimit shkencor*”, Shkodër, 2007 (në bashkëpunim me I. Hoti).
- “*Didaktikë e gjuhës shqipe, për CU*”, Shkodër, 2009 (në bashkëpunim me I. Hoti).
- “*Bibliografi e veprave e ligjëratave të profesor Sh. Osmani, e shkrimeve për të*”, Tiranë, 2015 (në bashkëpunim me studiuesen U. Osmani).
- “*Portrete të shquara*”, Shkodër, 2018.

Penda e profesor Kazazit gjendet edhe në faqet e shtypit me karakter fetar-kulturor e shpirtëror, “*Zani i Naltë*” (organ zyrtar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, themeluar më 1923).

Me ndarjen kësaj jete të Njazi Kazazit, për çdo koleg, bashkëpunëtor apo student, edhe më e madhe do të jetë përgjegjësia prej

intelektuali të ndershëm për secilin prej tyre, për të vazhduar punën e tij në drejtim të përmirësimit, e thellimit të punës, veçanërisht në lëmi të studimeve didaktike, si një betejë e nevojshme, që nuk duhet të vonohet. Falemnderit, i dashur profesor!!!

Bora Logu

JETA SHKENCORE**AKTIVITET SHKENCOR PROMOVUES KUSHTUAR 25-VJETORIT TË KRIJIMIT TË QENDRAVE KËRKIMORE-SHKENCORE TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS**

Në ditën botërore të librit, më 23.04.2021, Universiteti i Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” organizoi një aktivitet promovues për 25-vjetorin e krijimit të qendrave kërkimore-shkencore të Universitetit të Shkodrës, përkatësisht *Qendrës së Studimeve Albanologjike* dhe *Qendrës së Studimeve të Ujërave të Rajonit të Shkodrës*. Në këtë aktivitet u prezantua puna voluminoze, vlera dhe kontributi shkencor i këtyre dy qendrave të Universitetit. U theksua puna e bërë nga Qendra e Studimeve Albanologjike, e cila gjatë kësaj periudhe ka botuar 36 monografi (mbi 12 mijë faqe shtypi), duke kontribuar në shumë drejtime të Albanologjisë, por sidomos në pasqyrimin dhe vlerësimin e kulturës shkrimore gege; ndërsa për Qendrën e Studimeve të Ujërave të Rajonit të Shkodrës, përveç botimeve me rëndësi në këtë fushë, u vu në dukje organizimi e pjesëmarrja në shumë projekte ndërkombëtare me rëndësi të veçantë për studimin e ekosistemit dhe kompleksit ujor të zonës së Shkodrës.

Në këtë aktivitet, një vend të veçantë iu kushtua veprimtarisë kërkimore-shkencore të profesoratit të Universitetit të Shkodrës, ku përmes një katalogu të botimeve, titulluar “*Tregues kronologjik i botimeve të pedagogëve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*” përmbledhej puna studimore e botuar për periudhën 2003-2020. Në këtë katalog të botimeve janë përfshirë 177 tituj veprash, që si volum kapërcejnë 32 mijë faqet e botuara, 14 prej tyre janë botime në gjuhë të huaj, ndërsa 9 janë botuar nga shtëpi botuese në vendet e Bashkimit European.

Në fjalën përshëndetëse, prof. dr. Suzana Golemi, rektorja e Universitetit të Shkodrës mes të tjerash, theksoi se kërkimi shkencor në Universitetin e Shkodrës, së bashku me transferimin e teknologjive dhe inovacionit janë faktorë themelorë në rritjen e cilësisë së botimit dhe të orientimit të dijes. Rektorja Golemi shprehu besimin se falë stafit të përkushtuar akademik të Universitetit të Shkodrës, infrastrukturës, bazës laboratorike mbi të cilat po investohet gjithnjë e më shumë, projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, ku jemi organizatorë dhe pjesëmarrës, ky Universitet do të vazhdojë të renditet ndër vatrat arsimore më të suksesshme në vend.

Takimi vijoi me prezantimin e punës kërkimore të qendrës së

studimeve albanologjike, e cila u prezantua nga dr. Zamira Shkreli, përgjegjëse e kësaj qendre, e cila paraqiti punën 25-vjeçare të bërë në QSA dhe përpjekjet e një plejade pedagogësh që dhanë kontributin e tyre në këtë institucion duke lënë gjurmë në kërkimin shkencor në fushat përkatëse të studimeve shqiptare.

Takimi vijoi me prezantimin punës kërkimore të Qendrës së Studimeve të Ujërave në Rajon nga prof. Marash Rakaj, përgjegjës i kësaj qendre, i cili u ndal te rezultatet e dukshme studimore që kjo qendër ka arritur, sidomos mbi vrojtimin dhe analizimin e cilësive kimike dhe mikrobiologjike të ujërave të liqenit të Shkodrës dhe të biodiversitetit të rajonit tonë.

Dr. Erzen Koperaj, anëtar i Qendrës së Studimeve Albanologjike, u ndal në kontributin e studiuesve të këtij Universiteti, që përfshin jo vetëm tekste universitare, por shpeshherë arritje në fusha të mirëfillta jo vetëm në atë të albanologjisë, por edhe në disiplinat e tjera shkencore.

Në përmbyllje, fjalën e mori akademiku Bahri Beci (i ftuar nderi në këtë aktivitet), i cili vlerësoi punën ndër vite të pedagogëve të Universitetit të Shkodrës. Ai inkurajoi profesoratin e këtij universiteti, që me ritme të tilla të vijohet edhe në të ardhmen, pasi kanë “barrën” e përfaqësimit të një tradite të hershme të qytetit që mbart mbi vete historinë shekullore të arsimit dhe kulturës, por edhe me shikimin nga e ardhmja.

Ndërkohë, në hollin e rektoratit u prezantua një ekspozitë e librit universitar ku u shfaq një panoramë shkencore rreth punimeve ndër vite të pedagogëve dhe studiuesve të cilët shërbyen dhe vazhdojnë të kontribuojnë në Universitetin e Shkodrës.

Qendra e Studimeve Albanologjike

LETËRSIA SHQIPE DHE TRANZICIONI

Diskurs kulturor

Departamenti i Letërsisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” organizoi aktivitetin kulturor dhe shkencor: “*Letërsia shqipe dhe tranzicioni. -Diskurs kulturor-*” të konceptuar në katër pjesë dhe të realizuar në datat 5, 8, 9 dhe 12 korrik 2021, në bashkëpunim me Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës; Biblioteka Shkencore e Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”; Biblioteka Publike “*Marin Barleti*”, Muzeu Kombëtar i Fotografisë “*Marubi*”.

Aktiviteti pati në fokus nxitjen e një diskutimi kulturor dhe shkencor përmbi letërsinë shqipe dhe artet e tjera gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri. Ndërkaq nga departamenti i Letërsisë u synua që

përmes aktivitetit të merret një rol prijës kulturor në orientimin e publikut drejt vlerave të mirëfillta estetike të krijuara gjatë kësaj periudhe në letërsinë dhe artin bashkëkohor shqiptar. Janë angazhuar në këto diskutime përmes veprave të tyre studimore të botuara, pedagogë të këtij departamenti, si: prof. as. dr. Arben Prendi, prof. as. dr. Valbona Karakaçi, doc. Ridvan Dibra, dr. Gëzim Puka, dr. Ermira Alia, por edhe bashkëpunëtorë me departamentin, si: prof. dr. Stefan Çapaliku nga Akademia e Studimeve Albanologjike, në Tiranë, prof. as. dr. Albert P. Nikolla nga Universiteti i Durrësit, studiues dhe botues, si: prof. as. dr. Ag Apolloni nga Universiteti i Prishtinës dhe Frano Kulli nga shtëpia botuese “Gjergj Fishta”.

Aktiviteti ishte konceptuar në katër takime me studiues të fushave kulturore: letërsi, antropologji, arte (pikturë, teatër, arkitekturë, muzikë, kinema) dhe botime.

Takimi i parë

Takimi i parë u mbajt më 5 korrik, ora 11.00 tek Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, në Shkodër dhe u konceptua e moderua nga prof. as. dr. Valbona Karakaçi. Duke krijuar një situatë interaktive me publikun prof. Karakaçi shtjelloi edhe analizën e saj lidhur me temën e takimit duke ndërthurur shtjellimin me diskutimet e studiuesve, por edhe me opinionet e publikut.

Në këtë takim paraqiten tezat e tyre për tranzicionin në letërsi dhe në antropologji, studiuesit: prof. as. dr. Arben Prendi, përmes studimit “*Fatos Kongoli*” dhe prof. as. dr. Albert P. Nikolla përmes studimit “*Njeriu i ri shqiptar*”. Prof. Prendi vuri në dukje se vepra letrare e shkrimtarit Fatos Kongoli është ndër veprat që u bë dëshmitare e periudhës dhe e njeriut të tranzicionit shqiptar. Kjo dëshmohet edhe në faktin se shumica e personazheve të tij janë personazhe me trauma të forta që burojnë nga e kaluara e regjimit komunist, por edhe nga e tashmja e tranzicionit. Në romanet e këtij autori gjejmë pikërisht problematikën dhe tematikën e shoqërisë shqiptare në tranzicion, më shumë se te çdo shkrimtar tjetër.

Në këtë aktivitet u përfshinë edhe studentët: Elsa Zhejani, Deada Smajlaj, Klevisa Bardeli, Laura Kasteri në vitin e dytë të programit të studimit bachelor në Gjuhë-Letërsi, të cilët lexuan pjesë dhe citate nga veprat e Fatos Kongolit që lidhen me temën e tranzicionit.

Gjatë takimit nga moderatorja u përfshinë në diskutim edhe të pranishmit së sallë, të cilët shfaqën opinionet e tyre lidhur me temën e diskutimit.

Prof. as. dr. Albert Nikolla paraqiti në diskutim argumentin e tij për “*Njeriun e ri*” që propaganda e regjimit komunist u përpoq ta krijonte me çdo kusht, për të siguruar ekzistencën e vet.

Prof. as. dr. Paulina Hoti e pranishme në këtë takim vlerësoi rëndësinë e këtyre diskurseve kulturore për gjallërimin e jetës universitare, por edhe kulturore duke vlerësuar me këtë rast kontributin e departamentit të Letërsisë për realizimin e këtij aktiviteti.

Takimi i dytë

Takimi i dytë u mbajt më 8 korrik tek Biblioteka Shkencore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Kjo veprimtari e konceptuar dhe e moderuar nga dr. Gëzim Puka (kritik letrar dhe pedagog i Departamentit të Letërsisë) u përqendrua tema “*Shkrimtari në tranzicion*” si dhe tek librat më të fundit të këtij autori: “*Për romanin dhe romanet*” dhe “*Gruaja që deshe*”.

Me të pranishmit, pedagogë, studentë dhe intelektualë të njohur të qytetit, u ndanë mendimet e vyera për veprat më të fundit të shkrimtarit R. Dibra; për procesin krijues; për përmbajtjen dhe formën e tekstit letrar; për qëllimshmërinë autoriale dhe kuptimin e veprës; për mjetet e mëdha shprehëse që ka arti i fjalës; për përkthimin dhe vlerat e letërsisë shqipe bashkëkohore.

Takimin e pasuroi edhe një paraqitje artistike në formën e një montazhi letrar me pjesë nga libri i R. Dibrës “*Për romanin dhe romanet*”. Studentët Lazarino Pjetri, Klevisa Bardeli, Klea Nika dhe Deada Smajlaj interpretuan copëza mjaft interesante dhe morën duartrokitje të ngrohta nga pjesëmarrësit.

Në fjalën e tij të rastit drejtori i departamentit të Letërsisë, prof. as. dr. Arben Prendi, vuri në dukje kapacitetet e departamentit të Letërsisë për të qenë një faktor i rëndësishëm në jetën shkencore të universitetit, por edhe në jetën kulturore në përgjithësi. Më tej ai bëri një paraqitje të programeve të studimit ku departamenti është bashkëdrejtues dhe drejtues i tyre si: bachelor në Gjuhë - Letërsi, Gazetari dhe komunikim; Master profesional në Mësuesi në Gjuhë - Letërsi dhe Master shkencor “Etnokultura dhe letërsia shqipe”. Ai vlerësoi edhe performancën e mirë të anëtarëve të departamentit si në mësimdhënie, ashtu edhe në punën shkencore e krijuese.

Duke përshëndetur veprimtarinë, rektorja e Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” prof. dr. Suzana Golemi, shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen në këtë veprimtari. Ajo vlerësoi punën ndër vite të pedagogut dhe shkrimtarit Ridvan Dibra, si dhe falënderoi Departamentin e

Letërsisë për organizimin e aktivitetit kulturor “*Letërsia shqipe dhe tranzicioni - diskurs kulturor-*”.

Takimi vijoi me diskutime dhe pyetje nga të pranishmit.

Takimi i tretë

Takimi i 3-të i aktivitetit “*Letërsia shqipe dhe tranzicioni*” u zhvillua më 9 korrik, në Bibliotekën Publike “*Marin Barleti*”. Ai kishte në fokus: “*Botuesit në tranzicion*”. Për këtë ishin ftuar dy përfaqësues nga dy shtetet shqiptare: njëri: Frano Kulli, drejtues i Entit Botues “*Gjergj Fishta*” (Shqipëri) dhe tjetri, Ag Apolloni, (prof. as. dr) drejtues i Shtëpisë Botuese “*Bard Books*” (Kosovë).

Takimin e hapi drejtori i departamentit të Letërsisë, prof. as. dr. Arben Prendi që theksoi se janë zgjedhur këto shtëpi botuese, pasi kanë dëshmuar cilësi, si në tituj e përmbajtje, qoftë në cilësitë fizike të librave që kanë botuar. Ai gjithashtu e quajti takimin të rëndësishëm veçanërisht për krijuesit, për mundësinë e kontakteve që ofron dhe shfrytëzoi rastin të ftojë të gjithë botuesit, por edhe institucionet qendrore dhe lokale për të punësuar studentët që përfundojnë programin e studimit bachelor në Gjuhë-Letërsi, si redaktorë gjuhësorë dhe letrarë.

Takimi u moderua nga dr. Ermira Alija, kërkuese shkencore e cila u përqendrua tek roli i botuesve dhe i pozitës së tyre në periudhën e tranzicionit, sfidat dhe realitetet me të cilat përballen ata, për vijimësinë e tablosë së përgjithshme të botimeve në tranzicion në Shqipëri dhe Kosovë, për nevojën e krijimit të një rrjeti më të fortë filtrues nga shtëpitë botuese, për presionin që ushtron tregu në politikën e botimeve, për ndërkomunikimin e letërsisë që shkruhet në dy shtete të ndryshme shqipfolëse, për rolin që mund të luajë shteti në përkujdesjen për librin etj. Botuesit përmendën disa fakte interesante që kënë ndikuar në ndryshimin e tablosë së botimeve, referuar ndryshimeve në kohë, si për shembull, faktin që në vitet para tranzicionit kishte botime që shkonin në një tirazh prej 10 000, 20 000 apo 50 000 kopje, kurse tani botimet e suksesshme mund të kenë një tirazh mesatar që shkon deri në rreth 1 000 kopje. Ato treguan se mbijetesa e shtëpive botuese, nuk është vetëm çështje dëshirash, por edhe e një sërë mekanizmash.

Shumësinë e llojeve dhe titujve të botuar e konsiderojnë liri, që nuk përket shpesh në cilësi. Kjo, u fol sidomos për realitetin e Shqipërisë, në fazën e fillimit të tranzicionit, kurse në kohën e sotme ata konstatojnë se dëshira për të botuar dhe tregu kanë gjetur një farë vetërregullimi, pa mohuar domosdoshmërinë e mekanizmave të tjerë rregullues që duhet të ndërhyjnë.

Në takim pati edhe pyetje dhe diskutime nga të pranishmit. Të dy pjesëmarrësit falënderuan organizatorët, kurse drejtuesi i Entit Botues “Gjergj Fishta”, z. Frano Kulli, theksoi se e konsideron një dëshirë të kahershme këtë takim, bile shprehu nevojën për një bashkëpunim më të madh të universitetit me botuesit.

Takimi i katërt

Departamenti i Letërsisë pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në kuadrin e aktivitetit: *Letërsia shqipe dhe tranzicioni. -Diskurs kulturor-* organizoi, më 12 korrik, në bashkëpunim me Akademia e Studimeve Albanologjike, tek Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” takimin e katërt me temë: *Arti shqiptar në tranzicion*.

Prof. dr. Stefan Çapaliku, nga Akademia e Studimeve Albanologjike, autori i veprës *arti bashkëkohor shqiptar - kundrimet estetike 1991-2011* dhe prof. as. dr. Arben Prendi, moderatori i takimit, nga departamenti i Letërsisë, theksuan përmes disa analizave dhe interpretimeve veçori të teatrit, muzikës, kinemasë, pikturës dhe arkitekturës shqiptare gjatë periudhës së tranzicionit. Bashkëbisedimi u konceptua në dy pjesë.

Në pjesën e parë diskutimi nxori në pah kompleksitetin e llojeve të ndryshme të artit përgjatë tranzicionit shqiptar, arritjet dhe risitë e tij në kërkim të rrugëve të reja për mjete artistike, por edhe për mënyrën se si ky art bëhet shprehje e asaj me të cilën përballet njeriu dhe shoqëria shqiptare e kësaj periudhe.

Në pjesën e dytë, aktori Enver Hyseni paraqiti një interpretim nga drama “*Dome*” e Stefan Çapalikut. Pastaj dramaturgu i njohur solli në vëmendje të publikut disa prej dramave të tij më të sukseshme, në të cilat gjenden pjesë të mozaikut të jetës së shoqërisë shqiptare në tranzicion. Takimi u shoqërua edhe me ilustrime nga vepra të artit bashkëkohor shqiptar dhe u prit me interes nga publiku në sallë. Ky takim shënoi edhe mbylljen e aktivitetit.

Përfundimi

Aktiviteti kulturor dhe shkencor: “*Letërsia shqipe dhe tranzicioni. - Diskurs kulturor-*” i organizuar nga Departamenti i Letërsisë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për afro një javë u prit me interes nga publiku në sallat e takimeve, por edhe në rrjetet sociale, ku këto takime u pasqyruan dhe u ndoqën nga dhjetëra të interesuar për kulturën dhe artin tonë. Aktiviteti zgjoi interesin dhe vëmendjen e publikut të gjerë për departamentin e Letërsisë, por edhe për

vetë Universitetin e Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”. Në këto takime përveç të tjerash u synua edhe përcjellja tek publiku i informacioneve lidhur me programet e studimit në të cilat departamenti i Letërsisë është bashkëdrejtues me departamentin e Gjuhësisë, si: bachelor në Gjuhë-Letërsi, master profesional në Mësuesi në Gjuhë-Letërsi, si edhe drejtues i programeve të studimit: bachelor në Gazetari dhe Komunikim, master shkencor në Etnokulturë dhe letërsi shqipe. Takimet u ndoqën në salla dhe direkt, përmes rrjeteve sociale. Nga reagimi pozitiv i shumë kolegëve dhe i publikut, besojmë se aktiviteti i arriti qëllimet e synuara.

Falënderojmë për mikpritjen dhe mbështetjen e takimeve tona: Muzeun Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, Bibliotekën Shkencore të Universitetit të Shkodrës, Bibliotekën Publike “Marin Barleti”, Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi”, Shoqatën e Shkrimtarëve të Shkodrës, Bashkinë Shkodër, si edhe të gjithë studiuesit, krijuesit, botuesit e pedagogët dhe studentët që u bënë pjesë e këtyre takimeve dhe dhanë kontribute për realizimin e tyre. Një falënderim të veçantë kemi gjithashtu për publikun, i cili, pavarësisht temperaturave të larta, na ndoqi nga njëri takim në tjetrin. Dhe nuk mund të harrojmë këtu kontributin e çmueshëm të mediave lokale të qytetit të Shkodrës, për pasqyrimin e këtij aktiviteti, si stacionet televizive: Star Plus, TV1 Shkodra, Tv Rozafa, TVSH etj..

KONFERENCË SHKENCORE

“DANTE ALIGHIERI: PROFET I SHPRESËS DHE POET I DËSHIRËS NJERËZORE”

Në kuadër të aktiviteteve për nder të 700 -vjetorit të vdekjes (25 mars 1321-2021) së poetit Dante Alighieri, Konferenca Ispeshkvnore Shqiptare në bashkëpunim me Departamentin e Letërsisë në Universitetin e Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” organizoi, më datën 21.05.2021 konferencën “*Dante Alighieri: profet i shpresës dhe poet i dëshirës njerëzore*”. Konferenca u moderua nga dr. Ermira Alia, pedagoge e departamentit të Letërsisë.

Përveçse si vepër letrare me rëndësi për letërsinë botërore, vepra e shkrimtarit të madh Dante Aligieri u pa edhe si një vepër që nxit dialogun ndërkulturor në ditët e sotme.

Duke përshëndetur konferencën, Imzot Angelo Masaffra O.F.M. Kryetar i KISH, iu referua letrës apostolike *Candor Lucis Æternæ të Atit të Shenjtë Françesku*, në 700-vjetorin e vdekjes së Dante Aligierit, e sapo përkthyer në gjuhën shqipe. Kjo letër përmbledh pikëpamjet e Papëve mbi veprën e poetit që ka ushtruar një ndikim të madh kulturor edhe në botën shqiptare. Itinerari i Dantes, thotë Papa Françesku, është në vërtetë rruga e

dëshirës së brendshme për ta ndryshuar jetën vetjake në mënyrë që të arrijë lumturinë e kështu t'ua tregojë rrugën atyre që e gjejnë veten si poeti, në një pyll të errët ku kanë humbur rrugën e drejtë. Në kuadrin e realitetit kulturor shqiptar, ku debati kulturor mbi përdorimin e shqipes ende nuk ka përfunduar, Imzot Masaffra theksoi nevojën e njohjes edhe të veprave të tjera të poetit si *De vulgari eloquentia* në të cilën shprehen pikëpamjet e poetit për përdorimin e gjuhës popullore si gjuhë e gjallë.

Prof. as. dr. Paulina Hoti (Guli), zv.Rektore e Universitetit të Shkodrës falënderoi Konferencën Ipeshkvore të Shqipërisë që bëri pjesë të iniciativës së saj për të nderuar poetin Dante Aligieri edhe Universitetin e Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*" përmes bashkëpunimit me departamentin e Letërsisë. Duke e parë këtë aktivitet si pjesë e dialogut ndërkulturor, ajo theksoi rolin dhe misionin e universiteteve në nxitjen e jetës kulturore, shkencore, por edhe të dialogut ndërkulturor. Institucionet tona kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin e së ardhmes së shoqërisë shqiptare ndaj duhet vijojë bashkëpunimi mes nesh dhe të interesuarve të tjerë. Prof. as. dr. Paulina Hoti falënderoi departamentin e Letërsisë dhe studentët që u bënë pjesë e këtij organizimi.

Më pas përmes disa kumtesave u analizuan veçori të veprës *Komedia Hyjnore*, jehonës së saj në kohët moderne, si dhe takimit të kulturës shqiptare me të përmes përkthimeve.

Në temën *Poezia- shtegu i përkryerjes së dashurisë*, Don Robert Kola (Instituti Teologjik i Shkodrës) theksoi faktin se nderimi i poetit Dante Aligieri është tashmë në traditën e Kishës Katolike që nga Papa Benedikti në shek XV përmes letrave apostolike ku shqyrtohen aspekte të ndryshme të kësaj vepre. Ai u ndal në shqyrtimin e përshkrimeve poetike në *Komedinë Hyjnore të misterit të mishërimit* në krahërorin e Virgjërës Mari, veçanërisht në këngën e fundit të Parajsës, si dhe *misterit të Trinisë e buzëqeshjes së amshueme*. Më tej, don Robert Kola, vuri në dukje lidhjet e *Komedisë Hyjnore* me traditën biblike, ku njeriu i thuri poezinë e parë gruas, duke brohoritur "*Kjo është ashti i eshtrave të mi, mishi i mishit tim!*" (Libri i Zanafillës 2/23). Poezia e Dantes shfaq përsosjen e dashurisë, gjykimi i fundit shfaqet si përforcim që përkryen dashurinë. Filozofia dhe teologjia vijnë pas poezisë, tha don Robert Kola, duke vlerësuar gjenialitetin dhe universalitetin e poezisë së Dantes.

Drejtori i departamentit të Letërsisë, prof. as. dr. Arben Prendi në kumtesën e tij *Dante përmes disa konsideratave të shkrimtarëve bashkëkohorë* vuri në dukje se shkrimtarët e mëdhenj e kapërcejnë kohën në të cilën kanë krijuar e jetuar. Homeri, Eskili, Sofokliu, Euripidi, Virgjili, Dante, Servantes, Gëte etj., bëjnë pjesë tashmë në traditën e letërsisë

botërore dhe njëkohësisht janë bashkëkohorë. Jehona e veprës së Dante Aligierit vijon edhe përgjatë shekujve dhe këtë e tregojnë edhe vlerësimet e disa prej shkrimtarëve të rëndësishëm bashkëkohorë evropianë, si: Saint-John Perse, Ezra Paund, T. S. Eliot, Osip Mandelshtam, Jorge Luis Borges, Eugenio Montale, Jorgos Seferis, Seamus Heaney, Ismail Kadare etj.. Të gjithë i referohen Dantes si mjeshtër, duke vënë në pah përmes shkrimeve të tyre, universalitetin e veprës, rolin e saj në konsolidimin e gjuhës italiane, cilësitë poetike, filozofike, fetare të veprës *Komedia Hyjnore*.

Andreas Dushi (Student i masterit shkencor në Universitetin e Tiranës, redaktor i revistës “Ex Libris”) në kumtesën e tij *Historia dyshekullore e përkthimeve në gjuhën shqipe të Dante Alighierit* bëri një paraqitje të përkthimeve në gjuhën shqipe të *Komedisë Hyjnore*, duke nisur nga përkthimi i parë, nga Luigi Lorecchio në vitin 1896, për të vijuar pastaj me përkthimet e Sokol Baçit, Vinçens Prennushit, Ernest Koliqit, Pashko Gjeçit (që më 1960 e botoi të plotë *Komedinë*), Mark Ndoja, Mark Harapi, Çezar Kurti, Hektor Shënpremtë, deri tek Meritan Spahia, nën përkthimin e të cilit deri më tani është botuar “Ferri”.

Në mbyllje të konferencës, Dom Gjergj Meta, Ispeshkvi i Mirditës (Komisioni për Kulturën dhe mediat KISH) u shpreh se qëllimi i këtij aktiviteti ishte për të ndërtuar një kulturë të dialogut kulturor dhe ndërkulturor bashkë me universitetet. Koha po na thotë se asnjëri nga ne i vetëm nuk ka monopolin e kulturës, nuk ka monopolin e të vërtetës e të shkencës. I vetëm asnjëri nga ne nuk është i plotë, por vetëm bashkë ne mundemi të krijojmë një mozaik kulture. Bukur do të ishte që nesër pasnesër të mblidhemi për një poet të kulturës islame. Pa këtë dialog kulturor ne nuk mund të ecim, por bashkë të gjithë. Dhe Dante mund të jetë pikënisja.

Ndërmjet kumtesave, në kujdesin e pedagogut të Departamentit të Letërsisë dr. Gëzim Puka, u interpretuan disa prej këngëve të “*Komedisë Hyjnore*” të Dante Aligierit nga studentët: Desara Kerjota dhe Kamila Fjerza, studente e masterit profesional në Mësuesi në Gjuhë-Letërsi dhe Lazarino Pjetri, student në bachelor në Gazetari-Komunikim. Interpretimet e studentëve u pritën me interes dhe me duartrokitje nga të pranishmit në sallë. Aktiviteti u ndoq nga të pranishmit në sallë, por edhe online dhe u transmetua direkt nga televizionet lokale e kombëtare.

Departamenti i Letërsisë

GRADAT DHE TITUJT DHE E FITUAR

Qendra e Studimeve Albanologjike, pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, që ofron prej më shumë se 10 vitesh ciklin e tretë të studimeve Doktoraturë në “*Gjuhë shqipe*”, në vijim të punës së saj organizoi mbrojtje të doktoraturave :

- Më 18 qershor 2021, **doktorantja Arjola HOTI** realizoi mbrojtjen e disertacionit me titull “*Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shek XIX*”, me udhëheqës shkencor prof. dr. Tomor Osmani. Materiali i përcjellë nga doktorantja ngjalli mjaft interes dhe u vlerësua nga juria për punën skrupuloze të bërë nga vetë ajo, por edhe për kontributin e udhëheqësit shkencor prof. dr. Tomor Osmani.
- Më 10 shtator 2021, **doktorantja Blerina KRAJA** realizoi mbrojtjen e disertacionit me temë “*Sistemi foljor në përmbledhjen “Visaret e Kombit” (vëllimi II, Kângë kreshnikësh dhe Legjenda)*”, i realizuar nën udhëheqjen e prof. dr. Mimoza Priku. Puna serioze e doktorantes dhe mbështetja nga udhëheqësja e saj u vlerësuan nga ana e jurisë.

Urojmë dhe shpresojmë që të vijojmë të ecim në këtë rrugë, si dhe të kemi mbështetjen që ciklin e tretë të studimeve Doktoraturë në “*Gjuhë shqipe*” ta mbajmë të hapur, nisur nga serioziteti dhe përvoja që tashmë kemi krijuar në kërkim shkencor, si e vetmja njësi bazë pranë Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*” që ofron prej kaq vitesh një program të tillë studimi.

Gjithashtu, më 03 gusht 2020, **doktoranti Eduard NDRECA**, anëtar i departamentit të historisë ka fituar gradën shkencore “*Doktor*” pranë Universitetit të Tiranës.

Sipas objektivave të vendosura për kualifikimin e stafit akademik janë marrë titujt si më poshtë :

- Më 12 prill 2021, **prof. as. dr. Neritila LJARJA**, drejtore e departamentit të Historisë, fitoi titullin “*Profesor*” pranë Universitetit të Tiranës.
- Më 05 maj 2021, **dr. Medjon HYSENAJ**, anëtar i departamentit të Gjeografisë, fitoi titullin “*Profesor i asociuar*” pranë Universitetit të Tiranës.

Qendra e Studimeve Albanologjike


B O T I M E :

Gjatë këtij viti dolën nga shtypi këto vepra :

1. “*Letërshkëmbimi*”, At Gjergj Fishta OFM, përktheu prof. as. dr. Vinçens Marku, Biblioteka Françeskane, Shkodër, 2021.




2. “*Fatos Kongoli - contemporana I*”, studim, prof. as. dr. Arben Prendi, Shkodër, 2021, Bard Books.



3. “*Për romanin dhe romanet*”, eseistikë, doc. Ridvan Dibra, Shkodër, 2021, Bard Books.



4. “*Mbamendjet e mia*”, At Pierbatista Grumelli OFM, përktheu prof. as. dr. Vinçens Marku, Botimet françeskane, 2020.



5. “*Migrimi dhe ndryshimet e popullsisë në rajonin e Shkodrës*”, Bresena Kopliku, Shkodër, 2020, Fiorentia.



6. “*Qendrat shkencore të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në përvjetorin e 25*”, prof. dr. Artan Haxhi, prof. as. dr. Marash Rakaj, dr. Zamira Shkreli, Olimpia Kakarriqi, Universiteti i Shkodrës, 2020.



8. *“Tregues kronologjik i botimeve të pedagogëve të Universitetit të Shkodrës ‘Luigj Gurakuqi’”*, Olimpia Kakarriqi, Alida Luka, Endrina Tafili, Universiteti i Shkodrës, 2020.



ISSN 2221 - 6855

*Doli nga shtypi mars 2021 – tirazhi 120 kopje – Formati 176 x250 mm. Shtypur
në shtypshkronjën e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”*